



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI**  
**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**

**“BASHKIA RROGOZHINË”**

**Tiranë 2023**

## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMbledhje Ekzekutive.....</b>	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit .....	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	10
<b>II. Hyrja.....</b>	<b>12</b>
1. Objektivat e auditimit.....	12
2. Qëllimi i auditimit .....	13
3. Identifikimi i çështjes .....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	13
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	13
6. Kriteret e vlerësimit .....	14
7. Standardet e auditimit .....	14
8. Metodologjia e auditimit.....	15
9. Dokumentimi i auditimit .....	16
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>16</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Rrogozhinë.....	16
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	17
2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	17
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	24
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.....	66
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	98
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....	148
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit. ....	151
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit. ..	158
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .....	161
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>180</b>
<b>V. ANEKSET.....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektivi vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Rrogozhinë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën 01.11.2019 deri më 31.12.2022 për përputhshmërinë dhe 01.01.2022 deri më 31.12.2022 për anën financiare. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikën më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Rrogozhinë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Janë 21 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Rrogozhinë me 29 fatura në total të pa likuiduara “për investime”, vlera e të cilave është trashëguar në vitin 2023. Ndërsa “për mallra e shërbime” 24 subjekte me 49 fatura në vlerë totale 82,373,713 lekë;
- Llog. 218 “inventar ekonomik”, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si kategori më vete për të pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj dhe saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit;
- Në 9 raste lejet në sistemin e-leje, janë miratuar në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, duke evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e distancave ndërmjet ndërtimeve dhe pronave;
- Nuk janë aplikuar masa administrative për kundërvajtjet e kryera në fushën e mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, duke mos aplikuar vendimet për gjoba, pezullim dhe prishje të ndërtimeve pa leje;
- Detyrimi për abonentët familjarë është në vlerën **174,195 mijë lekë**, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën **25,557 mijë lekë**; për vitin 2022 detyrimi për taksa ndërtese, pastrim, gjelbërim, ndriçim është **19,973 mijë lekë**, ndërsa vlera progresive e detyrimit është **227,045 mijë lekë**;
- 8 procedura me vlerë të fondit limit **631,562 mijë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT;
- Ka diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **788,183 lekë pa Tvsh**.

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi rezultoi se janë 21 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Rrogozhinë me 29 fatura në total të pa likuiduara “për investime”, vlera e të cilave është trashëguar në vitin 2023 dhe “për mallra e shërbime” 24 subjekte me 49 fatura në vlerë totale 82,373,713 lekë; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve kreditore, Bashkia Rrogozhinë nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;</p> <p>Nga auditimi i PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”; kjo ka sjellë që likuiditeti i detyrimeve të prapambetura nga ana e bashkisë Rrogozhinë në raport me vlerën e detyrimit, të jetë i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, kjo pasi shoqërohet me lindjen e detyrimeve të reja për shkak të pamundësisë për pagesa nga mungesa e fondeve. (faqe 26-76 të RPA)</p>	E lartë	<p>Kryetari e Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.</p>
2	<p>Nga auditimi mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare, u konstatua se:</p> <p><b>1.</b> Nga analiza e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte inventarë të klasifikuara gabim, të cilat janë: me emërtimin makineri e pajisje në vlerën 74,063 lekë e cila duhej të ishte e regjistruar në llog. 214 “pajisje e makineri”; me emërtimin gjelbërim në vlerën 564,096 lekë duhej të ishte e regjistruar në llog. 212; me emërtimin riparim dyersh në vlerën 780,000 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; me emërtimin lulishte qendër –ura e mekeve në vlerën 790,922 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; në total vlera e regjistruar gabim në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është <u>2,209,081 lekë</u>. Pra llog.213 është mbivlerësuar në vlerën 2,209,081 lekë, llog.212 nënvlerësuar me 2,135,018 lekë dhe llog. 214 nënvlerësuar me 74,063 lekë;</p> <p><b>2.</b> Nga analiza e llog. 218 “inventar ekonomik” u konstatua se, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si kategori më vete për të pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj dhe saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit;</p> <p><b>3.</b> Nga analiza e llog. 401-408 rezulton se gjatë vitit 2022 janë 4 fatura të reja të pa likuiduara në kohë dhe që mbeten të paguhen për vitin pasardhës në vlerën totale 2,982,100 lekë, që iu përkasin 3 furnitorëve ekzistues. Ndërsa vlera e atyre të likuiduara është 12,817,950 lekë për 6 fatura që iu përkasin 6 furnitorëve. U konstatua një diferencë midis</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit Bashkia Rrogozhinë, të kryejë veprimet dhe sistemimet kontabël për diferencat, nënvlerësimet, mbivlerësimet në llogaritë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 466 “Mjete në ruajtje”, 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, 230-231, 218 “Inventar ekonomik”.</p> <p>Të hartohen dhe të miratohen Pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor Brenda afateve ligjore datë 31 Mars të vitit pasardhës; Të plotësohen me rigorozitet të gjitha pasqyrat sipas formateve të miratuara nga MFE.</p> <p>Të ndiqen me vëmendje pagesat e aktiveve në proces, që me likuidimin e vlerës së kontratës, të merren në dorëzim objekti i investimit dhe të bëhen veprimet kontabël për mbylljen e llog. 230-231 dhe kontabilizimin e vlerës së tij në llogarinë përkatëse të AAGJM.</p>

	<p>vlerës së llog. 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” pasqyruar në formatin 1 dhe analizës së kësaj llogarie dhe konkretisht: diferenca mes gjendjes në fillim në vlerën e 4,166,226 lekë dhe asaj në mbyllje të vitit me vlerën 5,002,307 lekë;</p> <p><b>4.</b> Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,729,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,471,672 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 335,126 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 nuk është pasqyruar. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar. Nga ditari i pagesave rezultoi se vlera e përbashkët e këtyre 2 llogarive është 1,796,119 lekë dhe që përbën 11.2% të pagës bruto [1.7% sig.shënd + 9.5% sig.shoq] të paguara nga punëdhënësi, u konstatua se vlera e llog. 436 nuk është pasqyruar më vete;</p> <p><b>5.</b> Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Rrogozhinë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 49,023,066 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 53,650,528 lekë; kjo llogari përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. U konstatua një diferencë mes vlerës së pasqyruar në format 1 dhe asaj në analizën e llogarisë prej 3,891,800 lekë më shumë, vlerë e cila mungon në analizën e llogarisë 466;</p> <p><b>6.</b> Llogaria 24 “Aktive te Qend. të trupëzuara të dëmtuara” në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 paraqitet me vlerën 0, ndërkohë që nga procedurat e inventarizimit janë vlerësuar të dëmtuara dhe për jashtë përdorimit inventare në vlerën 3,779,347.21 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 1,553,416.00 lekë për vitin 2022. Nga auditimi u konstatua se përderisa procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit nuk është realizuar për asnjë vit, këto vlera duhet të ishin pasqyruar në llog.24 “Aktive te Qend. të trupëzuara të dëmtuara” në pasqyrat format 1 dhe format 7/a,b;</p> <p><b>7.</b> Llogaria 600 “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 175,829,567 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “paga personeli i përhershëm”, “paga personeli i përkohshëm”, “shpërblime”, “shpenzime të tjera për personelin”. U konstatua se vlera e llogarisë 600 nuk është ndarë në 2 llogaritë respektive, për të pasqyruar vlerat përkatëse të llog. 6001 “paga personeli përhershëm” dhe llog. 6002 “paga personeli i përkohshëm; (faqe 76-113 të RPA)</p>		
3	<p>Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 9 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në <i>e-leje</i>, i kanë miratuar pa përmbushur dokumentacionin e rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me treguesit distancave ndërmjet ndërtimeve dhe pronave, në 1 rast konstatohet mos respektim i KSHT-së dhe intensitetit të ndërtimit. Në mënyrë të përhapur nga punonjësit e përfshirë në procesin</p>	E lartë	<p><b>1.</b> Drejtoria e Planifikimit Urban në procesin e miratimit për lejet e ndërtimit, të respektojë rregullat e zhvillimit të territorit kjo për të mundësuar trajtim të barabartë të parametrave teknik të zhvillimit, duke mos cenuar të drejtat e zhvillimit të subjekteve tjera sipas njësive strukturore.</p> <p><b>2.</b> Në mungesë të PDV-ve, të miratohen lejet e</p>

	e miratimit të lejeve, nuk është kërkuar Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës për objektet mbi 50m <sup>2</sup> . Janë miratuar leje ndërtimi në toka bujqësore me materiale të përhershme. Në 1 rast konstatohet përllogaritje e gabuar e sipërfaqeve totale të objektit. Në 2 raste planvendosjet e paraqitura nuk paraqesin gjendjen reale duke mos vendosur objektet kufitare. (faqe 179-187 të RPA)		ndërtimit vetëm kur subjekti zhvillues të jetë pajisur me lejen e zhvillimit. 3. Për të gjitha aplikimet për leje ndërtimi mbi 50 m <sup>2</sup> , të kërkohej në çdo rast Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës.
4	Nga auditimi për veprimtarinë e Inspektoratit të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, rezultoi se stafi i rekrutuar përfshirë Kryeinspektorin nuk kanë arsimin e duhur, duke mos dhënë garanci për një kontroll cilësor dhe efektiv të territorit. Konstatohet mos aplikim i masave administrative për kundërvajtjet e kryera, duke mos aplikuar vendimet për gjoba, pezullim dhe prishje të ndërtimeve pa leje. Mungojnë aktet e kontrollit për ndërtimet që kryhen me leje ndërtimi. Praktikrat e konstatuara nuk administrohen me dosje përkatëse si dhe nuk disponohen materiale provuese si fotografitë për evidentimin e situatave ndërtimore. Mungon korrespondenca 3 mujore me IKMT. Mungojnë planet e punës mujore dhe vjetore. Lidhur me gjobat e mbajtura, nuk është marrë asnjë masë për të bërë të mundur arkëtimin e tyre. (faqe 187-191 të RPA)	E lartë	1. Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. 2. IMT Bashkia Rrogozhinë, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës. 3. IMT Bashkia Rrogozhinë, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve. Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje. 4. IMT Bashkia Rrogozhinë, të disponojë të gjitha praktikrat në dosje të veçanta për secilin konstatim, duke u dokumentuar krahas akteve të mbajtura, edhe fotografitë për situatat e konstatuara të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes përkatëse.
5	Nga auditimi i të dhënave, rezulton se <i>më datën 31.12.2021</i> për mos pagesën e detyrimeve tatimore vlera debitore për abonentët familjarë është në vlerën <b>174,195 mijë lekë</b> , ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën <b>25,557 mijë lekë</b> ; <i>për vitin 2022</i> sipas rakordimit me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik detyrimi (për taksa ndërtese, pastrim, gjelbërim, ndriçim) është <b>19,973 mijë lekë</b> , ndërsa vlera progresive e detyrimit është <b>227,045 mijë lekë</b> . <u>Vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë</u> , nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. - Nga informacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ka një rritje në 3 vitet e fundit të numrit të debitorëve që nuk kanë paguar “taksën e ndërtesës” me 217 nga 2020 në 2021 dhe me 778 nga 2021 në 2022. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Rrogozhinë nuk disponon të dhëna mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave për familje në NjA Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj dhe Rrogozhinë, është <b>10,060 ha</b> e ndarë kjo sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas	E lartë	1. Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik /Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore progresive në vlerën totale 343,141 mijë lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon: - Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare. - Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme) - Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”. - Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me NjA, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë

<p>fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 70 datë 22.12.2021 (e rezultuar kjo edhe në paketën fiskale për vitin 2021), planifikimi i kësaj takse për vitin ushtrimor 2022 duhet të ishte në vlerën <b>35,734 mijë</b> lekë dhe jo në vlerën <b>25,942 mijë lekë</b> (sipas tabelës të plan/fakt të ardhurash), në fakt nga DAZHE Bashkia Rrogozhinë është realizuar në vlerën <b>21,540 mijë lekë</b>. Pra për dy vite radhazi planifikimi për të ardhurat nga toka bujqësore rezultoi në vlerë më të vogël <u>prej 9,792 mijë lekë</u> nga vlera e taksës që duhej të ishte llogaritur referuar kjo paketës fiskale 2021/2022 si dhe me trend në rënie nga viti 2021 në vitin 2022. Pra <u>vlera 9,792 mijë lekë është vlerë e pa përfshirë në vlerën e planifikuar të taksës së tokës bujqësore dhe konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.</u> - Nga auditimi rezultoi gjithashtu se, detyrimi i pa vjelë nga toka bujqësore deri në 31.12.2022, realizimi i vjeljes së taksës për vitin 2022 është (-) 4,402,327 lekë më pak nga planifikimi ose në masën 83%; Ndërsa deri në 31.12.2022 vlera e akumuluar e saj është për 7870 familjet debitore prej 9,623,461 lekë. Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se <u>për vitin 2020</u> për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 1226 subjekte në vlerën totale të detyrimit 29,145,411 lekë; <u>për vitin 2021</u> janë 1357 subjekte me vlerën totale të detyrimit 33,793,835 lekë; <u>për vitin 2022</u> janë 12918 debitorë në vlerën 26,643,829 lekë dhe me vlerë progresive deri më 31.12.2022 prej 154,675,658 lekë, <u>vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë;</u> Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB konstatohet se në bashkinë Rrogozhinë gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 22 subjekte. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregëtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua gjithashtu se vetëm 3 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të <u>VKM nr. 344, datë 19.04.2017</u> dhe kanë paguar rregullisht detyrimet në vlerën e 100,000 lekë secila dhe 300,000 lekë në total; 5 subjekte në vlerën <b>4,100,000</b> lekë të cilat nuk kanë paguar detyrimet si dhe kanë qenë të pa pajisura me autorizim, <u>vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë;</u> ndërsa 11 subjekte janë pajisur me autorizim 1 vjeçar të cilët kanë paguar detyrimet në total në vlerën 2,500,000 lekë, pajisja me autorizim për afatin 1 vjeçar është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15.</p>	<p>elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj.</p> <p><b>2.</b> Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 38,580,035 lekë dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Kavajë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p> <p><b>3.</b> DAZHE në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 5 subjekteve për arkëtimin e vlerës 4,100,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregëtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.</p> <p><b>4.</b> Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutivë, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën totale 5,700,000 lekë.</p>
--	--



	<p>Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Rrogozhinë janë vendosur 7 gjoba me vlerën në total 3,050,000 lekë; ndërsa bashkë me ato të vendosura në periudhat e mëparshme janë 15 gjoba në vlerën <b>5,700,000 lekë</b>, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që dhe nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre. Nga informacioni verbal i komunikuar, rezultoi se kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis IMTV dhe Drejtorisë Ligjore, për ndjekjen e hapave administrativë e ligjorë me qëllim arkëtimin e vlerës së gjobave nga ana e debitorit, duke mos e lënë në likuidimin vullnetar (si edhe na u komunikua nga bashkia Rrogozhinë), duke <u>sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 5,700,000 lekë. (faqe 26-76 të RPA)</u></p>		
6	<p>Nga auditimi i lejes së ndërtimit për zhvilluesin R. K. për objektin “Objekt banimi 1 Kat dhe 5 Kate dhe 1 Kat nëntokë, me funksion banimi dhe shërbimi, Spille “Bashkia Rrogozhinë”, rezultoi se përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është bërë e saktë. Sipas përlllogaritjes së zyrës së financës, R. K. duhet të paguaj 2,218,038 lekë, përlllogaritje e cila është bazuar në sipërfaqen totale të ndërtimit prej 2302.9 m<sup>2</sup> x 32105 lekë çmimi mesatar sipas Entit Kombëtar të Banesave x 3% TNI e përcaktuar në paketën fiskale = 2,218,038 lekë, ndërkohë në preventivin e paraqitur, vlera e investimit është 88,804,724 lekë x 3% = 2,664,141 lekë. Në mënyrë të paargumentuar, është ngarkuar një preventiv tjetër me vlerë me të vogël, e cila dukshëm ka ulur zërat e punimeve, ndërkohë nuk është reflektuar me ndryshime të projektit. Krahas uljes së volumeve të përcaktuara në preventivin fillestar, mungojnë edhe zëra të tjerë që duhet të parashikoheshin në preventiv si p.sh, parashikohet prishje e objektit 1 kat, zë i cili nuk është parashikuar, mungojnë zërat e transportit. Njëkohësisht, në preventiv është parashikuar që fasada lindore e objektit të jetë edhe me tulla xhami, fakt i cili nuk është parashikuar në preventiv. Sa më sipër, vendimmarrja e strukturave të ngarkuara për miratimin e lejes nuk ka evidentuar apo argumentuar mangësitë e mësipërme, duke miratuar lejen në kundërshtim me legjislacionin përkatës, si dhe duke shmangur minimalisht detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 446,103 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë. (faqe 179-187 të RPA)</p>	E lartë	Drejtorja e Planifikimit Urban, Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej <b>446,103 lekë</b> ndaj subjektit R. K. për taksën e ndikimit në infrastrukturë e cila është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës.
7	<p>Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, me vlerë të kontratës 109,882,338 (njëqind e tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë me Tvsh, me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, fituar nga BOE “B. B” Shpk &amp; “B. N” Shpk &amp; “M.” Shpk &amp; “P. V.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>93,600 lekë pa Tvsh</b>, në zërat e punimeve: Shtresë bindër me granil gurrkave, 6cm me makineri”, “Shtresë</p>	E lartë	Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>93,600 lekë pa Tvsh</b> nga BOE “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P. V.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

	asfaltobetoni me granil gur kave, 4cm me makineri”, “Puseta b/a shiu 40x60, h=100cm, me kapak gize.”, “F.V.Shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm”, “F.V. Krah shtylle KRH-MSI 1500/1500/10”, “Ndriçues Led 94Ë”, “F.V Morseteri shtylle 3P=sig, 16A+Kapak”, “F.V Elektroda tokëzimi”, “F.V. Puseta tokëzimi 40x40x40, kapak të fortë RIC1084+1064”, “F.V Tabela rrugore rë ndryshme D=90cm”. (faqe 176-179 të RPA)		
8	Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia Rrogozhinë, me vlerë të kontratës 43,585,255 (dyzetë e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë lekë pa Tvsh, me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021, fituar nga BOE “B.” Shpk, & “Sh.” Shpk BOE “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P. V.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>694,583 lekë pa Tvsh</b> , në zërat e punimeve: “F V dritare d/alumini plastike me dopioxham”, “F V Vetrare d/alumini plastike me dopioxham”, “Ulluk shkarkimi vertikal me baker Ø 120”, “F.V Elektroda tokëzimi të xinguara 50x3mm, L=150cm”, “Përcjellës tokëzimi bakri, Cu, S=50mm <sup>2</sup> i zhveshur”, “Kapikorta bakri 1x50mm <sup>2</sup> ”, “F.V Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm”, “Përcjellës shirit zinku tokëzimi, Zn =30x3mm”, “Shtizë rrufepritëse në çati L=38 D=166mm së bashku me aksesorët e fiksimit”, “Fiksues të zinkuar shirit-shirit 30x3mm” e “Gërmim e mbushje dheu me krah për kanale kategoria IV, h=1.5 m”. (faqe 176-179 të RPA)	E lartë	Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>694,583 lekë pa Tvsh</b> nga BOE “B.” Shpk, & “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021, me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
9	Nga auditimin e 8 procedurave me vlerë të fondit limit <b>631,562 mijë</b> , janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP në 8 procedura me vlerë kontrate <b>627,332 mijë lekë</b> ose 99 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën <b>627,332 mijë lekë</b> . (faqe 113-176 të RPA)	E lartë	Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masat për hartimin e kriterëve teknike në dokumentet e tenderit, të argumentuara dhe në përputhje me objektin e kontratës dhe të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomicitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën <b>627,332 lekë pa Tvsh</b> .

### 3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit OPINIONI I AUDITIMIT

#### I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Rrogozhinë më 31 dhjetor 2022, referuar Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit; Ligjit “Për Kontabilitetin”; Ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimeve të MF mbi përgatitjen e

pasqyrave financiare vjetore, etj. mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare, si rezultat shprehim ”Opinionit të pamodifikuar” për pasqyrat financiare.

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu në dhënien e opinionin ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 30,076,920 lekë mbështetur në: pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare.

#### **Theksimi i çështjeve:**

- Gjendja e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” e cila është mbivlerësuar në vlerën 2,209,081 lekë, shumë e cila llog.212 e ka nënvlerësuar me 2,135,018 lekë dhe llog. 214 nënvlerësuar me 74,063 lekë;
- Gjendja e llog. 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” pasqyruar në formatin 1 dhe analizës së kësaj llogarie për diferencën 836,081 lekë, mes gjendjes në fillim në vlerën e 4,166,226 lekë dhe asaj në mbyllje të vitit me vlerën 5,002,307 lekë;
- Gjendja e llog. 466 “mjete në ruajtje” të cilës i duhet saktësuar dhe sistemuar diferenca mes vlerës së pasqyruar në format 1 dhe asaj në analizën e llogarisë prej 3,891,800 lekë më shumë, vlerë e cila mungon në analizën e llogarisë 466;
- Bashkia Rrogozhinë vazhdon të mos ketë hartuar dhe miratuar regjistrin e aktiveve të njësisë, aktivet nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie, nuk është kryer rivlerësimi i tyre dhe për pasojë ka mos regjistrimin në vlera reale të AAGJM në llogaritë përkatëse 210, 211, 212, dhe 215;
- Gjendja e Llog 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në të cilën nuk paraqiten vlerat e aktiveve të vlerësuar nga komisionet e vlerësimit të inventarëve për dalje jashtë përdorimit/asgjësimit, për aq kohë sa nuk është realizuar procedura e asgjësimit të tyre.

#### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Rrogozhinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2019-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Rrogozhinë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar për përputhshmërinë.

#### **Baza për dhënien e opinionit të modifikuar**

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza P”, me vlerë të kontratës 109,882,338 lekë rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **93,600 lekë** pa Tvsh.
- Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë”, me vlerë të kontratës 43,585,255 lekë rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **694,583 lekë** pa Tvsh
- Nga auditimin e 8 procedurave me vlerë të fondit limit 631,562 mijë lekë janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 8 procedura me vlerë kontrate 627,332 mijë lekë ose 99 % e vlerës së kontratave të lidhura. Në këto procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues,

nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e Prokurimit Publik për vlerën 627,332 mijë lekë.

- Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve konstatohet se detyrimet që subjekteve fizikë/juridikë kanë për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 janë në vlerën progresive **343,141 mijë lekë**;

- Detyrime nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje **38,580,035 lekë**;

- Detyrime krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre **4,100,000 lekë**;

### **Përgjegjësitë e drejtuesve të Bashkisë Rrogozhinë.**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Rrogozhinë.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së.**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 203/1 Prot., datë 10.03.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar me shkresën nr. 203/2 Prot., datë 12.04.2023 nga data 13.03.2023 deri në datë 05.05.2023, në subjektin Bashkia Rrogozhinë u krye Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.11.2019-31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhet nga audituesit:

1. G. K. – *Përgjegjës Grupi*
2. S. J. – *Anëtar*
3. Sh. H. – *Anëtar*
4. A. D. – *Anëtar*
5. S. A. – *Anëtar*

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Rrogozhinë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>1</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

## **2. Qëllimi i auditimit**

Objekti i auditimit financiar në Bashkinë Rrogozhinë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

## **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Rrogozhinë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.11.2019-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

## **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Rrogozhinë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

## **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

## 6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Rrogozhinë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Rrogozhinë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Etj.

## 7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Rrogozhinë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e për zgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Rrogozhinë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

#### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>2</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për për llogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

---

<sup>2</sup>ISSAI 1315

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>3</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## 9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Rrogozhinë

*Zona Gjeografike:* Rrogozhina kufizohet në Veri me Bashkinë Kavajë, në veri-lindje me Bashkinë Tiranë, në Jug me Bashkinë Lushnje, në Lindje me Bashkinë Peqin dhe në Perëndim me detin Adriatik. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Rrogozhinës.

*Popullsia:* Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia numëron 22,148 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 40,684 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 223.5 km<sup>2</sup>. Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 182 banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas censurit, densiteti është 99 banorë/km<sup>2</sup>.

*Bashkia Rrogozhinë* përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Rrogozhinë, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë. Të gjitha NjA janë aktualisht pjesë e rrethit të Kavajës dhe Qarkut të Tiranës. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra.

*Profili i bashkisë:* Bashkia e Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe pjesërisht fushor deri në bregun e detit. NjA rurale përbërëse të bashkisë kanë lidhje të kufizuara me qendrën e saj. Qyteti i Rrogozhinës zë rreth një të tretën e të gjithë popullsisë banuese të bashkisë. Dy komunat bregdetare, Gosa dhe Kryevidhi, kanë mundësi të zhvillojnë turizmin. Bashkia përfshin edhe zona të rëndësishme bujqësore, të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje të infrastrukturës rurale, sidomos lidhur me sistemet vaditëse dhe kanalet kulluese.

<sup>3</sup>Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit



Aktualisht bashkia përfshin 20 kilometër vijë bregdetare. Hartimi i planeve të duhura zhvillimore, të shoqëruara me investimet e përshtatshme për rrugë, kanalizime, ndriçim dhe ujë të pijshëm ofron një mundësi për rritjen e të ardhurave të bashkisë së re, por përbën njëkohësisht edhe një sfidë për shkak se burimet aktuale buxhetore të Rrogozhinës dhe njësive administrative janë shumë të kufizuara. Gjithashtu, infrastruktura rrugore drejt bregut të detit në ish-komunat Gosë dhe Kryevidh kanë ende nevojë për shumë investime.

*Misioni i Bashkisë Rrogozhinë:* Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin). Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”. Ndërsa administrata (aparati) e këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

## **2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Rrogozhinë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

**Titulli i gjetjes 1:** Në Bashkinë Rrogozhinë ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.

#### **Situata:**

##### **1. Mjedisi i kontrollit**

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

##### **a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;**

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se ‘Kudri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje’. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Rrogozhinë disponon Kod Etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës është veç rregullores së brendshme si dhe Institucioni ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

**b) Politikat menaxheriale dhe stili i punës;**

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Titullarët e njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*’. Për sa më sipër rezulton se Bashkia Rrogozhinë ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se ‘*Titullarët e njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*’. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se ‘*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave*’. Grupit të auditimit i është paraqitur një urdhër: Urdhri nr.112, datë 27.04.2022 ‘Për ngritjen dhe riformatimin e Grupit të menaxhimit strategjik’ GMS.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se ‘*GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike*’. Për sa më sipër, për periudhën 2022 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës*’. Titullari nuk ka caktuar koordinatorin e riskut për Bashkinë Rrogozhinë.

**c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;**

Bashkia Rrogozhinë e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 5311, datë 06.12.2019 ‘*Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Rrogozhinë dhe institucioneve në varësi*’. Kjo rregullore është e përditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo bën të mundur kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.

Bashkia Rrogozhinë disponon disa përkrahje pune, këto kanë datë se kur janë bërë, gjithashtu edhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ‘*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*’ në të cilin përcaktohet se ‘*Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatës*’. Gjithashtu, këto përkrahje pune janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të Vendimit nr. 142, datë

12.3.2014 'Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore: a) miraton propozimin për klasifikim të pozicionit/pozicioneve të punës; b) kthen për rivlerësim pozicionin/pozicionet e punës dhe vendos një afat të arsyeshëm për plotësimin e rivlerësimit'.

Kompetencat e nëpunësit zbatues aktualisht kryhen nga znj. R. V., i cili caktohet nga urdhri nr.9748/1. Prot., datë 01.07.2021, Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimit Social në Bashkinë Rrogozhinë. Nëpunësi zbatues ka një sërë detyrash dhe përgjegjësish dhe jo vetëm firmën e dytë për llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve për institucionin. Me shkresën nr.243/1 prot., datë 20.01.2021, përcaktohet nëpunësi autorizues z. E. M..

**ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;**

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil' 'Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit'. Gjithashtu, Bashkia Rrogozhinë nuk disponon një program trajnimi për punonjësit.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Rrogozhine është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2022 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. R. V. i emëruar me urdhër nr. 141 datë 31.5.2021 dhe nga specialistja e pagave.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. R. V. dhe nga Kryetari Bashkisë; z. E. M.

Sa me sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil' 'Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit'.

➤ **Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Rrogozhinë.**

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve (të detyrueshëm dhe fakultativ) ofruar nga ASPA nëpërmjet Platformës ZOOM, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, Auditi i Brendshëm etj. Por nga Bashkia e Rrogozhinë nuk rezultojnë të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria e burimeve njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

**Konstatohet se** nga Sektori i Burimeve Njerëzore në bashkinë Rrogozhinë nuk janë hartuar plane / programe vjetore për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato, në kundërshtim me Ligjin nr.

10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

## **2. Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.”* Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Rrogozhinë nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296. *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se; “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Bashkia Rrogozhinë nuk disponon asnjë procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Bashkia Rrogozhinë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar’ ku përcaktohet se: *“Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.*

## **3. Veprimtaritë e kontrollit**

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Rrogozhinë, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsisë dhe nxjerrjen e përgjegjësive. Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se: *“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.* Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Rrogozhinë për vitet 2022 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

## **4. Informacioni dhe komunikimi**

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t’i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Rrogozhinë, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

## **5. Monitorimi**

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësive publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsisë dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësive që drejtojnë”. Për sa më sipër, nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Rrogozhinë mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paqaritet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Rrogozhinë nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimit të tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Nëpunësi autorizues i njësive publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësive publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësive publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual”. Për sa më sipër, për vitin 2022 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Rrogozhinë, ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në përputhje me nenin 18 të ligjit për MFK-në, me nr. e 3470 prot., datë 22.02.2022

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 20, 21.

**Shkaku:** Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e strategjisë së riskut si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

**Ndikimi:** Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësive.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

- Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive.

## Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm

### Titulli i gjetjes 2: Mos funksionim si duhet i Njesisë së Auditit të Brendshëm

**Situata:** Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është miratuar me urdhër të kryetarit të Bashkisë nr.102 prot datë 20.04.2022 me përbërje sipas strukturës 1 përgjegjës dhe 2 inspektorë. Për vitin 2022 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 përgjegjës dhe 2 inspektor. Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë e Rrogozhinë është e organizuar si Njësi në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë .

-Struktura e personelit të Njesisë është:

- ❖ Ekonomist 1 përgjegjës sektori.
- ❖ Ekonomistë 2 specialist.

Përgjegjësi i sektorit është në proces certifikimi kurse dy punonjësit e sektorit të AB nuk janë të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik“.

Njësia e AB në Bashkinë Rrogozhinë mbulon me auditim 21 subjekte nga ku 4 janë njësi *Administrative*:

1. Njësia Administrative Gosë
2. Njësia Administrative Kryevdhë
3. Njësia Administrative Sineballaj
4. Njësia Administrative Lekaj, si dhe

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social ,Drejtoria politike urbane ,Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun Drejtoria E Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve Kullimit e Vaditjes Drejtoria e Arsimit/Sportit, Kulturës, Turizmit Policia Bashkiake Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendorë(IMTV) Mbrojtja Ndaj Zjarrit (MZSH) Zyra e Regjistrimit të Bizneseve (QKB) Njësia e Prokurimit Publik Futboll Klub Egnatia Arsimi parashkollor Biblioteka Zyra gjendjes Civile dhe Ujësjellës Kanalizime SH.A.

#### ➤ *Komiteti i Auditit të Brendshëm:*

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në *kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”* i cili përcakton se :*“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

- a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
  - b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
  - c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
  - ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
  - d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
  - dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

### 2- Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm viti 2022;

Me shkresë nr. 4146, datë 11.10.2022, është dërguar Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së NJAB, për Bashkinë Rrogozhinë për vitet 2023 – 2025, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit e Brendshëm.

Me shkresë nr. 611, datë 13.02.2023, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Rrogozhinë për vitin 2022, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit e Brendshëm.

-Plani Strategjik për periudhën 2021 – 2021, përbëhet nga :

Pasqyra Nr.1- Të dhëna për Burimet Njerëzore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022.

Pasqyra Nr.2 –Realizimi i Planit të Angazhimeve nga NJAB për vitin 2022.

Pasqyra Nr.3- Përmbledhëse e gjetjeve me dëm ekonomik nga Angazhimet e auditimit për vitin 2022.

Pasqyra Nr.4 –Përmbledhëse e parregullive të identifikuar sipas sistemeve për vitin 2022.

Pasqyra Nr.5 – Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2022.

Pasqyra Nr.6 – Çështjet e dërguara për investigim për vitin 2022.

Në planin vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar në vitin 2022, gjithsej 9 Auditime.

### Planifikimi dhe realizimi 2022

Nr	Planifikimi 2022	Realizimi 2022
<b>a.</b>	<b>1</b>	
1	Drejtoria e Financave	Drejtoria e Financave
2	Ujësjetllës Kanalizime SH.A	
3	Mrojtja ndaj zjarrit MZSH	
4	Drejtoria E Bujqësisë, Pyjeve Kullimit e Vadiçjes	
5	Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetse	Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetse
6	Drejtoria Juridike	
7	(IMTV) Inspektorati Territorit Vendore	
8	Policia Bashkiake	
9	Drejtoria e Burimeve Njerzore	

Burimi: DAB

Për periudhën raportuese janë realizuar gjithsej 2 angazhime nga 9 angazhime të planifikuara, ose 22% e planit. Referuar Raporteve të Auditimit për çdo angazhim janë identifikuar **gjithsej 17 parregullsi**. Për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar plani i auditimit, si pasojë e mungesës së punonjësve me eksperiencë dhe mungesës së njohurive të duhura për të realizuar 9 auditime brenda kësaj periudhe.

#### ➤ *Dosjet e audituara për vitin 2022*

1. Programi i Angazhimit me nr.4206/2 , datë 13.10.2022, për Drejtorin Shërbimeve Mbështetëse

2. Programi nr.2114 datë 16/05/2022, për Drejtorinë e Financave.

#### ➤ *Nisur nga sa më sipër, grupi audituesve, ka konstatuar si më poshtë vijon:*

-Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2022 janë audituar 2 dosje të realizuara në, në subjektet e lartpërmenduar, ku rezulton se nga, NJAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ nuk janë korrekte, pra ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm. Në përgjithësi nga NJAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm . Nga auditimi u konstatua se janë respektuar afatet.

Nga auditimi u konstatua se në dosje nuk ka plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit e cila plotësohet nga njësia publike e audituar si dhe e miratuar nga titullari jo me vone se 20 dite pune pasi subjekti njihet me raportin përfundimtar, i dërguar njësisë, në kundërshtim kjo me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për vitin 2022, në Bashkinë Rrogozhinë, nuk është kryer Zbatimi i Rekomandimeve (detyrat e lëna), të vitit paraardhës, apo të 6-mujorit paraardhës nga sektori i Auditit. Gjithashtu, nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në këtë bashki.

Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Rrogozhinë, nuk ka një vlerësim të riskut, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit.

**Kriteri:** Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10, germa “c” e VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Krieteve të Krijimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik si dhe neni 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1),

**Shkaku:** Mungesë e kapaciteteve për kryerjen e gjitha angazhimeve, neglizhenca e drejtuesit për plotësimin e Strukturës Organizative të Auditit të Brendshëm.

**Ndikimi:** Nuk jep garanci në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Rrogozhinë.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për trajnimin e punonjësve të NJAB konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke marrë masa për certifikimin e audituesve të pa certifikuar.

- Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Rrogozhinë

## 2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

### 1. Programimi PBA-së dhe i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, i cili për periudhën nën auditim rezulton me Urdhër nr. 112 datë 27.04.2022 dhe shkresën nr. 1801 prot., datë 27.04.2022. Nga auditimi i dokumentacionit dhe i Urdhrit për ngritjen e GMS, **u konstatua** se nuk janë ngritur dhe miratuar Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për Bashkinë Rrogozhinë në moszbatim të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 i ndryshuar me atë nr. 108 datë 17.11.2016. EMP përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial në procesin e planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ku fokusohen në dy çështje kryesore: *së pari*, roli i ri i stafeve teknike në procesin buxhetor (përgatitja e PBA); dhe *së dyti*, aspektet konceptuale të programeve buxhetore, definimi i qëllimeve të politikave që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-së, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si edhe treguesit përkatës të performancës.

Një shpërndarje e programeve buxhetore për vitin 2022 sipas funksioneve/nën funksioneve që NNJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuuar me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pasqyrohen në Aneksin nr. 1 bashkëlidhur.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se ka funksione/nënfunksiione të cilat nuk kanë asnjë program buxhetimi, si: F- “në fushën e mbrojtjes së mjedisit”, N/f- “Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, “Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara”, “Ndërtimin, reH.timin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik”, “Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë”, “shtimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të pyllëzuara” etj. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimit ndaj komunitetit dhe territorit që mbulon bashkia Rrogozhinë.

*Në mijë lekë*

Nr. i kodit	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti Plan	2022 Fakt
01	1110 - Planifikim Menaxhim Administrim	343,868	241,140
01	3280 - Emergjencat Civile dhe Shërbimet e Mbrojtjes nga Zjarri	23,308	14,754
01	4240 - Ujitja dhe Kullimi	13,699	9,558



Nr. i kodit	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2022	
		Plan	Fakt
01	4260 - Administrim i Pyjeve dhe Kullotave	1,686	1,393
01	4520 - Rrjeti Rrugor Rural	2,716	
01	4960 – Fondi i Rindertimit	125,681	125,670
01	5100 - Menaxhimi Mbetjeve	15,300	
01	6190 - Fondi i Financimit te Rikonstruksionit te Njësive Individuale te Ndërtimit	575,603	229,641
01	6260 - Shërbimet Publike Vendore	96,020	79,407
01	8140 – Sporti dhe Argëtimi	4,930	4,051
01	8230 – Trashëgimia Kulturore, Evente dhe Kultura	8,581	6,484
01/05	9120 - Arsimi parashkollor dhe 9 Vjeçar	61,033	52,131
01	9230 - Arsimi Mesëm dhe i Përgjithshëm	2,503	2,198
	1170 - Gjendja Civile	3,523	3,382
	6370 - Ujësullës Kanalizime	90,716	90,716
	4130 - QKB	750	469
	1620 - K.Q.Z	2,028	1,960
	10430 - PAK&Ndihme Ekonomike	147,225	145,873
	<b>17</b>	<b>1,503,846</b>	<b>1,008,867</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE/Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore”, Udhëzimi i MFE për PBA-në nr. 07 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, VKB nr. 70 datë 22.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale 2022”. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

*Në mijë lekë*

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2022	
	Plan	Fakt
600	176,393	173,638
601	31,804	28,971
602	176,817	141,000
230-231	356,095	278,858
606	762,737	386,399
Mj. në ruajtje 466	56,129	53,651

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Është bërë analiza e pagave dhe është llogaritur pesha specifike e këtyre llogarive (600-601) të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve, nga ku rezulton se 208,197 (176,393 + 31,804) mijë lekë ose 13.9% në vitin 2022.

#### ➤ Mbi konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se Bashkia Rrogozhinë për PBA 2022-2024 dhe Projekt buxhetin e vitit 2022, nuk ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2022-2024 dhe Projekt buxheti vjetor 2022 nga ana e bashkisë Rrogozhinë është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun; Kjo pasi

nuk ka asnjë informacion të dokumentuar (shkresor apo elektronik) ku të vërtetohet realizimi i procesit konsultativ me komunitetin: njoftimi zyrtar në stenda, ëeb-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave të njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj. Kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” Kreu IV, neni 11-20;

**Konstatim:** Për prezantimin e PBA 2022-2024/ Projekt Buxheti Vjetor 2022 në komunitet dhe grupet e interesit, nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk është zhvilluar asnjë takim me komunitetin (me prezencë apo në platforma on line), në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave nga 5 (pesë) NjA: Rrogozhinë, Gosë, Lekaj, Kryevidh, Sinaballaj; drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm, janë përzgjedhur ato më prioritare.

*Në mijë lekë*

Njësi Administrative	PBA 2022-2024/ Plani Buxhetit 2022
	Vlera
NJQ-Rrogozhinë	<b>1,503,846</b>
NJA Gosë	
NJA Lekaj	
NJA Kryevidh	
NJA Sinaballaj	

*Punoi: Grupi i auditimit*

Nga auditimi rezultoi se në PBA-në 2022-2024 dhe Planin vjetor të buxhetit për vitin 2022, nuk janë shprehur qartë objektivat strategjikë të bashkisë, të cilat mbështetur në PPV<sup>4</sup> dhe PZHS<sup>5</sup>, bëhen planifikime buxhetore për ato programe të cilësuar si më prioritaret me projektet përkatëse. **U konstatua** se në PBA 2022-2024 dhe Planin e buxhetit vjetor 2022 nuk janë paraqitur projektet e planifikuara për buxhetim me këto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në moszbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2022 kanë qenë në proces këto projekte: - Projekte të filluara në vitin 2021 – “Shkolla Lekaj” me fondin 171,981,080 lekë; Shkolla “Qamil Gjuzi” me fondin 135,057,290 lekë; “Ujësjetllësi Gosë” me fondin 191,575,784 lekë dhe “Ujësjetllës Lekaj” 298,991,676 lekë; - Projekte të filluara në vitin 2022 “Sistemim Asfaltim rruga Shardushk pjec-Kryevidh” me fondin 13,002,320 lekë.

Nga auditimi rezultoi se në vitin 2022 janë paguar për projektet e “ujësjetllësit” 13 fatura në vlerë totale 87,420,954 lekë (fatura edhe të vitit 2021) që përbën 18% të vlerës totale të projekteve; për projektet “rikonstruksion shkollë” janë paguar 7 fatura në vlerë totale 125,988,068 lekë që përbën 41% të vlerës totale të projekteve;

PBA dhe Buxheti vjetor për vitin 2022, kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në KB si më poshtë:

Nr.	PBA 2022-2024	P.Buxheti 2022
1.	VKB nr.71 datë 22.12.2021	VKB nr.72 datë 22.12.2021
2.		VKB nr. 32 datë 07/07/2022
3		VKB nr. 44 datë 15.08.2022
4		VKB nr. 70 datë 15.12.2022
	<b>1</b>	<b>4</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

<sup>4</sup> Plani i Përgjithshëm Vendor

<sup>5</sup> Plani i Zhvillimit Strategjik

- a. Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë hartuar e miratuar “Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor” për bashkinë Rrogozhinë dhe njësisë të varësisë për vitin 2022, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave

buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

- b. PBA 2022-2024 është miratuar me VKB nr. 71, datë 22.12.2021 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2022 me VKB nr. 72 dt. 22.12.2021; është miratuar buxheti shtesë për vitin 2022, me fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm 2021. Buxheti fillestar për vitin 2022 ka pësuar 3 ndryshime, i cili është miratuar sipas VKB-ve për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh në buxhet, të pasqyruara në tabelën e mësipërme dhe konkretisht: VKB nr. 32 datë 07.07.2022 “Për rishpërndarje fondesh buxhetore me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”; VKB nr. 44 datë 15.08.2022 “Për miratimin e ndryshimeve në buxhetin e vitit 2022 të Bashkisë Rrogozhinë” dhe VKB nr. 70 datë 15.12.2022 “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

VKB nr. 32 datë 07.07.2022

*mijë lekë*

	Emërtimi	Artikulli	Llog. ekonomike	Vlera
<b>pakësohet</b>	00/5100/01	602	6029099	15,300,000
<b>shtohet</b>	00/6260/01	602	6020009	15,300,000
<b>Totali</b>				<b>15,300,000</b>

VKB nr. 44 datë 15.08.2022

	Emërtimi	Artikulli	Llog. ekonomike	Vlera
<b>pakësohet</b>	00/1100/05	602	6022099	5,000,000
<b>shtohet</b>	00/6260/05	602	6020009	5,000,000
<b>pakësohet</b>	00/1100/05	231	231000	13,000,000
<b>shtohet</b>	00/6260/05	602	6020009	13,000,000
<b>Totali</b>				<b>18,000,000</b>

VKB nr. 70 datë 15.12.2022

Nr	Emërtimi	Artikulli	Llog. ekonomike	Vlera
<b>1</b>	00/1110/01	231	2310000	15,000,000
<b>2</b>	00/1110/01	602	6020000	3,619,000
<b>3</b>	00/6260/01	602	6020009	3,000,000
<b>Totali</b>				<b>21,619,000</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 me VKB, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitulli, artikulli e vlerës, por **u konstatua** se transferimet/lëvizjet e ndryshme të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor kanë qenë në funksion të [llog ekonomike 6020009] llogari e cila i takon transportit të mbetjeve dhe nuk janë shoqëruar me argumentimet e nevojshme si dhe për nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Për sa më sipër nuk janë zbatuar kërkesat e akteve ligjore/nënligjore të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

- c. VKB për miratimin e PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022 nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të Bashkisë Rrogozhinë, në moszbatim të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” neni 23, 24; “Norma Tekniko-Profesionale Dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13 dhe neni 19 dhe Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”.

d. VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Tiranë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Kavajë në zbatim të afateve ligjore.

**Konstatim: 1.** Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë miratuar “Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Planit vjetor të Buxhetit 2022 për bashkinë Rrogozhinë dhe njësitë e Varësisë” në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

**2.** Nga Bashkia Rrogozhinë, PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit 2022 nuk janë hartuar/miratuar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

**3.** Ndryshimet e bëra në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 miratuar me VKB përkatëse, nuk janë shoqëruar me argumentimet përkatëse lidhur me rishpërndarjen apo lëvizjen e fondeve nga një artikull në tjetrin apo dhe më kryesorja nga një program në tjetrin, në moszbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

**Planifikimet sipas PBA-së me ndryshimet:**

*në mijë lekë*

Emërtimi	PBA 2022-2024		Buxheti 2022 (progresiv)	
	Ardh.	Shpenz.	Ardh.	Shpenz.
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	8,737		28,266	
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	17,795		25,838	
Trashëguar nga Transferta specifike	11,988		11,673	
Plani i të ardhurave viti ushtrimor	156,947		243,517	
Granti	609,639		957,084	
Transferta specifike	73,724		73,033	
Paga (600)		164,737		176,393
Sigurime shoqërore (601)		38,029		31,804
Shpenzime operative (602)		169,692		176,817
Transferta (604+606+609) Fondi Rezervë		97,779		184,266
Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtëzuara		334,868		356,095
Investime nga FZHR e M. Linjës		0		0
Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)		0		578,471
<b>Totali</b>	<b>805,106</b>	<b>805,106</b>	<b>1,503,846</b>	<b>1,503,846</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Të dhënat në tabelë janë për aparatin e bashkisë Rrogozhinë së bashku me NjA.

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se Bashkia Rrogozhinë ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 16.2% të shpenzimeve *për vitin 2022*. Ndërkohë që nga tabela rezulton se të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës janë 28,266 mijë lekë.

*në mijë lekë*

Nr	Burimet e Financimit	Viti 2022		Realizimi
		Plan	Fakt	
1	Buxheti i pakushtëzuar	948,238	571,156	60.2%
2	Buxheti i kushtëzuar	283,825	281,985	99.3%
3	Te ardhurat e veta	271,783	155,725	57.3%
	<b>Totali</b>	<b>1,503,846</b>	<b>1,008,866</b>	<b>67.1%</b>

Kështu shpenzimet me burim të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar: *për vitin 2022* në vlerën 271,783 mijë lekë; në fakt janë shpenzuar në vlerën 155,755 mijë lekë ose 57,3%; Nga fondet e pakushtëzuara janë shpenzuar 60.2% e atyre të planifikuara; si dhe nga fondet e “pakushtëzuara” janë shpenzuar rreth 99.3% të fondit të planifikuar.

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, rezulton se të ardhurat e shpenzimeve të planifikuara janë:

Ndërsa buxheti fillestar *për vitin 2022* është planifikuar në vlerën e 492,477 mijë lekë dhe me fondet e trashëguara nga viti 2021 prej 39,229 mijë lekë dhe transfertave të pakushtëzuara arrin në vlerën e

1,503,846 mijë lekë (plani progresiv) ose 1,011,369 mijë lekë më shumë dhe realizimi i tij në vlerën e 1,008,866mijë lekë.

Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa “dh” të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Rrogozhinë.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600 + 601) (nga të ardhur e grant i pakushtëzuar e specifike)	208,197	202,766	5,431
2	Shpenzime (602, 604, 609) (nga ardhura e grant i pakushtëzuar e specifike)	939,554	267,471	672,083
3	Investime Bashkia (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar)	356,095	334,868	21,227
4	Investime nga FZSH			0
	<b>Total i planit fillestar</b>	<b>1,503,846</b>	<b>805,106</b>	<b>698,740</b>
	Shtesat nga Pushteti Qendror		0	0
5	Investime grant i kushtëzuar		0	0
6	Shpenzime për pagat (600 + 601)		0	0
7	Shpenzime (602, 604, 609)	772,088	0	772,088
	Grant i kushtëzuar (230-231)	15,000	0	15,000
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,503,846</b>	<b>805,106</b>	<b>698,740</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2022 si më poshtë:

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022			Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022				në mijë lekë
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 71, datë 14.12.2021	Buxheti shtesë me VKB dhe shtesa nga pushteti Qendror	Vlera	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.71 datë 14.12.2021	Buxheti shtesë miratuar me VKB dhe shtesa nga pushteti Qendror	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	238,337			Paga + sigurime(600+601) =64,945 Shpenzime(602.604.609) = 95,842 dhe Investime = 77,550	238,337	0	238,337
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për	28,266			Shpenzime (602) = 17,266 Investime (231)= 10,500	28,266	0	28,266

shpenzim për vitin 2022								
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>266,603</b>				<b>266,603</b>	<b>0</b>	<b>266,603</b>	
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	3,099			Shpenzime (600=	3,099	0	3,099	
Të ardhura të trashëguara nga transferata specifike	11,988			Shpenzime (600,601)	11,988	0	11,988	
Transferata e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022	163,325	992,590		Paga + sigurime =56,696 Shpenzime (602.604.609)=72,723 dhe Investime = 33,906	163,325	992,590	1,155,915	
Transferata specifike e çelur për llogari të vitit 2022	66,244			Paga + sigurime = 66,244	66,244	0	66,244	
<b>Total të ardhurat nga transferata të buxhetit të shtetit</b>	<b>284,634</b>				<b>284,634</b>	<b>992,590</b>	<b>1,277,224</b>	
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>511,256</b>	<b>992,590</b>	<b>1,503,849</b>	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>511,256</b>	<b>992,590</b>	<b>1,503,849</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë

## 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Në mijë lekë

Bashkia Rrogozhinë së bashku me njësitë vartëse. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar. Viti 2022. Në 000/lekë									
Art	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	5	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit para ardhës Viti 2021	PBA Plan Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022 (VKB .71, datë 22/12/.2021)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022 VKB	Plani çelur ne thesar Viti 2022	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	165,376		166,048	176,393		173,638	2,755	98
601	Sigurime Shoqërore	28,157		30,823	31,804		28,971	2,833	91
<b>600+601</b>	<b>Paga +Sigurime</b>	<b>193,533</b>	<b>198,689</b>	<b>196,871</b>	<b>208,197</b>		<b>202,609</b>	<b>5,588</b>	<b>97</b>
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	111,519		148,795	176,817		141,000	35,817	80
603	Subvencione	0		0			0	0	0
604	Transferata Korente të Brendshme	0		1,404			0	0	0
605	Transferata Korente të Huaja	0		0			0	0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	587,802		53,514	762,737		386,399	376,388	51

602-606	Shpenzime operative	699,321	258,437	203,713	939,554		527,399	412,155	56
<b>Nën Totali Shpenzime Korrente</b>		<b>982,854</b>	<b>457,126</b>	<b>400,584</b>	<b>1,147,751</b>		<b>730,008</b>	<b>417,743</b>	<b>63.6</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,154		5,000	14,606		11,606	3,000	79
231	Kapitale të Trupëzuara	272,846		105,672	341,489		267,252	74,237	78
<b>Nën Totali Shpenzime Kapitale</b>		<b>277,000</b>	<b>334,868</b>	<b>110,672</b>	<b>356,095</b>		<b>278,858</b>	<b>77,237</b>	<b>78</b>
<b>Totali (korrente + kapitale)</b>		<b>1,169,854</b>	<b>805,106</b>	<b>511,256</b>	<b>1,503,846</b>		<b>1,008,866</b>	<b>494,980</b>	<b>67.1</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transfertat e kushtëzuar.

Nga analiza e vlerave në pasqyrat e mësipërme, vërehet se ka diferencë në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Rrogozhinë nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së Linjës/FZHR), ka programe si: **045/7-** “Transporti publik”, **102** “Të moshuarit”, **105** “Papunësia” dhe **106** “Strehimi social”, **041/6-** “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”, **042** dhe **042/20-** “Shërbimi, inspektimi i tregjeve dhe mbrojtja e konsumatorit”, **036-** “Marrëdhëniet në komunitet”, **056-** “Ndërgjegjësimi mjedisor”, **047/6** “zhvillimi i turizmit” dhe **062/1** “programe zhvillimi”, **072/2-** “Shërbimi shëndetësor” rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore apo me fonde të papërfillshme; gjë për të cilat tregon se Bashkia Rrogozhinë nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale.

**Konstatim.** Bashkia Rrogozhinë nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t’i kushtuar rëndësi programit 042 “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në mosbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor” si programe që lidhen ngushtë me atë 051- “Menaxhimi i mbetjeve”; 061- “Shërbimi urban; 036- “Marrëdhëniet në komunitet”, 041- “Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”; mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë për programet kyçe, tregon për një shërbim ku është çenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.


Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit Kavajë. Raportimi periodik i realizimit të buxhetit është bërë në MFE.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2022 rezultoi të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë viteve të periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Rrogozhinë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Tiranë. U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Kavajë dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Rrogozhinë janë kryer në bankat e nivelit të dytë dhe cash në zyrat e financës së Bashkisë (deri në verën e 100,000 lekë për taksapagues), të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive por edhe në zyrat e taksave. Nga sa më sipër, rezulton se kanë gjetur zbatim UMF nr. 1, datë 9.1.1996 “Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore” dhe UMF nr. 2, datë 27.1.1999 “Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave”.



Grafiku i planifikimit dhe realizimit të Buxhetit Bashkia Rrogozhinë

**Konstatim** Nga auditimi rezultoi se deri tani Kryetari i Bashkisë nuk ka raportuar në KB për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2022, në moszbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44.

Nga pasqyra e mësipërme rezulton se janë në total 27 programe (nënfunksione), nga të cilat për vitin 2022 janë planifikuar për tu trajtuar me fonde buxhetore vetëm 17 programe;

**Titulli i Gjetjes 3:** Planifikimi PBA dhe Planeve vjetore me program buxhetore sipas prioriteteve vendore dhe institucionale.

**Situata:1.** Nga auditimi i dokumentacionit dhe i Urdhrit për ngritjen e GMS, u konstatua se nuk janë ngritur dhe miratuar Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për Bashkinë Rrogozhinë në moszbatim të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 i ndryshuar me atë nr. 108 datë 17.11.2016;



2. Për prezantimin e PBA 2022-2024/ Projekt Buxheti Vjetor 2022 në komunitet dhe grupet e interesit, nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk është zhvilluar asnjë takim me komunitetin (me prezencë apo në platforma on line), në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;
  3. Nga auditimi u konstatua se në PBA 2022-2024 dhe Planin e buxhetit vjetor 2022 nuk janë paraqitur projektet e planifikuara për buxhetim me këto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në moszbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;
  4. Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë hartuar dhe miratuar në KB “Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Planit vjetor të Buxhetit 2022 për bashkinë Rrogozhinë dhe njësitë e Varësisë” në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;
  5. Nga Bashkia Rrogozhinë, PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit 2022 nuk janë hartuar/miratuar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;
  6. Ndryshimet e bëra në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 miratuar me VKB-të, nuk janë shoqëruar me argumentimet përkatëse lidhur me shpërndarjen apo lëvizjen e fondeve nga një artikull në tjetrin apo dhe më kryesorja nga një program në tjetrin, në moszbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;
  7. Bashkia Rrogozhinë nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t’i kushtuar rëndësi programit 042 “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve” dhe 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor”, si programe që lidhen ngushtë me programin 051- “Menaxhimi i mbetjeve”; 061- “Shërbimi urban; 036- “Marrëdhëniet në komunitet”, 041- “Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”; mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë për programet kyçe, tregon për një shërbim ku është çënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30;
- Kriteri:** Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, gërma “dh” të nenit 32, i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMF nr. 3, datë 16.01.2021, në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktin Normativ nr. 15, datë 15.4.2020, Ligjit nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualit MFK, "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Durrës;
- Ndikimi:** Mungesa e vëmendjes në planifikimin e fondeve në buxhetet vendore për programet prioritare në koherencë me Planin e Zhvillimit Vendor dhe Strategjitë Kombëtare, ul efektivitetin në aktivitetin e funksioneve të Bashkisë për komunitetin, në moszbatim të përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi;
- Shkaku:** Mungesa e një analize të detajuar nga Kryetari i bashkisë dhe e Grupit të Menaxhimit Strategjik e mos/realizimit të buxhetit në mbyllje të vitit ushtrimor dhe nxjerrja e detyrave për planifikimin e buxhetit vjetor dhe atë afatmesëm në vijim, të atyre programeve që i shërbejnë realizimit të objektivave institucionale në dobi të komunitetit.
- Rëndësia:** E mesme
- Rekomandimi:** Në Bashkinë Rrogozhinë, GMS dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për të hartuar dhe miratuar në KB “Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Planit vjetor të Buxhetit për bashkinë Rrogozhinë dhe njësitë e Varësisë”; të zhvillojnë takime me komunitetin dhe grupet e interesit për prezantimin e PBA-ve dhe Projekt planeve vjetore buxhetore; të paraqesin projektet e planifikuara për buxhetim me të gjitha specifikimet sipas kërkesave ligjore dhe EMP të secilit program; të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare

kryesisht atyre të mjedisit dhe pyjeve, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

### 3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Berat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Kavajë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuar nga transferata e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për secilin vit referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Artikulli	2020			2021		
	Plan	Fakt	Dif. / %	Plan	Fakt	Dif.
Llog. 600 "Paga"	167,193	163,546	-3,647	177,688	165,376	-12,312
Llog. 601 "Sig.shoqërore"	27,651	27,289	-362	30,492	28,157	-2,335
Llog. 602 "Shpenzime operative"	145,258	81,301	-63,957	155,438	111,519	-43,919
Llog. 604 "Transferime korrente të brendshme"	1,380	0	-1,380	0	0	0
Llog. 606 "Transferime për Buxh. familjare & Individë"	282,385	277,963	-4,422	597,930	587,802	-10,129
Llog. 609 "Rezervat"	8,120	0	-8,120	14,181	0	-14,181
Llog. 230-231 "Investime"	555,282	454,696	-100,586	398,164	277,000	-121,164
<b>Totali</b>	<b>1,187,269</b>	<b>1,004,795</b>	<b>-182,474</b>	<b>1,373,893</b>	<b>1,169,854</b>	<b>-204,040</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Nr.	Emërtimi	Viti 2022	Plan	Fakt	%
1	Llogaria 600 "Paga"		176,393	173,638	98.4
2	Llogaria 601 "Sigurime shoqërore"		31,804	28,972	91.1
3	Llogaria 602 "Shpenzime operative"		176,817	141,000	79.7
4	Llogaria 604 "Transferime korrente të brendshme"		1,404	0	0
5	Llogaria 606 "Transferime për Buxhetet familjare dhe Individë"		729,198	386,399	53.0
6	Llogaria 609 "Rezervat"		32,135	0	0
7	Llogaritë 230-231 "Investime"		356,095	278,858	78.3
<b>TOTALI</b>			<b>1,503,846</b>	<b>1,008,867</b>	<b>67.1</b>

Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 53% deri në 98,4% për vitin 2022; por gjithashtu vërehet se niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit ndërsa niveli i realizimit në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rënie nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Rrogozhinë dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit si për vitin 2020, 2021 dhe 2022 e zënë shpenzimet në llog.230 e 231 - Investimet, e ndjekur nga llog 606 - transferata buxhetore familjare/individë;

#### ➤ Sipas burimeve të financimit:

Sipas burimeve të financimit: **transferata e pakushtëzua, transferata specifike, të ardhura të veta,** treguesit e buxhetit *janë planifikuar* si më poshtë:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			% nga të ardhurat e veta
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike	Të Ardhura te veta	
1	Paga					
2	Sig.shoqërore	202,972	59,795	78,232	64,945	32
3	Shpenzime Operative					
4	Transferta korrente të brendshme	1,178,421	1,065,313		113,108	9.6
5	Trans.Buxh.Familjare/individë					
6	Investimet	121,956	33,906		88,050	72.2
<b>TOTALI</b>		<b>1,503,849</b>	<b>1,159,014</b>	<b>78,232</b>	<b>266,603</b>	<b>17.8</b>
<b>në %</b>		<b>100</b>	<b>77</b>	<b>5.2</b>	<b>17.8</b>	

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzua, transferta specifike, të ardhura të veta**, treguesit e buxhetit *janë realizuar* si më poshtë:

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			% nga të ardhurat e veta
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike	Të Ardhura te veta	
1	Paga	171,427.66	68,021.00	43,967.00	59,405.00	34.66
2	Sig.shoqërore	29,004.10	11,073.00	8,306.00	9,592.00	33.1
3	Shpenzime Operative	141,037.10	80,997.00	7,681.00	52,322.00	37.1
4	Transferta korrente të brendshme	5,109.18	4,217.00	0.00	875.00	17.18
5	Trans.Buxh.Familjare/individë	383,552.00	383,552.00	0.00	0.00	0
6	Investimet	278,869.42	246,993.00	0.00	31,865.00	11.42
<b>TOTALI</b>		<b>1,008,881.27</b>	<b>794,853.00</b>	<b>59,954.00</b>	<b>154,059.00</b>	<b>15.27</b>
<b>në %</b>		<b>100</b>	<b>78.78</b>	<b>5.94</b>	<b>15.27</b>	



Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Nga pasqyrat e realizimit të shpenzimeve nga burimi i financimit, rezulton se vlera totale e tij në planifikim është 1,503,846 mijë lekë dhe realizimi në 1,008,866 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë buxheti i pakushtëzuar në vlerën e 794,853 mijë lekë ose 78.78% të totalit; nga të ardhurat e veta është në vlerën 154,059 mijë lekë që përbën 15.27% të totalit.

Ndërsa nga zërat buxhetor me burim “të ardhurat e veta” janë pagat me 59,405 mijë lekë ose 34.66%; shpenzimet operative me 52,322 mijë lekë ose 37.1%.

#### ➤ Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore

Nga auditimi rezulton se realizimi i Buxhetit është: *për vitin 2020* në vlerën 1,004,795 mijë lekë ose (-)182,474 mijë lekë më pak nga planifikimi; *për vitin 2021* është 1,169,954 mijë lekë ose (-)204,040 mijë lekë më pak nga ai i planifikuar (progresivi); *për vitin 2022* buxheti faktik është në vlerën e 1,008,867 mijë lekë ose (-)494,979 mijë lekë më pak se ai i planifikuar ose në masën 67.1% të tij, duke rezultuar edhe vlera më e lartë e mosrealizimit për 3 vitet e fundit.

Nr.	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Trendi
1	Shpenzimet faktike	647,957	1,004,795	1,169,954	1,008,866	
2	Shpenzimet e planifikuara	771,441	1,187,269	1,373,893	1,503,846	

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Sa më sipër **u konstatua** se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie dhe që paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

në mijë lekë

2021	2022		Vlera & Trendi i mosrealizimit	
	Fakt	Plan		Fakt
1,179,982	1,503,846	1,008,866	494,980	-171,116 ↓

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Rrogozhinë nuk ka financime të huaja për vitin 2022; Bashkia Rrogozhinë nuk ka aplikuar për kredi në vitin 2022 (as në periudhat paraardhëse); Bashkia Rrogozhinë nuk ka patur subvencione nga shteti.

➤ **Miratimi i buxhetit faktik:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion **u konstatua** se, në mbyllje të vitit 2022, nga Bashkia Rrogozhinë nuk ka konfirmim të dokumentuar për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2022 në KB, pasi nuk është hartuar asnjë relacion përfundimtar mbi zbatimin e buxhetit me një analizë të detajuar të treguesve buxhetorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, në moszbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44<sup>6</sup>.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muajor në KB:**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezultojnë të jetë bërë raportim në MFE çdo 4 muajor dhe raportimi vjetor sipas formateve të përcaktuara nga MFE, me informacion statistikor të plotë dhe të renditur në tabelat e miratuara nga MFE. Këto raportime janë dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në afat; Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financave të Bashkisë Rrogozhinë, nuk është marrë konfirmimi nga Prefekti i Qarkut Tiranë, për njohjen nga ana e tij me Raportin e Monitorimit të vitit 2022.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë, Fondi i kontigjencës dhe Fondi i Emergjencës, vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.  
Në mijë lekë

Emertimi	Plan 2022	Fakt 2022
Fond Rezervë	6,442	0
Fond Emergjence (Familjet e dëmtuara nga tërmeti)	536,091	190,089
Fond Kontigjence	20,520	0
Mbrojtja Civile	5,005	0
<b>Totali</b>	<b>568,058</b>	<b>190,089</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Përdorimi i këtyre fondeve realizohet me VKB. Me VKB nr. 71 datë 22.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm” është miratuar Fondi Rezervë në vlerën 6,442 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës në 20,520 mijë lekë, që në total janë në vlerën 26,962 mijë lekë. Në referim të ligjit nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara.

**U konstatua** se vlera totale e tyre është 9,638 mijë lekë më pak ose rreth 74 % të vlerës që duhej të planifikohej dhe se për vitin 2022 ky fond nuk është përdorur; Fondi i Emergjencës është planifikuar në vlerën 536,091 mijë lekë dhe përfaqëson fondet e rindërtimit, nga të cilat janë shpenzuar 190,089 mijë lekë;

<sup>6</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Nga sa më lart, nga auditimi **u konstatua** se bashkia Rrogozhinë për vitin 2022 fondi për emergjencat civile është planifikuar në vlerën e 5,005 mijë lekë, nga i cili nuk ka patur shpenzime dhe është trashëguar për vitin pasardhës. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje jo racionale për përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi përmirësimit të situatës pas fatkeqësive natyrore, sesa masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1, që nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 11,353 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 6,348 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 44% të vlerës që duhej planifikuar.

**Realizimi i Investimeve:**

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2021 dhe 2022 për bashkinë Rrogozhinë, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferata e pakushtëzuara", pasqyrohet në tabelën më poshtë:

*në mijë lekë*

2021	2022		
Fakt	Plan	Fakt	Diferenca
277,000	356,095	278,858	1,858

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit, por në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 1,858 mijë lekë.

Duke iu referuar të dhënave në tabelën e mëposhtme të të ardhurave të vet bashkisë Rrogozhinë,

Burimet e Financimit	Viti 2022		%
	Plan	Fakt	
Të ardhurat e veta	271,783	155,725	57.3

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Ky **konstatim** sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

➤ **Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Rrogozhinë gjatë vitit 2022 të mos ketë patur fonde të planifikuara dhe rrjedhimisht as të shpenzuara për nevoja specifike të situatës.

**Titulli i Gjetjes 4:** Mosrealizimi i planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore;

**Situata: 8.** Nga analiza e të dhënave të buxhetit, u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Kështu nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie;

9. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, në mbyllje të vitit 2022, nga Bashkia Rrogozhinë nuk ka miratuar buxhetin faktik të vitit 2022 në KB, pasi nuk është hartuar asnjë relacion përfundimtar mbi zbatimin e buxhetit me një analizë të detajuar të treguesve buxhetorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, në moszbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44<sup>7</sup>;

10. Me VKB nr. 71 datë 22.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm” është miratuar Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës në vlerën totale 26,962 mijë lekë. Në referim të ligjit nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. U konstatua se vlera totale e tyre është 9,638 mijë lekë më pak ose rreth 74 % të vlerës që duhej të planifikohej si dhe për vitin 2022 ky fond nuk është përdorur;

11. Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë: a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Rrogozhinë për vitin 2022 fondin për emergjencat civile e ka planifikuar në vlerën e 5,005 mijë lekë. Ndërkohë fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1; Gjithashtu rezultoi se ky fond nuk është shpenzuar dhe është trashëguar për vitin pasardhës. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje jo racionale për përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi përmirësimit të situatës pas fatkeqësive natyrore, sesa masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore;

12. Nga auditimi rezultoi niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit, ndërsa niveli i realizimit në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rënie nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022; nga tabela e planifikimit të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta në vitin 2022, investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit, por në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 1,858 mijë lekë. Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse;

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktin Normativ Nr.15, datë 15.4.2020, Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1; VKB përkatëse;

**Ndikimi:** Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, i zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore në drejtim të këtyre shërbimeve;

---

<sup>7</sup>Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

**Shkaku:** Planifikim i të ardhurave dhe më pas përdorimi i tyre për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik; Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mos nxjerrja e konkluzioneve për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme;

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Në Bashkinë Rrogozhinë, GMS dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

#### 4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR është konfirmuar se nuk ka detyrime të prapambetura.

Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive për vitin 2022 paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja gjate 3 mujorit të tretë 2022	Mbetja në fund të vitit 2022
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës	0	0	0	0	0
b. Investime nga Bashkia	125,612,513	6,337,924	131,950,437	48,631,440	82,373,713
<b>Investime</b>	<b>125,612,513</b>	<b>6,337,924</b>	<b>125,612,513</b>	<b>48,631,440</b>	<b>82,373,713</b>
Mallra dhe shërbime	115,650,467	69,161,815	178,371,068	102,438,569	83,318,997
Vendime gjyqësore	420,150			420,150	
Të tjera ...					
<b>Totali</b>	<b>241,683,130</b>	<b>75,499,739</b>	<b>303,983,581</b>	<b>151,490,159</b>	<b>165,692,710</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të vitit çdo viti ushtrimor, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha. Me mbylljen e vitit ushtrimor, rezultojnë edhe vlerat e sakta të detyrimeve; gjithashtu kolona e gjendjes në fund të vitit 2021 është në vlerën e 241,683,130 lekë (mallra, shërbime, investime dhe vendime gjyqësore).

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rrugë elektronike.

Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 106, ku citohet:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që jo më vonë se data 10 Prill 2020 për tremujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura” bashkëlidhur këtij udhëzimi.”

Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

- Për vitin 2021 është në vlerën e 241,683,130 lekë, ku 125,612,513 lekë janë për “investimet e bashkisë”, 115,650,467 lekë “për mallra dhe shërbime” dhe 420,150 lekë për vendimet gjyqësore;

- *Për vitin 2022* ka patur lindje të detyrimeve të reja në vlerën e 75,499,739 lekë për “investime” dhe “mallra e shërbime”, duke e çuar vlerën totale të detyrimit në 303,983,581 lekë; gjithashtu rezultoi se ka një shlyerje në masë të konsiderueshme të tyre në vlerën e 151,490,159 lekë ose 49.8% të totalit, duke e mbyllur vitin 2022 me një detyrim të mbartur për vitin e ardhshëm prej 165,692,710 lekë.

Një pasqyrim të detajuar të detyrimeve të prapambetura jepet në tabelën e mëposhtme:

Emërimi i detyrimit të prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2022 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022
2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
<b>I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta</b>						
Detyrime për shërbime	109,209,253	51,840,515	102,438,569	13,211,898	69,161,815	82,373,713
Detyrime për investime	132,053,727	42,418,200	48,631,440	76,981,073	6,337,924	83,318,997
Detyrime të tjera/V.Gjyq	420,150	420,150	420,150	420,150		
<b>Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta</b>	<b>241,683,130</b>	<b>94,678,865</b>	<b>151,490,159</b>	<b>90,613,121</b>	<b>75,499,739</b>	<b>165,692,710</b>
<b>II. Detyrime të prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministririte e linjës)</b>						
<b>Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti</b>	<b>241,683,130</b>	<b>94,678,865</b>	<b>151,490,159</b>	<b>90,613,121</b>	<b>75,499,739</b>	<b>165,692,710</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Nga auditimi rezultoi se janë 21 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Rrogozhinë me 29 fatura në total të pa likuiduara, vlera e të cilave është trashëguar në vitin 2023; **u konstatua** se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve, Bashkia Rrogozhinë nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Rrogozhinë është debitore “për mallra e shërbime” ndaj 24 subjekteve me 49 fatura në vlerë totale 82,373,713 lekë; **u konstatua** se likuidimi i faturave të prapambetura për mallra e shërbime të kryera ndër vite, është kryer në kundërshtim me VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13.

Në mënyrë analitike detyrimet e prapambetura, vitin e krijimit, likuidimet pjesore apo të plota, vlera e detyrimit të mbartura në vitin 2023 paraqiten në Aneksin nr.2 bashkëlidhur.

➤ **Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore:**

Nga auditimi i PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”. Nga auditimi i likuiditeteve **u konstatua** se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2022 për pamundësi likuiditeti të “Investime” dhe “mallra e shërbime”, kjo për arsye se nga bashkia Rrogozhinë në vitet paraardhëse nuk janë bërë planifikime të përlogaritura në mënyrë që të bëhet e mundur likuidimi i çdo fature shërbimi apo mallrash brenda vitit ushtrimor.

Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2022 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështirësisë financiare është :

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua sfatgjatë</b>	<b>0</b>		
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		



<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>165,692,710</b>		<b>28.91%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>82,373,713</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime	82,373,713		
<b>b</b>	<b>Shenzime kapitale</b>	<b>83,318,997</b>		
b,2	Subjekte private	83,318,997		
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>0</b>		
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>165,692,710</b>	<b>573,081,010</b>	<b>28.91%</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
<b>0</b>	<b>0</b>	<b>Vështirësi financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Rrogozhinë është në vështirësi financiare, e cila është e trashëguar nga vitet paraardhëse.

**Titulli i gjetjes 5:** Mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime:

**Situata: 12.** Nga auditimi rezultoi se janë 21 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Rrogozhinë me 29 fatura në total të pa likuiduara “për investime”, vlera e të cilave është trashëguar në vitin 2023 dhe “për mallra e shërbime” 24 subjekte me 49 fatura në vlerë totale 82,373,713 lekë; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve kreditore, Bashkia Rrogozhinë nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pika 13;

**13.** Nga auditimi i PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”; kjo ka sjellë që likuiditeti i detyrimeve të prapambetura nga ana e bashkisë Rrogozhinë në raport me vlerën e detyrimit, të jetë i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, kjo pasi shoqërohet me lindjen e detyrimeve të reja për shkak të pamundësisë për pagesa nga mungesa e fondeve.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktin Normativ nr.15, datë 15.4.2020; VKM nr. 50 datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit"; Udhëzimit nr. 5 datë 27/02/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si dhe VKB përkatëse;

**Ndikimi:** Mos planifikimi në PBA dhe Planet vjetore të buxhetit fonde për programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura” si dhe mosrespektimi i radhës së kreditorëve për likuidim sipas radhës brenda llojit, të periudhës së krijimit të detyrimit, sjell lindjen e detyrimeve të reja dhe shtimin e vlerës të atyre të krijuara në periudha të mëparshme, duke e çuar në vështirësi financiare bashkinë dhe si pasojë uljen e performancës së shërbimeve të saj ndaj komunitetit;

**Shkak:** Moszbatimi i akteve ligjore/nënligjore në fuqi lidhur me hartimin e PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit mbi nevojat e komunitetit dhe të realizimit faktik të buxheteve paraardhëse, etj;

**Rëndësia:** E lartë


**Rekomandimi:** Kryetari e Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura .

### **5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre; fondet e Rindërtimit.**

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Rrogozhinë për vitin 2022 nuk ka patur të planifikuara fonde për investime nga FZHR dhe Ministri të linjës. Të vetmet investime kanë qenë nga fondet e Rindërtimit.

- Vështrim i përgjithshëm mbi Zbatimin e rregullave dhe të procedurave të përcaktuara për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë natyrore - tërmetit të 26 Nëntorit.

Politika e rindërtimit është ndërmarrë nga Ministria e Rindërtimit [MR] (*rindertimi.gov.al*), e cila u krijua me Vendim nr. 11, datë 10.1.2020 – për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtimin, për drejtimin e gjithë procesit së bashku me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit [KSHR] me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore – tërmeti i nëntorit 2019 & për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të [KSHR] si organ kolegjal. Aktorët e tjerë për rindërtimin dhe rivitalizimin e zonave të prekura nga tërmeti janë: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile [AKMC], Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit [AKPT], Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore/Bashkitë [NJVQV/B], si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit [FSHZH] si njësi zbatuese për rindërtimin e shtëpive individuale; grupimin dhe rindërtimin e shtëpive individuale në zonat rurale, bashkë me ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse; si dhe ndërtimin e lagjeve të reja urbane. Për këtë, qeverisja ndërmori rolin kryesor për përballimin e pasojave post-fatkeqësi, përkundër një qasjeje nga poshtë-lart, e cila sheh si thelbësor rolin e aktorëve në komunitet.



Skema e Strategjisë së Rindërtimit

Edhe Bashkia Rrogozhinë, për menaxhimin e situatës së rëndë të krijuar nga fatkeqësia natyrore - tërmeti i 26 Nëntorit 2019, u angazhua për përballimin dhe menaxhimin e situatës. Për zbatimin e akteve ligjore/nënligjore dhe menaxhimin më me efektivitet të situatës kontribuan të gjitha njësitë e strukturës së bashkisë.

**I.** Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor, grupi i auditimit përgatiti një pyetësor mbi të cilin do jepet një pasqyrim i aktivitetit të Bashkisë Rrogozhinë për këtë procedurë. Pyetësi iu dërgua me rrugë elektronike (email datë 04.04.2023).

1. Në Bashkinë Rrogozhinë cila njësi e strukturës organizative u angazhua për menaxhimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019?
2. Numri i aplikuesve nga regjistri elektronik “Shtëpia Ime” për vitin 2022;
3. Kërkesa e Bashkisë Rrogozhinë me <listën e nevojave> drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për grante ku përfshihen: llojet e granteve, buxhetin përkatës, arsyetimin e përzgjedhjes së programit të granteve të rindërtimit etj;
4. Lista e përfituesve nga granti i subvencionit të qerasë, VKB-të për çdo listë të hartuar;
5. Komisioni i vlerësimit të aplikimeve (përbërja); Nga rregjistri i aplikimeve, a ka një listë me aplikantë jo fitues? Nëse po, të na vihet në dispozicion;
6. A ka patur një listë drejtuar Institutit të Ndërtimit për ekspertizë të thelluar? Nëse po të na vihet në dispozicion;
7. Referuar përlogaritjes në preventiv dhe shpërndarjes së fondeve (grantit) të përfituesit (likuidimit), të jepet informacioni sipas kërkesave të tabelës;
8. Shpërndarja e grantit sipas formularëve për vitin 2022;
9. Të vihet në dispozicion lista e përfituesve që janë likuiduar dhe VKB përkatëse.

Përgjigjja e këtij pyetësori erdhi në 2 pjesë po në rrugë elektronike. Rezultoi se janë ngritur grupet dhe komisionet me Urdhër të Brendshëm të kryetarit të bashkisë, konform kërkesave të akteve ligjore/nënligjore për rastet e fatkeqësive natyrore dhe ato të dala për fatkeqësinë natyrore tërmetin e 26 nëntorit 2019.

**II.** Bashkia Rrogozhinë disponon regjistrin elektronik në platformën online “Shtëpia Ime”, në zbatim të VKM nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” kreu II pika 10 ;

**III.** Bashkia Rrogozhinë i vuri në dispozicion grupit të auditimit, kërkesat me “listën e nevojave” të miratuara me VKB drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për grante, ku përfshihen: llojet e granteve, buxheti përkatës, arsyetimin e përzgjedhjes së programit të granteve të rindërtimit etj Urdhrat e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë janë në zbatim të VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**IV.** Në Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2022 nuk ka patur aplikime të reja për të përftuar nga granti i rindërtimit;

**V.** Në Bashkinë Rrogozhinë komisioni i vlerësimit të aplikimeve nuk ka rezultuar asnjë aplikues i skualifikuar nga përftimi i fondit të Rindërtimit;

Bashkia Rrogozhinë	Numri i aplikuesve	Numri i përfituesve të likuiduar
	2295	1826

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

- Bashkia Rrogozhinë lidhur me masat për hartimin e listave të familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore tërmeti i 26 Nëntorit 2019, ka miratuar Vendime në KB me përmbajtje: lista emërore, vlerën e pagesës së qerasë, burimin e financimit (MFE), dokumentacionin që duhet të dorëzojë çdo aplikues, njësitë zbatuese të këtij vendimi: NjA, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Zyra e Emergjencave Civile.

Nr. VKB	Datë	Objekti i Vendimit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë – viti 2022	Nr. i familjeve	Vlera e fondit të kërkuar/lekë
6	26.01.2022	Miratimi i listës të subjekteve private që përfitojnë nga Granti I Rindërtimit për nivelet DS5 pas Akt ekspertizës së thelluar nga IN	23	65,148,998

Nr. VKB	Datë	Objekti i Vendimit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë – viti 2022	Nr. i familjeve	Vlera e fondit të kërkuar/lekë
8	26.01.2022	Miratimi I listës për rikonstruksionin e banesave individuale me nivel demtimi DS1, DS2, DS3	31	11,980,000
19	24.03.2022	Miratimi I listës për grant banesave me nivel demtimi DS5 pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN	2	5,661,310
20	24.03.2022	Miratimi I listës për rikonstruksionin e banesave me nivel demtimi DS3	2	1,000,000
24	12.04.2022	Miratimi I listës për rikonstruksionin e banesave individuale me nivel demtimi DS2, DS3	871	362,700,000
32	25.05.2022	Miratimi I listës për rikonstruksionin e banesave individuale me nivel demtimi DS2, DS3	331	141,250,000
33	07.07.2022	Miratimi I listës për grant banesave me nivel demtimi DS4, DS5 pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN	3	7,463,268
36	07.07.2022	Miratim në parim për prishjen e objektit “bashkia Rrogozhinë” me akt ekspertize të thelluar nga IN me nivel DS5	1	-
47	15.08.2022	Miratimi I listës për rikonstruksionin e banesave me bashkëpronësi me nivel DS2, DS3	2	47,200,000
53	21.09.2022	Miratimi i listës të subjekteve private që përfitojnë nga Granti I Rindertimit për nivelet DS5 pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN	12	38,662,896
55	21.09.2022	Miratimi I listës për rikonstruksionin e banesave me nivel demtimi DS2, DS3	98	47,200,000
<b>11</b>	<b>Vendime</b>	<b>Lista sipas nevojave për përfitim granti</b>	<b>1376</b>	<b>728,266,472</b>
47	01.06.2020	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	152	1,543,000
45	23.07.2021	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	95	999,000
55	24.09.2021	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	91	958,000
7	06.01.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	23	274,000
18	24.03.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	2	18,000
61	28.10.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	4	43,000
54	21.09.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	12	150,000
<b>7</b>	<b>Vendime</b>	<b>Lista përfundimtare të miratuara për bonusin e qirasë deri në fund të vitit 2022</b>	<b>379</b>	<b>3,985,000</b>

*Punoi: Grupi i auditimit*

- Nga auditimi i informacionit dokumentar rezultoi se nga Bashkia Rrogozhinë janë dërguar në Ministrinë për Rindërtim/Ministrinë e Infrastrukturës **11** shkresa me objekt “Listat sipas nevojave për grant nga fondi i rindërtimit të familjeve të dëmtuara nga tërmeti” për 1376 objekte të dëmtuara në vlerën 728,266,472 lekë; dhe **7** shkresa me objekt “përfitim nga bonusi i qirasë” të cilat janë shoqëruar me praktikën përkatëse.

- Listat e hartuara me përfituesit nga Subvencionimi i qerasë janë në përditësim të vazhdueshëm. Komisioni për hartimin e listave të përfituesve nga subvencionimi i qerasë, bazohet në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të KM “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subveccionin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore tërmetit të datës 26.11.2019” i ndryshuar me Aktin Normativ nr. 37 datë 24.12.2020.

Mbi shpërndarjen e fondit “subvencionim i bonusit të qirasë” për çdo muaj në vitet 2020, 2021 e 2022 jepen në tabelën e mëposhtme:

Muaji pagesës	Nr. i familjeve që trajtohen 2020	Fonde të nevojshme për 1 muaj 2020	Nr. i familjeve që trajtohen 2021	Fonde të nevojshme për 1 muaj 2021	Nr. i familjeve që trajtohen 2022	Fonde të nevojshme për 1 muaj 2022
Dhjetor 2019	135	1,365,000				
Janar	135	1,365,000	151	1,540,000	329	3,350,000
Shkurt	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000
Mars	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000
Prill	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000
Maj	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000
Qershor	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000
Korrik	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000
Gusht	135	1,365,000	238	2,397,000	351	3,616,000

Shtator	135	1,365,000	238	2,397,000	327	3,326,000
Tetor	135	1,365,000	329	3,350,000	327	3,326,000
Nëntor	135	1,365,000	329	3,350,000	266	2,754,000
Dhjetor	135	1,365,000	329	3,350,000	266	2,754,000
<b>Totali</b>		<b>17,745,000</b>		<b>30,766,000</b>		<b>40,822,000</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Referuar të dhënave në tabelë, jepet një informacion mbi numrin e përfituesve nga bonusi i qirasë dhe vlera e tij. Kjo procedurë është në zbatim të Aktit Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019” me një afat kohor prej një viti (12 muaj) i ndryshuar me AN<sup>8</sup> nr. 37, datë 24.12.2020.

- Me ndryshimin e nenit 7 të AN nr. 8 datë 07.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, lehtëson familjet e dëmtuara të cilat janë strehuar në objekte banimi me qira, pasi subvencionimi i qirasë për to zgjat në një afat që lidhet me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja të banimit; por nga ana tjetër nuk është shoqëruar me një shtesë apo ndryshim të një akt ligjor /nënligjor që të kushtëzojë njësinë zbatuese që është FSHZH dhe nëpërmjet saj OE që kanë qenë fitues në tenderat për Rindërtimin, për të respektuar rigorozisht afatet kohore të përcaktuara në kontratë, me qëllim shmangien e rritjes (shtimit) të vlerës së fondit për Subvencionimin e qerasë pra për të përdorur me ekonomicitet dhe efikasitet fondet e Rindërtimit.

**VI.** Nga ana e Bashkisë Rrogozhinë janë dërguar rregullisht lista e objekteve për ekspertizë të thelluar në Institutin e Ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në rrugë elektronike, rezultoi se vetëm në vitin 2022 janë dërguar 5 (pesë) shkresa me praktika të plota të 33 objekteve, konform përcaktimeve në VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; VKM nr. 26 datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;

Shkresa	Datë	Objekti i shkresës për në Institutin e Ndërtimit – viti 2022	Nr. i objekteve
<b>339</b>	<b>23.01.2023</b>		
2077	12.05.2022	Kërkesë për Akt ekspertizë të thelluar	6
2158	19.05.2022	Kërkesë për Akt ekspertizë të thelluar	18
2157	19.05.2022	Kërkesë për Akt ekspertizë të thelluar	7
2813	30.06.2022	Kërkesë për Akt ekspertizë të thelluar	1
3969	28.09.2022	Kërkesë për Akt ekspertizë të thelluar	1
<b>5</b>	<b>Totali</b>	<b>5 Kërkesa</b>	<b>33</b>

*Punoi: Grupi i Auditimit*

Gjithashtu nga auditimi rezulton se për çdo akt të miratuar në KB, është respektuar edhe afati për konfirmim të ligjshmërisë së tij nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

- Grupet e punës në terren kanë plotësuar formularët duke klasifikuar paraprakisht nivelin e dëmtimit të objekteve në DS1, DS2, DS3, DS4 e DS5; praktikat e tyre janë dërguar për ekspertizë të thelluar në IN dhe në bazë të aktekspertizës janë përpiluar listat emërore me përfituesit për grant të cilat pasi miratohen në KB, paraqiten me kërkesë në KSHR. Numri i përfituesve nga grantet jepet në tabelën më poshtë:

Formulari Tip	Bashkia Rrogozhinë (për 5 njësi administrative)	
	Numri i Regjistruar	Numri i Likuiduar
<b>DS1</b>	127	121
<b>DS2</b>	480	505
<b>DS3</b>	1425	1192
<b>DS4</b>	1 pallat	0

<sup>8</sup>AN –Akt Normativ

<b>DS5</b>	262	8
<b>Totali</b>	<b>2295</b>	<b>1826</b>

*Burimi :Bashkia Rrogozhinë*

**U konstatua** se Bashkia Rrogozhinë për nivelin e demit DS4 që i përket objekte të përbashkëta banimi (pallat) nuk ka likuiduar asnjë përfitues.

- Referuar përlllogaritjes në preventiv dhe shpërndarjes së fondeve të përfituesit (likuidimit të tyre) për çdo njësi administrative sipas klasifikimit në formularin DS, janë të tabelat si më poshtë:

Formulari Tip	Bashkia Rrogozhinë	
	Vlera e Preventivit	Vlera e Likuiduar
<b>DS1</b>	12,000,000	11,420,000
<b>DS2</b>	121,500,000	117,500,000
<b>DS3</b>	723,200,000	549,200,000
<b>DS4</b>	23,388,617	0
<b>DS5</b>	718,565,782	14,039,312
<b>Totali</b>	<b>1,577,654,399</b>	<b>692,159,312</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Nga analiza e shifrave në tabelë rezultojnë se për objektet e klasifikuara me Formularin DS3 sipas preventivit është vlera më e lartë 723,200,000 lekë dhe likuiduar në vlerën 549,200,000 lekë; ndërsa vlera më e vogël e preventivit është për formularin DS1 me 12,000,000 lekë dhe likuiduar në vlerën 11,420,000 lekë;

Nga Bashkia Rrogozhinë janë dërguar në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit [KSHR] shkresat me objekt “Kërkesë për grante” të specifikuar sipas formularëve [DS] të klasifikuar sipas nivelit të dëmtueshmërisë.

<b>FONDI I LËVRUAR DHE QË KA LIKUJDUAR PERFITUESIT NGA GRANTI I RINDERTIMIT (në lekë)</b>			
	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
DS1	7,800,000	1,420,000	2,200,000
DS2	17,800,000	71,650,000	28,050,000
DS3	85,300,000	318,100,000	145,800,000
DS4	0	0	0
DS5	0	0	14,039,312
<b>TOTAL</b>	<b>110,900,000</b>	<b>391,170,000</b>	<b>190,089,312</b>

*Burimi: Bashkia: Rrogozhinë*

**6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 4, datë 05.01.2021, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2022”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, e cila sipas strukturës është e përbërë nga 2 sektorë dhe në total ka 14 punonjës nga të cilët 5 punonjës, sipas njësive administrative dhe 9 punonjës të Drejtorisë së të Ardhurave nga të cilët: 1 Drejtor, Sektori i Administrimit Vlerësimi të Biznesit dhe Kontabilizimit të të Ardhurave me 1 përgjegjës, 1 specialist i biznesit të vogël dhe të madh, 1 specialist kontrolli dhe verifikimi; Sektori i taksave dhe tarifave familjare me 1 përgjegjës, 2 specialistë taksash dhe tarifash familjare dhe 1 taksambledhës.

Konstatohet se edhe pse struktura e DAZHE Bashkia Rrogozhinë është e plotë dhe aktiviteti i saj është mbështetur nga Sektori i Masave Shtrënguese, përsëri nga auditimi rezultoi se ka probleme në vjeljen e të ardhurave dhe për pasojë nuk ka patur efektivitet në realizimin e të ardhurave, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), *për vitin 2021* në vlerën 207,989 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetëror në vlerë 33,793 mijë lekë dhe abonentë familjarë në

vlerë 174,195 mijë lekë; për vitin 2022 në vlerë 267,260 mijë lekë, nga e cila 40,215 mijë lekë subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore dhe 227,045 mijë lekë nga abonentë familjarë.

- Gjithashtu **konstatohet** se në strukturën organizative të DAZHE Bashkia Rrogozhinë, janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit, si ajo e drejtorit dhe e 3 specialistëve, që ndonëse me profilin e duhur arsimor, nuk ka rezultuar me zgjidhjen e problematikave të trashëguara ndër vite, uljen e borxhit tatimor të njësisë; mungesa e një specialisti IT në strukturën e DAZHE ka sjellë mungesën e krijimit të një regjistri të plotë elektronik të subjekteve taksapaguese si dhe në mos evidentimin në kohë reale të subjekteve (ose vonesa në evidentimin e tyre), mos llogaritjen e detyrimeve fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi Nëpunësin Autorizues si dhe Drejtorinë Ligjore, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhëniet me Publikun/Sektori i Burimeve Njerëzore për mungesën e planifikimit efektiv për trajnime të punonjësve në përgjithësi dhe atyre të Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik në veçanti, për të kuptuar në kohë rëndësinë dhe nevojën imediate për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukurore për të maksimizuar vjeljen e taksave dhe miradministrimin e tyre.

- Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik (DAZHE), nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 29, pika 1.

- Nga DAZHE është në proces inventarizimi i dokumentacionit që ndodhet në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” neni 24, neni 9; Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” kapitulli II, neni 21, 27 (konstatuar kjo edhe nga auditimi i mëparshëm).

#### ➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

**Për vitin 2022**, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 70, datë 22.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë. Nga të dhënat e **pasqyrës përmbledhëse** më poshtë, shihet se për vitin 2021 sipas planit fillestar janë në vlerën 257,877 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 150,410 mijë lekë ose 58.33 %, me një mosrealizim në vlerën 107,467 mijë lekë; për vitin 2022 janë planifikuar në vlerën 238,336 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 138,859 mijë lekë ose 58.2%, me një mosrealizim në vlerën 99,477 mijë lekë. Duhet theksuar se planifikimi i të ardhurave ka ardhur në rënie me (-)19,540 mijë lekë dhe realizimi i tyre me (-)11,551 mijë lekë. Peshën kryesore të mosrealizimit e zënë tatimi i thjeshtuar mbi fitimin me 23%, taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore me 66.8%, taksa e ndërtesës me 66.8% dhe tarifa e pastrimit me 56.25% etj. **Konstatohet** se:

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtoria e të Ardhurave, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Kavajë (ASHKK); Drejtoria e të ardhurave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Rrogozhinë, nuk ka dërguar njoftim detyrimi për këto familje, baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Nga ana e DAZHE na u komunikua se UK Rrogozhinë nuk pranon bashkëpunim për të marrë mbi vete rolin e agjentit tatimor, kjo për shkak të problemeve të tyre të akumuluar. Në këto kushte deri në fund të vitit 2022 Akt rakordimet me agjentët tatimorë UK Rrogozhinë dhe ASHKDVK rezultojnë të mos jenë mbajtur; Ndërsa janë bërë akt rakordime me DRSHTRR në modelin e një proces-verbali, duke marrë

informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk është konfirmuar baza e të dhënave statistikore mbi të cilën janë bërë llogaritjet dhe është vlerësuar niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime të cilat janë në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve. Informacion më i detajuar rreth planifikimit dhe realizimit të të ardhura për vitin 2021-2021 paraqitet në Aneksin nr.3 bashkëlidhur.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

**Konstatohet** se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 5311prot. datë 06.12.2019, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Durrës”, për llogari të Bashkisë Rrogozhinë.

Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gjurmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësisë përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Rakordimet me DRSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, janë kryer rregullisht, vërtetuar kjo nga akt rakordimet mujore.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Durrës”.

Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”” dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qendrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për efekt të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, janë kryer çdo muaj.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)”.

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ZVRPP Kavajë, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer;

4. Renta Minerare nga Agjentët Tatimorë “Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Durrës”

Në zbatim të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, Neni 4 “Niveli i Taksave Kombëtare”, pika 4, e cila shprehet: “Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare....5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës...” të Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008, dhe UMF Nr. 12, Dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, “...Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit...”. sipas shtojcën 2 të këtij ligji, niveli i Rentës Minerare varion nga 4 deri në 10%, sipas llojit të



mineralit. Rakordimet me Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Durrës, për Rentën Minerare, nuk janë kryer. Nga administrata tatimore e bashkisë Rrogozhinë nuk është ushtruar kujdesi i duhur për të arkëtuar të ardhurat nga veprimtaria minerare dhe ky subjekt që ushtron veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, tatohet vetëm për detyrimet e tjera vendore, si një biznes i thjeshtë, ndërkohë që është edhe debitor. Më poshtë janë paraqitur të dhënat për lejet minerare në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, të nxjerra nga regjistri i lejeve minerare, nga faqja zyrtare e AKBN-së (konstatuar nga grupi i mëparshëm i auditimit).

Nr.	Nr i lejes	Datë	Emri i subjektit	Emërtimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	Lloji i Lejes	Adresa e selisë	S= Km2
240	1150/1	09.10.2017	H. shpk	Rrogozhinë	Zhavorr	Shfrytëzimi	Lagjia Nr. 4, Rruga "Princ Topia", ndërtesë private 1 katshe, pasuria 74/8, Kavajë	0,0115
210	1200/2	01.07.2008	S. & V.	Rrogozhinë	Ranor Konglomerati	Shfrytëzimi	Lekaj	0,138

Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin kullësor", pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor".

Nga grupi i auditimit u kërkua informacion mbi këto 2 subjekte debitore, dhe nga ana e DAZHE Bashkia Rrogozhinë, na u bë me dije se vetëm për subjektin "S. & V." kemi informacion të dokumentuar mbi aktivitetin e hershëm të tij dhe të klasifikuar si debitor nga ana jonë<sup>9</sup>; ndërsa për subjektin "H." shpk nuk disponojmë asnjë informacion dokumentar.

#### ➤ *Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore*

Bashkia Rrogozhinë ka sipërfaqe bujqësore të dhëna me qira, nga kontrata të lidhura ndër vite dhe që rezultojnë aktive edhe në vitin 2022. Për vitin 2021 ka qenë e planifikuar që nga qiratë e tyre të vileshtin 801,200 lekë dhe rezultojnë të mos jenë realizuar arkëtime<sup>10</sup>; për vitin 2022 është planifikuar në vlerën e 4.376.050 lekë dhe realizuar me 582.000 lekë ose 13.3% e tyre. Një informacion i detajuar mbi subjektet qiramarrëse të tokave bujqësore vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela e sipërfaqeve pyjore të dhëna në përdorim ndër vite dhe që janë aktive për vitin 2022**

Nr	Akt Ligjor, VKM, U.Ministri, VKB	Data lidhjes	Subjekti	Sip	Vlera kontratës lekë	Kohë zgjatja	Paguar lekë	Shënime Detyrimi
1	U.nr.475, dt 15.05.2013	kontrates	F. M.	0.655	68,120	10 vjet	Nr.232 dt.25.03.2022 leke <b>68.120</b>	
2	U.nr.475, dt.15.05.2013	20.06.2013	M. L.	0.5	52,500	10 vjet	nr.ref.161BPAdt .9.02.2023 leke <b>52.500</b>	
3	U.nr.475, dt.15.05.2013	19.06.2013	H.D.&B.P.	0.552	57,960	10 vjet	Nr.514. dt.13.6.2022 leke <b>57,960</b>	

<sup>9</sup>Informacion i detajuar pasqyrohet tek rubrika "Pajisja me autorizime të subjekteve që tregëtojnë hidrokarbure"

<sup>10</sup> Nga ana e DAZHE na u komunikua se janë rregjistruar vlera të konsiderueshme arkëtime në llogari të gabuara, të cilat do të sistemohen në periudhat e ardhshme.

Nr	Akt Ligjor, VKM, U.Ministri, VKB	Data lidhjes	Subjekti	Sip	Vlera kontratës lekë	Kohë zgjatja	Paguar lekë	Shënime Detyrimi
4	U.nr.633 dt.12.06.2013	17.07.2013	P. M.	0.5	38,500	10 vjet	Derg. njoftim nr.490,prot.date 03.02.2023	38,500
5	U.nr.475, dt.15.05.2013	19.06.2013	Sh. A.	0.5	52,500	10 vjet	Nr.421,dt 10.05.2022 leke <b>52,500</b>	
6	U.nr.762, dt.23.08.2013	24.09.2013	E. D.	0.552	45,300	10 vjet	dt.18.03.022 Leke <b>45,300</b>	
7	U.nr.634, dt.12.06.2013	19.07.2013	Z. K.	0.6	90,400	10 vjet	M.A. Nr.823 dt.18.8.2022 leke <b>90,400</b>	
8	U.nr.348, dt.18.06.2012	01.11.2022	E. D.	0.5	73,320	5 vjet	dt.18.03.2022 leke <b>69,000</b> , Nr.67.dt.4.11.20 22 leke <b>73,320</b>	
9	Shk.nr.1048/1, dt.14.6.2000	15.1.2001	B. G.	1	50,000	25 vjet	Paguar per Gjitheperiudhen e mbetur	
10	U. nr.88, dt.30.3.2021	06.12.2021	S. Gj.	77.94	2,475,500	10 vjet	Derg. njoftim nr.489,date 03.02.2023	2,475,500
11	U. nr.88, dt.30.3.2021	20.12.2021	S. M.	1.59	16,000	10 vjet	Nr.123,dt 1.02.2023, leke <b>16,000</b>	
<b>TOTALI</b>					<b>3,020,100</b>		<b>506,100</b>	<b>2,514,000</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë/Drejtoria e Bujqësisë

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, rezultoi se 2 subjekte: - Subjekti "P. M." me kontratën e lidhur në vitin 2013 dhe vlerën e kontratës 38,500 lekë me afat 10 vjeçar, rezultoi se deri më 03.02.2023 nuk ka kryer pagesë pra është debitor në vlerë të plotë 38,500 lekë; - Subjekti "S. Gj." me kontratën e lidhur në fund të vitit 2021 dhe vlerën e kontratës 2,475,500 lekë me afat 10 vjeçar, rezultoi se deri më 03.02.2023 nuk ka kryer pagesë, pra është debitor në vlerë të plotë 2,475,500 lekë.

Të dyja këto subjekte janë njoftuar me shkresat nr. 490 prot., dt.03.02.2023 dhe nr. 489 prot., dt.03.02.2023. **U konstatua** se nga Drejtoria e Bujqësisë e vetmja masë për vjeljen e detyrimeve është njoftimi zyrtar i Subjekteve debitore, ndonëse Subjektit "P. M." i përfundon afati në dt.17.07.2023 dhe ka një detyrim me një vlerë relativisht të vogël prej 38,500 lekë.

**Tabela e sipërfaqeve bujqësore të pandara të dhëna në përdorim ndër vite dhe që janë aktive në 2022**

Nr	Aktligjor, VKM, U.Ministri, VKB	Data lidhjes kontrates	Subjekti	Sip	Vlera kontratës lekë	Kohë zgjatja	Paguar lekë
1	Konkurim	21.06.2019	E. H.	77.32	582,000	35 vjet	Nr.reference 22001848889,date 28.10.2022,leke 582.000
2	Konkurim	23.07.2019	A. P.	3.075	18,450	99 vjet	M.A.NR.938 ,date 13.12.2022,leke 18.450
					<b>600,450</b>		<b>600,450</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë/Drejtoria e Bujqësisë

➤ **Detyrimet e familjarëve**

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për qytetin dhe në NjA nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Rrogozhinë nuk ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor. Kjo nga ana e DAZHE na u komunikua si mungesë vullneti për bashkëpunim nga ana e UK sha, për arsye të problematikave të mbartura ndër vite të këtij enti.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumenti i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore vlera debitore për abonentët familjarë është në vlerën **174,195 mijë lekë**, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën **25,557 mijë lekë**; për vitin 2022 sipas rakordimit me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik detyrimi (për taksa ndërtesë, pastrim, gjelbërim, ndriçim) është **19,973 mijë lekë**, ndërsa vlera progresive e detyrimit është **227,045 mijë lekë**, *Vlerë e cilakonsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë*, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Nr	NjA	Detyrimi për taksat e tarifave viti 2022								Totali
		Ndërtesa		Pastrim		Ndriçim		Gjelbërim		
		Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	
1	Rrogozhinë	2321	5.709.839	2321	2.785.200	2321	928.400	2321	928.400	
2	Gosë	1478	2.064.180	1558	1.276.722	1812	543.789	1812	543.789	
3	Lekaj	814	513.229	1100	517.841	1210	303.182	1210	303.182	
4	Kryevidh	1660	1.267.250	681	730.860	1451	618.700	1451	618.700	
5	Sinaballaj	147	224.924	120	26.800	145	25.687	145	42.813	
	<b>Total</b>	<b>6420</b>	<b>9.779.422</b>	<b>5780</b>	<b>5.337.423</b>	<b>6939</b>	<b>2.419.758</b>	<b>6676</b>	<b>2.436.884</b>	<b>19,973,487</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë/DAZHE

Më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor 2022 si vijon:

Përshkrimi	Nr.	Vlera e borxhit progres. Më 31.12.2021	Nr.	Borxhi Krijuar gjatë vitit 2022	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2022
				<b>19,973,487</b>	<b>113,399,685</b>
Debitorë taksa e ndërtesës familje	6350	51.121.641	6486	9.779.422	60.901.063
Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim)	5708	42.304.557	6221	10.194.065	52.498.622
Debitorët taksa e tokës bujqësore	4353	104.378.062	4052	9.268.130	113.646.192
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.					
Debitorët qiratë					
<b>Total Borxhi</b>	<b>16,411</b>	<b>197,804,260</b>	<b>16,759</b>	<b>29,241,617</b>	<b>227,045,877</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë/DAZHE

Ndërsa një përmbledhje mbi historikun e “detyrimeve të familjarëve” për 3 vitet e fundit, pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Nr	Për abonentët familjar	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera

		Familje	progresive	Familje	progresive	Familje	
1	Taksa e tokës bujqësore	3958	69,876,578	4353	104,378,062	4052	9,268,130
2	Taksa pastrimi, gjelbërimi ndriçimi	5073	34,383,210	6350	51,121,641	6221	10,194,065
3	Taksa ndërtesë (objekt banimi)	5491	42,989,427	5708	42,304,557	6486	9,779,422
	<b>Nëntotal</b>		<b>147,249,215</b>		<b>197,804,260</b>		<b>29,241,617</b>
4	Taksa vaditje	296	254,750				
5	Te tjera	1003	1,138,000	873	2,101,000		
<b>B</b>	<b>SHUMA</b>		<b>148,641,965</b>		<b>199,905,260</b>		<b>29,241,617</b>

*Punuar: Grupi i auditimit*

Nga informacioni i vënë në dispozicion **u konstatua** se ka një rritje në 3 vitet e fundit të numrit të debitorëve që nuk kanë paguar “taksën e ndërtesës” me 217 nga 2020 në 2021 dhe me 778 nga 2021 në 2022. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “taksës së ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si edhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Kjo vihet re edhe në informacionin e paplotë të dhënë nga DAZHE/Bashkia Rrogozhinë mbi taksat dhe tarifatat vendore të miratuara me VKB në territorin e saj. Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mos marrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimin vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur edhe numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

➤ **Taksa e tokës bujqësore:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022 është prej 25.942.995 lekë dhe është arritur të vilet 21.540.668 lekë, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mos planifikim në vlerën **9,792 mijë lekë**, konkretisht:

**Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022**

Kategoria e tokës	Totali	Sip/HA NjA Kryevidh	Sip/HA NjA. Lekaj	Sip/HA NjA. Gosë	Sip/HA NjA. Sinaballaj	Sip/HA NjA. Rrogozhinë	Vlera/Ha sipas VKB	Pritshmëria vjetore Lekë
Kategoria II	853	270	215	368			4,900	4,179,700
Kategoria III	2,668	735	863	650		420	4,200	11,205,600
Kategoria IV	3,028	1,590	554	450	334	100	3,600	10,900,800
Kategoria V	2,323	1,185	105	540	442	51	3,000	6,969,000
Kategoria VI	569	203	343			23	2,400	1,365,600
Kategoria VII-X	619		263	345		11	1,800	1,114,200
<b>Totali</b>	<b>10,060</b>	<b>3,983</b>	<b>2,343</b>	<b>2,353</b>	<b>776</b>	<b>605</b>		<b>35,734,900</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë dhe auditimet e mëparshme të KLSH-së*

Sa më sipër **konstatohet** se Bashkia Rrogozhinë nuk disponon të dhëna mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” ç’ka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave për familje në NjA Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj dhe Rrogozhinë, është **10,060 ha** e ndarë kjo sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 70 datë 22.12.2021 (e rezultuar kjo edhe në paketën fiskale për vitin 2021), planifikimi i kësaj takse për vitin ushtrimor 2022 duhet të ishte në vlerën **35,734 mijë lekë** dhe jo në vlerën **25,942 mijë lekë** (sipas tabelës të plan/fakt të ardhurash), në fakt nga DAZHE Bashkia Rrogozhinë është realizuar në vlerën **21,540 mijë lekë**. Pra për dy vite radhazi planifikimi për të ardhurat nga toka bujqësore rezultoi në vlerë më të vogël prej 9,792 mijë lekë nga vlera e taksës që duhej të ishte llogaritur referuar kjo paketës fiskale 2021/2022 si dhe me trend në rënie nga viti 2021 në vitin 2022. Pra vlera 9,792 mijë lekë është vlerë e pa përfshirë në vlerën e planifikuar të taksës së tokës bujqësore dhe konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

- Nga auditimi rezultoi gjithashtu se, detyrimi i pa vjelë nga toka bujqësore deri në 31.12.2022 është si në tabelën më poshtë:

Nr.	NJA	Nr. Familjeve	Vlera 31.12.2022
1	Rrogozhinë	4138	1,605,923
2	Gosë	1266	1,828,753
3	Lekaj	912	811,682
4	Kryevidh	1172	4,666,435
5	Sinaballaj	382	355,334
	<b>Totali</b>	<b>7870</b>	<b>9,623,461</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Pra realizimi i vjeljes së taksës për vitin 2022 është (-) 4,402,327 lekë më pak nga planifikimi ose në masën 83%; Ndërsa deri në 31.12.2022 vlera e akumuluar e saj është për 7870 familjet debitore prej 9,623,461 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

- Z. R. S., Drejtor i Drejtorisë së të ardhurave dhe të zhvillimit ekonomik deri më 30.05.2022;
- Z. A. K. me pozicion Përgjegjës Sektori i biznesit dhe Kontabilizimit e të Ardhurave;
- Z. O. T. me pozicion Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nga 13.06.2022 e në vijim;
- Znj. M. Th përgjegjës i Sektorit të taksa e tarifa familjare;
- Z. A. H. specialist i të ardhurave e tarifave familjare;
- Znj. E. S. specialist i të ardhurave e tarifave familjare.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

- Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2022 në Bashkinë Rrogozhinë, është si mëposhtë:

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur/Pezullim Aktiviteti	Gjendja në fund të 2022
<b>NJA Rrogozhinë</b>						
1	Biznesi vogël		167	8	14	161
2	Biznes i madh		59	2	1	60
	<b>Gjithsej</b>	<b>2022</b>	<b>226</b>	<b>10</b>	<b>15</b>	<b>221</b>
<b>NJA Gosë</b>						
1	Biznesi vogël		91	9	8	92
2	Biznes i madh		21	2	2	21
	<b>Gjithsej</b>	<b>2022</b>	<b>112</b>	<b>11</b>	<b>10</b>	<b>113</b>
<b>NJA Lekaj</b>						
1	Biznesi vogël		52	3	8	47
2	Biznes i madh		11	1	1	11
	<b>Gjithsej</b>	<b>2022</b>	<b>63</b>	<b>4</b>	<b>9</b>	<b>58</b>
<b>NJA Kryevidh</b>						
1	Biznesi vogël		142	16	21	137
2	Biznes i madh		16	4	2	18
	<b>Gjithsej</b>	<b>2022</b>	<b>158</b>	<b>20</b>	<b>23</b>	<b>155</b>
<b>NJA Sinaballaj</b>						
<b>Nuk ka</b>						
1	<b>Nën total - Biznes i vogël</b>		<b>452</b>	<b>36</b>	<b>51</b>	<b>437</b>
2	<b>Nën total - Biznes i madh</b>		<b>107</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>110</b>
	<b>Totali</b>	<b>2022</b>	<b>559</b>	<b>45</b>	<b>57</b>	<b>547</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, rezultoi se Bashkia Rrogozhinë e ka mbyllur vitin 2021 me **559** biznese aktive në total, prej të cilëve 452 janë biznes i vogël dhe 107 janë biznes i madh; janë në total **45** regjistrime të reja nga të cilat 26 janë regjistrim për herë të parë, ku për biznesin e vogël janë 36 dhe për biznesin e madh janë 9; Shpërndarja e tyre sipas NJA është si vijon:

- NJA Sinaballaj vazhdon të mos ketë biznese të regjistruara në territorin e saj administrativ; numri më i lartë i regjistrimeve të reja gjatë vitit 2022 për biznesin e vogël është regjistruar në NJA Kryevidh me 16

dhe ai më i ulët në NJA Lekaj me 3; për biznesin e madh numri më i lartë i regjistrimeve është në NJA Kryevindh me 4 dhe ai më i ulët në NJA Lekaj me 1.

- Mbi mbylljen e aktivitetit në vitin 2022, Bashkia Rrogozhinë regjistron një numër prej **57** biznesesh në total, prej të cilëve 9 biznese janë me çregjistrim të përhershëm dhe 48 biznese çregjistruar përkohësisht, pasi janë me aktivitet sezonal. Kjo ka bërë që viti 2022 të mbyllet me një numër prej 547 biznesesh në total, pra me një diferencë prej (-)9 biznese më pak se viti 2021.

Nr	Subjekti	Veprimtaria	Nipti	Muaj i Cregjistrimit
1	F. D.	Argjendari	K.....A	Janar 2022
2	M. D.	Tregtim me pakice produkte mishi	L.....G	Mars 2022
3	R. B.	Riparime automjetesh.	L.....H	Mars 2022
4	H. H.	Farmaci veterinare	L.....A	Prill 2022
5	A. M.	Import-eksport tregtim materiale ndertimi, ferramente	L.....T	Prill 2022
6	A. M.	Berber	L.....V	Prill 2022
7	R. T.	Tregetim me pakice te artikujve te ndryshem ushqimore. Qender interneti.	L.....S	Maj 2022
8	A. B.	Punime hidraulike	L.....M	Shtator 2022
9	E. D.	Kancelari dhe kozmetike. Multimedia,punime te ndryshme.	L.....R	Dhjetor 2022

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë/DAZHE*

Referuar të dhënave të marra nga DAZHE Bashkia Rrogozhinë, situata e lëvizjes së subjekteve për tre vitet e fundit paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2020	463	18	38	443
		2021	453	47	42	458
		2022	452	36	51	437
2	Biznesi Madh	2020	86	1	2	85
		2021	87	3	2	88
		2022	107	9	6	110
(1+2)	Gjithsej	2020	549	19	40	528
		2021	540	50	44	546
		2022	559	45	57	547

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Rrogozhinë ndonëse ka 45 regjistrime të bizneseve të reja (të përhershme dhe sezonale), kjo është shoqëruar edhe me mbylljen (çregjistrimin e përhershëm) të aktivitetit të 9 bizneseve (48 janë sezonale), duke e çuar në 547 numrin e bizneseve aktive në fund të vitit 2022; gjithashtu rezultoi se ka trend në rënie numri i biznesit të vogël, kurse për biznesin e madh është trend në rritje. Për këtë nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, Koordinatori i Riskut, GMS, DAZHE, DLBNJ nuk kanë bërë asnjë analizë mbi risqet që ndikojnë dhe që kanë krijuar këtë situatë, me qëllim marrjen e masave për hartimin e planeve periodikë e vjetorë, për minimizimin e rasteve të mbylljes së aktivitetit të subjekteve tatimpaguese si dhe për të mbajtur në nivel të kënaqshëm të ardhurat që vilen nga aktiviteti i tyre; Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara në regjistra, sipas aktiviteteve, njoftimet mbi detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që u kërkuan për auditim, u konstatua se informacionet e vëna në dispozicion, nuk paraqesin të dhëna të analizuara për çdo zë tatimor që DAZHE/ Bashkia Rrogozhinë aplikon.

- Nga DAZHE Bashkia Rrogozhinë janë lidhur këto akt marrëveshje për biznese me aktivitet të ndryshëm, si më poshtë vijon:

Numri i Subjekteve 2022	Emërtimi	Sipërfaqe m2	çmimi	vlera
56	Stacion Plazhi Spille	139,085	200	27,817,000
18	Stacion Plazhi Vilë-Bashtovë	34,670	100	3,467,000
14	Autorizim për Tregtim Karburanti"			2,500,000
5	Vendosje kend Lojrash,Ambulant	360		307,200

*Burimi: DAZHE/Bashkia Rrogozhinë*

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik/Bashkia Rrogozhinë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së

ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> për Bashkinë Rrogozhinë. Llogaritja e vlerës është (Sip. Objektivit\* 32,105 \* 0.5 %). Grupi auditues kërkoi nga Drejtoria e Planifikimit Urban regjistrin e plotë të përfituesve nga legalizimet dhe që janë të detyruar të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë sipas akteve ligjore. Ky regjistër është përpiluar nga informacioni shkresor që ASHK Drejtoria Vendore Kavajë dhe ajo e Përgjithshme në periudha një mujore i kanë dërguar Bashkisë Rrogozhinë, listën e qytetarëve të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit. Kjo korrespondencë ka filluar me shkresën e nisur në datën 12.11.2021, me nr. 5333 prot. dhe në datë 13.11.2021, me nr. 4933/2 prot. ka patur përgjigje nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Kavajë. **U konstatua** se nuk kryhet Akt Rakordimi mes Bashkisë Rrogozhinë/DAZHE dhe ASHKDV Kavajë, por Bashkia Rrogozhinë mjaftohet vetëm me informacionin mujor shkresor që i nis zyrtarisht ASHK-DV Kavajë. Ky informacion duhet të përmbajë të gjithë parametrat mbi të cilët llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë. Në disa raste ky informacion ka qenë jo i plotë dhe kjo ka sjellë pamundësi të llogaritjes së taksës.

Drejtoria e Planifikimit Urban nuk ka krijuar nga ana e saj asnjë regjistër elektronik sipas kriterëve proceduriale dhe akteve ligjore/nënligjore mbi të cilat ajo ushtron funksionet e saj, ku të ketë të përcaktuar (emër mbiemër i subjektit, sipërfaqen e ndërtimit, funksionin e banimit/ ekonomik- verifikim nëse për të dyja ka të njëjtin nivel takse, detyrimin etj), përveç se listën e qytetarëve të cilët e kanë paguar detyrimin e tyre me shumën e paguar sipas viteve. Shkresa e dërguar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë në lidhje me numrin e qytetarëve të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit për periudhën 2015- 2020, është nisur nga Bashkia Rrogozhinë me nr. 5333 prot., datë 12.11.2021 dhe me nr. 4933/2 prot., datë 13.11.2021, ka patur përgjigje nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Kavajë. Në total për periudhën 2015- 2022 iu është miratuar leja e legalizimit 1621 subjekteve, nga të cilat 1018 subjekte rezultuan debitorë në vlerën 38,580,035 lekë dhe 13 subjekte me vlerën e detyrimit 439,493 lekë, janë dërguar gabimisht në Bashkinë Rrogozhinë, pasi i përkasin Bashkisë Kavajë<sup>11</sup>. Nga auditimi rezultoi se nga DPU Bashkia Rrogozhinë nuk iu është dërguar zyrtarisht informacioni dokumentar për 13 subjektet të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Kavajë, duke i lënë jashtë listës së debitorëve të saj. Deri në 31.12.2022 janë 603 subjekte që kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 26,778,170 lekë dhe 1018 debitorë ndaj Bashkisë Rrogozhinë që nuk e kanë shlyer detyrimin.

<b>Tabela përmbledhëse Pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e Legalizimit Janar 2016 - Dhjetor 2022</b>		
<b>Viti</b>	<b>Numri Praktikave</b>	<b>Shuma (lekë)</b>
<b>2016</b>	12	562,094
<b>2017</b>	7	218,511
<b>2018</b>	48	1,526,590
<b>2019</b>	138	6,967,473
<b>2020</b>	201	7,919,959
<b>2021</b>	97	4,739,931
<b>2022</b>	100	4,843,612
<b>Totali</b>	<b>603</b>	<b>26,778,170</b>

*Burimi: DPU/Bashkia Rrogozhinë*

**U konstatua** gjithashtu se nga këta, 57 debitorëve nuk iu është llogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë, pasi informacioni i ardhur nga ASHK- DV Kavajë nuk është i plotë me të gjithë parametrat e domosdoshëm mbi të cilët llogaritet taksa. Kështu, vlera e taksës së papaguar e 974 debitorëve është 39,019,528 lekë. Diferenca e papaguar për periudhën 2015- 2022 është më shumë se 38,580,035 lekë për 1018 subjekte dhe *konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Rrogozhinë*. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit Urban për vitin 2022 rezultoi të jenë arkëtuar 4,843,612 lekë për 100 subjekte; Ndërsa për 57 subjektet të cilëve nuk i është

<sup>11</sup> Drejtoria e Planifikimit Urban me informacionin që i kërkoi grupi i auditimit, e konstatoi këtë problematikë.

përcaktuar sipërfaqja, grupi auditues nuk e ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë, lista e detajuar paraqitet në Aneksin nr.4 bashkëlidhur.

- Nga auditimi **u konstatua** se DPU/Bashkia Rrogozhinë, nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik me të dhënat që përmban: Vendimi për lejen e legalizimit: numrin e Zonës kadastrale, numrin e pasurisë, numrin e Vendimit, datën e miratimit, sipërfaqen etj; por kjo drejtori informacionin e plotëson nga Vendimi i ardhur nga ASHKDV Kavajë, në momentin e paraqitjes së kërkesës së debitorit për pajisjen e tij me faturën e detyrimit. Kjo sjell mungesën e informacionit paraprak mbi detyrimin e secilit subjekt për taksën e ndikimit në infrastrukturë. - **U konstatua** gjithashtu se Bashkia Rrogozhinë për periudhën ushtrimore nuk ka njoftuar subjektet debitorë, nuk i është drejtuar zyrtarisht ASHKDV Kavajë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës, pa bërë më parë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Rrogozhinë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1. Për këtë ngarkohen me përgjegjësi Drejtorja e PZHU dhe DAZHE Bashkia Rrogozhinë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

A. Z. S. L., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban deri më 30.05.2022 dhe Z. G. Gj. për periudhën nga 31.05.2022 (kur është emëruar) e në vijim.

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se detyrimet e paguara ndër vite (progresive) nga 346 subjektet e biznesit të madh e biznesit të vogël dhe subjektet juridike (përfshirë ato shtetërore e publike), janë në total 40,215,142 lekë bashkë me penalitetet, ku për biznesin e vogël janë 295 subjekte ose 85 % e numrit total në vlerën e 28,124,416 lekë dhe për biznesin e madh janë 51 subjekte ose 15% e numrit total në vlerën 12,090,726 lekë. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për çdo Njësi administrative të Bashkisë Rrogozhinë.

Numri i Subjekteve debitore të biznesit të vogël dhe të madh/P.Juridik për periudhën nga 01.01.2011 deri më 31.12.2022 Bashki Rrogozhinë me NJA			
Numri	Debia	Penaliteti	Debia Totale (lekë)
<b>Bashkia Rrogozhinë /NJA Qendër      Biznesi i Vogël</b>			
130	12,643,407	2,130,400	14,773,807
NJA Gosë			
54	3,100,043	33,730	3,133,773
NJA Lekaj			
24	2,278,115	248,906	2,527,021
NJA Kryevidh			
87	6,933,530	756,285	7,689,815
<i>Nëntotali për Biznesin e Vogël</i>			
295	24,955,095	3,169,321	28,124,416
<b>Bashkia Rrogozhinë /NJA Qendër      Biznesi i Madh/P.Juridik</b>			
20	4,306,921	448,004	4,754,925
NJA Gosë			
12	2,642,680	50,420	2,693,100
NJA Lekaj			
9	2,546,692	175,179	2,721,871
NJA Kryevidh			
10	1,644,470	276,360	1,920,830
<i>Nëntotali për Biznesin e Madh</i>			
51	11,140,763	949,963	12,090,726
<i>Totali</i>			
346	36,095,858	4,119,284	40,215,142

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2020 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 1226 subjekte në vlerën totale të detyrimit 29,145,411 lekë;



për vitin 2021 janë 1357 subjekte me vlerën totale të detyrimit 33,793,835 lekë; për vitin 2022 janë 12918 debitorë në vlerën 26,643,829 lekë dhe me vlerë progresive deri më 31.12.2022 prej 154,675,658 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet në tabelën si vijon:

Nr.	Debitorët për subjektet fizik/ juridik/ shtetëror	Detyrime sipas viteve						Debia progresive 31.12.2022
		Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022		
		Nr.sub	Vlera	Nr.sub	Vlera	Nr.sub	Vlera	
1	Takse Ndertese familje	239	6,579,001	250	7,803,473	6486	9,779,422	60,901,063
2	Takse Tabele	165	946,490	195	1,042,080			
3	Takse Pastrimi	273	10,259,138	294	12,871,848			
4	Takse Ndrëçimi	222	615,470	262	790,223	6221	10,194,065	52,498.622
5	Takse Gjëlberimi	68	192,420	96	317,750			
6	Taksë Truall							
7	Biznes i Vogel	39	1,517,250	39	1,517,250	180	4,403,333	28,913.239
8	Kamatvonesa/Penalitet	69	1,340,489	97	1,737,305			
9	Biznes i madh					31	2,267,009	12,362.434
10	Taksë hoteli	14	951,790	14	1,079,540			
11	Te tjera...	137	6,743,363	110	6,634,366			
		<b>1226</b>	<b>29,145,411</b>	<b>1357</b>	<b>33,793,835</b>	<b>12918</b>	<b>26,643,829</b>	<b>154,675,658</b>
12	Taksë e tokës bujqësore					4052	9,268,130	113,646,192
<b>A</b>	<b>SHUMA</b>	<b>1226</b>	<b>29,145,411</b>	<b>1357</b>	<b>33,793,835</b>	<b>16970</b>	<b>35,911,959</b>	<b>268,321,850</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë/DAZHV

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Rrogozhinë, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- B. Z. R. S., Drejtor i Drejtorisë së të ardhurave dhe të zhvillimit ekonomik;
- C. Z. A. K. me pozicion Përgjegjës Sektori i biznesit dhe Kontabilizimit e të Ardhurave;
- D. Z. O. T. me pozicion Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik;
- E. Znj. M. Th përgjegjës i Sektorit të taksa e tarifa familjare;

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB konstatohet se në bashkinë Rrogozhinë gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 22 subjekte. Nga auditimi rezulton se Bashkia Rrogozhinë sipas Akt Konstatimit të datës 02.06.2020 ka

verifikuar subjektet që tregtojnë hidrokarbure në terren (me foto të bashkangjitura) dhe që rezultojnë aktiv në QKB, gjendja për subjektet është:

1. B. O. - mbyllur
2. S. P. A. - është i zëvendësuar me A.
3. K. O. - është i zëvendësuar me B. O.
4. K. O. - mbyllur
5. K. P. - mbyllur
6. P. P. - mbyllur

Në total rezultojnë 22 subjekte, që në mënyre të detajuar sipas problematikës paraqiten si më poshtë:

Nr	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Aktiviteti	Vlera per tu paguar	Pagesat e kryera	Detyrimi
			Fillimi	Mbarimi				
1	M. O.	J.....Q	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
2	G. C. G	K.....T	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
3	A. 1	L.....E	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
4	A. 2	L.....E	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
5	E.	J.....J	05.01.2022	05.01.2023	Karburant	200,000	200,000	
6	G. C.	K.....T	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
7	A. T.	L.....Q	15.02.2021	15.02.2026	Karburant	100,000	100,000	
8	M. O.	J.....Q	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
9	A.O.	K.....R	16.09.2021	16.09.2022	Karburant	200,000	200,000	
10	R.	K.....C	05.08.2019	05.08.2024	Lëndë djegëse	100,000	100,000	
11	K.G.	K.....F	01.01.2021	15.06.2026	Lëndë Djegëse	100,000	100,000	
12	O. Shpk	J.....I	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
13	Sh.G.	L.....S	01.01.2022	31.12.2022	Karburant	200,000	200,000	
14	K.O.	L.....T	04.9.2021	04.09.2022	Karburant	200,000	200,000	
15	A.M.	L.....I	Pa Autorizim	Pa Autorizim	Lëndë Djegëse	100,000		100,000
16	K. P.	L.....O	Pa autorizim		Karburant	Mbyllur		
17	K. O.zv B. O.	L.....M	PaAutorizim		Karburant	1,000,000		1,000,000
18	B.G.	J.....M	Pa Autorizim	Pa Autorizim	Karburant	1,000,000		1,000,000
19	P.P	K.....K	Pa Autorizim	Pa Autorizim	Karburant	Likuidim		
20	B.O.	L.....N	Pa Autorizim	Pa Autorizim	Karburant	Mbyllur		
21	E.B.	L.....G	Pa Autorizim	Pa Autorizim	Karburant	1,000,000		1,000,000
22	S.P.A.	L.....M	Pa Autorizim	Pa Autorizim	Karburant	1,000,000		1,000,000
<b>Totali</b>						<b>6,600,000</b>	<b>2,500,000</b>	<b>4,100,000</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë përpunuar nga grupi i auditimit.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2022 ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, **u konstatua** se vetëm 3 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar rregullisht detyrimet në vlerën e 100,000 lekë secila dhe 300,000 lekë në total; 5 subjekte në vlerën **4,100,000** lekë të cilat nuk kanë paguar detyrimet si dhe kanë qenë të pa pajisura me autorizim, *vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë*; ndërsa 11 subjekte janë pajisur me autorizim 1 vjeçar të cilët kanë paguar detyrimet në total në vlerën 2,500,000 lekë, pajisja me autorizim për afatin 1 vjeçar është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15;

Lidhur me 5 subjektet të cilat janë konstatuar me aktivitet të mbyllur në terren, nga ana e DAZHE na u bë me dije se gjatë vitit 2022 i është dërguar për bllokim të llogarive bankare të subjekteve debitore, gjithë bankave të nivelit të dytë dhe së fundmi rikërkuar me shkresën nr. 599 prot., datë 13.02.2023 ndaj subjektit debitor “A.M.”. Theksojmë se nga ana e DAZHE kjo është e vetmja masë që është marrë ndaj këtyre subjekteve debitore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

F. R. S., Drejtor i DAZHE deri në 31/05/2022 dhe Z.O. T. për periudhën nga 14/06/2022 (data e emërimit) e në vijim;

➤ ***Burimi i krijimit të të ardhurave, nga gjobat e IMTV***

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të IMTV të Bashkisë Rrogozhinë, u kërkua informacion i detajuar për periudhën 01.10.2018 deri 31.12.2022, nga IMTV/Bashkia Rrogozhinë. Gjatë periudhës objekt auditimi IMTV-ja ka ushtruar funksionin publik duke u bazuar në ligjin nr. 183/2014, datë 24/2014 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga veprimet e kundërligjshme” sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji. IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë, ka bashkëpunuar rregullisht me Zyrën e Urbanistikës, me Policinë Bashkiake, me Zyrën e Shërbimeve, me IKMT, Qendrore në Tiranë.

Nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.01.2018 deri në 31.012.2022 nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Rrogozhinë, janë 8 gjoba të vendosura prej 2018 deri në 2021 në vlerën e 2,650,000 lekë dhe 7 gjoba të vendosura në vitin 2022 në vlerën 3,050,000 lekë. Një informacion i detajuar pasqyrohet në tabelën mëposhtme:

Nr	Subjekti	Nr. data e Vendimit	Arsyeja gjobës	Vlera gjobës	Totali
1	R. M.	Nr. 01 dt 13.08.2018	Punime pa leje	50,000	50,000
2	Xh.K.	Nr. 02 dt 30.08.2018	Punime pa leje	500,000	500,000
3	K.A.	Nr. 03 dt 16.05.2019	Punime pa leje	500,000	500,000
4	A.M.	Nr. 04 dt 16.05.2019	Tejkalim Leje	50,000	50,000
5	R.Xh.	Nr. 05 dt 16.07.2019	Punime pa leje	500,000	500,000
6	L.C.	Nr. 06 dt 29.06.2020	Punime pa leje	500,000	500,000
7	G.G.	Nr. 07 dt 26.06.2021	Punime pa leje	50,000	50,000
8	N.D.	Nr. 08 dt 08.07.2021	Punime pa leje	500,000	500,000
	<b>Nëntotali I</b>			<b>2,650,000</b>	<b>2,650,000</b>
9	G.H.	Nr. 09 dt 07.02.2022	Punime pa leje	500,000	500,000
10	A.K.	Nr. 10 dt 07.02.2022	Punime pa leje	500,000	500,000
11	D.H.	Nr. 11 dt 03.03.2022	Punime pa leje	500,000	500,000
12	P.Gj.	Nr. 12 dt 03.03.2022	Punime pa leje	500,000	500,000
13	S.B.	Nr. 13 dt 16.05.2022	Punime pa leje	500,000	500,000
14	I.Sh.	Nr. 14 dt 30.05.2022	Punime pa leje	500,000	500,000
15	Sh.O.	Nr.15 dt.02.08.202	Dënim me gjobë	50,000	50,000
	<b>Nëntotali II</b>			<b>3,050,000</b>	<b>3,050,000</b>
	<b>Totali Gjendje 31.12.2022</b>			<b>5,700,000</b>	<b>5,700,000</b>

Burimi: *Bashkia Rrogozhinë/IMTV*

Sa më sipër u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Rrogozhinë janë vendosur 7 gjoba me vlerën në total 3,050,000 lekë; ndërsa bashkë me ato të vendosura në periudhat e mëparshme janë 15 gjoba në vlerën **5,700,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që dhe nuk ka filluar procesi i kërkimit të tyre. Nga informacioni verbal i komunikuar, rezultoi se kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis IMTV dhe Drejtorisë Ligjore, për ndjekjen e hapave administrativë e ligjorë me qëllim arkëtimin e vlerës së gjobave nga ana e debitorit, duke mos e lënë në likujdimin vullnetar (si edhe na u komunikua nga bashkia Rrogozhinë), duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 5,700,000 lekë.

**a-neni 16**, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të

prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-**Neni 15**-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni )(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

b- Nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

c- Nga Drejtoria Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

d- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike në Bashkinë Rrogozhinë nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat të vendimeve të gjobave në vlerën **5,700,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile në RSH" i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit dhe nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z. D.D. me detyrë Kryeinspektor i IMTV

#### **➤ Shlyerja e detyrimeve të prapambetura me këste**

Nga DAZHE /Bashkia Rrogozhinë për shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura, është aplikuar edhe lidhja e Akt marrëveshjeve për pagesë me këste nga ana e debitorëve.

Nr.	Akt-marrëveshja	Detyrimi total në lekë	Pagesa deri në 30%	Detyrimi në marrëveshje	Shuma e paguar në lekë	Paguar në %	Shuma e mbetur 31.12.2022
1	A.SH.	810.825	270.305		342.445	42	468.380
2	M.Xh.	251.095	25.620		99.840	39.7	151.255
3	Z.D.	181.120	40.000	141.120	20.000	33	121.120
	<b>Totali</b>	<b>1,243,040</b>	<b>335,925</b>		<b>502,285</b>	<b>40.4</b>	<b>740,755</b>

Burimi: DAZHE/Bashkia Rrogozhinë

Nga të dhënat e pasqyruara rezultojnë se deri më 31.12.2022 janë paguar me këste 502,285 lekë ose rreth 40.4% e vlerës totale. Pagesat nga ana e subjekteve janë konform akt marrëveshjeve.

#### **Konkluzion:**

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë për periudhën 2015-2022 në vlerën totale (progresive) **391,521 mijë lekë**.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve për vitin 2022 në vlerën **29,241,617 lekë** dhe në vlerën progresive **227,045,877 lekë**.
2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit për vitin 2022 në vlerën **26,643,829 lekë** dhe vlera progresive **154,675,658 lekë**;
3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për periudhën 2015-2022 në vlerën **38,580,035 lekë**.
4. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën **4,100,000 lekë**.
5. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMTV në vlerën **5,700,000 lekë**.

**Titulli i gjetjes 6:** Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

**Situata: I Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

1. Nga auditimi u konstatua se në strukturën organizative të DAZHE/ Bashkia Rrogozhinë, janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit, si ajo e drejtorit dhe e 3 specialistëve, që ndonëse me profilin e

duhur arsimor, nuk ka rezultuar me zgjidhjen e problematikave të trashëguara ndër vite, uljen e borxhit tatimor të njësisë; mungesa e një specialisti IT në strukturën e DAZHE ka sjellë mungesën e krijimit të një regjistri të plotë elektronik të subjekteve taksapaguese si dhe në mos evidentimin në kohë reale të subjekteve (ose vonesa në evidentimin e tyre), mos llogaritjen e detyrimeve fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018;

### II Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

**2.** - Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtoria e të Ardhurave, duke mos patur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Kavajë (ASHKK);

- Drejtoria e të ardhurave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Rrogozhinë, nuk ka dërguar njoftim detyrimi për këto familje, baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Nga ana e DAZHE na u komunikua se UK Rrogozhinë nuk pranon bashkëpunim për të marrë mbi vete rolin e agjentit tatimor, kjo për shkak të problemeve të tyre të akumuluar. Në këto kushte deri në fund të vitit 2022 Akt rakordimet me agjentët tatimorë UK Rrogozhinë dhe ASHKDVK *rezultojnë të mos jenë mbajtur*;

- Ndërsa janë bërë akt rakordime me DRSHTRR në modelin e një proces-verbali, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk është konfirmuar baza e të dhënave statistikore mbi të cilën janë bërë llogaritjet dhe është vlerësuar niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime të cilat janë në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve;

### III Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

**3.** Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 5311 prot., datë 06.12.2019 (e cila nuk është përditësuar), nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

- Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ZVRPP Kavajë, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, *nuk janë kryer*;

- Renta Minerare nga Agjentët Tatimorë “Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Durrës”. Në zbatim të të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, Neni 4 “Niveli i Taksave Kombëtare”, pika 4, të Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008, dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, sipas shtojcën 2 të këtij ligji, niveli i Rentës Minerare varion nga 4 deri në 10%, sipas llojit të mineralit. Rakordimet me Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Durrës, për Rentën Minerare, *nuk janë kryer*. Nga administrata tatimore e Bashkisë Rrogozhinë, nuk është ushtruar kujdesi i duhur për të arkëtuar të ardhurat nga veprimtaria minerare e dy subjekteve debitore;

### IV. Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore

**4.** Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, rezultoi se 2 subjekte:

- Subjekti “P.M.” me kontratën e lidhur në vitin 2013 dhe vlerën e kontratës 38,500 lekë me afat 10 vjeçar, rezultoi se deri më 03.02.2023 nuk ka kryer pagesë pra është debitor në vlerë të plotë 38,500 lekë;

- Subjekti “S.Gj.” me kontratën e lidhur në fund të vitit 2021 dhe vlerën e kontratës 2,475,500 lekë me afat 10 vjeçar, rezultoi se deri më 03.02.2023 nuk ka kryer pagesë, pra është debitor në vlerë të plotë 2,475,500 lekë. Të dyja këto subjekte janë njoftuar me shkresat nr. 490 prot., dt.03.02.2023 dhe nr. 489 prot., dt.03.02.2023. U konstatua se nga Drejtoria e Bujqësisë e vetmja masë për vjeljen e detyrimeve është njoftimi zyrtar i Subjekteve debitore, ndonëse Subjektit “P.M.” i përfundon afati në dt.17.07.2023 dhe ka një detyrim me një vlerë relativisht të vogël prej 38,500 lekë;

#### V. Detyrimet e familjarëve

5. - Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore vlera debitore për abonentët familjarë është në vlerën **174,195 mijë lekë**, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën **25,557 mijë lekë**; për vitin 2022 sipas rakordimit me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik detyrimi (për taksa ndërtese, pastrim, gjelbërim, ndriçim) është **19,973 mijë lekë**, ndërsa vlera progresive e detyrimit është **227,045 mijë lekë**, Vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar;

- Nga informacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ka një rritje në 3 vitet e fundit të numrit të debitorëve që nuk kanë paguar “taksën e ndërtesës” me 217 nga 2020 në 2021 dhe me 778 nga 2021 në 2022. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarië së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “taksës së ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si edhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Kjo vihet re edhe në informacionin e paplotë të dhënë nga DAZHE/Bashkia Rrogozhinë mbi taksat dhe tarifave vendore të miratuara me VKB në territorin e saj. Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mos marrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimin vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur edhe numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.;

#### VI. Taksa e tokës bujqësore

6. -Nga auditimi u konstatua se Bashkia Rrogozhinë nuk disponon të dhëna mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave për familje në NjA Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj dhe Rrogozhinë, është **10,060 ha** e ndarë kjo sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 70, datë 22.12.2021 (e rezultuar kjo edhe në paketën fiskale për vitin 2021), planifikimi i kësaj takse për vitin ushtrimor 2022 duhet të ishte në vlerën **35,734 mijë lekë** dhe jo në vlerën **25,942 mijë lekë** (sipas tabelës të plan/fakt të ardhurash), në fakt nga DAZHE Bashkia Rrogozhinë është realizuar në vlerën **21,540 mijë lekë**. Prapër dy vite radhazi planifikimi për të ardhurat nga toka bujqësore rezultoi në vlerë më të vogël prej **9,792 mijë lekë** nga vlera e taksës që duhej të ishte llogaritur referuar kjo paketës fiskale 2021/2022 si dhe me trend në rënie nga viti 2021 në vitin 2022. Pra vlera 9,792 mijë lekë është vlerë e pa përfshirë në vlerën e planifikuar të taksës së tokës bujqësore dhe konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

- Nga auditimi rezultoi gjithashtu se, detyrimi i pa vjelë nga toka bujqësore deri në 31.12.2022, realizimi i vjeljes së taksës për vitin 2022 është (-) 4,402,327 lekë më pak nga planifikimi ose në masën 83%; Ndërsa deri në 31.12.2022 vlera e akumuluar e saj është për 7870 familjet debitore prej 9,623,461 lekë;

#### VII. Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave

7. Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Rrogozhinë ndonëse ka 45 regjistrime të bizneseve të reja (të përhershme dhe sezonale), kjo është shoqëruar edhe me mbylljen (çregjistrimin e përhershëm) të aktivitetit të 9 bizneseve (48 janë sezonale), duke e çuar në 547 numrin e bizneseve aktive në fund të vitit 2022; gjithashtu rezultoi se ka trend në rënie numri i biznesit të vogël, kurse për biznesin e madh është trend në rritje. Për këtë nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, Koordinatori i Riskut, GMS, DAZHE, DLBNJ nuk kanë bërë asnjë analizë mbi risqet që ndikojnë dhe që kanë krijuar këtë situatë, me qëllim marrjen e

masave për hartimin e planeve periodikë e vjetorë, për minimizimin e rasteve të mbylljes së aktivitetit të subjekteve tatimpaguese si dhe për të mbajtur në nivel të kënaqshëm të ardhurat që vilen nga aktiviteti i tyre; Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara në regjistra, sipas aktiviteteve, njoftimet mbi detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që u kërkuan për auditim, u konstatua se informacionet e vëna në dispozicion, nuk paraqesin të dhëna të analizuara për çdo zë tatimor që DAZHE/ Bashkia Rrogozhinë aplikon;

**VIII. Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

**8.** - Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik/Bashkia Rrogozhinë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> për Bashkinë Rrogozhinë. Llogaritja e vlerës është (Sip. Objektivit\* 32,105 \* 0.5 %). Grupi auditues kërkoi nga Drejtoria e Planifikimit Urban regjistrin e plotë të përfutësve nga legalizimet dhe që janë të detyruar të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë sipas akteve ligjore. Ky regjistër është përpiluar nga informacioni shkresor që ASHK Drejtoria Vendore Kavajë dhe ajo e Përgjithshme në periudha një mujore i kanë dërguar Bashkisë Rrogozhinë, listën e qytetarëve të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit. Kjo korrespondencë ka filluar me shkresën e nisur me nr. 5333 prot., datën 12.11.2021, dhe me nr. 4933/2 prot., datë 13.11.2021, ka patur përgjigje nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Kavajë. U konstatua se nuk kryhet Akt Rakordimi mes Bashkisë Rrogozhinë/DAZHE dhe ASHKDV Kavajë, por Bashkia Rrogozhinë mjaftohet vetëm me informacionin mujor shkresor që i nis zyrtarisht ASHK-DV Kavajë. Ky informacion duhet të përmbajë të gjithë parametrat mbi të cilët llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë. Në disa raste ky informacion ka qenë jo i plotë dhe kjo ka sjellë pamundësi të llogaritjes së taksës;

- Drejtoria e Planifikimit Urban nuk ka krijuar nga ana e saj asnjë regjistër elektronik sipas kriterëve proceduriale dhe akteve ligjore/nënligjore mbi të cilat ajo ushtron funksionet e saj, ku të ketë të përcaktuar (emër mbiemër i subjektit, sipërfaqen e ndërtimit, funksionin e banimit/ ekonomik- verifikim nëse për të dyja ka të njëjtin nivel takse, detyrimin etj), përveç se listën e qytetarëve të cilët e kanë paguar detyrimin e tyre me shumën e paguar sipas viteve. Shkresa e dërguar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë në lidhje me numrin e qytetarëve të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit për periudhën 2015- 2020, është nisur nga Bashkia Rrogozhinë në datë 12.11.2021 me nr. 5333 prot. dhe në datë 13.11.2021, me nr. 4933/2 prot. ka patur përgjigje nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Kavajë. Në total për periudhën 2015- 2022 iu është miratuar leja e legalizimit 1621 subjekteve, nga të cilat 1018 subjekte rezultuan debitore në vlerën 38,580,035 lekë dhe 13 subjekte me vlerën e detyrimit 439,493 lekë, janë dërguar gabimisht në Bashkinë Rrogozhinë, pasi i përkasin Bashkisë Kavajë<sup>12</sup>. Nga auditimi rezultoi se nga DPU Bashkia Rrogozhinë nuk iu është dërguar zyrtarisht informacioni dokumentar për 13 subjektet të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Kavajë, duke i lënë jashtë listës së debitorëve të saj. Deri në 31.12.2022 janë 603 subjekte që kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 26,778,170 lekë dhe 1018 debitorë ndaj Bashkisë Rrogozhinë që nuk e kanë shlyer detyrimin;

- U konstatua gjithashtu se nga këta, 57 debitorëve nuk iu është llogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë, pasi informacioni i ardhur nga ASHK- DV Kavajë nuk është i plotë me të gjithë parametrat e domosdoshëm mbi të cilët llogaritet taksa. Kështu, vlera e taksës së papaguar e 974 debitorëve është 39,019,528 lekë. Diferenca e papaguar për periudhën 2015- 2022 është më shumë se 38,580,035 lekë për 1018 subjekte dhe konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Rrogozhinë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit Urban për vitin 2022 rezulton të jenë arkëtuar 4,843,612 lekë për 100 subjekte; Ndërsa për 57 subjektet të cilëve nuk i është përcaktuar sipërfaqja, grupi auditues nuk ka mundur të llogarisë taksën e ndikimit në infrastrukturë;

- Nga auditimi u konstatua se DPU/Bashkia Rrogozhinë, nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik me të dhënat që përmban Vendimi për lejen e legalizimit: numrin e Zonës kadastrale, numrin e

<sup>12</sup>Drejtoria e Planifikimit Urban me informacionin që i kërkoi grupi i auditimit, e konstatoi këtë problematikë.

pasurisë, numrin e Vendimit, datën e miratimit, sipërfaqen etj; por kjo drejtori informacionin e plotëson nga Vendimi i ardhur nga ASHKDV Kavajë, në momentin e paraqitjes së kërkesës së debitorit për pajisjen e tij me faturën e detyrimit. Kjo sjell mungesën e informacionit paraprak mbi detyrimin e secilit subjekt për taksën e ndikimit në infrastrukturë;

- U konstatua gjithashtu se Bashkia Rrogozhinë për periudhën ushtrimore nuk ka njoftuar subjektet debitorë, nuk i është drejtuar zyrtarisht ASHKDV Kavajë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës, pa bërë më parë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Rrogozhinë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1;

#### **IX. Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore**

**9.** Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2020 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 1226 subjekte në vlerën totale të detyrimit 29,145,411 lekë; për vitin 2021 janë 1357 subjekte me vlerën totale të detyrimit 33,793,835 lekë; për vitin 2022 janë 12918 debitorë në vlerën 26,643,829 lekë dhe me vlerë progresive deri më 31.12.2022 prej 154,675,658 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë;

#### **X. Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

**10.** - Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB konstatohet se në bashkinë Rrogozhinë gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 22 subjekte. Nga auditimi rezultoi se Bashkia Rrogozhinë sipas Akt Konstatimit të datës 02.06.2020 ka verifikuar subjektet që tregtojnë hidrokarbure në terren (me foto të bashkangjitura) dhe që rezultojnë aktiv në QKB.

Në total rezultojnë 22 subjekte, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nga Bashkia Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2022 ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua gjithashtu se vetëm 3 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar rregullisht detyrimet në vlerën e 100,000 lekë secila dhe 300,000 lekë në total; 5 subjekte në vlerën **4,100,000** lekë të cilat nuk kanë paguar detyrimet si dhe kanë qenë të pa pajisura me autorizim, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë; ndërsa 11 subjekte janë pajisur me autorizim 1 vjeçar të cilët kanë paguar detyrimet në total në vlerën 2,500,000 lekë, pajisja me autorizim për afatin 1 vjeçar është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15;

- Lidhur me 5 subjektet të cilat janë konstatuar me aktivitet të mbyllur në terren, nga ana e DAZHE na u bë me dije se gjatë vitit 2022 i është dërguar për bllokim të llogarive bankare të subjekteve debitore, gjithë bankave të nivelit të dytë dhe së fundmi rikërkuar me shkresën nr. 599 prot., datë 13.02.2023 ndaj subjektit debitor “A.M.”. Thëksojmë se nga ana e DAZHE/Bashkia Rrogozhinë kjo është e vetmja masë që është marrë ndaj këtyre subjekteve debitore;

#### **XI. Burimi i krijimit të të ardhurave nga gjocat e IMTV**

**11.** Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Rrogozhinë janë vendosur 7 gjoba me vlerën në total 3,050,000 lekë; ndërsa bashkë me ato të vendosura në periudhat e mëparshme janë 15 gjoba në vlerën **5,700,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që dhe nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre. Nga informacioni verbal i komunikuar, rezultoi se kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis IMTV dhe Drejtorisë



Ligjore, për ndjekjen e hapave administrativë e ligjorë me qëllim arkëtimin e vlerës së gjobave nga ana e debitorit, duke mos e lënë në likuidimin vullnetar (si edhe na u komunikua nga bashkia Rrogozhinë), duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 5,700,000 lekë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare” Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve; Me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1;nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. E VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar; Neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime; Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - Nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

**Ndikimi:** Mos vjelja në kohë e taksave dhe tarifave vendore; mos vjelja e gjobave të vendosura nga IMT -ja si dhe mos zbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje; mos hartimi i një plani masash për arkëtimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura, ka çuar në mungesë të ardhurash në një vlerë totale progresive prej 391,521 mijë lekë për periudhën 2015-2022;

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit mes njërive të strukturës së Bashkisë Rrogozhinë: Drejtoria e të ardhurave dhe Zhvillimit ekonomik, Drejtoria Ligjore, Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Drejtoria e Planifikimi Urban dhe Policia Bashkiake, për ndjekjen e të gjitha hapave administrativë e ligjorë për arkëtimin e detyrimeve;

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** 1. DAZHE/Bashkia Rrogozhinë të marrë masat për krijimin e një regjistri elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit;

2. Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, GMS dhe DAZHE të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me

qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;

**3. DAZHE** të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Rrogozhinë nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë sakt mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Rrogozhinë të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

**4. DAZHE/Bashkia Rrogozhinë**, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore progresive në vlerën totale 343,141 mijë lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

- Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me NjA, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj;

**5. Drejtoria e Planifikim Urban** në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 38,580,035 lekë dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Kavajë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**6. DAZHE** në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 5 subjekteve për arkëtimin e vlerës 4,100,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre;

**7. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike**, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutivë, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së paguar në vlerën totale 5,700,000 lekë.

### **2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.**

#### **▪ Hartimi i pasqyrave financiare**

Bashkia Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2022 ka plotësuar pasqyrat financiare sipas formateve nga 1-8, të cilat i ka dorëzuar në Degën e Thesarit Kavajë dhe regjistruar me nr. 150 prot., në datën 04.04.2023.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon:

Format 1 - Pasqyra e Pozicionit Financiar,

Format 2 - Pasqyra e Performancës Financiare,

Format 3 - Pasqyra e Flukseve Monetare,

Format 4 - Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto,

Format 5 – Pyetëtori dhe Shënime Shpjeguese,

Format 6 - Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit,

Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike,

Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto,

Format 8 - Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2022 janë bërë duke kryer

paraprkisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në programin *Microsoft Excel*;

▪ **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare i përkasin Bashkisë Rrogzohinë, janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; nga auditimi **u konstatuase** për vitin ushtrimor 2022 janë dërguar në Degën e Thesarit Kavajë me shkresën nr. 1394 prot., datë 04.04.2023 dhe me nr. 150 prot., datë 04.04.2023 të Degës së Thesarit Kavajë, në tejkalim të afatit ligjor datë 31 Mars 2023.

▪ **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin ushtrimor 2022 rezulton verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ekstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

➤ **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues;
- Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin "Microsoft Excel";
- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, aktmarrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësish ekonomike.

➤ **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësish për aktivitetin ekonomik –financiar të vitit 2022. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës së Drejtorisë Financës dhe Mbështetjes Sociale. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

**1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

Aktiviteti neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet

	Viti 2021	Viti 2022
Aktivitet	2,382,116,597 lekë	2,609,094,841 lekë
Pasivitet	307,391,148 lekë	159,542,135 lekë
Aktivitet neto	2,074,725,449 lekë	2,449,552,706 lekë

**Aktivitet afatshkurtra**

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 650,029471 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 390,432,908lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 31,416,308 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 149,830,275 lekë dhe

“Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 78,359,980 lekë.

**Llogaritë e Klasës 5** “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën e 386,584,108 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 83,338,096 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-floë), sipas metodës direkte. përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare në arkë			
512	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	386,541,108	83,338,096	303,203,012
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera	3,891,800	4,929,200	-1,037,400
54	Akredeitiva dhe paradhënie			
59	Provizione zhvlerësimi			
<b>Totali</b>		<b>390,432,908</b>	<b>88,267,296</b>	<b>302,165,612</b>

**Vlera e llogarisë 520** “Disponibilitete në thesar” në shumën 386,541,108 lekë, përbëhet nga gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 49,758,728 lekë. Llog.466 “Mjetet në ruajtje” përbën

garancinë e punimeve e cila e shpërndarë sipas viteve është: për vitin 2021 ka vlerën 40,629,939 lekë, është ngurtësuar gjatë vitit 2022 me 4,281,793 lekë dhe shtuar në shumën 13,410,582 lekë.

**Llog. 532** “Vlera të tjera” pasqyrohet në vlerën 4,929,200 lekë në mbyllje të vitit 2021 dhe në vlerën 3,891,800 lekë në mbyllje të vitit 2022, me një diferencë prej (-)1,037,400 lekë; Analiza e kësaj llogarie është si më poshtë:

	Gjendja e letrave me vlerë Gj.Civile + Blloqe bileta 2022		Hyrje	Dalje	Gjendja fund
1	NJA Lekaj	378,000.00	-	155,950.00	222,050.00
2	NJA Rrogozhine	557,050.00	630,000.00	763,000.00	424,050.00
3	NJA Gose	900,250.00	-	39,700.00	860,550.00
4	NJA Kryevindh	435,500.00	-	144,750.00	290,750.00
	<b>Nëntotali I</b>	<b>2,270,800.00</b>	<b>630,000.00</b>	<b>1,103,400.00</b>	<b>1,797,400.00</b>
1	Blloqe bileta.	3,288,400.00	3,500.00	1,197,500.00	2,094,400.00
	<b>Nëntotali II</b>	<b>3,288,400.00</b>	<b>3,500.00</b>	<b>1,197,500.00</b>	<b>2,094,400.00</b>
	<b>Totali</b>	<b>5,559,200.00</b>	<b>633,500.00</b>	<b>2,300,900.00</b>	<b>3,891,800.00</b>

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

**Llogaritë e Klasës 3** “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	21,535,300	20,228,967	1,306,333
32	Objekte inventari	9,881,008	9,873,316	7,692
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	<b>Totali</b>	<b>31,416,308</b>	<b>30,102,283</b>	<b>1,314,025</b>

**Llogaritë e Klasës 3**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Rrogozhinë në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 31,416,308 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 21,535,300 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 “Objekte inventari” në vlerën 9,881,008 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (-)1,314,025 lekë.

**Llogaria 312** “Materiale”, në fillim të vitit 2022 ka vlerën 20,228,967 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	20,228,967
Hyrje gjatë vitit 2021	20,092,792
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	18,786,459
Gjendja në 31.12.2021	21,535,300

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

**Llogaria 327** “Objekte inventari”, në fund të vitit 2022 ka vlerën 9,881,008 lekë dhe përpunet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	9,873,316
Hyrje gjatë vitit 2022	3,940,808
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	3,933,116
Gjendja në 31.12.2022	9,881,008

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit". Titullari i ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve që klasifikohen të dëmtuara.<sup>13</sup>

**Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2021-2020
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>149,830,275</b>	<b>224,608,107</b>	<b>-74,777,832</b>
411	Klientë e llogari te ngjashme			0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	5,447,339	3,697,156	1,750,183
431	Tatime e taksa			0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal			0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			0
435	Sigurime Shoqërore			0
436	Sigurime Shëndetësore			0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			0
44	Institucione te tjera publike			0
466	Kreditore per mjete ne ruajtje			0
468	Debitorë të ndryshëm	38,491,329	56,409,159	-17,917,830
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	105,891,607	164,501,792	-58,610,185
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit			0
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)			0
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>78,359,980</b>	<b>93,866,290</b>	<b>-15,506,310</b>
409	Furnitore(Debitor),parapagime pagesa pjesore			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	78,359,980	93,866,290	-15,506,310
	<b>Totali</b>	<b>228,190,255</b>	<b>318,474,397</b>	<b>-90,284,142</b>

"Llogari të arkëtueshme" për vitin 2022 është në shumën 149,830,275 lekë dhe në vitin 2021 është 224,608,107 lekë me një diferencë prej -74,777,832 lekë. Ky pakësim ka ardhur si rezultat i pagesave ndaj kreditorëve dhe konkretisht: rënies së llog. 468 "debitorë të ndryshëm" në shumën (-)17,917,830 lekë, llog. 4342 "të tjera operacione me shtetin (debitor)" me shumën (-)58,610,185 lekë dhe rritjes së llog. 423,429 "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba" me 1,750,183 lekë.

**Llog. 423-429** "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,697,156 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,447,339 lekë, gjendje e cila përfaqëson detyrimet e 26 punonjësve, ku për 10 prej tyre të lindura nga rekomandimet "shpërblim dëmi" të lëna nga KLSH ndër vite, për të cilat nga Bashkia nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet. Analiza e kësaj llogarie është si më poshtë:

Nr i punonjësve	Gjendje 31.12.2021	Hyrje 2022	Dalje 2022	Gjendje 31.12.2022
10	3,697,156			
16		1,878,303	128,120	1,750,183
26				5,447,339

**Llogaria 468** "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në fund të vitit 2021 është 56,409,159 lekë dhe në mbylljet e vitit 2022 është në vlerën 38,491,329 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	56,409,159
Shtesa gjatë vitit 2022	422,147

<sup>13</sup>Trajtohet në rubrikën për inventarizimin

Pakesime gjatë vitit 2022	5,026,317
Gjendja në 31.12.2022	38,491,329
<b>Diferenca</b>	<b>-17,917,830</b>

Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie vjen në rënie në shumën e (-)17,917,830 lekë, por ende në vlera të larta pasi vlerës së llogarisë 429 i bashkëngjitet edhe vlera e debitorëve nga taksat e tarifit. Analiza e kësaj llogarie është si më poshtë:

Nr	Debitorët Llog.468	Gjendje 01.01.2022	Shtesa 2022	Pagesa 2022	Gjendje 31.12.2022
1	Debitorë Biznesi Rrogozhinë	24,799,008		288,896	15,062,703
2	Debitorë Biznesi Gosë	5,521,035	422,147		5,438,546
3	Debitorë Biznesi Lekaj	7,112,393		1,622,811	5,023,445
4	Debitorë Biznesi Kryevidh	16,721,332		3,114,610	12,966,635
5	Debitorë Biznesi Sinaballaj				
		54,155,768	422,147	5,026,317	38,491,329
	“K”	12,200			
	“A”	42,427			
	B.T	62,914			
	“E” Shpk	2,011,000			
	“M” Shpk	124,850			
		2,253,391		13,313,660	0
	<b>Totali</b>	<b>56,409,159</b>	<b>422,147</b>	<b>18,339,977</b>	<b>38,491,329</b>

Shuma e detyrimeve debitohet në llogarinë 468 dhe kreditohet në llog. 4341 “të tjera operacione me shtetin (kreditor).

**Llogaria 4342** “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 164,501,792lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 105,891,607 lekë, shtuar vlerën e llog. 486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerë 8,359,980, janë në vlerën 184,251,587 lekë; kjo shumë kuadron me shumën e llogarive të pagueshme në pasiv si në tabelë:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	26,169,069
Detyrime personelit llog 42	13,269,119
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	542,790
Sigurime shoqërore llog.435	4,471,672
Sigurime shëndetësore llog.436	
Organizma të tjerë shtetërorë	0
Kreditorë të ndryshëm llog.467	61,438,957
<b>Totali</b>	<b>105,891,607</b>

**Llogaria 486** “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 93,866,290 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 78,359,980 lekë. Diferenca prej (-)15,506,310 lekë tregon për pakësim të llogarisë nga pagesat e kryera në vlerën 15,506,310. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie në shumën 78,359,980 lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera mallra dhe shërbime, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: “Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të pa financuara”.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## **II. Aktivët afatgjatë materiale**

Objektivat e auditimit janë që të sigurohemi se: Aktivët ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet e subjektit janë të plota dhe korrekte.

Në Formatin 1 “Pozicioni Financiar” , “Aktivët afatgjatë” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog.231). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën

1,945,272,621 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 1,959,055,370 lekë; Ndërsa në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike), paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,075,039,356 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,164,475,592 lekë, të cilat janë pasqyruar më poshtë sipas llogarive analitike.

#### **Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20** “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në fund të vitit 2021 në vlerën 21,103,998 lekë dhe në fund të vitit 2022 është 32,709,998. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike), paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 22,903,998 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 34,509,998 lekë, ku diferenca prej 11,606,000 lekë i përket projekteve shtesë të vitit 2022, analizuar si vijon:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	21,103,998
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	11,606,000
Gjendja në 31.12.2022 (D)	32,709,998

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto), llog.202 paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Aktivit Llog. 202	Gjendja më 31.12.2021	Amortiz. Akum.	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022
Stud.Proje Rrjeti të Brend.Ujësjell.	2,200,000			2,200,000
Stud. Proj. rruge e sheshe	20,703,998		11,606,000	32,309,998
	<b>22,903,998</b>	1,800,000	<b>11,606,000</b>	<b>34,509,998</b>
<b>TOTALI</b>				<b>32,709,998</b>

Kjo vlerë rakordon me vlerën e regjistrit të Aktiveve për llog. 202 të vitit 2022. Projektet janë në proces.

#### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21** “Aktivet Afatgjata Materiale” në Formatin 1 (Aktivi i bilancit), paraqiten me vlerën neto për vitin ushtrimor 2022 në vlerën 1,622,960,884 lekë; në vitin paraardhës 2021, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,627,034,153 lekë, me një pakësim të AAM-ve me(-)4,073,269lekë. Sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,052,135,358 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 2,129,965,594 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet: nga ndryshimi i llog. 212 nga 298,097,858 lekë në vitin 2021 dhe 283,192,965 lekë në vitin 2022 me një diferencë në rënie (-)14,904,893 lekë më pak; në llog. 213 shtuar në 2022 me vlerën e 13,076,338 lekë, llog. 214 pakësuar me shumën (-)682,451 lekë; nga pakësimi i llog. 215 me (-)2,091,485 lekë dhe shtimi i llog.218 me 529,223 lekë.

				Diferenca -
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,622,960,884</b>	<b>1,627,034,153</b>	<b>4,073,269</b>
210	Toka, T,roje, Terene	5,839,355	5,839,355	0
211	Pyje, Plantacione	1,596,452	1,596,452	0
212	Ndertesat e Konstruksione	283,192,965	298,097,858	-14,904,893
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,315,617,260	1,302,540,922	13,076,338
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	3,311,726	3,994,177	-682,451
215	Mjete Transporti	8,365,941	10,457,426	-2,091,485
216	Rezerva Shtetore	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	5,037,186	4,507,963	529,223
24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0	0
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	0	0

**Llog.210** “Toka, troje, terrene” paraqitet në mbyllje të viteve 2021 e 2022 në vlerë të pandryshuar 5,839,355 lekë; si dhe në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” paraqitet në të njëjtën vlerë 5,839,355 lekë. Sipas vlerës bruto paraqitet:

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog.210	Gjendja 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
<b>1</b>	Trotuar agjenci rrug Lushnje	2,856,950		2,856,950
<b>2</b>	Truall fusha e sportit	398,000		398,000



3	Truall për varreza	2584405		2584405
	<b>Totali Bashkia Rrogozhine</b>	<b>5,839,355</b>		<b>5,839,355</b>

**Llog. 211** “Pyje, plantacione” paraqiten në mbyllje të viteve 2021 e 2022 në vlerën 1,596,452 lekë; Në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” paraqiten në të njëjtën vlerë 1,596,452 lekë. Analiza e llog.211 si më poshtë:

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 211	Gjendja 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Pemë dekorative	1,476,452		1,476,452
2	Pemë dekorative	120,000		120,000
	<b>Totali Bashkia Rrogozhine</b>	<b>1,596,452</b>		<b>1,596,452</b>

**Llog.212** “Ndërtesa Konstruksiione” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 298,097,858 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 283,192,965 lekë, me një pakësim prej (-)14,904,893 lekë. Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 në vlerë të njëjtë 405,423,924 lekë; në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 298,097,858 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 283,192,965 lekë; Diferenca (-)14,904,893 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit, pasi nuk ka patur shtim apo pakësim të numrit të aktiveve të kësaj llogarie.

**Llog. 213** “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto të saj 1,560,476,133 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 1,302,540,922 lekë; Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,560,476,133 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,642,795,485 lekë, ku diferenca prej 82,319,352 lekë përbën vlerën shtesë për 2 rikonstruksiione (analizuar më poshtë); në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,302,540,922 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 283,192,965 lekë; Diferenca (-)14,904,893 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit, pasi nuk ka patur shtim apo pakësim të numrit të aktiveve të kësaj llogarie.

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Rikonstrukcion sheshi Fshati Luzi i Madh	19,478,489.00		19,478,489.00
2	Reabilitimi i Kanaleve sekond. Peqin-Kavaje	51,802,593.00		51,802,593.00
3	Reabilitimi i Kanaleve sekond. Peqin-Kavaje	16,287,553.00		16,287,553.00
4	Rivitalizimi Urban i Qendres se Qyt.Rrogozhine	126,846,479.00		126,846,479.00
5	Rikonstr.Rruga Lekaj +Rr.Varrezave	13,517,864.00		13,517,864.00
6	Rivitalizimi Urban i Qendres Gose	50,642,745.00	48,000,472.00	98,643,217.00
7	Ndert.i Rrjetit brend.ujesj.Faza e II	62,088,254.00		62,088,254.00
8	Mbikq.punim.Rrjetit brend.ujesj.Faza e II	434,700.00		434,700.00
9	Ndert.i Rrjetit brend.ujesj.Faza e III	212,246,062.00		212,246,062.00
10	Mbikq.punim.Rrjetit brend.ujesj.Faza e III	1,952,505.00		1,952,505.00
11	Reabilitim i Diges Okshun	46,000,000.00		46,000,000.00
12	Rikonstr.i Rrugeve te Brend. Faza e II	1,949,049.00		1,949,049.00
13	Rikonstr.Rruga Greth - Rreth Greth	45,199,240.00	34,318,880.00	79,518,120.00
14	Rikonstrukcion Rruga St.Trenit Rrogozhine	963,862.00		963,862.00
15	Reabilitim i Kanaleve Kulluese Faza III	96,093,140.00		96,093,140.00
16	Mbikqyrje punime Rikonstr.Rruga Lekaj +Rr.Varrezave	3,240,000.00		3,240,000.00
17	Rikonstruksin Ujesjellesi Lekaj	92,277,452.00		92,277,452.00
18	Mb.Pun.Rikonstruksin Ujesjellesi Lekaj	796,000.00		796,000.00
19	Rikonstruksin Ujesjellesi Gose	68,698,608.00		68,698,608.00
20	Rikonstr.KUZ Gose	4,806,558.00		4,806,558.00
21	Makineri e paisje	74,063.00		74,063.00
22	Pus uji Shkolla 9-vjecare L.I Madh	115,400.00		115,400.00
23	Sistemim Rruge Parcele	120,840.00		120,840.00
24	Proj shkolles G.Vogel	266,986.00		266,986.00
25	Depo Ujesjellesi Okshun	298,480.00		298,480.00
26	Rruga Ura e Grethit-Patk milot	306,500.00		306,500.00
27	Ujsjelli I ri Spanesh	350,000.00		350,000.00
28	PASTRIM SISTEMIM PERROI	356,364.00		356,364.00
29	Linje ujesjelli stacioni pompave-Kryevidh	366,000.00		366,000.00
30	Riparim Kanali Kullues	384,536.00		384,536.00

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
31	Sistemime Kanalizimesh	451,440.00		451,440.00
32	Ndertim Ura e Hakeve	453,834.00		453,834.00
33	Rruga Mushnike	470,130.00		470,130.00
34	Ure Shkozet	492,160.00		492,160.00
35	Gjelberim	564,096.00		564,096.00
36	Trotuar Rruga dy Cezmet	639,975.00		639,975.00
37	Proj Rruga Gose e vogel	757,000.00		757,000.00
38	Riparim Dyersh	780,000.00		780,000.00
39	Lulishte Qender-Ura e mekeve	790,922.00		790,922.00
40	Rruga e lagjes Shalje	829,734.00		829,734.00
41	Pastrim I Perroit te Hazizit	999,312.00		999,312.00
42	Rruga Shkolla Vjeter - Luz I Madh	1,100,000.00		1,100,000.00
43	Rruga Sinaballaj Hasdushk	1,449,528.00		1,449,528.00
44	Kan.Ujra te Zeza Gose	1,454,822.00		1,454,822.00
45	Rruga Gose e Madhe	1,561,880.00		1,561,880.00
46	Rruga Kerçukaj	1,735,526.00		1,735,526.00
47	Kan.Ujra te Zeza Basht	1,739,950.00		1,739,950.00
48	Rruga Qender Ura e Mekeve	1,950,000.00		1,950,000.00
49	Rruga Qafa e Beqirit-Spanesh	1,990,545.00		1,990,545.00
50	Trotuari Gose	2,335,515.00		2,335,515.00
51	Rruga Lekaj	2,701,270.00		2,701,270.00
52	Rruga Spille 1	2,775,000.00		2,775,000.00
53	Ujsjellsi Vile-Bashtov	3,044,000.00		3,044,000.00
54	Rruga Qendres Gose	4,877,861.00		4,877,861.00
55	Rruga Harizaj	3,643,800.00		3,643,800.00
56	Ujesjellesi Luz i Madh	4,000,000.00		4,000,000.00
57	RRUGA LAGJIA KODER	4,371,649.00		4,371,649.00
58	RRUGA MBI STAC.TRENIT	4,457,760.00		4,457,760.00
59	Kanalizime shkolla e mesme	4,822,818.00		4,822,818.00
60	Rruga Germej Zanbishe	5,000,000.00		5,000,000.00
61	Rruga Greth Mesem -Spille	6,706,617.00		6,706,617.00
62	Rruga Rrogzhine Hemenraje	7,551,217.00		7,551,217.00
63	Trotuar Burgu - Bashkia	7,717,786.00		7,717,786.00
64	Rruga Ballaj-Lagje Çame	8,912,610.00		8,912,610.00
65	RIKONSTR.RRUGA E VARREZAVE	9,145,800.00		9,145,800.00
66	Rruga Greth madh+lagje Pezaj Sterbeg	14,329,852.00		14,329,852.00
67	Rruga Germej Mushnike	10,000,000.00		10,000,000.00
68	Rruga qender fshati Zhabjak	10,653,024.00		10,653,024.00
69	Rruga Sinaballaj Thartor Demarkaj	10,887,790.00		10,887,790.00
70	Rruga Axhensi Rruga Lushnjes	11,236,045.00		11,236,045.00
71	Rruga ura e Çoromit-Ura Çobanit	11,431,270.00		11,431,270.00
72	Rruga Luz I Madh Shkozet	11,600,000.00		11,600,000.00
73	Rruga Ballaj-Lagje Ostrec	14,207,564.00		14,207,564.00
74	RRUGA QENDER-URA E SHABES	14,500,900.00		14,500,900.00
75	Rruga Pjeç-Kryevidh	15,677,846.00		15,677,846.00
76	RRUGA QENDER ST.TRENIT	17,034,572.00		17,034,572.00
77	Rruga Germej Okshtun	20,000,000.00		20,000,000.00
78	Rruga Luz I Madh Lekaj	23,200,000.00		23,200,000.00
79	Rruga Kryeluzaj Germej	23,725,051.00		23,725,051.00
80	Rruga Shkolla 9 vjeçare-Kryevidh Qender	23,816,626.00		23,816,626.00
81	Rruga e Xhamise Faza e I	27,259,765.00		27,259,765.00
82	Rruga Fshatit Sterbeg	27,756,948.00		27,756,948.00
83	Rruga Kalush	31,764,470.00		31,764,470.00
84	Rruga Gose-Bashtov	35,025,112.00		35,025,112.00
85	Rregullime brenda Aktiveve	35,219,935.00		35,219,935.00
86	Sistemime.te tjera	5,580,100.00		5,580,100.00
87	Stacion pompimi Kryevidh	522,142.00		522,142.00
88	Stacion pompimi Greth	7,456,326.00		7,456,326.00
89	Stacion pompimi Greth/1	150,224.00		150,224.00
90	Stacion pompimi Ballaj/1	4,906,216.00		4,906,216.00
91	Stacion pompimi Ballaj /2	1,135,140.00		1,135,140.00
92	Stacion pompimi Harizaj	10,100,285.00		10,100,285.00
93	Stacion pompimi Germenj	169,193.00		169,193.00
94	Stacion pompimi Lekaj	712,458.00		712,458.00

Nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
95	Rezervuare VileBashtove	307,298.00		307,298.00
96	Rezervuare VileBashtove	3,989,869.00		3,989,869.00
97	Rezervuare Sharrdushk	22,192,168.00		22,192,168.00
98	Rezervuare Sterbeg	2,141,709.00		2,141,709.00
99	Rezervuare Domen	7,994,866.00		7,994,866.00
100	Kanal kullues kk 1-1 Greth-Spille	192,192.00		192,192.00
101	Kanal kullues kk 1-2 Greth-Spille	120,960.00		120,960.00
102	Kanal kullues kk 1-3 Greth-Spille	104,365.00		104,365.00
103	Kanal kullues kk 3-1 Greth-Spille	401,500.00		401,500.00
104	Kanal kullues kk 3-2 Greth-Spille	350,400.00		350,400.00
105	Kanal kullues kk 51 Gose -Shkozet	2,154,729.00		2,154,729.00
106	Kanal kullues kk 56/2 Gose - Kalush	7,416,396.00		7,416,396.00
107	Kanal kullues kk M 1 Shkozet	1,218,250.00		1,218,250.00
108	Kanal kullues kk M 1+1 Shkozet	609,125.00		609,125.00
109	Kanal kullues kk M2 Shkozet	354,400.00		354,400.00
110	Kanal kullues kk M3 Luzi Madh	376,550.00		376,550.00
111	Kanal kullues kk M4 Luzi Madh	1,594,800.00		1,594,800.00
112	Kanal kullues kk M5 Luzi Madh	1,154,195.00		1,154,195.00
113	Kanal kullues Shkumbin 1 Rrog.	1,250,865.00		1,250,865.00
114	Kanal kullues kk 2 Rrogozhine	874,500.00		874,500.00
115	Kanal kullues KU 2 Sinaballaj	2,633,545.00		2,633,545.00
116	Kanal kullues KU 3 Sinaballaj	1,145,496.00		1,145,496.00
117	Kanal kullues KU 4/1 Rrogozhine	2,633,545.00		2,633,545.00
118	Kanal kullues KU 5 Rrogozhine	3,108,206.00		3,108,206.00
119	Kanal kullues KU 9 Gose	730,290.00		730,290.00
120	Kanal kullues KU 10 Gose	2,633,545.00		2,633,545.00
121	Kanal kullues KU 11 Gose	21,117,569.00		21,117,569.00
122	Kanal kull. KU 15/1 Shkozet Luzi M	2,633,545.00		2,633,545.00
123	Kanal kull. KU 15/2 Shkozet Luzi M	12,286,522.00		12,286,522.00
124	Rrjeti ndric.dhe Sinjalistika	16,641,000.00		16,641,000.00
	<b>Totali Bashkia Rrogozhine</b>	<b>1,560,656,133.00</b>	<b>82,319,352.00</b>	<b>1,642,975,485.00</b>

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

**Konstatim:** Nga analiza e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte inventare të klasifikuara gabim, të cilat janë: nr.rendor 21 me emërtimin makineri e pajisje në vlerën 74,063 lekë e cila duhej të ishte e regjistruar në llog. 214 “pajisje e makineri”; nr.rendor 35 me emërtimin gjelbërim në vlerën 564,096 lekë duhej të ishte e regjistruar në llog. 212 ose 211 në varësi të asaj çfarë përfaqëson (lulishte apo pyje /kullota); nr. 38 me emërtimin riparim dyersh në vlerën 780,000 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; nr.rendor 39 me emërtimin lulishte qendër –ura e mekeve në vlerën 790,922 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; Pra në total vlera e regjistruar gabim në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është 2,209,081 lekë. Pra llog.213 është mbivlerësuar në vlerën 2,209,081 lekë, dhe llog.212 nënvlerësuar me 2,135,018 lekë dhe llog. 214 nënvlerësuar me 74,063 lekë<sup>14</sup>.

**Llogaria 214** “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,994,177 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,311,726 lekë me një diferencë prej (-)682,451 lekë; Ndërsa në formatin 7/a paraqitet në vlerën bruto në mbyllje të vitit 2021 prej 13,144,869 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 12,201,621 lekë. Analiza e gjendjes së log. 214 me ndryshimet nga viti 2021 në 2022 paraqitet si vijon:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 214	Gjendja 31.12.2021	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Dyer per shk.Mesme	394,589.00		394,589
2	Kosha Plehrash	1,128,720.00		1,128,720
3	Makine Korrse Bari	360,000.00		360,000
4	makineri e paisje	902,656.00		902,656
5	Makineri e paisje	2,830,446.00		2,830,446
6	Ndriçim Gose Qender	390,308.00		390,308

<sup>14</sup> Vlerat e llogaritura nga grupi i auditimit konsiderohen si në vlerësime të llogarive përkatëse, për të mos patur përsëritje do merren në konsideratë për çka është shprehur tek llog.213

7	NDRICIMI I QYTETIT	1,000,000.00	1,000,000
8	Sinjalistika e Qytetit	1,908,150.00	1,908,150
9	Soba zjarri per shkollat	4,230,000.00	4,230,000
	<b>Totali Bashkia Rrogozhine</b>	<b>13,144,869</b>	<b>13,144,869</b>

Nga të dhënat e pasqyruara në formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike & vlera neto), vlera 145,480 lekë nuk gjendet në analizën e llogarisë se çfarë përfaqëson.

**Llogaria 215** “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë më datë 31.12.2021 në shumën 10,457,426 lekë dhe në 31.12.2021 në shumën 8,365,941 lekë, ku diferenca (-)2,091,485 lekë (pakësim) është vlerae amortizimit vjetor; Ndërsa në formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” paraqitet në vlerën 34,016,264 lekë në mbyllje për të dy vitet 2021 e 2022.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	10,457,426
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	
Gjendja në 31.12.2021 (D)	8,365,941

Bashkia Rrogozhinë ka në pronësi të saj dhe në gjendje aktive 11 mjete transporti dhe lista e tyre pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

I	Automjete	Targa	EmërPërdorues	Viti blerjes	njësia	nr	Çmimi për njësi	Vleratotale
1	Makine Zjarrfikse IVEKO HAGIRAS 1991	AA 227 VX	B.D.		copë	1	4,800,000.00	4,800,000.00
2	Kamjon M. Benz	-	E.B.		copë	1	1,080,000.00	1,080,000.00
3	Auto Portredevë	AA 271 DI	A.K.		copë	1	4,200,000.00	4,200,000.00
4	Fadrome 0964059	AI MT 06	F.P.		copë	1	4,200,000.00	4,200,000.00
5	Rimorkio 1474	AG R 748	E.B.		copë	1	1,800,000.00	1,800,000.00
6	Autovetur Fuoristrad SSANGYONG, tip RJA	KJ 9829 A	E.N.		copë	1	2,080,000.00	2,080,000.00
7	Autovetura Benc	AA 996 AD	A.C.		copë	1	2,964,000.00	2,964,000.00
8	Autovetura Benc	KJ 6255 A	R.J.		copë	1	580,000.00	580,000.00
9	Furgon(8+1) tip ford tranzit	AB 261 EU	E.N.		copë	1	1,287,600.00	1,287,600.00
10	mjete trasporti	-			copë	1	1,969,468.00	1,969,468.00
11	Furnizim me mjet te rende Eskavator	-	E.D.		copë	1	9,055,196.40	9,055,196.40
	<b>Totali Bashkia Rrogozhine</b>	<b>11</b>			<b>11</b>	<b>11</b>	<b>34,016,264</b>	<b>34,016,264</b>

Nga analiza e llog. 218 rezulton vlera bruto e saj nuk ka ndryshuar për dy vite radhazi prej 34,016,264 lekë.<sup>15</sup>

**Llogaria kontabël 218** “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga Bashkia Rrogozhinë. Sipas pasqyrave financiare të Rrogozhinë, gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 4,507,963 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 5,037,186 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 826,424 lekë. Amortizimi është llogaritur në vlerën 23,055,307 lekë.

Nga analiza e llog. 218 “inventar ekonomik” **konstatohet** se, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si kategori më vete për të pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj dhe saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit.

Vlera neto e AAM në fund të vitit 2021 është 1,627,034,153 lekë dhe në fund të vitit 2022 është 1,622,960,884 lekë, ku diferenca prej (-)4,073,269 lekë, përfaqëson vlerën e amortizimeve dhe kostove historike [kosto historike- amortizim i akumuluar].

Levizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2022, vlera në lekë	
Çelje me 01.01.2022	4,507,963
Blerje me pagesë (D)	

<sup>15</sup> Analiza e detajuar trajtohet në Aktin e Konstatimit të Procedurës së Inventarizimit si edhe më poshtë te nënpika e Inventarizimit

Dalje (K)	
Gjendja me 31.12.2022	5,037,186

**Llog. 24** “Aktive te Qend.të trupëzuara të dëmtuara” në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 paraqitet me vlerën 0, ndërkohë që nga procedurat e inventarizimit janë vlerësuar të dëmtuara dhe për jashtë përdorimit inventare në vlerën 3,779,347.21 lekëpërvitin 2021 dhenëvlerën1,553,416.00lekëpërvitin 2022. Nga auditimi **u konstatua** se përdërisa procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesimit nuk është realizuar për asnjë vit, këto vlera duhet të ishin pasqyruar në llog.24 “Aktive te Qend.të trupëzuara të dëmtuara” në pasqyrat format 1 dhe format 7/a,b.

**Llog 209 & 219** “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Rrogozhinë në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 1,321,428,416 lekë. Në mbyllje të vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet në vlerën 508,804,710lekë me një shtesë prej 81,903,505lekë.

### **Pasqyra statistikore nr. 7/b “Akivet afatgjata me vlerë neto”**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Rrogozhinë, janë si më poshtë:

ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5 %
inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20 %
për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
për mjetet e transportit	20%
për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare)	15 %

**Llogaria 230 dhe 231 “Investime”** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në vlerën 10,320,733 lekë dhe 1,981,846,985 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 196,797,035lekë.

Nr.	Emërtimi i Llog	Gjendja fillim viti 2022	Gjendja më 31.12.2022	Diferenca
1	Aktive Afatgjata jomateriale			
2	Aktive Aftagjata materiale	235,082,510	241,332,528	6,250,018
<b>Totali</b>		<b>235,082,510</b>	<b>241,332,528</b>	<b>6,250,018</b>

Investimet e kryera gjatë vitit 2021 janë në proces. Për investimet referuar Udhëzimit të MFE nr. 8 dt.09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, veprimet kontabël ndjekin këto hapa: me çeljen e fondeve - debitohet llog. 520 dhe kreditohet llog. 476; me konstatimin e shpenzimit – debitohet llog. 231 dhe kreditohet llog.404; në momentin e pagesave- debitohet llog. 404 dhe kreditohet llog.520; në fund të vitit ushtrimor për fondet e përdorura për investimet në proces debitohet llog. 476 dhe kreditohen llog.720 dhe llog.4342 për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues; me përfundimin e investimit të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimin total të vlerës së kontratës bëhet kapitalizimi i aktivitetit në debi të llog.21 (përcaktohet artikulli kontabël) dhe kredi të llog.231; me kapitalizimin e aktivitetit - debitohet llog.476 dhe kreditohet llog.105; kreditohet llog. 1011 dhe debitohet llog.105.

Pra të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre dhe detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e ndodhjes si shpenzim pavarësisht nga data e pagesës. Në mënyrë analitike aktivet afatgjata materiale në proces paraqiten si më poshtë:

Aktive ne proces per vitin 2022 gjithsej - llog.231			Gjendja në fillim	Shtesa	Pakësime	Gjendja në fund
Nr	EMERTIMI	Llog.210	Llog.211	Llog.212	Llog.213	Llog.214
1	Sinjalistika Rrugore					2,903,506
2	Rikonstr.Magj.kryes.dhe Rrjetit Br.Ujesj.				31,570,954	
3	Rikonstruksion Ujesjellesi Lekaj					
4	Mb.Punim.Rikonstruksion Ujesjellesi Lekaj				800,000	
5	Rikonstruksion Ujesjellesi Gose				20,000,000	
6	Ndertim Shkolla e Mesme"Rushdi Qehaj"			4,637,949		
7	Rikonstr.Shkolla e Mesme Qamil Gjuzi			87,347,719		
8	Mb.Pun.Rikonstr.Shkolla e Mesme Qamil Gjuzi			1,520,000		
9	Rikonstr.Shkolla e Mesme Lekaj			34,002,400		
10	Rehab i diges se rezerv.Okshtun, pastrim kanal kull.vadit.				5,000,000	
11	Pastrim kanal. kulluese				4,000,000	
	<b>Totali Bashkia Rrogozhinë</b>	-	-	<b>127,508,068</b>	<b>110,920,954</b>	<b>2,903,506</b>

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

**Llogaritë e klasës 4**, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e -së më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	26,169,069	26,826,386	-657,317
42	Detyrime ndaj personelit	13,269,119	11,055,342	2,213,777
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	542,790	565,009	-22,219
435	Sigurime shoqërore	4,471,672	4,729,475	-257,803
436	Sigurime shëndetësore		335,126	-335,126
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	53,650,528	49,023,066	4,627,462
467	Kreditorë të ndryshëm	61,438,957	214,856,744	-153,417,787
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)			
	<b>Gjendja në fund të periudhës</b>	<b>159,542,135</b>	<b>307,391,148</b>	<b>-147,849,013</b>
	<b>Të tjera pasive afatshkurtra</b>			
C	<b>F (A-B)</b>	<b>2,449,552,706</b>	<b>2,074,725,449</b>	374,827,257
D	<b>FONDI I KONSOLIDUAR</b>	<b>2,449,552,706</b>	<b>2,074,725,449</b>	374,827,257
101	Fonde bazë			
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	386,541,109	83,338,096	303,203,013
E	<b>TOTALI I PASIVIT (B+C)</b>	<b>2,609,094,841</b>	<b>2,382,116,597</b>	<b>226,978,244</b>

**Llogaria 401-408** "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2021 është në vlerën 26,826,386 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 26,169,069 lekë me një diferencë 657,317 lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturave pa likuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Rrogozhinë deri më 31.12.2022. Nga analiza e gjendjes së kësaj llogarie rezultoi se janë 16 fatura të pa likuiduara për 12 furnitorë në vlerën 21,166,762 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr	401-408 Furnitorë e llogari të lidhura me to	Gjendja në fillim	Pakësime 2022	Shtesa 2022	Gjendja në fund
1	M.B.K.	5,743,080.00			5,743,080.00
2	M.B.K.	4,702,100.00		280,300.00	4,982,400.00
3	G.C.	1,964,100.00	1,964,100.00		-
4	E.M.	1,164,600.00			1,164,600.00

5	N.G	485,400.00	485,400.00		-
6	Gj.B.	3,335,800.00	3,335,800.00		-
7	VASAA	5,342,250.00	5,342,250.00		-
8	S.T.	4,940,400.00	1,640,400.00		3,300,000.00
9	S.T.			1,797,600.00	1,797,600.00
10	S.T.			339,000.00	339,000.00
11	Shtyp.Letra me vlere	156,000.00			156,000.00
12	E.L.	537,600.00			537,600.00
13	E.P.	799,999.00			799,999.00
14	E.P.	533,333.00			533,333.00
15	A.K.	262,800.00			262,800.00
16	K.Z.	134,400.00			134,400.00
17	A. Sh.pk	224,400.00			224,400.00
18	T. G.	245,950.00			245,950.00
19	G. Sh.p.k	380,400.00			380,400.00
20	A.G.	50,000.00	50,000.00		-
21	I.O.			565,200.00	565,200.00
	<b>Totali</b>	<b>31,002,612.00</b>	<b>12,817,950.00</b>	<b>2,982,100.00</b>	<b>21,166,762.00</b>

Nga analiza e llog. 401-408 rezulton se gjatë vitit 2022 janë 4 fatura të reja të pa likuiduara në kohë dhe që mbeten të paguhen për vitin pasardhës në vlerën totale 2,982,100 lekë, që iu përkasin 3 furnitorëve ekzistues. Ndërsa vlera e atyre të likuiduara është 12,817,950 lekë për 6 fatura që iu përkasin 6 furnitorëve. **Konstatohet** një diferencë midis vlerës së llog. 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” pasqyruar në formatin 1 dhe analizës së kësaj llogarie dhe konkretisht: diferenca mes gjendjes në fillim në vlerën e 4,166,226 lekë dhe asaj në mbyllje të vitit me 5,002,307 lekë;

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Celje e vitit 2022	26,826,386
Shtesa (K)	
Pakësime (D)	
Gjendja në 31.12.2022 (K)	26,169,069

**Llogaria 42**, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Rogozhinë, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 11,055,342 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,269,119 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 2,213,777 lekë. Vlera e llog.42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

**Llogaria 431**, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vitin 2021 në vlerën 565,009 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 542,790 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimi mbi pagën.

**Llogaria 435**, “Sigurime shoqërore” dhe **llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,729,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,471,672 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 335,126 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 nuk është pasqyruar. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar. Vlera 4,471,672 lekë përbën 15% të pagës bruto paguar nga punëdhënësi; sig shënd. ndahen 1.7% punëdhënësi dhe 1.7% punëmarrësi. Nga ditari i pagesave rezultoi se vlera e përbashkët e këtyre 2 llogarive është 1,796,119 lekë dhe që përbën 11.2% të pagës bruto [1.7% sig.shënd + 9.5% sig.shoq] të paguara nga punëdhënësi. **Konstatohet** se vlera e llog. 436 nuk është pasqyruar më vete. Analiza e tyre pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Nr.	Pagat Dhjetor 2022	Paga	Sig.Shoq	Tatimi mbi page
1	Aparati	9,922,942	2,350,005	303,391
2	Sporti	35,325	31,899	0
3	Kultura	140,576	31,486	2,616
4	Gj.Civile	215,515	73,582	17,127
5	Arsimi parashkollor	2,055,695	1,489,719	138,113
6	Arsimi	144,957	59,454	2,437

	parauniversitar			
7	Pyje	83,210	27,566	4,524
8	Ujitja dhe kullimi	76,486	13,127	1,834
9	Mbr.Nga zjarri dhe shpetimi	594,413	323,286	57,026
10	Projekti		71,548	15,722
	<b>Totali</b>	<b>13,269,119</b>	<b>4,471,672</b>	<b>542,790</b>
				<b>18,283,581</b>

**Llogaria 466** “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Rrogozhinë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 49,023,066 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 53,650,528 lekë; kjo llogari përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Analiza e llog.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet si më poshtë:

	<b>Llog.466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"</b>	<b>Gjendja 31.12.2021</b>	<b>Pakësime</b>	<b>Shtesa</b>	<b>Gjendja në 31.12.2022</b>
1	E. 2000 "Rikonstruksion Rruga Lekaj"	986,200			986,200
2	H. "Magj.i Rrjetit kryesor te Ujesjellsit Loti II	12,195,433		-	12,195,433
3	H. "Magj.i Rrjetit kryesor te Ujesjellsit Loti III	2,116,794		1,585,548	3,702,342
4	5. V. "Rikonstruksion Shkolla e Mesme"	4,263,586		-	4,263,586
5	6. V. "Rikonstruksion Rruga St.Trenit"	7,224,500		-	7,224,500
6	H. "Diga Okshtun'	1,756,796		100,000	1,856,796
7	H. "Diga Okshtun'+Kanale dytesore	2,467,975		-	2,467,975
8	M. Sh.p.k. "Rivitalizimi Urban Q.Gose	2,643,462	2,643,46	-	-
9	B. sh.p.k "Sinjalistika	423,050		-	423,050
10	B. sh.p.k "Strehim Social"	432,664		-	432,664
11	Ll. Sh.p.k "Rikonstruksion Rruga Greth Rreth Greth"	1,638,331	1,638,331	-	-
12	E. S. "Reabilitim i Kanalit Peqin Kavaje"	4,481,148		-	4,481,148
13	Magjistrali Ujesjellesit Gose			1,000,000	1,000,000
14	Magjistrali Ujesjellesit Lekaj			4,629,706	4,629,706
15	Rikonstruksion shk. 9-Vjecare Q.Gjuzi			4,295,208	4,295,208
16	Rikonstruksion shk. 9-Vjecare Lekaj			1,800,120	1,800,120
\	<b>Totali</b>	<b>40,629,939</b>	<b>4,281,793</b>	<b>13,410,582</b>	<b>49,758,728</b>

**Konstatohet** një diferencë mes vlerës së pasqyruar në format 1 dhe asaj në analizën e llogarisë prej 3,891,800 lekë më shumë, vlerë e cila mundon në analizën e llogarisë.

**Llogaria 467** “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e pa likuiduara si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të papaguara për mungesë fondesh. Gjendja në mbyllje të vitit 2021 është në vlerë 214,856,744 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 61,438,957 lekë me një diferencë (-)153,417,787 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2022	214,856,744
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	23,763,497
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	36,242,419
Gjendja në 31.12.2022	61,438,957

Analiza e llog.467 “kreditorë të ndryshëm” paraqitet si më poshtë:

Nr	<b>Llog. 467 Kreditorë të ndryshëm</b>	<b>Gjendja në fillim viti 2022</b>	<b>Shtesa gjatë 2022</b>	<b>Pakësime gjatë 2022</b>	<b>Gjendja në 31.12.2022</b>
1	"B."sh.p.k	14,487,296.00	3,609,987.00		10,877,309.00
2	V.G. sh.p.k	21,071,809.00	20,153,510.00		918,299.00
3	"Oshee" Kavaje	13,400,930.00		36,242,419.00	49,643,349.00
	<b>Totali</b>	<b>48,960,035.00</b>	<b>23,763,497.00</b>	<b>36,242,419.00</b>	<b>61,438,957.00</b>

**Llogaria 85** “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepriçë kreditorë në vlerën 386,541,108 lekë në mbyllje të vitit 2022 dhe në vlerën 83,338,096 në mbyllje të vitit 2021 me një diferencë (shtim) në vlerën 303,203,012 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlera e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet, që Bashkia Rrogozhinë trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit Kavajë mbi fondet që trashëgohen.



**Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive te të “Ardhurat” dhe “Shpenzimet”**

Kjo pasqyrë ka rubrikën A – Të Ardhurat dhe Rubrikën B- Shpenzimet.

	<b>Përshkrimi i Operacioneve</b>	<b>Viti ushtrimor 2022</b>	<b>Viti paraardhës</b>	<b>Diferenca</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>1,117,181,745</b>	<b>976,948,126</b>	140,233,619
<b>70</b>	<b>I. Të ardhurat nga taksat e tatimet</b>	<b>118,711,967</b>	<b>128,874,875</b>	-10,162,908
<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>687,862</b>	<b>2,185,515</b>	-1,497,653
7000	Tatim mbi te ardhurat personale			0
7001	Tatim mbi Fitimin			0
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	687,862	2,185,515	-1,497,653
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat			0
<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>43,464,979</b>	<b>51,104,153</b>	-7,639,174
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	43,464,979	51,104,153	-7,639,174
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme			0
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine			0
<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>74,559,126</b>	<b>75,585,207</b>	-1,026,081
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)			0
7031	Akciza			0
7032	Takse mbi sherbimet specifike			0
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie			0
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	74,559,126	75,585,207	-1,026,081
<b>704</b>	<b>4.Takse mbi tregtine dhe transakcionet nderkombtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	0
<b>705</b>	<b>5.Takse e rruges</b>			0
<b>708</b>	<b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombetare</b>			0
<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>			0
<b>75</b>	<b>II. Kontribute Sigurime Shoqërore e Shëndetësore</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	0
<b>71</b>	<b>III. Të ardhura jo tatimore</b>	<b>4,787,162</b>	<b>6,670,425</b>	-1,883,263
<b>710</b>	<b>1.Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>2,725,445</b>	<b>2,448,784</b>	276,661
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare			0
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare			0
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	2,725,445	2,448,784	276,661
<b>711</b>	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>2,061,717</b>	<b>4,221,641</b>	-2,159,924
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	2,061,717	4,221,641	-2,159,924
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh			0
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale			0
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve			0
7114	Te ardhura nga biletat			0
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestri dhe zhdemtime			0
7116	Te ardhura nga transferimi prones, Legalizimi i ndertimeve pa leje			0
<b>719</b>	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>			0
<b>76</b>	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	0
<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>993,682,616</b>	<b>841,402,826</b>	152,279,790
<b>720</b>	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>993,682,616</b>	<b>841,402,826</b>	152,279,790
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	794,048,499	568,169,168	225,879,331
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	122,327	1,800,000	-1,677,673
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH			0
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)			0
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	15,260,203	13,065,576	2,194,627
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit			0
7206	Financim i pritshem nga buxheti	184,251,587	258,368,082	-74,116,495
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)			0
7209	Te tjera grante korente te brendshme			0
<b>721</b>	<b>2.Grant korent I Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	0
	<b>VI. Të ardhura të tjera</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	0

	Përshkrimi i Operacioneve	Viti ushtrimor 2022	Viti paraardhës	Diferenca
73	<i>VII. Ndryshimi i gjendjes se inventarit te produkteve</i>			0

Nga pasqyrat rezultojnë se rubrika e të "Ardhurave" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 976,948,126 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,117,181,745 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 140,233,619 lekë që tregon për përmirësim të vjeljes së taksave e tarifave. Analiza e llogarive të të Ardthurave paraqitet si më poshtë vijon:

- **Llog. 70** "të ardhura nga taksa e tatime" paraqitet në bilanc të vitit 2022 në vlerën 118,711,967 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

**Llog. 7002** "tatim mbi biznesin e vogël" paraqitet në vitin 2022 në vlerën 687,862 lekë ;

**Llog. 7020** "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme" paraqitet në vitin 2022 në vlerën 43,464,979 lekë;

**Llog. 7035** "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie" paraqitet në vlerën 74,559,126 lekë dhe përfaqëson taksën e pastrimit, taksën e gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj;

- **Llog. 71** "të ardhurat jo tatimore" paraqitet në bilanc në vlerën 4,787,162 lekë.

**Llog. 7109** "të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia" paraqitet në vlerën 2,725,445 lekë dhe përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe pyjet;

**Llog. 7110** "tarifë administrative dhe të ardhura sekondare" në vlerën 2,061,717 lekë;

- **Llog. 72** "Grante korrente"/ **llog. 720** "Grant korrent i brendshëm" paraqitet në vitin 2022 në vlerën 993,682,616 lekë ;

**Llog. 7200** "nga buxheti për NJQP (Qendrore)" në vlerën 794,048,499 lekë;

**Llog. 7201** "nga buxheti për NJQP (Vendore) në vlerën 122,327 lekë;

**Llog. 7204** "pjesëmarrje institucionit në tatimet nacionale" në vlerën 15,260,203 lekë;

**Llog. 7206** "financim i pritshëm nga buxheti" në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 184,251,587 lekë , e cila kuadron me shumën e gjendjes së llog. 4342 "operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 105,891,607 lekë dhe llog. 486 " shpenzime të periudhave të ardhshme" në vlerën 78,359,980 lekë.

### **Rubrika B -SHPENZIMET**

	Përshkrimi i Operacioneve	Viti ushtrimor 2022	Viti paraardhës
<b>B</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>730,640,636</b>	<b>893,610,030</b>
<b>600</b>	<b>I. Pagat dhe përfitimet e punonjësve</b>	<b>175,829,567</b>	<b>165,375,655</b>
6001	Paga, personel i perhershëm	175,829,567	165,375,655
6002	Paga personel i Perkohshëm	0	
6003	Shperblime	0	
6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	
<b>601</b>	<b>II. Kontribute të sigurimeve</b>	<b>28,784,656</b>	<b>28,157,204</b>
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	28,784,656	28,157,204
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore		
<b>602</b>	<b>III. Blerje mallra e sherbime</b>	<b>143,703,230</b>	<b>111,519,227</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	9,241,318	9,731,092
6021	Materiale dhe sherbime speciale	4,276,930	1,380,609
6022	Sherbime nga te trete	103,380,570	79,598,478
6023	Shpenzime transporti	6,732,805	8,271,465
6024	Shpenzime udhetimi	30,150	
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	6,629,016	2,898,259
6026	Shpenzime per qeramarrje	3,274,621	3,095,660
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	3,512,000	3,773,000
6029	Shpenzime te tjera operative	6,625,820	2,770,664
<b>603</b>	<b>IV. Subvecone</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>V. Transferime korente</b>	<b>383,637,208</b>	<b>587,791,315</b>
<b>604</b>	<b>I. Transferime korente te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		

	<b>Përshkrimi i Operacioneve</b>	<b>Viti ushtrimor 2022</b>	<b>Viti parardhës</b>
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetstore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>383,637,208</b>	<b>587,791,315</b>
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	383,637,208	587,791,315
	<b>VI. Shpenzime financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>66</b>	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>VII. Kuota amortizimi dhe shuma te parashikuara</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>63</b>	<b>VIII. Ndryshimi i gjendjes se inventarit</b>	<b>-1,314,025</b>	<b>766,629</b>
	<b>IX. Shpenzime te tjera</b>	<b>0</b>	
<b>85</b>	<b>Teprica ose deficit i periudhës (Rezultati i Veprimtarisë së vitit Ushtrimor)</b>	<b>386,541,109</b>	<b>83,338,096</b>

- **Llog. 600** “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 175,829,567 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “paga personeli i përhershëm”, “paga personel i përkohshëm”, “shpërblime”, “shpenzime të tjera për personelin” . U **konstatua** se vlera e llogarisë 600 nuk është ndarë në 2 llogari duke pasqyruar vlerat përkatse në llog. 6001 “paga personeli përhershëm” dhe llog. 6002 “paga personel i përkohshëm”;
  - **Llog. 601** “kontribute të sigurimeve” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 28,784,656 lekë , ku u konstatua se kjo vlerë (e përbashkët e 2 llogarive) është pasqyruar vetëm në llog. 6010 “kontribut i sigurimeve shoqërore” duke mos e ndarë në vlerat përkatëse sipas llog. 6010 dhe llog. 6011” kontribut i sigurimeve shëndetsore”;
  - **Llog. 602** “blerje mallra e shërbime” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 143,703,230 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:  
Llog. 6020 “materiale zyre të përgjithshme” në vlerën 6,241,318 lekë;  
Llog. 6021 “materiale dhe shërbime speciale” në vlerën 4,276,930 lekë;  
Llog. 6022 “shërbime nga të tretë” në vlerën 103,380,570 lekë;  
Llog. 6023 “shpenzime transporti” në vlerën 6,732,805 lekë;  
Llog. 6024 “shpenzime udhëtimi” në vlerën 30,150 lekë;  
Llog. 6025 “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 6,629,016 lekë;  
Llog. 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 3,274,621 lekë;  
Llog. 6028 “shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua” në vlerën 3,512,000 lekë;  
Llog. 6029 “shpenzime të tjera operative” në vlerën 6,625,820 lekë.
  - **“Transferime korrente”/ llog. 606** “ transferime për buxhetet familjare e individë” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 383,637,208 lekë;
  - **Llog. 63** “ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën (-)1,314,025 lekë, e cila është e barabartë me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;
  - **Llog. 85** “teprica ose deficit i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” në vlerën 386,541,109 lekë, vlerë e cila rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve.
  - **Formati 5** “shënime shpjeguese” është plotësuar;
  - **Formati 8** “numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është plotësuar pjesërisht, duke mos dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit.
- Për konstatimet më sipër nuk janë zbatuar drejt Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022, kreu I, II dhe III; Aneksi I.

**Titulli i gjetjes 7:** *Mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.*

**Situata: I. Pasqyra Format 1 “Pasqyra e Pozicionit Financiar” - Aktivet & Pasivet**  
*Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike*  
*Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto*

1. Nga analiza e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte inventarë të klasifikuara gabim, të cilat janë: me emërtimin makineri e pajisje në vlerën 74,063 lekë e cila duhej të ishte e riregjistruar në llog. 214 “pajisje e makineri”; me emërtimin gjelbërim në vlerën 564,096 lekë duhej të ishte e riregjistruar në llog. 212; me emërtimin riparim dyersh në vlerën 780,000 lekë duhej të ishte riregjistruar në llog. 212; me emërtimin lulishte qendër –ura e mekeve në vlerën 790,922 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; në total vlera e regjistruar gabim në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është 2,209,081 lekë. Pra llog.213 është mbivlerësuar në vlerën 2,209,081 lekë, llog.212 nënvlerësuar me 2,135,018 lekë dhe llog. 214 nënvlerësuar me 74,063 lekë;

2. Nga analiza e llog. 218 “inventar ekonomik” u konstatua se, kategoria “pajisje kompjuterike” nuk është ndarë si kategori më vete për të pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj dhe saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit;

3. Nga analiza e llog. 401-408 rezulton se gjatë vitit 2022 janë 4 fatura të reja të pa likuiduara në kohë dhe që mbeten të paguhen për vitin pasardhës në vlerën totale 2,982,100 lekë, që iu përkasin 3 furnitorëve ekzistues. Ndërsa vlera e atyre të likuiduara është 12,817,950 lekë për 6 fatura që iu përkasin 6 furnitorëve. U konstatua një diferencë midis vlerës së llog. 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” pasqyruar në formatin 1 dhe analizës së kësaj llogarie dhe konkretisht: diferenca mes gjendjes në fillim në vlerën e 4,166,226 lekë dhe asaj në mbyllje të vitit me vlerën 5,002,307 lekë;

4. Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,729,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,471,672 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 335,126 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 nuk është pasqyruar. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar. Nga ditari i pagesave rezultoi se vlera e përbashkët e këtyre 2 llogarive është 1,796,119 lekë dhe që përbën 11.2% të pagës bruto [1.7% sig.shënd + 9.5% sig.shoq] të paguara nga punëdhënësi, u konstatua se vlera e llog. 436 nuk është pasqyruar më vete;

5. Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Rrogozhinë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 49,023,066 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 53,650,528 lekë; kjo llogari përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. U konstatua një diferencë mes vlerës së pasqyruar në format 1 dhe asaj në analizën e llogarisë prej 3,891,800 lekë më shumë, vlerë e cila mungon në analizën e llogarisë 466;

6. Llogaria 24 “Aktive te Qend.të trupëzuara të dëmtuara” në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 paraqitet me vlerën 0, ndërkohë që nga procedurat e inventarizimit janë vlerësuar të dëmtuara dhe për jashtë përdorimit inventare në vlerën 3,779,347.21 lekë për vitin 2021 dhenëvlerën 1,553,416.00 lekë për vitin 2022. Nga auditimi u konstatua se për derisa procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesimit nuk është realizuar për asnjë vit, këto vlera duhet të ishin pasqyruar në llog.24 “Aktive te Qend.të trupëzuara të dëmtuara” në pasqyrat format 1 dhe format 7/a,b;

**II Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive të të “Ardhurat“ dhe “Shpenzimet”**

7. Llogaria 600 “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 175,829,567 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “paga personeli i përhershëm”, “paga personel i përkohshëm”, “shpërblime”, “shpenzime të tjera për personelin” . U konstatua se vlera e llogarisë 600 nuk është ndarë në 2 llogaritë respektive, për të pasqyruar vlerat përkatëse të llog. 6001 “paga personeli përhershëm” dhe llog. 6002 “paga personel i përkohshëm”;

**III Pasqyra Format 8 “numri i punonjësve dhe fondi i pagave”**

8. Nga analiza dhe verifikimet mbi plotësimin e pasqyrave sipas formateve standarde të miratuara nga MFE, u konstatua pasqyra format 8 “numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është plotësuar pjesërisht, duke mos dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit;

9. Nga auditimi u konstatua se për vitin ushtrimor 2022 janë dërguar në Degën e Thesarit Kavajë me shkresën nr. 1394 prot., datë 04.04.2023 dhe me nr. 150 prot., datë 04.04.2023 të Degës së Thesarit Kavajë, në tejkallim të afatit ligjor, datë 31 Mars 2023.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022; UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël”; UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998, ligjin Nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin Nr. 9807, datë 20.09.2007; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar; VKM nr. 610, datë 24.07.2013 “Për miratimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”; VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e Njësitë të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësitë të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”; Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

**Ndikimi:** Mos pasqyrimi në vlerë reale i llogarive ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me rakordimin aktiv-pasiv të bilancit dhe jo vetëm, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara;

**Shkaku:** Kontabilizim i gabuar në llogari apo në vlerë të llogarive nga ana e Sektorit të financës në llogaritë e pasqyrave financiare;

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit Bashkia Rrogozhinë të kryejë veprimet dhe sistemimet kontabël:

1. Në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” e cila është mbivlerësuar në vlerën 2,209,081 lekë, llog.212 nënvlerësuar me 2,135,018 lekë dhe llog. 214 nënvlerësuar me 74,063 lekë;
2. Në llog. 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” pasqyruar në formatin 1 dhe analizës së kësaj llogarie për diferencën mes gjendjes në fillim në vlerën e 4,166,226 lekë dhe asaj në mbyllje të vitit me vlerën 5,002,307 lekë;
3. Paraqitjen te pasqyrat financiare me vlerat përkatëse të secilës prej Llog 435 “Sigurime shoqërore” dhe llog 436 “Sigurime shëndetësore”;
4. Në llog. 466 “mjete në ruajtje” të saktësohet dhe sistemohet diferencames vlerës së pasqyruar në format 1 dhe asaj në analizën e llogarisë prej3,891,800 lekë më shumë, vlerë e cila mungon në analizën e llogarisë 466;
5. Në Llog 24 “Aktive të Qend.të trupëzuara të dëmtuara” të paraqiten vlerat e aktiveve të vlerësuar nga komisionet e vlerësimit të inventareve për dalje jashtë përdorimit/asgjësim në vlerat respektive 3,779,347.21 lekë për vitin 2021 dhenëvlerën1,553,416 lekë për vitin 2022, deri në përfundim të procedurës së asgjësimit;

6. Të hartohen dhe të miratohen Pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor Brenda afateve ligjore datë 31 Mars të vitit pasardhës; Të plotësohen me rigorozitet të gjitha pasqyrat sipas formateve të miratuara nga MFE;

7. Të ndiqen me vëmendje pagesat e aktiveve në proces, që me likuidimin e vlerës së kontratës, të merren në dorëzim objekti i investimit dhe të bëhen veprimet kontabël për mbylljen e llog. 230-231 dhe kontabilizimin e vlerës së tij në llogarinë përkatëse të AAGJM sipas nomenklaturës së llogarive.

8. Në llog. 218 “inventar ekonomik”, vlera e kategorisë “pajisje kompjuterike” të llogaritet e ndarë si kategori më vete për të pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj dhe saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit;

➤ **Drejtimit kryesore të auditimit mbi procedurën e inventarizimit janë:**


- Njohja dhe zbatimi i Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 për marrjen e masave të nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi;
- Përgjegjësia e Titullarit të Njesisë Publike (Kryetari i Bashkisë) në cilësinë e NA, për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njesisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi;
- Përgjegjësia e Nëpunësit zbatues NZ dhe menaxherëve të të gjitha niveleve të Njesisë Publike mbi aktivitetet e njesisë;
- Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve në Bashkinë Rrogozhinë.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia Rrogozhinë: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullore për Menaxhimin e Aktiveve (nëse ka), Manuali i Proceseve të Punës (nëse ka), Manuali i Parandalimit të Konfliktit të Interesit, etj.
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitin 2022; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. Shkresat për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik [GMS]; planin vjetor dhe procesverbalet e takimeve;
5. Strategji dhe Regjistër Risku; Regjistri i Aseteve të Bashkisë Rrogozhinë.

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion nga Bashkia Rrogozhinë, në përgjigje të kërkesave të përshkuara më lart lidhur me Procedurën e inventarizimit të aktiveve, grupi i auditimit referuar Udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, të gjitha njësitë e sektorit publikkanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Nga auditimi në Bashkinë Rrogozhinë, u kërkuan praktikatat e procedurave të inventarizimit për vitet 2021 dhe 2022.



Sk
Inventarizimit

Proçesverbali  
& Raporti  
Përmbledhës

Nga auditimi rezultoi se:

**1.** Referuar Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, praktika e procedurës së Inventarizimit përmban:

- Urdhrit e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e NA për krijimin e komisioneve të verifikimit fizik, vlerësimit dhe asgjesimit të aktiveve; zbatuar

- Përmbledhëse Inventare të 5(pesë) Njësi Administrative: në llogaritë 327, 218, 214, 212, 215; zbatuar

- Relacioni ose Raporti përmblyës përpiluar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të Verifikimit Fizik dhe vlerësimit paraprak të Inventareve; pjesërisht zbatuar

- Bazuar në Raportin e Komisionit tëverifikimit fizik të inventarëve, vijohet me Komisionin e vlerësimit të vlerave materiale për asgjesim; zbatuar

- Komisionin e asgjesimit të vlerave materiale, zbatimi i procedurave të tyre monitorohen nga NZ; Pa zbatuar

**2.** Praktika shkresore për ngritjen e komisioneve për dy vite 2021 dhe 2022 dhe statusi i çdo faze të procedurës së Inventarizimit të Bashkisë Rrogozhinë, njësisë qendrore administrative dhe katër Njësi të tjera administrative është si më poshtë vijon:

Viti	Urdhrat Brendshëm për Komisionet e Inventarit Fizik	Relacionet	Urdhrat Brendshëm për Komisionet e Vlerësimit	Relacionet	Urdhrat Brendshëm për Komisionin e Asgjesimit	Relacionet	Vlera e aktiveve vlerësuar për (në lekë)	Statusi Procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit
2021	UB. 380 dt. 18.11.2021		UB. 381 dt. 18.11.2021		UB. 382 dt. 18.11.2021		3,779,347.21	Pa përfunduar
	UB. 407 dt. 18.11.2021				UB. 388 dt. 23.11.2021	Nr. 4639 dt. 07.11.2022		
					UB. 345 dt. 18.07.2022	24 procesverbale		
					UB. 362 dt. 28.09.2022			
2022	UB. 428 dt. 23.11.2022		UB. 422 dt. 22.11.2022	R. nr.521 dt. 06.02.2023	UB. 423 dt. 22.11.2022	Nëproces	1,553,416.00	UB. 424 dt. 22.11.2022
	UB. 420 dt. 22.11.2022	R. nr. 384 dt. 25.01.2023						Në proces
	UB. 421 dt. 22.11.2022	R. nr. 384/1 dt. 25.01.2023						
	UB. 429 dt. 23.11.2022	25.01.2023						

*Punuar: Grupi i auditimit*

Nga auditimi i dokumentacionit që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, një përmbledhje informacioni të detajuar të praktikës së procedurës së inventarizimit, pasqyrohet në anekset bashkëlidhur.

**Konstatim 1.** Urdhrat e Brendshëm të titullarit nuk kanë afat për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit, duke sjellë vonesa dhe zvarritje të procedurës në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 73, 74;

**Konstatim 2.** Nga auditimi i praktikave dokumentare të procedurës së Inventarizimit rezultoi se nga NjA, nuk janë zbatuar me rigorozitet hapat e procedurës, nga nxjerrja e Urdhrave të brendshëm të administratorëve të njëjësive për ngritjen e komisioneve, deri tek relacioni përmbyllës i procedurës; Këto parregullsi u konstatuan në NJA Kryeviidh dhe Sinaballaj, në moszbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 81, 82;

**Konstatimi 3.** Në praktikat e Inventarizimit Fizik të aktiveve Procesverbalet e vlerësimit të aktiveve nuk kanë informacion të plotë mbi aktivet e cilësuara të dëmtuara: emërtimin e plotë, vitin e hyrjes, çmimin, sasia, vlera etj. Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 95;

**Konstatim 4.** Komisionet e krijuara me Urdhrin e Brendshëm të titullarit për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për asgjësim/ shkatërrim të tyre, nuk e kanë përfunduar këtë procedurë për vitin 2021 dhe për vitin 2022 në mos zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;

**Konstatim 5.** Bashkia Rrogozhinë dhe GMS nuk kanë hartuar dhe miratuar një Strategji dhe Rregullore për menaxhimin e aktiveve të njësisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9;

**Konstatim 6.** Bashkia Rrogozhinë vazhdon të mos ketë hartuar dhe miratuar regjistrin e aseteve të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli IV pika 85/a,b,c. Kjo ka sjellë mos regjistrimin në vlera reale të AAGJM dhe mos pasqyrim të sakt të vlerave të llogarive 210, 211 212 dhe 215 në pasqyrat financiare të njësisë. Në Bashkinë Rrogozhinë për njohjen dhe zbatimin e Ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” rezultoi se:

- Bashkia Rrogozhinë për vitet 2021 e 2022 ka realizuar Inventarizimin e aktiveve të njësisë duke mos i përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore të sipërcituara;
- Komisionet e Inventarizimit krijuar me Urdhër të Titullarit (Nëpunësit Autorizues) për periudhën 2 vjeçare, rezultuan të mos i kenë përmbushur detyrimet sipas përgjegjësive të përcaktuara, duke mos paraqitur kështu një pasqyrim real për kushtet e ruajtjes së aktiveve, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, reflektuar kjo edhe në vlerat e llogarive kontabël të aktiveve të njësisë;
- GMSfunktionon pa hartuar nje plan vjetor dhe grafik takimesh ku të përfshihen edhe hartimi e miratimi i strategjive për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre, hartimin e një rregulloreje për menaxhimin e aktiveve të njësisë;
- NZ nuk ka kushtuar vëmendjen e duhur për përmbylljen e të gjitha proceseve të Inventarizimit dhe hartimin e regjistrin të aktiveve të njësisë.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:*

- 1) Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, si dhe nenet 9, 10, 11 të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 2) Udhëzimi i vitit 2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”
- 3) Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitet dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”
- 4) Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

#### **Titulli i gjetjes 8: Mbi procedurën e Inventarizimit**

**Situata: 9.** Urdhrat e Brendshëm të titullarit nuk kanë afat për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit, duke sjellë vonesa dhe zvarritje të procedurës në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 73, 74;

**10.**Nga auditimi i praktikave dokumentare të procedurës së Inventarizimit rezultoi se nga NjA, nuk janë zbatuar me rigorozitet hapat e procedurës, nga nxjerrja e Urdhrave të brendshëm të administratorëve të



njësive për ngritjen e komisioneve, deri tek relacioni përmbyllës i procedurës; Këto parregullësi u konstatuan në NJA Kryevidh dhe Sinaballaj, në moszbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 81, 82;

**11.** Në praktikat e Inventarizimit Fizik të aktiveve Procesverbalet e vlerësimi të aktiveve nuk kanë informacion të plotë mbi aktivet e cilësuar të dëmtuara: emërtimin e plotë, vitin e hyrjes, çmimin, sasia, vlera etj. Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 95;

**12.** Komisionet e krijuara me Urdhrin e Brendshëm të titullarit për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për asgjësim/ shkatërrim të tyre, nuk e kanë përfunduar këtë procedurë për vitin 2021 dhe për vitin 2022 në mos zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;

**13.** Bashkia Rrogozhinë dhe GMS nuk kanë hartuar dhe miratuar një Rregullore për menaxhimin e aktiveve të njësisë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9;

**14.** Bashkia Rrogozhinë vazhdon të mos ketë hartuar dhe miratuar regjistrin e asetëve të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli IV pika 85/a,b,c. Kjo ka sjellë mos regjistrimin në vlera reale të AAGJM dhe mos pasqyrim të saktë të vlerave të llogarive 210, 211 212 dhe 215 në pasqyrat financiare të njësisë;

**15.** Nga auditimi rezultoi se asetet e Bashkisë Rrogozhinë nuk janë të pajisura me certifikate pronësie, mos rivlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë mos pasqyrim të saktë të vlerave të tyre në llogaritë përkatëse 210, 211, 212, dhe 215.

**Kriteri:** Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”; Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

**Ndikimi:** Nga Bashkia Rrogozhinë rezulton të mos jenë përmbushur detyrimet lidhur me të gjitha hapat e procedurës së inventarizimit veçanërisht atë të asgjësimit të atyre inventarëve të vlerësuara si të papërdorshme apo me jetën e dobishme 0 (për jashtë përdorimi) me qëllim shkarkimin nga kontabiliteti i Njësisë; Gjithashtu mungesa e Grupit të Menaxhimit Strategjik ka sjellë mos hartimin/ miratimin e një strategjie për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre; e një rregulloreje për menaxhimin e tyre, mungesa e të cilave riskon efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi aktivet e njësisë.

**Shkaku:** Gjatë periudhës nën auditim Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe Sekretari i Përgjithshëm, nuk kanë treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur në përmbushjen e detyrimeve ligjore/nënligjore lidhur me procedurën e inventarizimit të aktiveve të Njësisë, krijimin e regjistrit të aktiveve dhe pasjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm sa më efektiv mbi aktivet e bashkisë.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi: 9.1:** Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Sekretari I Përgjithshëm në Bashkinë Rrogozhinë të marrin masa për të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë, kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/ asgjësimit të atyre të amortizuara; në krijimin e regjistrit të aktiveve sipas kërkesave të akteve ligjore/nënligjore në fuqi;

**9.2** Nëpunësi Autorizues, GMS dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa në miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi;

**9.3** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me njësitë e tjera në strukturë të hartojnë regjistrin e asetëve të bashkisë, ku të identifikohen dhe të pasqyrohen gjithë të dhënat konform udhëzimeve ligjore;

**9.4** Dejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisin proceduar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e

bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave te sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.

➤ **Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike, në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës**

Në Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të republikës së Shqipërisë”, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë: *Bashkia* - njësia bazë e vetëqeverisjes vendore dhe *Qarku* - njësia e nivelit të dytë. Bazuar në *Misionin* e Vetëqeverisjes Vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Qarku	Qendra e Bashkisë	NjA
Tiranë	Rrogzhinë	Gosë
		Lekaj
		Kryevindh
		Sinaballaj


Burimi: *Bashkia Rrogzhinë*

**I.** Struktura e Bashkisë Rrogzhinë dhe emërimet e personelit përbërës të saj, janë kompetencë e kryetarit të bashkisë bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9/c dhe neni 64/e,ë,j,k; ndërsa Këshilli Bashkiak ushtron kompetencat e tij bazuar në nenin 54/ç,dh të po këtij ligji në miratimin e nivelit të pagave dhe buxhetit ku konfirmohet edhe numri i përgjithshëm i punonjësve në strukturë.

**a.** Për strukturën organizative janë miratuar:

- *Për vitin*

*2022*, Vendimi nr. 102 datë 20.04.2022 i kryetarit të bashkisë me nr. 1510/1 prot. datë 20.04.2022 “Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Rrogzhinë për vitin 2022”.



Skema miratim /konfirmim e Strukturës dhe Nivelit të pagave

**b.** Për miratimin e nivelit të pagave dhe të buxhetit janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me:

**1.** VKB nr. 73 datë 22.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave” konfirmuar me ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Tiranë nr. 35/1 datë 11.01.2022;

VKB nr. 71 datë 22.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor të vitit 2022 në Bashkinë Rrogzhinë” dhe VKB nr. 72 datë 22.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”. Struktura organizative për vitin 2022 është miratuar me 317 punonjës, prej të cilëve 87 pozicione janë me statusin e nëpunësit civil.

**Konstatim** Nga auditimi rezultoi se VKB nr. 71 dhe VKB nr.72 datë 22.12.2021 nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për Arkivat” nenet 23, 24; “Norma Tekniko-Profesionale Dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13 dhe neni 19 dhe Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

a. Strukturat e Bashkisë janë hartuar/miratuara sipas kërkesave të Ligjit nr.139/2015 neni 64/j, ku specifikohen elementët që duhet të përmbajë Struktura organizative e NJVQV: pozicioni, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, numrin e personelit për çdo pozicion, në përputhje kjo me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu rezultoi se vitet e fundit ka rikompozime të njësive të strukturës, lëvizje të numrit të personelit dhe qarkullim të tyre brenda njësisë. Struktura organizative e Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022 është miratuara me Vendim të kryetarit nr. 102 datë 20.04.2022 dhe ka këtë kompozim.

Viti	Buxheti Faktik në 000/lekë	Nr. i Drejtorive	Nr. i Sektorëve	Nr. i stafit Plan / Fakt
2022	173,638	7	22	317   309

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 në Bashkinë Rrogozhinë ka një numër të kufizuar punonjësish me statusin e “Grupit të veçantë” ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Nga 317 pozicione në strukturë, janë vetëm **3** punonjës të këtij grupi: **2** punonjës me statusin “invalid” dhe **1** punonjës nga komuniteti Rom.

**Konstatim.** Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Rrogozhinë rezulton se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i vecantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 datë13.03.2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”.

b. Punësimi në Bashkinë e Rrogozhinës mbështetet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Ndërsa për njësitë e MZSH-së dhe Policisë Bashkiake i shtohen edhe kriteret e veçanta të pëcaktuara në Ligjin nr.152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin” shoqëruar me aktet nënligjore të tij VKM nr.895/2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të Gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKM nr.350/2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; Mbi Ligjin nr. 8224, datë 15. 5. 1997 “Për policinë e bashkisë”, VKM nr.313/2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së Bashkisë dhe Komunës” i ndryshuar.

Procedura e punësimit rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë Rrogozhinë përshkruar si më poshtë:

» Drejtoria e Ligjore dhe Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me publikun [DLBNJMP] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

» Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM-së nr.243/2015 i ndryshuar;

» Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Komiteti i Përhershëm i Pranimit është ngritur me Urdhrin e Brendshëm të kryetarit të bashkisë nr. 404 datë 26.12.2021 me nr. 5685 prot., datë 26.12.2021 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit për strukturën organiozative të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022”. Ky komision përbëhet nga 3 anëtarë.

- Bashkia Rrogozhinë ka miratuara me Vendim të Kryetarit të Bashkisë “Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil” dhe dërguar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit si më poshtë vijon:

Për vitin 2022 – VKB nr.123 datë 12.05.2022 me nr. 2059 prot. datë 12.05.2022, praktikë e cila përmban kërkesat drejtuar të gjitha njësive të strukturës për nevojat e secilës për personel të ri me shpjegimet

përkatëse, relacionin e Drejtorisë Juridike e burimeve njerëzore me përmbledhjen e kërkesave për personel, duke specifikuar numrin, pozicionin, grupin e pagës;

Pozicionenëstrukturë (NC)	viti 2022	
	plan	vakant
Kategoria e lartë	1	-
Kategoria e mesmedrejtuese	7	-
Kategoria e ulëtdrejtuese	19	2
Kategoriaekzekutive	57	2
<b>Totali</b>	<b>84</b>	<b>4</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

**Konstatim** Plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil është miratuar në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar neni 18, por në tejkallim të afateve, në moszbatim të VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 11.

Struktura e Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022 është miratuar me Vendimin nr. 102 datë 20.04.2022 të kryetarit të bashkisë me nr. 1510/1 prot. datë 20.04.2022 “Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022”;

Në Bashkinë Rrogozhinë nga auditimi rezultoi se për vitin 2022, nuk ka të punësuar me kontratë me kohë të pjesshme;

Në Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2022 informacioni i vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore për punonjësit me kontratë të përkohshme (bashkë me NjA) për periudhën janar-dhjetor është si në tabelën më poshtë, kryesisht në Drejtorinë e shërbimeve publike në pozicionet: sanitare, mirëmbajtje, punëtor krahu etj. **U konstatua** se në Strukturën organizative dhe planin vjetor të punësimeve, nuk është pasqyruar edhe numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të planifikuar si dhe sektorët /drejtoritë që u nevojitet ky kontigjent, në moszbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika c, neni 54 pika dh, neni 64 pika j.

Muaji / viti 2022	Nr i punonjësve me kontratë të përkohshme	Paga bruto
Janar	44	621,812
Shkurt	44	657,258
Mars	18	511,364
Prill	18	576,000
Maj	43	1,121,455
Qershor	63	1,066,106
Korrik	39	1,147,334
Gusht	41	1,276,411
Shtator	52	1,207,734
Tetor	37	1,123,545
Nëntor	40	1,281,182
Dhjetor	42	1,409,455

*Punoi: Grupi i auditimit*

- Nga auditimi i ditarit të pagesave rezultoi se numri i të punësuarve me kontratë të përkohshme ka qenë i shtrirë në të gjithë muajt e vitit 2022 dhe me numër të ndryshëm punonjësish, ku numrin më i ulët i përket muajve mars e prill me 18 punonjës, ndërsa numri më i lartë në muajin qershor me 63 punonjës.

- Me përzgjedhje u audituan disa nga listëpagesat e periudhës janar-dhjetor 2022. Rezultoi se plotësohen konform rregullave të përcaktuara, të cilat plotësohen mbi bazën e listëprezencave mujore të hartuara nga burimet njerëzore dhe të nëshkruara nga Sekretari i përgjithshëm dhe Kryetari i bashkisë, është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin 7961 datë 12.07.1995 ”Kodi i Punës” i ndryshuar.

- Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit mbi sigurimet shoqërore të punonjësve në Bashkinë Rrogozhinë, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8434 datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjit nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në RSH”;

- Sipas listëpagesave të përzgjedhura, është zbatuar struktura sipas vendimeve të miratuara;

- Listëpagesat janë të nënshkruara nga Drejtori i Financës dhe specialistja e pagave;

- Është përgatitur përmbledhësja e listëpagesave me nënshkrimin e Drejtorit të Financës dhe Kryetarit të Bashkisë;

- Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimit mbi pagën, dhe sigurimit suplementar në masën 5%, janë bërë ndalesat edhe për punonjësit debitorë mbi bazën e urdhrave përkatëse;

- Për shkak të përfshirjes në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie të Bashkisë Rrogozhinë, disa punonjës në referim të Akteve ligjore të KQZ-së, kanë paraqitur kërkesën për pjesëmarrjen në procesin e votimit, si pjesë e strukturave të tij. Punonjësit e nënshtruar kësaj procedure janë:

1. E.S.,
2. A. H.
3. M.M.
4. R.T..

c. Të dhënat mbi largimet dhe emërimet e punonjësve nga puna për Bashkinë Rrogozhinë është si më poshtë:

Arsyet e largimit	2022	Punësime
Pension	6	
Doreheqje	28	
Me procedure/mos paraqitje në punë	7	
Përfundim kontratë	3	
KMCAP	1	
Transferim	0	
Mbyllje e vendit të punës/ristrukturim	1	
Ndarje nga jeta	0	
<b>TOTALI</b>	<b>46</b>	<b>50</b>

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se numri i punonjësve të larguar nga puna është 46, ku numrin më madh prej 28 e zënë të larguarit me “dorëheqje” ose rreth 61 % e tyre; numri i punonjësve të larguar për mosparaqitje në punë është 7 ose 15.2 %. Për këta punonjës janë ndjekur hapat ligjorë dhe rezultojnë se nuk ka procese gjyqësore; Procese gjyqësore në shkallë të ndryshme gjykimi janë 3, por për largime të kryera para vitit 2022.

- Punësimet e punonjësve në Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2022 janë si rezultat edhe i strukturës së re organizative, duke e çuar numrin e punonjësve në strukturë me 317 punonjës.

Për vitin 2022 nga auditimi rezultoi se janë punësuar 50 punonjës në total. Kjo ka bërë që për vitin 2022 numri i punësimeve është më i lartë se ai i largimeve të tyre dhe se numri i vendeve vakante në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve në strukturë është 4 me status të NC dhe 3 me Kod Pune.

b. Informacioni që [DLBNJMP] i vuri në dispozicion grupit të auditimit lidhur me personat e larguar nga puna procedura e të cilëve është shoqëruar me padi në Gjykatën Administrative, u kërkuar statusi ligjor i saj në gjykatë dhe rezultojnë si më poshtë:

EmërMbiemër	Statusiiprocesitgjyqësor	
A.B.	Shkalla e Parë/humbur	Gjykataadministrapelit/ fituar
B.P.	Shkalla e Parë/fituar	Gjykataadministrapelit/ nëproces
E.A.	Shkalla e Parë/humbur	Nuk ka

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

e. Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhet të jenë pjesë në rregulloren e brendshme të njësisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. [SBNJ] nga ana e tij pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimit ligjor në fuqi, “Kodit të punës”, VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar. Gjithashtu [SBNJ] harton Formularët e Përshkrimit të Pozicionit të Punës të çdo pozicioni në strukturë në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, duke e bërë pjesë të dosjes në zbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky formular është pjesë përbërëse e manualit të procedurave të njësisë publike.

Drejtoria Ligjore dhe e Burimeve Njerëzore, si struktura përgjegjëse për personelin, njofton për çdo rast Titullarin e bashkisë mbi vendet vakante në strukturën organizative të njësisë publike, i cili nga ana e vet në fund apo fillim të çdo viti, nxjerr Urdhrin për ngritjen e Komisionit të përhershëm të punësimit, i cili ndjek procedurën e punësimit: njoftimi, konkurimi, shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesit, etj deri në emërimin e aplikuesve nga ana e titullarit të bashkisë.

f. Referuar Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 21 “Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.”, përshkrimet e punës janë miratuar nga DAP dhe për të gjitha punësimet e kryera në vitin 2022 janë zbatuar, pjesë e strukturës janë edhe njësitë: Njësia e Auditimit të brendshëm [NJAB], Policia Bashkiake [PB], Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi [MZSH], Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit [IVMT], të cilat i nënshtrohet edhe zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore specifike, përsa i përket numrit të punonjësve dhe kërkesave të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët për tu emëruar në këto njësi.

nr	Emërtimi i njësisë	Akti Ligjor bazë	Numri i punonjësve në strukturë	Numri i punonjësve faktik
1	Njësia e AB	Ligji 114/2015 dhe Manuali AB	3	3
2	Policia Bashkiake	Ligj nr. 8224, datë 15.5.1997 VKM nr. 313, datë 01.07.2002	11	11
3	MZSH	Ligji Nr. 152/2015, VKM nr. 350, datë 19.4.2017 VKM Nr. 366, datë 18.5.2016	14	14
4	IVMT	Ligj nr.9780, datë 16.7.2007 i ndryshuar me Ligjin nr.183/2014; VKM nr.894 datë 04.11.2015	6	5

*Punoi: Grupi i auditimit*

Njësia e MZSH-së i ushtron funksionet e veta në zbatim të Ligjit nr.152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe Shpëtimin” si dhe Aktet nënligjore të tij VKM nr.895/2016 “Kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo grade, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKM nr.350/2017 “Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” etj.

**Konstatim:** Referuar Ligjit 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, neni 7, pika 5 “Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin **1** zjarrfikës profesionist për **1500-2000** banorë”; pika 6 “Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se **14** zjarrfikës, personel profesionist”, nga auditimi rezulton se njësia e MZSH-së në Bashkinë Rrogozhinë, nuk i plotëson kriteret përsa i përket numrit të personelit profesionist; nisur nga numri i banorëve, Bashkia Rrogozhinë hyn në kategorinë nga [20000-50000] banorë, duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë nga 19 deri në 23 zjarrfikës personel profesionist.

- Nga verifikimi i dosjeve të menaxherëve të njësisë të strukturës, rezultoi se ka përputhje të kualifikimit profesional me pozicionin e punës në strukturë.

**Konstatim:** Lidhur me arsimin/llojin e diplomimit e personelit përbërës të Njesisë së IVMT-së, rezultojn se kryeinspektori nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme”, gjë që rikon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njesisë vendore”.

- Nga verifikimi i pozicioneve me kod pune i punonjësve të cilët janë të punësuar si “shofer” dhe që kanë në ngarkim për të përdorur një mjet transporti, rezultoi si më poshtë:

Emër mbiemër	Akti i punësimit	Praktika e procedurës së punësimit	Dokumentacioni përbërës i dosjes	Dokumenti i drejtimit të mjetit	Pozicioni	Dëshmi e aftësisë profesionale
E.B.	Urdhri nr.108 dt 27.06.2020	mungon	Me mangësi	po	manovrator	jo
Sh.K.	Urdhri nr.39 dt.8.02.2020	mungon	Me mangësi	jo	shofer	Nuk nevojitet
F.P.	Urdhri nr.247 dt.12.09.2019	mungon	Me mangësi	jo	ekskavatorist	jo
A.D.	Urdhri nr.85 dt. 07.05.2020	mungon	Me mangësi	jo	shofer	Nuk nevojitet
E. D.	Urdhri nr.1017	mungon	Me mangësi	po	manovrator	po

*Punoi: Grupi i auditimit*

Gjithashtu klasifikimi i tyre për efekt page është: shofer automjeti deri në 2.5 t - [klasa IV] dhe shofer automjeti mbi 2.5 t - [klasa VIII]. Nga auditimi i dosjeve të tyre, rezultoi se për automjete me destinacion të veçantë, që duhet të përdoren nga drejtues që janë të pajisur me “leje drejtimi” dhe “dëshmi aftësie profesionale” (sipas llojit të mjetit që ka në përdorim), punonjësit e punësuar si drejtues mjeti (shoferë) nuk janë të gjithë të pajisur me dokumentacionet justifikuese profesionale, në moszbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 200 datë 16.05.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”;

g. Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave është si më poshtë:

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2022	
	Plan	Fakt
600	176,393	173,638
601	31,804	28,971

*Burimi: Bashkia Rrogozhinë*

Nga të dhënat e pasqyrës, rezultojn se fondi i pagave në Bashkinë Rrogozhinë zë 20.6% të buxhetit.

Nga auditimi mbi fondet e pagave, **konstatohet** se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve; gjithashtu nuk zbatohet as VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.

h. Mbi verifikimin e dokumentacionit përbërës të dosjeve të personelit të emëruar dhe të larguar në vitin 2022, përzgjedhëm disa dosje për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

- Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit kërkuam dosjet e punonjësve të emëruar në Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2022 për të gjitha kategoritë, lëvizjeve të personelit /ngritjet në detyrë si dhe të punonjësve të larguar të periudhës nën auditim.

**Konstatim:** Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në dosjet e personelit mungonin: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; vërtetimi i prokurorisë dhe gjykatës, formulari i vetdeklarimit, përshkrimi i punës;

- *Dosjet e punonjësve të larguar* nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.) për Bashkinë Rrogozhinë rezultoi se:

- Të krijohet një strukturë organizative efektive në zbatim të të gjitha akteve ligjore/nënligjore;

- Për emërimet në punë të zbatohen aktet ligjore/nënligjore lidhur me plotësimin e kriterëve bazë dhe të veçanta që kërkon çdo pozicion në strukturë;

-Të zbatohen aktet nënligjore lidhur me shpërblime/ dieta ushqimore punonjësve me Kod Pune, duke parashikuar në PBA-të dhe buxhetin vjetor të Bashkisë në Llog.600 “Paga dhe përfitime të punonjësve”, në llog. përkatëse.

- Të plotësohen dosjet e personelit sipas kërkesave të VKM 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit ”Lidhja 1 e 2;

*Mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:*

-Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, si dhe nenet 9, 10, 11 të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

-Udhëzimi nr. 21 date 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”

-Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinitorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinitorit të riskut në njësitë publike”.

**Titulli i gjetjes 9: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022**

**Situata: 14.** Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Rrogozhinë rezultoi se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i vecantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”;

**15.** Plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil është miratuar në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar neni 18, por në tejkallim të afateve, në moszbatim të VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”pika 11;

**16.** Nga auditimi i informacionit dokumentar të vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore për punonjësit me kontratë të përkohshme (bashkia me NjA) për periudhën janar-dhjetor e pasqyruar dhe në tabelë, rezultoi se punësimet e kësaj kategorie janë kryesisht në Drejtorinë e shërbimeve publike në pozicionet: sanitare, mirëmbajtje, punëtor krahu etj. U konstatua se në Strukturën organizative dhe planin vjetor të punësimeve miratuar me VKB, nuk është pasqyruar edhe numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të planifikuar për vitin 2022 si dhe sektorët /drejtoritë që u nevojitet ky kontigjent, në moszbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika c, neni 54 pika dh, neni 64 pika j;

**17.**Referuar Ligjit 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, neni 7, pika 5 “Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin **1** zjarrfikës profesionist për **1500-2000** banorë”; pika 6 “Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se **14** zjarrfikës, personel profesionist”, nga auditimi rezultoi se njësia e MZSH-së në Bashkinë Rrogozhinë, nuk i plotëson kriteret përsa i përket numrit të personelit profesionist; nisur nga



numri i banorëve, Bashkia Rrogozhinë hyn në kategorinë nga [20000-50000] banorë, duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë nga 19 deri në 23 zjarrfikës personel profesionist;

**18.** Lidhur me formimin arsimor e profesional/ lloji diplomës e personelit përbërës të Njesisë së IVMT-së, rezulton se kryeinspektori nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme”, gjë që riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr.894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njesisë vendore”;

**19.** Nga të dhënat e pasqyrës së pagave, rezulton se fondi i pagave në Bashkinë Rrogozhinë zë 20.6% të buxhetit. Nga auditimi mbi planifikimin e fondit të pagave, u konstatohet se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve me “status civil”; gjithashtu nuk zbatohet as VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore” për punonjësit me “kod pune”;

**20.** Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në *dosjet e personelit* nuk ishin bërë pjesë e tyre: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; vërtetimi i prokurorisë dhe gjykatës, formulari i vetdeklarimit, përshkrimi i punës;

- *Dosjet e punonjësve të larguar* nuk ishin bërë pjesë e tyre praktika e plotë të ndërprerjes së marrëdhënies të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

**Kriteri:** Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr.152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”; Ligjin nr. 8224, datë 15. 5. 1997 “Për policinë Bashkiake”; VKM nr.313/2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së Bashkisë dhe Komunës” i ndryshuar; VKM nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 177, datë 08.03.2017; VKM nr.895/2016 “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të Gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018 ; VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”; Ligjin nr.183/2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”; VKM nr.894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njesisë vendore”.

**Ndikimi:** Mungesa e politikave efektive të burimeve njerëzore ka cenuar garantimin e kriterëve dhe kërkesave të përshtatshme mbi bazën e kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit.

**Shkaku:** Mungesa e vëmendjes për një vlerësim real të rëndësisë së përcaktimit të kriterëve profesionale në rekrutimin dhe emërimin e stafit nga ana e NA dhe Drejtorisë ligjore, të burimeve njerëzore dhe komunikimit dhe Komisionit të punësimit në Bashkinë Rrogozhinë.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe Komunikimit, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Rrogozhinë të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë

organizative konform funksioneve që i atribuon ligji, për rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit; hartimin e kriterëve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale; të caktojnë në strukturën organizative pozicione për kategorinë “grup i veçantë”; si dhe të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, të gjitha këto për motivimin e punonjësve në rritjen e efektivitetit të shërbimeve nga ana e tyre në dobi të komunitetit.

## 2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

### *Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve*

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendime të KB, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Rrogozhinë (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës	Vlera e kontratës	Data e kontratës
1	Blerje detergjente për shkollat dhe cerdhet	1500000.00	Kërkesë për propozim	1,498,000	6/16/2020
2	Blerje dru zjarri	3,000,000	Kërkesë për propozim	2,988,000	12/17/2020
3	Blerje karburanti	6,500,000	Kërkesë për propozim	14%	6/23/2020
4	Dezinfektim i rrugëve, shesheve, objekteve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë Rrogozhinë në kuadër të Covid 19.	1,500,000	Negocim pa shpallje	1,486,274.40	4/15/2020
5	Izolim të taracave të institucioneve	1,243,333	Kërkesë për propozim	763,750	7/8/2020
6	Mbikqyrje punimesh për objektin: “Rehabilitimi i kanaleve sekondare Peqin-Kavaje, Faza e Tretë”	1,837,282	Kërkesë për propozim	1,655,719	11/6/2020
7	Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujerave të zeza „Lagja e Re Gose, Bashkia Rrogozhine	24,570,117	E Hapur	24,308,811	3/1/2021
8	Pastrim të kanaleve kulluese Bashkia Rrogozhine	4,099,950	Kërkesë për propozim	4,080,980	2/23/2021
9	ReH.timi i Kanaleve Sekondare Peqin-Kavajë, Fazas e Tretë	83,333,333	E Hapur	81,402,620	11/3/2020
10	Rikonstruksion i magjistratit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshun dhe Mushnik NjA Lekaj, Bashkia Rrogozhinë.	249,541,030	E Hapur	249,435,752	2/4/2021
11	Rikonstruksion i rrugës Greth-Rrethgreth	66,666,666	E Hapur	66,265,100	6/30/2020
12	Rikonstruksion i rrugëve të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza e Parë.	91,666,666	E Hapur	91,568,615	5/7/2020
13	Rikonstruksion objekti në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë për strehim social	10,607,556	Kërkesë për propozim	10,399,155	10/9/2020

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Rrogozhinë (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

N r.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Procedura	Vlera e kontratës	Data e kontratës
1	Blerje dru zjarri dhe pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë	3,000,000	E Hapur e thjeshtuar	2,988,000	12/16/2021
2	Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë	6,500,000	E Hapur e thjeshtuar	6,499,995	7/19/2021
3	Mbikqyrje punimesh në objektin: “Rikonstruksion i ujësjellësit Gosë, Bashkia Rrogozhinë	2,569,661	Kërkesë për propozim	2,241,289	4/30/2021
4	Mbikqyrjepunimeshpërobjektin: “Rikonstruksion i magjistratit kryesor dhe rrjetit	3,317,020	Kërkesë	2,892,708	3/11/2021

	të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluizaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik NJA Lekaj, Bashkia Rrogozhinë”.		për propozim		
5	Rikonstruksion i ujësjellësit Gosë, Bashkia Rrogozhinë	161,244,201	E Hapur	159,636,487	4/26/2021
6	Rikonstruktimi i structures dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë	38,987,720	E Hapur	38,933,223	5/26/2021

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Rrogozhinë (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Procedura	Vlera e kontratës	Data e kontrates
1	Blerje dru zgjarri dhe pellet për nevojatë B. Rrogozhine	3,000,000	E Hapur e thjeshtuar	3,000,000	10/26/2022
2	Blerje Karburanti për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë	11,200,000	E Hapur	9,720,260	4/28/2022
3	Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtja e varrezave dhe dekorit në territorin e Bashkisë Rrogozhinë (5 vjet)	305,040,650	Open INT	304,164,000	10/17/2002

### **Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara**

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon*:

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon*:

- Nga auditimi i **8** procedurave me vlerë të fondit limit **631,562 mijë lekë**, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, gjithsej **8** procedura me vlerë të kontratës **627,332 mijë lekë ose 99 %** e vlerës së fondit limit të audituar, ku në të gjitha rastet OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK Bashkia Rrogozhinë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime që kanë sjell përdorim në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **627,332 mijë lekë pa Tvsh**. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për PP. **Për sa trajtuar ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NjHDT, KVO dhe Titullari i AK sipas procedurave, si më poshtë vijon:**

### **Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara**

Janë audituar procedurat e prokurimit si më poshtë:

Nr	Objekti prokuruar	Fondi limit pa TVSH	Operatori fitues	Kontrata me OE fitues	
				Nr/ datë	Vlera pa TVSH
1	Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I	91,666,666	P.V.	05.07.2020	91,568,615
2	Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë	6,500,000	G. C. G.		6,500,000
3	Rikonstruksion objekti në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë për strehim social	10,607,556	B.	10.09.2020	10,399,155
4	ReH.timi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë , Faza e Tretë	83,333,333	E.S.	01.03.2020	81,402,620
5	Pastrim Kanalesh Kulluese Bashkia Rrogozhinë	4,099,950	“Ll.” Shpk & “B.”	10.12.2020	4,080,980
6	Rikonstruksion i Magjistratit kryesor dhe rrjetit të Ujësllësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluizaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik NjA Lekaj.	249,541,030	B.. B	02.04.202	249,435,752
7	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, lagjia e re Gosë	24,570,117	BOE “M.” Shpk & “E.” Shpk		24,308,811
8	Rikonstruksion i ujësjellësit Gosë.	161,244,201	B.. B	26.04.2021	159,636,487
	<b>SHUMA</b>	<b>631,562,853</b>		<b>99.33%</b>	<b>627,332,420</b>

A. Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2020, deri më 31.12.2020**, paraqiten si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i Rrugëve të Lagjes sipër Stacionit të Trenit, në Qytetin e Rrogozhinës, Faza e Parë”,viti 2020.**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rrugëve të Lagjes sipër Stacionit të Trenit, në Qytetin e Rrogozhinës, Faza e Parë”,viti 2020.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 28 datë 05.02.2020	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 680 prot., datë 05.02.2020	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr. 680 prot., datë 05.02.2020
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1. H.P.(Jurist) 2. A.S. (Arkitekt) 3. E.H. (Shkenca sociale)	1. J.M. (Kryetar)-Jurist 2. F.M. (Ekonomist) 3. S.B. (Ekonomist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> <b>91,666,666</b> lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “B.-B” Shpk &“B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, vlera e ofertës <b>91,568,615</b> lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 98,051 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 13.03.2020	<b>9. Burimi Financimit:</b> AKUM	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE“B.-B” Shpk &“B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V. Shpk 2. BOE “B. X” Shpk & “Gj.C.” shpk 3. OE “E.V.” Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b> 1.OE “Ll.” Shpk nr. 1015 prot., datë 14.02.2020 2. OE “K.K.” Shpk, nr. 977 prot., datë 14.02.2020. 3. OE “B. – X” Shpk & “Gj.” nr. 1 prot., datë 17.03.2020	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nr. 1948/1 Prot.,datë 01.04.2020	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b> Vendim K.P.P 146/2020
<b>b. Kontrata nr. 2283 prot., datë 07.05.2020</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 07.05.2020</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>109,882,338</b>

#### **Përlllogaritja e Fondit Limit:**

Projekt zbatimi është realizuar nga OE “A.S.” Shpk.

Me shkresën nr. 2888 prot., datë 23.11.2020, AKUM ka miratuar Projekt zbatimin për objektin: Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Nj. A, Lekaj, Bashkia Rrogozhinë”, me vlerë të plotë 299,449,236 lekë me Tvsh.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Oponenca Teknike me nr. 2855/2 prot., datë 08.11.2021, është realizuar nga Drejtoria e Rregullave dhe Oponencave në Institutin e Ndërtimit.

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit më datë 05.02.2020, janë formuluar/nënshkruar formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interesit.

#### **Ankesa për DT:**

Me nr. 155 prot., datë 02.09.2020 OE “B.” Shpk, (në Bashkinë Rogozhinë) ka formular kërkesën për sqarim ankesën depozituar në Bashkinë Rogozhinë me me nr. 4843 prot., datë 03.09.2020.

Me nr. 4843 prot., datë 11.09.2020, Sqarim për kriteret dhe Specifikimet Teknike drejtuar OE “B.” Shpk, nga Titullari i AK znj. A.D., ku sqarohet se Kriteret dhe specifikimet teknike janë të hartuara në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me nr. 923 prot., datë 12.02.2020 OE “R.” Shpk, ka formular ankesën nr. 10, datë 11.02.2020 në lidhje me DT.

Me nr. 924 prot., datë 12.02.2020 është formuluar tërheqja nga ankesa e shoqërisë së sipërcituar.

#### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP është dërguar më datë 24.02.2020, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të lagjes sipër stacionit të trenit, në

qytetin e Rrogozhinës”, Bashkia Rrogozhinë me fond limit **91,666,666 lekë pa Tvsh**, AK Bashkia **Rrogozhinë, në lidhje me** procedurën me REF—49311-02-05-2020, në lidhje me disakonstatime në DT. Me nr. 1635 prot., datë 05.03.2020 Urdhëri nr. 50 i Titullarit të AK znj. A.D., për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe modifikimin e DT nga NJHDT.

Më datë 06.03.2020 është hartuar shtojca 12 e DT.

**Titulli i gjetjes 10:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

#### **Situata:**

**1. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik,** është kërkuar: *“Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:*

*N.P – 6 A Diga dhe tunele hidroteknike.*

*N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

*N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to*

*N.S - 6 A Sinjalistika rrugore jo ndricuese*

*Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

Referuar nga zërat e punimeve të përfshira në DT (projekt preventive), licencat e kërkuara nuk parashikohen për zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës.

AK nuk ka parashikuar punim për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorive në licencë, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi erregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterereve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**2. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik,** është kërkuar: *“OE të ketë Licencë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL.Kodi 1.2.A. Në rast të BOE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve).*

Ekspertiza profesionale është realizuar që në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektitit dhe relacionit teknik. OE i shpallur fitues është i detyruar të zbatojë punimet sipas KTZ.

Në rastet kur ekspertiza e sipërcituar do të ishte e domosdoshme në zbatimin e punimeve, për objektit që prokurohet, atëherë kjo ekspertizë mund të sigurohet nëpërmjet kontratave me konsulentë tëlicencuar, dhe nuk është e nevojshme të kërkohej që vetë OE ofertues të disponojë një licencë të tillë.

- *“OE duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Tipi C Kodi III.1.A. për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve”).*

Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme, nuk është i nevojshëm për realizimin e projektit, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi OE të cilët mund të disponojnë të gjithë kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, penalizohen vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh, e për rjedhojë as lejen mjedisore të kërkuar.

- *“OE të ketë Licencë për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor ndikim në mjedis) Kodi III.2.A (1+2). Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve”).*

Vlerësimet për ndikimin në mjedis, pas realizimit të objektit të kontratës, do të kryhen në vijim dhe nuk janë objekt i kontratës qëprokurohet.

Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: “VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte të një projekti mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore”.

-OE duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve).

Për kriterin e vendosur të kërkesës për licencë QKB, III.2.B, argumentojmë, që në bazë të legjislacionit shqiptar, çdo operator ekonomik që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, duhet të hapë edhe një seli të saj, NIPT si dhe të ushtrojë aktivitetin e plotë si subjekt ekonomik.

Mbështetur në Ligjin për lejet e mjedisit si dhe VKM 419 “Mbi procedurat e pajisjes me leje mbjedisit për ushtrimin e aktivitetit”, Subjekti që do të kryejë punimet, klasifikohet në operator që gjeneron mbetje urbane në atë njësi administrative ku do të kryejë punime. Për rrjedhojë, çdo subjekt duhet të jetë i pajisur me lejen përkatëse të mjedisit, ku detyrimisht përcaktohen format, detyrat dhe metodat të trajtimit të mbetjeve të gjeneruara, si dhe metodat e trajtimit dhe rekuperimit të ndërhyrjeve. Në këtë rast bashkia është partneri dhe bashkëpuntori që bën të mundur trajtimin me efikas të mbetjeve, por theksojmë se, nga pikëpamja ligjore, është operatori, ai që bën gjenerimin e mbetjeve dhe për rrjedhojë edhe ka edhe detyrimin ligjor të trajtojë këto mbetje.

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës:

Vendosja e kriterereve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**3. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik**, është kërkuar: “Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën: OE duhet të jetë i pajisur me:

- *Certifikatë ISO 9001-2015 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve).*
- *Certifikatë ISO 14001-2015 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve).*
- *Certifikatë OHSAS 18001-2007 ose certifikatën ekuivalente ISO 45001-2018, të njohur nga standartet shqiptare, (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve).*
- *Certifikatë ISO 39001 -2012 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve).*
- *Certifikatë BS PASS 99:2012 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve).*
- *Certifikatë ISO 1452-1:2009 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve).*
- *Certifikatë ISO 15128:2005 (E vlefshme me auditim vjetor. Në rast të bashkimit të OE duhet të plotësohet nga të paktën një prej anëtarëve).*
- *3 (Tre) inxhinier të certifikuar për përgjegjes për sigurin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të punësuar si drejtues teknik pranë subjektit ofertues.*

*Certifikatat të jenë lëshuar në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara”.*

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mësipërme për sistemet e: menaxhimit të mjedisit; menaxhimit të integruar; e tubacioneve plastike e kualifikimi për produktet e salduara, nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: ...*Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në*

**përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.**

**4. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik,** është kërkuar: “*Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës si dhe nga volumet e punimeve të parashikuara në preventiv për ekzekutimin kontrarës, kostatohet numri i konsiderueshëm makinerive në sasi dhe lloj. Konkretisht: Kamiona, autovinç, tërheqës, rimorkiator rula, eskavator, minieskavator autobetoniere, motosharrë vinç, vinçkullë, makineri bujqësore, makineri hidrombjellje.

OEOftues janë subjekte ndërtuese dhe mund të mos kenë detyrimisht, në pronësi ose me qira gurrëthyes; fabrikë asfalti; nyje fraksionimi inertesh apo impiant automatik betoni dhe sigurimi i këtyre mallrave/materialeve është lehtësisht në treg. Në këtë rast, kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore dhe dokumentave e tjerë rezulton ti adresohet palëve të treta të cilat nuk janë konkurrent në procedurën konkrete të prokurimit.

**5. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik,** është kërkuar:

- *Për materiale pllaka betoni për shtrim trotuaresh dhe bordure anësore OE duhet të jetë prodhues, tregtues me autorizim nga prodhuesi ose të ketë kontratë furnizimi noteriale për materialin me certifikatë ISO 9001:2015 si dhe raport testimi për materialin të lëshuar nga laborator i certifikuar.*
- *Për materialin tubo për KUB OE duhet të jetë prodhues, tregtues me autorizim nga prodhuesi ose të ketë kontratë furnizimi noteriale të pajisur me certifikatë cilësie ISO 9001:2015.*
- *Për materialin shtyllë ndricimi OE duhet të plotësojë një nga kushtet e mëposhtme:*

OE ofertues janë subjekte ndërtuese dhe mund të mos kenë detyrimisht në pronësi ose me qira fabrikë asfalti dhe e sigurojnë mallin me kontratë furnizimi. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen elejes mjedisore dhe dokumentave e tjerë rezulton ti adresohet palëve të treta të cilat nuk janë konkurrent në procedurën konkrete të prokurimit.

**6. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik,** është kërkuar: “*Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguar mesatar 150 punonjës (me kohë të plote) për periudhën Janar 2018–Dhjetor 2019. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat të konfirmuara nga administrata tatimore perkatëse me nenshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarimin e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të jenë kusht për skualifikimi. Të gjithë të punësuarit duhet të jenë të deklaruar në listëpagesat e shoqërisë sipas kushteve të përcaktuara në kontratë punës”.*

Kërkesat për fuqinë punëtore (150) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

**7. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik,** është kërkuar: “*Subjekti duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier / specialistë:*

AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve në fjalë.

Referuar punimeve konkrete të parashikuara në preventiv, nuk është parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do të ishte e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të kërkuar nga AK dhe do të ishte e nevojshme ekspertiza plotësuese e **inxhinierëve: Transport; mekanik, mjedisi e gjeomjedisi (gjithësej 11 ing. drejtues teknik inxhinier të punësuar me kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, plus certifikata dhe specializime).**

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Objekti i VNM përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: “VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte të një projekti mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm

dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore”. Problematikat, urbanistike dhe strukturore të një projekti nuk zgjidhen në zbatimin e punimeve por në stadin fillestar të projektit.

AK nuk ka parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do nevojitej ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi e rregullave të prokurimit publik” *që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*

**Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit**, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “*Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...*” dhe jo “*të lidhura para noterit*”.

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës:**

Vendosja e kriterëve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP *për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.*

**8. Në pikën 2.3 të kapacitetin teknik**, është kërkuar: “*OE duhet të ketë të punësuar dhe të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, nga muaji Janar 2018 e në vijim, punonjësit e mëposhtëm:*

Kërkesat për 71 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

Kërkesat për 8 (tetë) manovrator, 11 (njëmbëdhjetë) shoferë, të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë OE për ekzekutimin e kontratës, kërkojnë të jenë *në pronësi ose me qera*. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listëpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga OE edhe nëpërmjet kontraktimit.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë.

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AK Bashkia Rrogozhinë, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që. në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, të mirëargumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Për sa trajtuar më sipër**, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk nxitin konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” ***ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. H.P., z. A.S., z. E.H. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.***



**-Zhvillimi i procedurës.**

**Kane marrë pjesë në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE: “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk** (me Nipti-e respektive K.; K.; L. dhe L.) me vlerë ekonomike të ofertës: **91,568,615** (nëntëdhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) **lekë pa Tvsh.**

**2. BOE “B.-X” Shpk & “Gj.C” Shpk** (me Nipti-e respektive K. e J.), me vlere te ofruar: **55,000,020** (pesëdhjetë e pesë milion e njëzet) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “E.V.”, Shpk** (me Nipt K.) nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, skualifikohet nga KVO-ja, sepse nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe dokumentacion ligjor.

**Janë Skualifikuar:**

**1. BOE: “B.-X” Shpk & “Gj.C” Shpk**

**2. OE “E.V.” Shpk;**

Për arsyet e mëposhtme:

**1. BOE: “B.-X” Shpk & “Gj.C” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës **55,000,020** (pesëdhjetë e pesë milion e njëzet) **lekë pa Tvsh**, është skualifikuar:

**Ankesa Për Klasifikimin**

Me nr. 88 e nr. 1956 prot., datë 01.04.2020 Titullari i AK ka urdhër pezullimi e procedurës së prokurimit dhe është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (me nr. 1956 prot., datë 01.04.2020) i përbërë nga z. G.Gj. (Kryetar) z. E.A. e znj. E.K., për shqyrtimin e ankesës së BOE “B. X” Shpk & “Gj.C.” Shpk, ka marrë përgjigje në datë, 01-04-2020, Nr.1948/1 Prot, gjithashtu ka Vendim të KPP nr.146/2020, date 23.04.2020, për lejimin e vazhdimit të mëtejshëm të procedurës së prokurimit, nga AK. Kontrata me **BOE “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk**, fitues nr. 2283 prot., datë 27.05.2020. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **91,568,615 lekë me Tvsh.**

**Lidhur me BOE “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk**, rezulton se BOE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Me nr. 227 Rep., e nr. 114 Kol., datë 02.03.2020, Deklaratanoteriale e OE “P.V.” Shpk me përfaqësues z. Sh.D., OE “M.” Shpk me përfaqësues z. E.B., OE “B. N” Shpk, përfaqësuar nga z. F.M. (me prokurë të posaçme me nr. 1203 rep., nr. 523 kol., datë 13.03.2017 dhe OE “B. B” Shpk me përfaqësues z. B.D..

Përfaqësuesi i BOE është OE “P.V.” Shpk:

a. OE “B. B” Shpk, do të realizojë 20.12% të punimeve sipas preventivit të ofertës.

b. OE “B. N” Shpk, do të realizojë 51.10% të punimeve sipas preventivit të ofertës.

c. OE “M.” Shpk, do të realizojë 16.64% të punimeve sipas preventivit të ofertës.

d. OE “P.V.” Shpk, do të realizojë 12.14 % të punimeve sipas preventivit të ofertës.

Bashkangjitur me nr. 228 Rep., e nr. 115 kol., datë 02.03.2020 “Prokurë e posaçme” përpërfaqësimin e BOE nga OE “P.V.” Shpk:

**Titulli i gjetjes 11:** KVOka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**A. OE “B. B” Shpk,**

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Peqin; Korçë; Berat; Kavajë; Durrës; Fier; Selenicë; Mallakastër; Roskovec dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Fier, Roskovec, Durrës e Berat.*

**Në vitin 2019**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Fier; Cërrik; Rrogozhinë; Berat; Peqin; Kavajë; Cërrik; Durrës; Mallakastër; Korçë; Elbasan; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime

vendore në bashkitë: *Mallakastër, Fier, Roskovec, Durrës, Peqin, Berat, Rrogozhinë, Kavajë, Maliq, Cërrik, Shijak, Elbasan e Pustec.*

**B. OE “B. N” Shpk, ka ushtruar veprimtari:**

**Në vitin 2017**, ka ushtruar veprimtarinë bashkitë: Tiranë; Mat; Elbasan; Librazhd; Peqin; Gramsh; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Elbasan e Librazhd.*

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Tiranë; Elbasan; Peqin; Librazhd; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Tiranë e Elbasan.*

**Në vitin 2019**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Elbasan; Tiranë; Librazhd; Pogradec; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Tiranë e Elbasan.*

**C. OE “M.” Shpk,**

Në vitin 2017, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Tiranë; Elbasan; Gramsh; Librazhd

Në vitin 2018, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Gramsh; Librazhd; Korçë; Elbasan; Tiranë.

Në vitin 2019, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Elbasan; Tiranë; Librazhd; Gramsh; Fier; Korçë;

**OE “P.V.” Shpk**

**Në vitin 2017**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Fier; Ballsh; Gjirokastrë; Kavajë; Berat e Peqin, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore nga bashkia Fier.

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Fier; Peqin; Roskovec; Kavajë e Berat, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore nga bashkitë: Fier, Roskovec e Berat.

**Në vitin 2019**, ka ushtruar veprimtarinë bashkitë: Fier; Mallakastër; Gjirokastrë; Roskovec; Kavajë; Cërrik; Berat e Maliq, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore nga bashkitë: Fier; Mallakastër; Peqin; Rrogozhinë; Maliq; Cërrik; Roskovec;

Referuar SPE dhe deklaratës së disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

OE B.” Shpk, Kontratë qiraje me nr. 811 kol., datë 09.04.2019 me OE “D.K.” Shpk me afat deri më datë 31.12.2024:

OE “B.” Shpk, Kontratë qiraje me nr. 810 Rep., e nr. 272 kol., datë 09.04.2019 me z. N. Ll. me afati i kontratës deri më datë 31.12.2024:

OE “B.” Shpk, Kontratë qiraje me nr. 808 Rep., nr. 270 kol., datë 09.04.2019 me OE “B. E.” Shpk, “Fabrikë betoni” me afat të kontratës deri më datë 31.12.2020:

OE “B.” Shpk, Kontratë qiraje me nr. 117 Rep., e nr. 621 kol., datë 12.05.2019 me z. P. B. me afati të kontratës 24 muaj duke filluar nga data 12.04.2019 deri më datë 11.04.2021 , për mjetet:

OE “B. B” Shpk, Kontratë qiraje me nr. 786 Rep., e nr. 252 kol., datë 04.04.2019 me OE “M. E.” Shpk me afati të kontratës deri më datë 31.12.2024 , për mjetin:

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga Titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e **BOE B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk**. Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 “*Shqyrtimi i ofertave*” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet “*AK nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuartrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. J.M., z. F.M. dhe z. S.B.

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **91.568.615 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **91.568.615 lekë pa Tvsh.**

**Konkluzioni:** Referuar sa më sipërm, kualifikimi i BOE "B.-B" Shpk & "B.N." Shpk & "M." Shpk & "P.V." Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", dhe ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e KVO të përbërë nga: z. J.M., në cilësinë e Kryetarit të KVO, z. F.M. dhe z. S.B. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e AK znj. A.D..**

Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikimi **BOE B.-B" Shpk & "B.N." Shpk & "M." Shpk & "P.V."** "Shpk, në kushtet kur duhej anuluar dhe AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **91.568.615 lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

**2.** -Procedura e prokurimit me objekt: **"Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë"**, me këto të dhëna:

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë" Viti 2020</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 88, datë 08.05.2020	<b>3.2 Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:</b> 1.H.P. (Kryetar) 2.A.S. (Anëtar) 3.E.H. (Anëtar)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër Nr.234, datë 17.08.2020 1. J.M. (Kryetar) 2. F.M. (Anëtar) 3. S.B. (Anëtar)
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> Kërkesë për propozim		
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>6,500,000 lekë</b>	<b>6. Oferta fituese:</b> OE "G. C. G." shpk me marzh fitimi 14%	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 18.05.2020	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit	<b>10. Operoret Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime në AK</b> <b>JO</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b> <b>JO</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> <b>JO</b>

**Titulli i Gjetjes 12:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt : "Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë", me fond limit **6,500,000 lekë pa tvsh**.

**Situata:** Kriteret e Veçanta të Kualifikimit janë hartuar në përputhje me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Tenderi është hapur me datë 18.05.2020. Në të kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar nga KVO sa më poshtë vijon:

Nr.	OE Pjesëmarrës	Oferta Ekonomike (Pa Tvsh)	Vlerësimi i KVO-Së
1	"G. C. G. Shpk	<b>14% Të Marzhit Fitimit</b>	<i>Kualifikuar Dhe Shpallur Fitues</i>

Në këtë tender kanë marrë pjesë 1 OE "G. C. G." Shpk dhe është shpallur fitues me 14% te marzhit të fitimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues i përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DT dhe vendimi i KVO për shpalljen e tij fitues është i drejtë.

*Me shkresën nr. 2072 prot/1 Prot, datë 29.06.2023, me nr. 203/10 prot., datë 03.07.2023 në KLSH, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. J.M. ka shprehur kundërshtit për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë", me fond limit 6,500,000 lekë pa Tvsh, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:**

*"1. Faturë tatimore shitje me nr. 74 datë 20.1.2020, me vlerë 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) lekë pa Tvsh të lëshuar në favor të subjektit "I." Sh.a.*

*2. Faturë tatimore shitje me nr. 49 datë 13.1.2020 me vlerë 3,200,000 (tre milion e dyqind mijë) lekë pa tvsh të lëshuar në favor të subjektit "I." Sh.a.*

*Këto fatura janë lëshuar brenda periudhës 3 vjeçare si dhe janë në një vlerë më të madhe se 40% e fondit limit.*

Referuar dokumenteve te dorëzuara ne SPE nga ana e OE "G. C. G." Shpk, provohet se ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për Bashkinë Kavajë viti 2019, Bashkinë Devoll viti 2018, Bashkinë Divjakë viti 2019, Bashkinë Peshkopi viti 2018, Bashkinë Memaliaj viti 2018, Bashkinë Gjirokastrë 2019 dhe Bashkinë Burrel vitet 2018-2019, vërtetime te cilat janë si me poshtë :

1. Vërtetimi për pagesën e taksave vendore Bashkia Kavajë, provohet me vërtetimin me nr. 45 prot date 28.6.2019 ku provohet se "G. C. G." Shpk, ka shlyer taksat vendore deri më datë 31.12.2019 pranë Bashkisë Kavajë.

2. Vërtetimi për pagesën e taksave vendore për Bashkinë Mat (Burrel) për periudhën 2018/2019 provohet me vërtetimin nr. 2676 prot date 23.10.2019 ku theksohet se "G. C. G." Shpk nuk ka detyrime te taksave vendore ndaj Bashkisë Mat.

3. Vërtetimi për pagesën e taksave vendore ndaj Bashkisë Devoll për periudhën 2018, provohet me vërtetimin nr.87 prot date 19.5.2020 te lëshuar nga Bashkia Devoll ku theksohet se "G. C. G. shpk" ka shlyer detyrimet vendore ndaj Bashkisë Devoll përfshirë dhe vitin 2018.

4. Kërkesa për te dorëzuar vërtetimin për pagesën e taksave vendore për vitin 2018 ndaj Bashkisë Dibër (Peshkopi) nuk qëndron pasi në këtë periudhë OE "G. C. GG.KG" Shpk, nuk ushtronte aktivitet ekonomik ne territorin e kësaj bashkie. Sipas të dhënave në ekstraktin historik të OE "G. C. G." Shpk, aktiviteti i saj në territorin e Bashkisë Dibër ka filluar më datë 14.10.2020. Për pasojë nuk ka pasur detyrim për shlyerjen e taksave vendore.

5. Kërkesa për të dorëzuar vërtetimin për pagesën e taksave vendore për vitin 2018 ndaj Bashkisë Memaliaj nuk qëndron pasi në këtë periudhë OE "G. C. G." Shpk, nuk ushtronte aktivitet ekonomik ne territorin e kësaj bashkie. Sipas të dhënave ne ekstraktin historik të OE "G. C. G." Shpk aktiviteti i saj në territorin e Bashkisë Memaliaj ka filluar më datë 17.1.2020. Për pasojë nuk ka pasur detyrim për shlyerjen e taksave vendore.

- Vërtetim për shlyerje detyrimesh të lëshuar nga Bashkia Divjakë datë 12.2018.

- Vërtetim nr.752 prot date 11.12.2018 të lëshuar nga Bashkia Gjirokastrë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimet e paraqitura nga ana juaj janë të bazuara dhe për rrjedhojë merren parasysh duke u reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**3 -Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion objekti në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë", me këto të dhëna:**

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion objekti në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë", Viti 2020		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 234, datë 17.08.2020	<b>3.2 Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:</b> 1. H.P. (Kryetar) 2.A.S. (Anëtar) 3.E.H. (Anëtar)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër Nr.234, datë 17.08.2020 1. J.M. (Kryetar) 2. O.D. (Anëtar) 3. G.Gj. (Anëtar)
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> Kërkesë për propozim		
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>10,607,556 lekë</b>	<b>6. Oferta fituese:</b> OE "B." Shpk me vlerë <b>10,399,155lekë</b> , lidhur kontratë datë 09.10.2020 me afat 3 mujor.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> <b>208,401 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 31.08.2020	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Shtetit	<b>10. Operoret Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender: 6 OE b) S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 3 OE
<b>11. Ankimime në AK</b> <b>PO</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b> <b>PO</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> <b>JO</b>

**Titulli i Gjetjes 13:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi prokurimin publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt: "Rikonstruksion objekti në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë", me fond limit **10,607,556 lekë pa tvsh**.

**Situata:** Kriteret e Veçanta të Kualifikimit janë hartuar në përputhje me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Tenderi është hapur mw datë 31.08.2020. Në këtë tender kanë marrë pjesë 6 (gjashtë) OE, 3 (tre) nga të cilët janë kualifikuar, dhe është shpallur fitues oferta e OE "B." Shpk me vlerë **10,399,155 lekë**, me diferencë nga fondin limit në vlerën **208,401lekë**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DT dhe vendimi i KVO për shpalljen e tij fitues nuk është i drejtë.

-OE nuk përmbush pikën **2.3.8** mbi kapacitetin teknik pasi që kërkohen 2 hidraulik dhe OE ka paraqitur vetëm një.

-OE nuk përmbush pikën **2.4.14** mbi disponimin e makinerive pasi për 2 kamionçinat e paraqitura mjeti me targën AA856GK nuk ka paraqitur vërtetimin e pagesës së taksave.

-OE nuk përmbush pikën **2.3.16** mbi disponimin e certifikatave, konkretisht certifikata:

**OHSAS 18001:2007** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë” lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve të skualifikuar me vlerë më të vogël se sa OE fitues rezulton që skualifikimi i OE “C.” Shpk është i padrejtë. Arsyet e skualifikimit nga KVO janë këto:

**1.** OE nuk disponon në listë pagesën e shoqërisë Inxhinier –Auditues energjie i pajisur me “Certifikatë për auditimin e energjisë” fakt i cili bie në kundërshtim me pikën 2.3.11 të kriterëve të kapacitetit teknik.

**2.** OE nuk përmbush kriterin 2.3.14 të kapacitetit teknik në lidhje me faktin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës pasi nuk disponon kamionçina 2 (dy) copë. Mjeti me targa AA 760 JN është me kapacitet mbi 3.5 ton dhe sic figuron në lejen e qarkullimit konsiderohet si kamion dhe jo kamionçinë.

**3.** OE nuk përmbush kriterin 2.3.14 të kapacitetit teknik në lidhje me faktin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës pasi nuk disponon kamionçina copë 2 .Mjeti me targa VL 8646 është me kapacitet mbi 3.5 ton dhe siç figuron në lejen e qarkullimit të mjetit të lëshuar nga Drejtoria e Transportit Rrugor konsiderohet si kamion dhe jo kamioncinë.

**4.** Preventivi i punimeve përmban gabime të cilat rezultojnë mbi vlerën 2% të shumës totale të ofertës së paraqitur pa tvsh dhe për këtë arsye refuzohet siç e sanksionon neni 66 pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**5.** OE nuk përmbush kriterin 2.3.8 të kapacitetit teknik në lidhje me faktin e disponimit të teknikëve të ndërtimit (dy). Punonjësit I.L. dhe F.M., nuk disponojnë diplomë/dëshmi përkatëse të lëshuar nga organi kompetent që e provon një gjë të tillë.

-Nga verifikimi i pikës 1 rezulton që arsyet e skualifikimit sipas KVO nuk qëndrojnë pasi që ing. Elektrik A. i pajisur me certifikatën “Auditor për sistemin e enrgjisë” figuron në lispagesën e OE “C.” Shpk.

- Në lidhje me pikën 2 dhe pikën 3 nuk qëndron si arsye skualifikimi pasi që mjetet e paraqitura nga OE “C.” Shpk janë 3.5 deri në 5 ton, gjë e cila nuk cenon aspak natyrën e punës së kërkuar, kjo mangësi konsiderohet si “*devijim i vogël*”, referuar nenit 53 të LPP.

- Në lidhje me pikën 4, pas shqyrtimit të preventivit të paraqitur nga OE “C.” Shpk edhe në këtë rast rezulton që Vendimi i KVO është i pa argumentuar, pasi gabimi aritmetik rezulton të jetë 0.7% i shumës totale të ofertës dhe jo mbi 2% siç është shprehur KVO.

- Në lidhje me pikën 5 rezulton që arsyet e skualifikimit sipas KVO nuk qëndrojnë pasi që OE “C.” Shpk ka paraqitur dy teknik ndërtimi, punonjësit znj. D.S. dhe z. E.Z. të cilët janë të pajisur me diplomë dhe dëshmi kualifikimi.

**Konkluzion:** Skualifikimi i OE “C.” Shpk, nuk është në përputhje me nenin 53 ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i OE “B.” Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Lidhja e kontratës me vlerë **10,399,155** lekw pa Tvsh, me fitues OE “B.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT dhe skualifikimi i OE “C.” Shpk me vlerë **9,417,761** lekw pa Tvsh në mënyrë të padrejtë është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. J.M., z. O.D. dhe z.G.Gj..

**Kriteri:** Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

**Ndikimi:** Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë **10,395,155** lekë pa Tvsh, me OE “B.” shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga ana e bashkisë Rrogozhinë të merren masa për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DT si dhe të s'kualifikimit të padrejtë të OE që i plotësojnë kriteret e miratuara në DT.

*Me shkresën nr. 2072 prot/1 Prot, datë 29.06.2023, me nr. 203/10 prot., datë 03.07.2023 në KLSH, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. J.M. ka shprehur kundërshtit për procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, NjA. Lekaj, Bashkia Rrogozhinë" me fond limit 249,541,030 lekë pa Tvsh, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** "1. OE nuk përmbush kriterin 2.3.14 të kapacitetit teknik në lidhje me faktin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës pasi nuk disponon kamionçina copë 2. Mjeti me targa AA 760 JN është me kapacitet mbi 3.5 ton dhe siç figuron ne lejen e qarkullimit konsiderohet si kamion dhe jo kamionçinë.

2. OE nuk përmbush kriterin 2.3.14 të kapacitetit teknik në lidhje me faktin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve që nevojiten për ekzekutimin e kontratës pasi nuk disponon kamionçina copë 2. Mjeti me targa VL 8646 B është me kapacitet mbi 3.5 ton dhe siç figuron ne lejen e qarkullimit të mjetit të lëshuar nga Drejtoria e Transportit Rrugor konsiderohet si kamion dhe jo kamionçinë.

*Klasifikimi i mjeteve të qarkullimit behet nga ana e ligjit nr. 8378 date 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" në nenin 47 të tij. Neni 47, pika 2/C parashikon karakteristikat që duhet të ketë një mjet për tu klasifikuar si automjet për transport të përzier (kamionçinë) që figuron si më poshtë :*

*OE nuk disponon në listapagesën e shoqërisë Inxhinier – Auditues Energjie i pajisur me "Certifikatë për auditimin e energjisë", fakt i cili bie në kundërshtim me pikën 2.3.11 të DT.*

- Certifikata e trajnimit të lëshuar nga ana e kompanisë AQSCERT me nr. AQS/TS123820218 e lëshuar me datë 17.06.2018 është një dokument që provon faktin se z. M.A. ka marrë pjesë në trajnimin me temë "Auditor për menaxhimin e sistemit të energjisë" të zhvilluar mes datave 11-15.06.2018 me kohëzgjatje 40 ore pune .

Në certifikatë theksohet se kjo certifikatë është e vlefshme për të provuar faktin e trajnimit dhe nuk përbën titull ose certifikim si auditues energjetik.

-Nga kryerja e veprimeve matematikore mbi oferten e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik "C." Shpk ka rezultuar se ajo përban gabime në masën mbi 2% të vlerës së saj dhe për këtë arsye në bazë të nenit 66 pika 4 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" është refuzuar dhe përbën shkak për skualifikim. Rezultatet e kryerjes së veprimeve matematikore mbi ofertën e paraqitur janë si më poshtë ;

-Oferta e paraqitur është në vlerën 9,417,761, lekë pa Tvsh dhe 11.301.313 lekë me me Tvsh ndërsa nga verifikimi dhe kryerja e veprimeve aritmetike rezulton se është në vlerën 9,766,211 lekë pa Tvsh dhe 11,593 688 lekë me Tvsh pra një diferencë prej 292,375 lekë që përbën shumën prej 2.5 % më tepër se oferta e paraqitur. Pra marzhi i gabimit është më tepër se 2% .

*OE "C." Shpk, ka paraqitur si punonjës teknik ndërtimi shtetasit D.S. dhe E.Z. të cilët rezultojnë që disponojnë kualifikimet e nevojshme si teknik ndërtimi si dhe kanë kontratë pune të vlefshme me punëdhënësin "C." Shpk.*

*Por auditimi i listepagesave të OE "C." Shpk për periudhën janar-korrik 2020 rezulton se këta punonjës janë të regjistruar me poshtë:*

1. D.S. rezulton se punonjës i punësuar në listëpagese rishtazi me kod 2/006 për çdo muaj nga janari deri në korrik 2020 dhe për çdo muaj rezulton e ka punuar 4 ditë pune.

2. E.Z. rezulton i punësuar në listëpagese rishtazi me kod 2/006 në tatime për çdo muaj nga janari deri në korrik 2020 dhe për çdo muaj rezulton se ka punuar 8 ditë pune.

*Duke u nisur nga kriteret e kërkuara ku është kërkuar një periudhë punësimi e plotë për një periudhë 6-mujore rezulton se dy punonjësit e mësipërm. Këto punonjës figurojnë të punësuar rishtas në korrik 2020 dhe për më tepër me kohë të pjesshme, nga 4 deri në 8 ditë pune. Arsyet pse AK ka kërkuar që teknikët e ndërtimit të kenë të paktën një kohëzgjatje prej të paktën 6-muaj me kohë të plotë është sepse ky fakt provon qëndrueshmërinë dhe seriozitetin në marrëdhëniet e punës të operatorit ekonomik."*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa është paraqitur më sipër, nga anëtarët e KVO, nuk janë paraqitur prova dhe argumente të reja të cilat të rrëzojnë sa është paraqitur në akt konstatim dhe projekt raport. Më konkretisht, përsa i përket mjeteve të transportit, i qëndrojmë mendimit që është devijim i vogël dhe OE nuk duhej të ishte skualifikuar për këtë mangësi.

Në lidhje me certifikatën për "Auditues Energjie", KVO ka vepruar me 2 standarde, pasi të njëjtën certifikatë ka edhe z. G.M. me nr. AQS/T/S01872018 i OE "B." Shpk i cili është shpallur fitues. Pra për të njëjtën certifikatë keni mbajtur dy qëndrime.

Në lidhje me preventivin e OE "C." shpk, shuma e cila është llogaritur gabim rezulton të jetë 58.075 lek, dhe që përbën vetëm 0.7 % diferencë dhe jo 2.5 % siç pretendoni ju.

**Shuma e pajisjeve të mjeteve të paraqitura nuk duhej llogaritur 2 herë nga ana juaj.**

Përsa i përket punonjësve të paraqitur si teknikë ndërtimi, ju keni paraqitur të tjerë punonjës me iniciale për të argumentuar skualifikimin ndërsa në argumentet tuaja keni paraqitur emra të tjerë. Gjithsesi edhe emrat e personave të paraqitur nga ana juaj siç edhe ju vetë e pranoni, figurojnë në listpagesa dhe fakti që nuk janë me kohë të plotë pune nuk është arsye skualifikimi nga ana juaj pasi ky argument nuk është përdorur nga ana juaj në raportin përmbljedhës si arsye skualifikimi të këtij OE.

Si përfundim, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë dhe nuk pranohen nga ana e grupit të auditimit.

#### 4. Procedura e prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë, Faza e Tretë", viti 2020.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë, Faza e Tretë", viti 2020.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 240 datë 28.08.2020	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 4693 prot., datë 28.08.2020	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr.1067/1 prot., datë 07.05.2019
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> "E Hapur"	1. H.P.(Jurist) 2. A.S. (Arkitekt) 3. E.H. (Shkenca sociale)	1. J.M. (Kryetar)-Jurist 2. O.D. (Ekonomist) 3. G.Gj. (Ekonomist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 81,891,7661 ekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE "E.S" Shpk & "B.-B" Shpk & "B. N" Shpk, vlera e ofertës <b>81,402,620</b> lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 489,146 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 28.09.2020	<b>9. Burim i Financimit:</b> AKUM	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE "E.S" Shpk & "B.-B" Shpk & "B. N" Shpk
<b>11. Ankimime AK: KA</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 4693/2 prot., datë 03.11.2020</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 03.11.2020</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>97,683,144</b>

#### **Përlllogaritja e Fondit Limit:**

Projekt zbatimi është realizuar nga OE "A.S." Shpk.

Me shkresën nr. 2888 prot., datë 23.11.2020, AKUM ka miratuar Projekt zbatimin për objektin: Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Nj.A Lekaj, Bashkia Rrogozhinë", me vlerë të plotë 299,449,236 lekë me Tvsh.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Oponenca Teknike me nr. 2855/2 prot., datë 08.11.2021, është realizuar nga Drejtoria e Rregullave dhe Oponencave në Institutin e Ndërtimit.

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit më datë 28.08.2020, janë formuluar/nënshkruar formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Më datë 28.08.2020, NJHD ka proshverbalin e miratimit/hartimit të dokumentave të tenderit, në të cilin janë përcaktuar kushtet, specifikimet teknike, dhe kriteret e kualifikimit.

Raporti analitik i datës 28.08.2020, (nënshkrimin e 1 specialisti) i referohet: Fuqisë punëtore; Eskavator; Fadromë; Autobot; Mini Eskavator; Betoniere 0.5 m3; Vibrator; Saldatriçe; aparat saldimi tubo saldimi tubo çeliku; Kamion ving; Kamioçinë; Kamiona nga .3.5 deri 18 ton.

#### **Ankesa për DT:**

Me nr. 155 prot., datë 02.09.2020 OE "B." Shpk, (në Bashkinë Rrogozhinë) ka formular kërkesën për sqarim ankesën depozituar në Bashkinë Rrogozhinë me nr. 4843 prot., datë 03.09.2020.

Me nr. 4843 prot., datë 11.09.2020, sqarim për kriteret dhe Specifikimet Teknike drejtuar OE "B." Shpk, nga Titullari I AK znj . A.D., ku sqarohet se Kriteret dhe specifikimet teknike janë të hartuara në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me datë 28.09.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) BOE kanë marrë pjesë me vlerë ekonomike përkatëse të ofruara:

Me Procesverbali i KVO, datë 01.10.2020 i hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat e konomike, ka marrë vendimin për kualifikimin dhe klasifikimi e ofertës të paraqitur në prokurim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 01.10.2021. Formulari i njoftimit të fituesit më datë 09.10.2020.

Kryetari i KVO-ja z. J.M. ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 08.10.2020, miratuar nga Titullari i AK znj. A.D. më datë 08.10.2020.

**Titulli i gjetjes 14:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:** Kriteret që nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 46 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Licenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të kategorive dhe niveleve:

**Punime të përgjithshme ndërtimi**

**3. NP – 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit**

- sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

*Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

AK nuk ka parashikuar punim për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorisë NP – 12 Anë licencë, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi rregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kritererit të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**2. Në pikën 90/a të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: **Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit çertifikimet**

a. Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori) stafin teknik të shoqërisë, si mëposhtë:

Nr	Pozicioni	Vitet e punës pranë shoqërisë
<b>Stafi Kryesor</b>		
2 (dy)	<b>Inxhinier Ndërtimi</b> – si <b>Drejtues Projekti</b> gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik	3 vjet
1 (një)	<b>Inxhinier Hidroteknik</b> gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik	6 muaj
1 (një)	<b>Topograf/Gjeodet</b> - gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik	6 muaj
1 (një)	<b>Inxhinier Mjedisi</b> gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik	6 muaj



<b>F</b>		
1 (një)	<b>Inxhinier Gjeomjedisi</b> gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës	-
1 (nje)	<b>Inxhinier Mekanik</b> gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës	-

Përvoja e punës pranë shoqërisë është tregues i aftësive organizative, reputacionit dhe besueshmërisë së një OE. Marrëdhëniet e stafit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës së punës dhe në stafin teknik të shoqërisë nuk mund të jenë persona që janë të angazhuar në çdo punëmarrje publike. Paqëndrueshmëria e stafit teknik në vecanti dhe e punonjësve në përgjithësi është tregues i paqëndrueshmërisë së vetë shoqërisë. Përvoja e punës dhe eksperiencia ndikon në efikasitetin dhe zbatimin e kontratës. Largimi i shpeshtë dhe brenda afateve të shkurtra i stafit teknik të shoqërisë, përveç paqëndrueshmërisë së strukturës organizative të shoqërisë pengon po ashtu rritjen e ekspertizës dhe eksperiencës së këtij stafi.

**- Për stafin e mësipërm të paraqiten:**

**- Kontratë punë e noterizuar**

- Diploma/certifikata

**Stafi kryesor** të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën e përcaktuar si staf i shoqërisë OE duhet të deklarojë me shkrim se inxhinierët dhe punonjësit e kërkuar në pikën 90/a, janë të paangazhuar në marrëdhënie punë me institucionet shtetërore dhe private përveç operatorit ekonomik. Konstatimi i dypunësimit të stafit teknik përbën shkak për skualifikim të menjëhershëm dhe deklaratë të rreme sipas nenit 13 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2009 “Për prokurimin publik”.

- Për drejtuesit teknik, inxhinieret, stafi teknik i mesëm, manovratorët, specialistat dhe punëtorët e ofertuesit, duhet të jenë të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë jo më pak se 8 orë pune në ditë, vlera e pagës e deklaruar në listëpagese, vlera e pagës e kaluar në llogarin bankare të punonjësit të jetë e barabartë me vlerën e përcaktuar në kontratën e punës. Për këtë duhet të paraqitet ekstrakti i llogarisë bankare, listëpagesat dhe kontrat e punës.

- Shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë, nga administratori i shoqërisë, ku të përcaktoj drejtuesin/t teknik të shoqërisë/i të cilin/ët do të jetë/në i/të pranishëm gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Gjithashtu në këtë deklaratë administratori i shoqërisë duhet të deklarojë se autorizon AK për verifikimin e informacionit të dhënë për drejtuesin teknik.

Referuar punimeve konkrete të parashikuara në preventiv, nuk është parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do të ishte e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar nga AK dhe do të ishte e nevojshme ekspertiza plotësuese e **inxhinierëve: mekanik, mjedisi e gjeomjedisi** (gjithësej 7 ing. drejtues teknik inxhinier të punësuar me kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, plus certifikata dhe specializime).

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Objekti i VNM përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: “VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte të një projekti mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore”. Problematikat, urbanistike dhe strukturore të një projekti nuk zgjidhen në zbatimin e punimeve por në stadin fillestar të projektit.

AK nuk ka parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do nevojitej ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi e rregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit**, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...” dhe jo “të lidhura para noterit”.

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.:

Vendosja e kriterereve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe

pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**3. Në pikën 90/g4. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi nga administrata tatimore ku të ketë një punësim mesatar i të paktën 120 (njëqindë njëzet) punonjës për periudhën **Janar 2020 Korrik 2020**”.

Kërkesat për fuqinë punëtore (120) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës**.

*Në lidhje me: Licencat:* Për mbrojtjen nga zjarri (Kodi 1.2.A); Për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis [(Kodi III.2.A (1+2)); Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B.); Për grumbullim dhe transportim mbetjeve inerte dhe Licencë për transportin e ujërave të zeza kodit të shoqëruar me autobot për pastrimin e ujërave të zeza ose të disponojë kontratë materiale me një subjekt.

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës**.

Vendosja e kriterëve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**4. Në pikën 90/h të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të jetë i pajisur me Licencë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) **Kodi III.2.B.**, Licencë për grumbullim dhe transportim mbetjeve inerte”.

Referuar objektit të prokuruar “Reabilitim kanale vaditës” transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: *lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, siguracionin, kolaudimin, certifikatë transporti*.

Kriteri për disponimin e licencë me Kodin III.2.B, Për *Grumbullim dhe transportim i mbetjeve*, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve inerte.

Kërkesa nuk lidhet me objektin e prokurimit, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdokriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Kërkesa që nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate, nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 44, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit” ku përcaktohet që “*Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*”

**6. Në pikën “i” të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të kenë të punësuar si staf teknik punonjës të pajisur me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 6 muajt e fundit nga dita e zhvillimit të procedurës së prokurimit nga të cilët të jenë”:

Nr	EMERTIMI	
1	Teknik ndërtimi	4 (katër)
2	Automakinist	3 (tre)
3	Manovrator	8 (tetë)
4	Hekurthyes	6 (gjashtë)
5	Karpentier	7 (shtatë)
6	Murator	3 (tre)
7	Shofer	10 (dhjetë)
8	Murator	3 (tre)
9	Mekanik	4 (katër)

Kërkesat për 45 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

Kërkesat për 8 (tetë) manovrator, 10 (dhjetë) shoferë, 3 (tre) automakinist e 4 (katër) mekanik, të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë OE për ekzekutimin e kontratës, kërkohen të jenë *nëpronësi ose me qera*. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga OE edhe nëpërmjet kontraktimit.

**6. Në pikën “3” të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Dëshmi për mjetet e pajisje teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion**

*Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës”:*

Vendosja e kërkesës për disponimin e mjete/makineri/pajisje të mësipërme, mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, punimet konkrete që do të realizohen dhe volumet e tyre nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**7. Në pikën “1” të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “OE duhet të jetë i pajisur me certifikatat si mëposhtë”:**

- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”
- PAS 99:2012 mbi “Sisteme të menaxhimit të integruar”
- ISO 1452-1 :2009 mbi “Sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë”
- EN ISO 3834-2:2006 “Sistem kualifikimi për produktet e salduara”

Objekti i lëshimit të secilës nga certifikatat e mësipërme duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit dhe në rast të *bashkimit të operatorëve ekonomik*, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata, ISO sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit”.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mësipërme për sistemet e: menaxhimit të mjedisit; menaxhimit të integruar; e tubacioneve plastike e kualifikimi për produktet e salduara, nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: *...Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJHDT:z. H.P., z. A.S., z. E.H., në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AK Bashkia Rrogozhinë, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Për sa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk nxitin konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. H.P., z. A.S., z. E.H. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa “c”, “ç”, “d”, neni 2 germa “a”, “b”, “c”, 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. H.P., z. A.S., z. E.H.***

**-Zhvillimi i procedurës.**

**Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “E.S.” Shpk & “B..B” Shpk & “B..N” Shpk,** (me Nipt-e respektive L.,K. dhe K.), me vlerë ekonomike të ofertës: **81,402,620** (tetëdhjetë e një milion e katërqind e dy mijë e gjashtëqind e njëzet) **lekë pa Tvsh.**

**Nuk ka ofertues të skualifikuar.**

Kontrata me **BOE “E.S.” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk,** fitues nr. 4693/2 prot., datë 03.11.2020. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **97,683,144** (nëntëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzetë e katër) **lekë me Tvsh.**

**Titulli i gjetjes 15:** KVOka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “E.S” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “E.S” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Lidhur me BOE “E.S” Shpk & “B.-B” Shpk & “B.-N” Shpk, rezulton se BOE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Me nr. 1339 rep., nr. 620 kol., datë 26.09.2020, kontrata e bashkpunimit të përkohshëm ndërmjet OE “E.S” Shpk, OE “B.-N” Shpk & dhe OE “B.-B” Shpk, ku punimet do të realizohen në raporte respektive 9.11%, 56.26% e 34.63%, mardhëniet nga dita e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e punimeve do të kryhen nga përfaqësues i BOE, OE “E.S” Shpk, me administrator z. G.B..

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “E.S” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**1. BOE nuk plotëson** shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitet (2017, 2018, 2019), dhe kështu e maturuara të vitit 2020, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij

**A. OE “B. B” Shpk,**

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Peqin; Korçë; Berat; Kavajë; Durrës; Fier; Selenicë; Mallakastër; Roskovec dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Fier, Roskovec, Durrës e Berat.*

**Në vitin 2019**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Fier; Cërrik; Rrogozhinë; Berat; Peqin; Kavajë; Cërrik; Durrës; Mallakastër; Korçë; Elbasan; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Mallakastër, Fier, Roskovec, Durrës, Peqin, Berat, Rrogozhinë, Kavajë, Maliq, Cërrik, Shijak, Elbasan e Pustec.*

**Në vitin 2020**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Roskovec; Peqin; Korçë; Tepelenë; Cërrik; Kavajë; Divjakë; Tiranë; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Korçë, Maliq, Kavajë, Peqin, Berat, Rrogozhinë, Shijak, Vorë e Fier.*

**B. OE “B. N” Shpk, ka ushtruar veprimtari:**

**Në vitin 2017**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Tiranë; Mat; Elbasan; Librazhd; Peqin; Gramsh; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Elbasan e Librazhd.*

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Tiranë; Elbasan; Peqin; Librazhd; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Tiranë e Elbasan.*

**Në vitin 2019**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Elbasan; Tiranë; Librazhd; Pogradec; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Tiranë e Elbasan.*

**Në viti 2020**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Elbasan; Tiranë; Librazhd; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Tiranë, Librazhd e Elbasan.*

**2. OE “E.S” Shpk, nuk plotëson kërkesën e përvojës së sukseshme pasi për punë të ngjashme ka paraqitur kontratat të cilat nuk plotësojnë kërkesat e pikës “1/b” Për kontrata të realizuara me sektorin privat, nuk janë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DT.**

**3. BOE nuk plotëson pikën 90/a për stafin teknik të shoqërisë:**

**4. BOE nuk plotëson mjetet e pajisje teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion:**

**5. AK Bashkia Rrogozhinë me BOE “B.-B” Shpk & “B.-N” Shpk, ka lidhur kontratën me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, ku nga operatorët ekonomik është deklaruar që mjetet/makinertë dhe punonjësit që do të ishin prezent gjatë zbatimit të kontratës.**

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. J.M., në cilësinë e Kryetarit e KVO, z. G.Gj. dhe z. O.D..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **81,402,620 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “E.S” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **81,402,620 pa Tvsh.**

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i **BOE “E.S” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk**, nuk është në kushtet e plotësimin të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: z. J.M., në cilësinë e Kryetarit e KVO, z. G.Gj. dhe z. O.D. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e AK znj. A.D..

Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikimi **BOE “E.S” Shpk & “B.-N” Shpk & “B.-B” Shpk**, në kushtet kur duhej anuluar dhe

AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **81,402,620 lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

Me shkresën nr. 2072 prot/1 Prot, datë 29.06.2023, me nr. 203/10 prot., datë 03.07.2023 në KLSH, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. J.M. ka shprehur kundërshtitë për procedurën e prokurimit: “ReH.timi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë, Faza e tretë” me fond limit 81,891,766 leke pa Tvsh, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** “OE “B. B” Shpk, në vitin 2018 ka ushtruar veprimtari në Bashkitë Peqin, Korçë, Berat, Kavajë, Durrës, Fier, Selenicë, Mallkastër dhe Roskovec dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrimeve vendore në Bashkitë Fier, Roskovec, Durrës e Berat. Në lidhje me këtë pretendim që OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për Bashkitë Peqin, Korçë, Kavajë, Selenicë, Mallkastër po parashtrijmë shpjegimet e mëposhtme:

Duke u bazuar në dokumentat e depozituara në SPE dhe në ekstraktin historik në QKB rezultojnë se për periudhën 2017-2018-2019 anëtarët i BOE OE “B. B” Shpk, ka ushtruar aktivitetet në bashkitë e mëposhtme:

2017	Fier	Durrës	Berat					
2018	Fier	Durrës	Berat	Roskovec		Peqin	Korçë	
2019	Fier	Durrës	Berat	Roskovec	Cërrik	Kavajë	Elbasan	Rrogozhinë

Në përmbushje të këtij kriteri OE për periudhën e vitit 2018, paraqitur vërtetimet e mëposhtme :

- Vërtetim me datë 21.8.2020, për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2020 ndaj Bashkisë Peqin.

- Vërtetim nr. 4699, datë 20.6.2019, për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitin 2019 të lëshuar nga Bashkia Korçë, dhe mospasjen e asnjë detyrimi deri në këtë moment .

-Vërtetim nr. 45 prot., date 22.10.2019 për shlyerje detyrimesh për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Peqin dhe mospasjen e asnjë detyrimi ndaj këtij institucioni deri në këtë moment.

- Vërtetim nr.1268/1 datë 31.5.2019 për shlyerje detyrimesh ndaj Bashkisë Peqin.

Në lidhje me vërtetimet për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë Kavajë, Selenicë, Mallkastër theksojmë faktin se sipas ekstraktit historik rezultojnë që OE “B. B” Shpk nuk ka ushtruar aktivitetet në këto NJV.Pavarësisht faktit që nuk ka pasur detyrim ligjor, OE ka paraqitur vërtetime që vërtetojnë që nuk ka pasur detyrime ndaj këtyre Njësi Vendore si më poshtë:

-Vërtetim nr.72 prot., datë 24.10.2019 për shlyerje detyrimesh deri në datë 31.12.2019 ndaj Bashkisë Kavajë.

- Vërtetim nr.730/1 datë 22.7.2019 për shlyerjen e detyrimeve deri në datë 22.7.2019 ndaj Bashkisë Mallkastër.

**Për vitin 2019** ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Fier, Cërrik, Rrogozhinë, Berat, Peqin, Kavajë, Cërrik, Durrës, Mallkastër, Korçë, Elbasan dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore në Bashkitë Mallkastër Fier, Roskovec, Durrës, Peqin, Berat, Rrogozhinë, Kavajë, Maliq, Cërrik, Shijak, Elbasan, Pustec. Sipas këtij pretendimi nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë Korçë dhe Durrës. Ky kriter plotësohet me vërtetimet që po paraqesim me poshtë dhe që gjenden në Sistemin e Prokurimit Elektronik .

-Vërtetim ekstra datë 13.6.2019, për shlyerje detyrimesh për taksat vendore për vitin 2019 ndaj Bashkisë Durrës. Më datë 14.5.2019 sipas të dhënave në ekstraktin historik në QKB është mbyllur aktiviteti në Bashkinë Durrës.

- Vërtetim nr. 4699, datë 20.6.2019 për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2019 të lëshuar nga Bashkia Korçë.ku citohet fakti i shlyerjes së detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019 ndaj Bashkisë Korçë.

**Për vitin 2020** ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Roskovec, Peqin, Korçë, Tepelenë, Cërrik, Kavajë, Divjakë dhe Tiranë dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për Bashkitë Korçë, Maliq, Kavajë, Peqin, Berat, Rrogozhinë, Shijak, Vorë e Fier . Sipas këtij pretendimi nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të maturuara për Bashkitë Tiranë, Divjakë, Cërrik, Tepelenë, Roskovec. Ky kriter plotësohet me vërtetimet dhe të dhenat që po paraqesim me poshtë dhe që gjenden në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

-Sipas të dhënave që gjenden në ekstraktin historik të OE “B. B” ky operator ekonomik nuk ka ushtruar aktivitetet në Bashkitë Divjakë dhe Tepelenë në periudhën e vitit 2020.

-Në Bashkinë Tiranë sipas të dhënave në ekstraktin historik nuk rezultojnë që OE “B. B” e ka hapur adresën e ushtrimit të aktivitetit për vitin 2020 dhe si rezultat nuk ka detyrim për paraqitje vërtetimi.

-Në Bashkinë Cërrik është mbyllur aktiviteti në datë 01.11.2019 dhe për pasojë nuk ka pasur detyrim për tu pajisur për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020.

-Në Bashkinë Roskovec është mbyllur aktiviteti më datë 14.5.2019 dhe për pasojë nuk ka pasur detyrim për tu pajisur me vërtetim për taksat dhe tarifave vendore për periudhën e vitit 2020.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Po ju risqarojmë që grupi i auditimit i është referuar trasaksioneve të thesarit, të cilat janë të aksesueshme nga kushdo që dëshiron.

*Për shembull: OE "B. B" Shpk, ka lidhur kontratën: GOA 2020 datë 09.06.2020, me Fondi i Zhvillimit Shqiptar, për Rindërtim i objektit arsimor, në Tiranë. Ju i referoheni vetëm Ekstraktit Historik.*

*Shpreheni: "Ky kriter plotësohet me vërtetimet që po paraqesim me poshtë dhe që gjenden në SPE" e më poshtë përshkruani vërtetimet.*

*Nga ju është kërkuar: prova, dokumentacion mbështetës që kundërshtojnë gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit. (jo komete, vlerësime apo opinione, por vërtetimet që janë në SPE e nuk janë cituar apo janë cituar gabim nga grupi i auditimit).*

*Grupi i auditimit nuk është imun nga pasaktësitë/lapsus apo gabimeve njerëzore, prandaj ka kërkuar disa herë nga ju kundërshtimet me dokumentacion mbështetës, të cilin ju nuk e keni paraqitur. Sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë e trajtohen në Raporitin përfundimtar të auditimit.*

**Në lidhje me aktivitetin e OE** Ushtrimi i aktivitetit të OE "B. B" Shpk, në bashkitë e cituara nga grupi i auditimit i është referuar ëeb-it zyrtar të "Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit", i aksesueshëm nga kushdo që i nevojitet informacioni. Në këtë rast po ju sqarojmë që çdo pretendim juaj nuk merret në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:** "OE "B. N" Shpk, në vitin 2017, ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Tiranë, Mat, Elbasan, Librazhd, Peqin, Gramsh dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë Elbasan dhe Librazhd. Pretendohet që nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për bashkitë Mat, Peqin, Gramsh dhe Tiranë. Më poshtë po paraqesim komentet dhe shpjegimet në lidhje me pretendimet e mësipërme sipas të dhënave në SPE.

*-Vërtetim nr.10678/1 datë 14.8.2019 për shlyerjen e detyrimeve për vitet 2017, 2018, 2019 ndaj Bashkisë Tiranë.*

*-Sipas të dhënave në ekstraktin historik rezulton se për periudhën e vitit 2017 OE "B. N" shpk, nuk ka ushtruar aktivitet në këto bashki Mat, Peqin, Gramsh dhe si rezultat nuk ka pasur detyrimin për të paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore.*

*-OE "B. N" Shpk, në vitin 2018,* ka ushtruar veprimtari në Bashkitë Tiranë, Elbasan, Librazhd, Peqin, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Pretendohet që nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për Bashkitë Peqin, Librazhd. Me poshtë po paraqesim komentet dhe shpjegimet në lidhje me pretendimet e mësipërme sipas të dhënave në Sistemin e Peukurimit Elektronik :

*Me vërtetim nr. 6776 prot., datë 30.10.2018 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Librazhd për vitet 2017 dhe 2018 të lëshuar nga Bashkia Librazhd.*

*Sipas të dhënave në ekstraktin historik në QKB rezulton se për periudhën e vitit 2018 OE "B. N" shpk, nuk ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Peqin, dhe si rezultat nuk ka pasur detyrimin për të paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.*

*- OE "B. N" Shpk, në vitin 2019,* ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Tiranë, Elbasan, Librazhd, Pogradec, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Pretendohet që nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë Pogradec, Librazhd. Më poshtë po paraqesim komentet dhe shpjegimet në lidhje me pretendimet e mësipërme sipas të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

*Në lidhje me pretendimin për paraqitje vërtetimi për shlyerje taksash dhe tarifash vendore për Bashkinë Librazhd për vitin 2019 sipas të dhënave në ekstraktin historik rezulton se kjo adresë ushtrimi aktiviteti është mbyllur në datë*

*10.5.2018 dhe për pasojë OE "B. N" nuk ka pasur detyrim për paraqitjen e këtij vërtetimi për periudhën e vitit 2019.*

*Sipas të dhënave në ekstraktin historik rezulton se për periudhën e vitit 2019 OE "B. N" Shpk, nuk ka ushtruar aktivitet në Bashkinë Pogradec, dhe si rezultat nuk ka pasur detyrimin për të paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore.*

*-OE "B. N" Shpk, në vitin 2020* ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Tiranë, Elbasan, Librazhd, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Pretendohet që nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Librazhd. Më poshtë po paraqesim komentet dhe shpjegimet në lidhje me pretendimet e mësipërme sipas të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

*Në lidhje me pretendimin për paraqitje vërtetimi për shlyerje taksash dhe tarifash vendore për Bashkinë Librazhd për vitin 2019, sipas të dhënave në ekstraktin historik rezulton se kjo adresë ushtrimi aktiviteti është mbyllur në datë 10.5.2018 dhe për pasojë OE "B. N" nuk ka pasur detyrim për paraqitjen e këtij vërtetimi për vitin 2019"*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Po ju risqarojmë që grupi i auditimit i është referuar trasaksioneve të thesarit, të cilat janë të aksesueshme nga kushdo që dëshiron.

*Për shembull në lidhje me "OE "B. N" Shpk, në vitin 2017,*

*ka ushtruar veprimtari në Bashkitë: Tiranë, Mat, Elbasan, Librazhd, Peqin, Gramsh dhe ka paraqitur*

*Nga ju është kërkuar: prova, dokumentacion mbështetës që kundërshtojnë gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit. (jo*

komete, vlerësime apo opinione, por vërtetimet që janë në SPE e nuk janë cituar apo janë cituar gabim nga grupi i auditimit).Për Bashkinë Tiranë ju nuk paraqesni vërtetimin por e përshkruani atë. Grupi i auditimit nuk është imun nga pasaktësitë/lapsus apo gabimeve njerëzore, prandaj ka kërkuar disa herë nga ju kundërshtimet me dokumentacion mbështetës, të cilin ju nuk e keni paraqitur. Po ju paraqesim trasaksionet në thesar të OE“B. N” Shpk, të cilta janë të aksesueshme nga kushdo.

**Bashkia Mat:** Lik. Situac. Perf. Dt.15.09.2016 - Dt.15.02.2017 “Rik. i zyres se sherb. me nje ndalese”.Fat.Nr.953 Dt.15.03.2017 Kontr. Pune Nr. 953 Dt.15.03.2017 Akt-Kol. Dt.27.02.2017, Certif. e perk. dorez. Dt.17.03.2017.

**Bashkia Peqin:** Likujduar Sistemim asfaltim te rrugeve te fshatit Trash-Njesia Admin Sheze. , fature nr.004 dt 08.08.2017, urdher prokurimi nr.90 dt 21.04.2017, formular kontrate dt 06.07.2017, situacion pjesor nr.1

**Bashkia Gramsh:** Fat nr.998 dt 11.02.2017,situacion perfundimtar,akt-marrje dorezim,akt kolaudimi,urdher nr 31 dt 20.02.2017

Sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë e trajtohen në Raporitin Përfundimtar të Auditimit.

**Pretendimet e subjektit:** “Duke u bazuar në dokumentat e depozituara në SPE rezulton se OE ka paraqitur si punë të ngjashme objektin: “Objekt sherbimi 2 kat dhe 1 kat nëntoke Himarë”, me vlerë ndertimi 9.747.250 (nëntë milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë” lekë pa Tvsh. Për të provuar përmbushjen e pikës 2.3.1/b në lidhje me kontrata të realizuara ne sektorin privat OE “E.S.” Shpk, ka paraqitur dokumentat e meposhtme :

-Kontratë sipermarrje nr.188 rep., dhe 99 kol., datë 28.2.2019 të lidhur midis investitorit E.N. dhe sipërmarrësit OE “E.S.” Shpk.

-Formular Vlerësimi të lëshuar nga investitori E.N. për përmbushje 100% dhe në cilësi shumë mirë të kontratës.

-Akt kolaudimi të objektit datë 15.9.2020 të lëshuar nga kolaudatori i objektit: OE “A.M” me nr.2892/2 licence, mbikqyrësi i punimeve “A.S.” me nr. Mk. 2692 licence.

-Situacion përfundimtare të objektit te firmosur nga Mbikqyrësi si punimeve “A.S.”, Shpk.

-Akt marrje në dorëzim të objektit datë 18.9.2020, të firmosur nga mbikqyrësi punimeve, investitori dhe sipërmarrësi.

**Këto dokumenta gjenden në folderin me emërtim “Dokumenta punë e ngjashme N.”.**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga ju është kërkuar: prova, dokumentacion mbështetës që kundërshtojnë gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit. (jo komete, vlerësime apo opinione, por është në SPE e nuk është cituar apo janë cituar gabim nga grupi i auditimit). Për objektin e sipërcituar ju nuk paraqesni dokumentacionin por e përshkruani atë.

Grupi i auditimit nuk është imun nga pasaktësitë/lapsus apo gabimeve njerëzore, prandaj ka kërkuar disa herë nga ju që kundërshtimet të shoqërohen me dokumentacion mbështetës, të cilin ju nuk e keni paraqitur.

Sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë e trajtohen në Raporitin Përfundimtar të Auditimit.

**Pretendimet e subjektit:** “90. Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet

Për sa parashtruar provohet se BOE “B. N” & “E.S.” & “B. B” përmbush kriteret e kërkuara në pikën 90.a, Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet.

Bazuar në akt konstatimin pretendohet se BOE “B. N & E.S. & B. B” Shpk, nuk përmbush kriterin e kapacitetit teknik të parashikuar në pikën 3. Dëshmi për mjetet e pajisje teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion.

Konkretisht pretendohet se BOE nuk disponon mjetet si më poshtë:

41.Makineri për veshjen e kanalit me beton ne menyre automatike 1 cope.

- Fatura blerjes me nr.88 datë 25.9.2020 me shites 3 A&B shpk dhe blerës E.S. .(në folder në SPE figuron “fatura e makinerise për betonim automatik të presuar”)

-Skedë teknike e makinerisë e shoqëruar me fotografi. (në folder në SPE figuron me emërtimin makineria për betonim automatik të presuar “.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se mjetet e cituara më lart dhe të kerkuara në DT më sipër zotërojnë kolaudim, siguracion dhe certifikata të vlefshme.

Nga sa parashtruar me sipër provohet përmbushja e kriterit për disponueshmërinë e mjeteve për ekzekutimin e kontratës.

- AK Bashkia Rrogozhinë me OE “B. B” Shpk dhe OE “B. N” Shpk ka lidhur kontraten me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, ku nga OE është deklaruar që mjetet/makinerite dhe punonjësit që do të ishin present gjatë zbatimit të kontratës.

Në kuptim të këtij përshkrimi pretendohet se mjetet/makinerite e deklaruar në procedurën e mësipërme “ReH.timi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë, Faza e tretë”, janë të angazhuara ne zbatimin e punimeve të kontratës me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të lagjes sipër stacionit të trenit, në qytetin e Rrogozhinës, Faza e parë”.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE dhe të dhënave të administruara pranë Ak konstatohet se mjetet /makinerite dhe punonjësit e deklaruar nuk janë në kushtet e angazhimit në zbatimin e punimeve për kontraten e mësipërme duke u nisur



nga faktet e mëposhtme :

-Grafiku i punimeve parashikon një afat 4-mujor për realizimin e punimeve dhe si rezultat data e përfundimit të punimeve është **07.09.2020**. Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit publik është **28.9.2020**.

-Bazuar në situacionimet e punimeve provohet se punimet janë kryer përpara datës 28.9.2020 që ka qënë data e hapjes së tenderit me objekt: “ReH.timi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë, Faza e tretë”. Këto të dhëna janë të administruara në dosjen e zbatimit të punimeve si dhe në të dhënat publike në faqen web “Spending Data”.

**Shenim:** Të dhënat e pasqyruara në parashtrimet e mësipërme gjenden në dokumentat e dorëzuara në SPE nga ana e BOE “B. N” Shpk & “B. B” Shpk & “E.S.” Shpk.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me** “Makineri për veshjen e kanalit me beton në mënyrë automatike” ju nuk keni paraqitur dokumentacion mbështetës që kundërshtojnë gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit. (jo komete, vlerësime apo opinione, por është në SPE e nuk është cituar apo janë cituar gabim nga grupi i auditimit). Për objektin e sipërcituar ju nuk paraqesni dokumentacionin por e përshkruani atë.

Në lidhje me objektin: “Rikonstruksion i rrugëve të lagjes sipër stacionit të trenit, në qytetin e Rrogozhinës, Faza e parë”, nga dokumentacioni i i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 07.05.2020 dhe kanë përfunduar me datë 07.01.2021, (parashikuar 4 muaj, realizuar 8 muaj)

Ju kujtojmë që për procedurën me objekt: “ReH.timi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë”

Data e hapjes së ofertave është 28.09.2020, kualifikimi dhe klasifikimi i ofertës më datë 01.10.2020, formulari i njoftimit të fituesit më datë 09.10.2020.

Pra ju e keni shpallur fitues kur ai nuk kishte përfunduar akoma punimet në objektin: “Rikonstruksion i rrugëve të lagjes sipër stacionit të trenit, në qytetin e Rrogozhinës, Faza e parë”.

**Sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë e trajtohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit.**

#### 5. Procedura e prokurimit me objekt: “Pastrim kanali kullues Bashkia Rrogozhinë”, me këto të dhëna:

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pastrim Kanalesh Kulluese Bashkia Rrogozhinë”, viti 2020

<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr.430,datë 10.12.2020	<b>2. Urdhër për Njësinë e Prokurimit</b> nr. 430, dt.10.12.2020 1. H.P.(kryetar) 2. A.S. (Anëtar) 3. E.H. (Anëtar)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër nr.430, datë 10.12.2020 1. J.M.(Kryetar) 2. O.D.(Anëtar) 3. G.Gj.(Anëtar)
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> <b>4,099,950 lekë</b>	<b>6.Oferta fituese:</b> BOE “Ll.” Shpk & “B.” Shpk: <b>Vlera 4,080.980</b> lekë, lidhur kontratë datë 23.02.2021, me afat 1 mujor.	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> <b>18,970</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> <b>22.12.2020</b>	<b>9.Burimi Financimit:</b> Buxheti Shtetit	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 BOE
<b>11.Ankimime</b> AK: Po	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b> Po	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> jo

**Titulli i Gjetjes 16:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në hartimin e kriterëve dhe në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt: “Pastrim kanalesh kulluese Bashkia Rrogozhinë”, me fond limit **4,099,950 lekë pa tvsh**.

**Situata:** Kriteret e Veçanta të Kualifikimit janë hartuar në përputhje me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Kriteret e vendosura, nuk janë në përputhje dhe në përpjesëtim me vlerën dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi dhe më konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “OE duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) e përditësuar
- **ISO14001** (Për Menaxhimin e Ambjentit) e përditësuar
- **OHSAS 18001** (Për Kushtet e Sigurisë dhe të Shëndetit të Punonjësve)

ISO-t e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse certifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.*

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mësipërme për konfirmimet e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të energjisë dhe sigurisë së zinxhirit të furnizimit nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe të nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: *...Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**2. Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: “OE duhet të paraqesi dëshmi nga administrata tatimore (Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave) për punësimin mesatar jo më pak se 25 (njëzet e pesë) punonjës për periudhën Prill 2020 - Tetor 2020.**

**a) Të paraqiten:**

1. Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën **Prill 2020 - Tetor 2020**

2. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën **Prill 2020 – Tetor 2020.**

**b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”, stafi inxhinierik si më poshtë:**

- Minimumi 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimumi 1 (një) **Inxhinier Topograf**

c. Kandidati ofertues duhet të ketë pjesë të stafit një punonjës të certifikuar si **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme (me kohë të plotë), diplomë, Certifikatë, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën “a”.

**Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”.**

Kërkesa për Inxhinier Ndërtimi profili transport dhe Inxhinier Mjedisi, nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 77 të LPP, që *“...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”*, si dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

*Sa më sipër për kritere të vendosura në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, mban përgjegjësi njësisia e prokurimit e përbërë nga: z. H.P., z. A.S. dhe z. E.H..*

Në këtë procedurë prokurimi rezulton se kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë. KVO ka s’kualifikuar 1 prej tyre për mangësi në dokumentacion, duke kualifikuar dhe shpallur fituese ofertën tjetër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij OE rezultuan këto mangësi si më poshtë vijon:

-OE “LI.” Shpk nuk ka paraqitur

a) Deklaratën për ofertë të pavarur sipas shtojcës 1/1

b) Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas shtojcës 4/1.

c) Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas shtojcës 5.

d) Deklaratën mbi konfliktin e interesit sipas shtojcës 6.

e) Deklaratën që nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP dhe që nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë për vepra penale që lidhen me veprimtarinë profesionale.

-OE "B." Shpk nuk përmbush pikën 2.2.4 për shlyerjen e taksave vendore në Bashkitë ku ka ushtruar aktivitet, konkretisht në Bashkinë Vlorë vitin 2020 dhe Bashkinë Mallakastër viti 2018 për punimet e kryera të cilat OE ka paraqitur si punë të ngjashme.

Lidhja e kontratës me vlerë **4,080,980 lekë pa Tvsh**, me fitues BOE "Ll." Shpk & "B." Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. J.M., z. O.D. dhe z. G.Gj..

**Kriteri:** Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

**Ndikimi:** kufizim i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në tender. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë **4,080,980 lekë pa Tvsh**, me BOE "Ll." shpk & "B." shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga ana e bashkisë Rrogozhinë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DT në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DT.

*Me shkresën nr. 2072 prot/1 Prot, datë 29.06.2023, me nr. 203/10 prot., datë 03.07.2023 në KLSH, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. J.M. ka shprehur kundërshtit për procedurën e prokurimit: "Pastrim Kanalesh Kulluese Bashkia Rrogozhinë" me fond limit 4,099,950 lekë pa Tvsh, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** "1. Sipas përmbajtjes së akt konstatimit pretendohet se OE "B 93 II" shpk nuk përmbush pikën 2.2.4 të kriterëve të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për Bashkitë Mallakastër për vitin 2018 dhe Vlorë për vitin 2020 për punime të kryera të cilat OE ka paraqitur si punë të ngjashme. Në lidhje me këtë pretendim fillimisht po referohemi te përmbajtja e pikës 2.2.4 të kriterëve të kualifikimit që përcakton :

"Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2018, 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB". Bazuar në përcaktimin e mësipërm dhe referuar ekstraktit historik të shoqërisë "B." Shpk rezulton se kjo shoqëri figuron me adresë aktiviteti në adresën "Tiranë; TIRANE; Tiranë; ; TIRANE; Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Pallati Nr.3/162, Kati 4-t, Ap.10" .; dhe nuk disponon adresë ushtrimi aktiviteti në Bashkitë Mallakastër dhe Vorë".

Në tërësinë e tyre mangësitë e deklaratave të OE "Ll." Shpk konsiderohen devijime të vogla që nuk ndikojnë në provimin e kapacitetit teknik, ekonomik dhe ligjor, konsiderohet devijim i vogël në bazë të nenit 53 të ligjit për prokurimin publik në fuqi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** OE "B." Shpk nuk e përmbush pikën 2.2.4 për shlyerjen e taksave vendore në Bashkitë ku ka ushtruar aktivitet, konkretisht në Bashkinë Vlorë vitin 2020 dhe Bashkinë Mallakastër viti 2018 për punimet e kryera të cilat OE ka paraqitur si punë të ngjashme. Përderisa ky operator ekonomik ka paraqitur si punë të ngjashme këto dy vende, duhej të kishte hapur niptin sekondar dhe për rrjedhojë të kishte paguar edhe taksat në këto dy vende të ushtrimit të aktivitetit.

Përsa i përket deklaratave të paraqitura, ato nuk konsiderohen devijim i vogël pasi me anë të këtyre deklaratave, KVO njihet me gjendjen e operatorit ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe vendos kualifikimin ose jo të tij. Në observacionet e paraqitura për skualifikimin e OE "C." shpk, argumentuat se ato nuk duhen konsideruar si devijim i vogël ndërsa në këtë rast përdorni standard të dyfishtë.

Për këtë arsye, argumentet e paraqitura nga ana juaj nuk kanë bazë ligjore dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

**6. - Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Nj.A Lekaj, Bashkia Rrogozhinë".**

**6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Njësia Administrative, Lekaj, Bashkia Rrogozhinë", Bashkia Rrogozhinë, viti 2020.**

<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 432 datë 16.12.2020	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr.6534 prot., datë 16.12.2020	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr.1067/1 prot., datë 07.05.2019
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> "E Hapur"	1. H.P.(Jurist) 2. A.S. (Arkitekt)	1. J.M. (Kryetar)-Jurist 2. G.Gj. (Ekonomist)

	3. E.H. (Shkenca sociale)	3. O.D. (Juriste)
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 249,541,030 lekë	6. Oferta fituese: BOE“B.-B” Shpk&“P.V.” Shpk& “D.C.” Shpk, vlera e ofertës 249,435,752 lekë pa Tvsh	7. Diferenca me fondin limit 105,278 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 18.01.2021	9. Burimi Financimit: AKUM	10. Operatorët Ekonomikë 1.BOE“B.-B” Shpk &“P.V.” Shpk&“D.C.” Shpk
11. Ankimime AK: KA OE “B. – X” Shpk nr. 17 prot., datë 05.01.2021	12. Përgjigje ankesës nga AK, Vendimi nr. 17/3 prot., datë 13.01.2021	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.
<b>b. Kontrata nr. 534 prot., datë 04.02.2021</b>		
14. Lidhja e kontratës 24.09.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	298,991,676

#### **Përlllogaritja e Fondit Limit:**

Projekt zbatimi, Specifikimet teknike dhe preevenivi janë realizuar nga OE “A.S.” Shpk.

Me shkresën nr. 2888 prot., datë 23.11.2020, AKUM ka miratuar Projekt zbatimin për objektin: Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Nj. A, Lekaj, Bashkia Rrogozhinë”, me vlerë të plotë 299,449,236 lekë me Tvsh.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Oponenca Teknike me nr. 2855/2 prot., datë 08.11.2021, është realizuar nga Drejtoria e Rregullave dhe Oponencave në Institutin e Ndërtimit.

Anëtarët e Njësisë së Prokurimit më datë 16.12.2020, janë formuluar/nënshkruar formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Më datë 16.12.2020, NJHD ka proseverbalim e miratimit/hartimit të dokumentave të tenderit, në të cilin janë përcaktuar kushtet, specifikimet teknike, dhe kriteret e kualifikimit.

#### **Ankesa për DT:**

Më datë 31.12.2020 OE “B.–X” Shpk, ka formular ankesën depozituar në Bashkinë Rrogozhinë me nr. 17 prot., datë 05.01.2021.

Me Urdhërin e brendshëm nr.10 e nr. 17/1 prot., datë 13.01.2021, për shqyrtimin e ankesës është ngarkuar z. M. D.

Me Vendimin nr. 17/2 prot., datë 13.01.2021, formuluar/nënshkruar nga z. M.D., nuk është pranuar ankesa e OE “B.–X” Shpk .

Ankesa e paraqitur është jashtë afatit të përcaktuar të përcaktuar në pikën 2 të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe nenit 84 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me nr. 17/3 prot., datë 13.01.2021, Vendimi i Titullari të AK z. E. M. i është dërguar operatorit ekonomik ankimues të DT.

**Titulli i gjetjes 17:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:** Kriteret që nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 46 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**1. Në pikën 3.4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:

- N.P – 1 D Punime gërmimi në tokë
- N.P – 2 A Ndërtime civile dhe industrial.
- N.P - 3 A Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash.
- N.P – 5 C Punime nëntokësore, ura e vepra arti.**
- N.P – 7 F Ujësjiellsa, gazësjellësa, vajësjellësa,**
- N.P – 12 D Punime të inxhinierisë së mjedisit.**
- N.S - 1 B Punime për prishjen e ndërtimeve.**
- N.S - 4 E Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to.**
- N.S – 18 B Punime topogjeodezike.**
- N.S – 20 A Shpime gjeologjike-inxhinierike,

*Për operatorët e huaj të bëhet njëhësi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

AK nuk ka parashikuar punim për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorive në licencë, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi erregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterereve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**2. Në pikën 3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën: OE duhet të jetë i pajisur me:

- EN-ISO 9001 mbi “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”.
- EN-ISO 14001 mbi “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”.
- BS OHSAS 18001/2007 ose ISO 45001/2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”.
- BS PAS 99 “Sistemi i menaxhimit të integruar”.
- ISO 50001 “Sistemin i menaxhimit të energjisë”.
- ISO 39001 “Certifikatë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor”.
- ISO EN 3834-2:2006 “Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike”.
- SA 8000 “Sistemi i menaxhimit të përgjegjësive shoqërore”
- ISO 1452-1 “Sistemi i tubacioneve plastike”
- DS CEN 15128 “Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit”.
- BS EN 13331-1 2002 “Sistemet për veshjen e kanaleve”
- 4 (katër) inxhinier të certifikuar për përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të punësuar si drejtues teknik pranë subjektit ofertues

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mësipërme për konfirmimet me sisteme e menaxhimit të mjedisit; energjisë; sigurisë në trafikun rrugor; cilësisë për saldimin e materialeve metalike; përgjegjësive shoqërore; për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit e sistemet për veshjen e kanaleve nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: ...*Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**3. Në pikën 3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 10, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Vendosja e kërkesës për disponimin e mjete/makinere/pajisje të mësipërme, mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, punimet konkrete që do të realizohen dhe volumet e tyre

nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

**4. Në pikën 3.7 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguar mesatar **150 punonjës** për gjashtë muajt e fundit. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat të konfirmuara nga administrata tatimore përkatëse me nënshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarinimin e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të jenë kusht për skualifikimi.

Kërkesat për fuqinë punëtore (150) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

**5. Në pikën 3.8 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "8. Subjekti duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontratë **pune të lidhur para noterit.**

Referuar punimeve konkrete të parashikuara në preventiv, nuk është parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do të ishte e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar nga AK dhe do të ishte e nevojshme ekspertizë applotësuese e **inxhinierëve: mekanik, mjedisi e strukturist (gjithësej 12 ing. drejtues teknik inxhinier të punësuar me kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, plus certifikata dhe specializime).**

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Objekti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përshkruhet në nenin 3 të Direktivës nr. 85/377/CEE: "VNM individualizon, përshkruan dhe vlerëson, në mënyrë specifike, për secilin rast në veçanti efektet direkte dhe indirekte **të një projekti** mbi faktorët e mëposhtëm: njeriu, fauna, flora; toka, ajri, klima dhe peisazhi; ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm dhe të mirave materiale dhe pasurisë kulturore". Problematikat, urbanistike dhe strukturore të një projekti nuk zgjidhen në zbatimin e punimeve por në stadin fillestar të projektit.

AK nuk ka parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do nevojitej ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" që kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterëve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**5. Në pikën 3.9 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "Mjekë, 1 të punësuar, me kontratë individuale pune të lidhur para noterit i cili të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë referuar VKM nr. 742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë. Në rast bashkim operatorësh të paktën njëri duhet ta plotësojë këtë kriter.

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. AK nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik të vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. AK duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga AK, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet esigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar ngajasthtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë OE pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Vendosja e këtij kriteri, penalizon/kufizon pjesëmarrjen e OE/BOE, që nuk janë të detyruar për marrjen në punë të mjekut të ndërmarrjes referuar VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar (pika 12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për atondërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.).

6. Në pikën 3.10 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “OE duhet të ketë të punësuar dhe të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë, punonjësit e mëposhtëm:

- Hidraulik, shoqëruar me: kontratë individuale të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 5 të punësuar.

- Hekurkthyes, shoqëruar me: kontratë individuale të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

- Karpentjer, shoqëruar me: kontratë individuale të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

- Manovrator për makineritë e rënda, shoqëruar me: kontratë individuale të punës dhe leje manovrimi, minimalisht 10 të punësuar .

- Automakinist shoqëruar me kontratë individuale të punës dhe leje manovrimi minimalisht 4 të punësuar.

- Buldozerist shoqëruar me kontratë individuale të punës dhe leje manovrimi minimalisht 1 të punësuar.

- Murator, shoqëruar me: kontratë individuale të punës të lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 8 të punësuar.

- Mekanik, shoqëruar me: kontratë individuale të punës, dëftesë (diplomë)/çertifikate dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 5 të punësuar.

- Saldator, shoqëruar me: kontratë individuale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.

- Montator, shoqëruar me: kontratë individuale të punës të lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.

- Specialist ndërtimi, shoqëruar me: kontratë individuale të punës të lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

- Shofer për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me: kontratë individuale të punës të lidhur para noterit me afat jo më pak se 4 vjeçar dhe leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE”, minimalisht 11 të punësuar.

- Suvatues, shoqëruar me: kontratë individuale të punës të lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.

- Teknik ndërtimi, shoqëruar me: kontratë individuale të punës të lidhur para noterit me dëftesë (diplomë) dhe me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

Kërkesat për 34 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

Kërkesat për 10 (dhjetë) manovrator, 11 (njëmbëdhjetë) shoferë, 4 (katër) automakinist e 1 (një) Buldozerist, të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë OE për ekzekutimin e kontratës, kërkohen të jenë në pronësi ose me qera. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga OE edhe nëpërmjet kontraktimit.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...” dhe jo “të lidhura para noterit”..

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë.

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AK Bashkia Rrogozhinë, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që. në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Për sa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. H.P., z. A.S., z. E.H. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga, H.P., z. A.S. e z. E.H.. Si dhe titullare e AK, znj. A.D., në cilësinë e miratuesit të tyre.***



### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me datë 18.01.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) BOE kanë marrë pjesë me vlerë ekonomike përkatëse të ofruara:

Me Procesverbali i KVO, datë 19.01.2021 i hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat e ekonomike, ka marrë vendimin për kualifikimin dhe klasifikimi e ofertës të paraqitur në prokurim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 19.01.2021. Formulari i njoftimit të fituesit më datë 27.01.2021

Kryetari i KVO-ja z. J.M. ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 26.01.2021, miratuar nga Titullari i AK Titullari i AK z. E. M., më datë 27.01.2021.

### **Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. **BOE “B. B” Shpk & “P.V.” Shpk, & “D.C.” Shpk**, me vlerë ekonomike të ofertës: **249,435,752 (dyqind e dyzet e nënte milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh.**

### **Nuk ka ofertues të skualifikuar.**

Kontrata me BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, fitues me nr. 534 prot., datë 04.02.2021. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **298,991,676 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë milion e nëntëqindë e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me Tvsh nënshkruar nga Titullari i AK z. E. M.)**

**Titulli i gjetjes 18:** KVOka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.”, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Me nr. 15 Rep., e nr. 15 Kol., datë 07.01.2021, është lidhur kontrata e bashkëpunimit midis OE “B.-B” Shpk & OE “P.V.” Shpk & OE “D.C.”

a. OE “B. B” Shpk, do të realizojë 41.94% të punimeve sipas preventivit të ofertës.

b. OE “P.V.” Shpk, do tërealizojë 8.02 % të punimeve sipas preventivit të ofertës.

c. OE “D.C.” Shpk, do tërealizojë 50.04 % të punimeve sipas preventivit të ofertës.

Bashkangjitur me nr. 17 Rep., e nr. 17 kol., datë 07.01.2021 “Prokurë e posaçme” përpërfaqësimin e BOE nga OE “B. B” Shpk:

### **A. OE “B. B” Shpk.**

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Peqin; Korçë; Berat; Kavajë; Durrës; Fier; Selenicë; Mallakastër; Roskovec dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë :*Fier, Roskovec, Durrës e Berat.*

**Në vitin 2019**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Fier; Cërrik; Rrogozhinë; Berat; Peqin; Kavajë; Cërrik; Durrës; Mallakastër; Korçë; Elbasan; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: *Mallakastër, Fier, Roskovec, Durrës, Peqin, Berat, Rrogozhinë, Kavajë, Maliq, Cërrik, Shijak, Elbasan e Pustec.*

**Në vitin 2020**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Roskovec; Peqin; Korçë; Tepelenë; Cërrik; Kavajë; Divjakë; Tiranë; dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: Korçë, Maliq, Kavajë, Peqin, Rrogozhinë, Fier, Berat, Shijak e Vorë.

### **B. OE “P.V.” Shpk**

**Në vitin 2017**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: *Fier; Ballsh; Gjirokastër; Kavajë; Berat e Peqin*, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore nga bashkitë Fier.

**Në vitin 2018**, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: *Fier; Peqin; Roskovec; Kavajë e Berat*, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore nga bashkitë: Fier; Roskovec e Berat.

Në vitin 2019, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Fier; Mallakastër; Gjirokastrë; Roskovec; Kavajë; Cërrik; Berat e Maliq, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore nga Bashkitë: Fier; Mallakastër; Peqin; Rrogozhinë; Maliq; Cërrik; Roskovec;

#### **C. OE “D.C.” Shpk**

Në vitin 2017, ka ushtruar veprimtarinë bashkitë: Skrapar; Tiranë; Korçë e Prrenjas, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: Tiranë ë Skrapar.

Në vitin 2018, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Berat; Skrapar; Tiranë; Durrës e Prrenjas dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: Tiranë, Durrës e Prrenjas.

Në vitin 2019, ka ushtruar veprimtari në bashkitë: Skrapar; Tiranë; Durrës; Ura Vajguore; Berat e Prrenjas dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrime vendore në bashkitë: Tiranë, Durrës, Berat e Prrenjas

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga Titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk. Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet: “AK nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. J.M., z. G.Gj. dhe z. O.D..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **249,435,752 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **249,435,752 lekë pa Tvsh.**

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishite propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: z. J.M., në cilësinë e Kryetare e KVO, znj. G.Gj. dhe z. O.D. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e AK znj. A.D..

Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikimi BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, në kushtet kur duhej anuluar dhe AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **249,435,752 lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

Me shkresën nr. 2072 prot/1 Prot, datë 29.06.2023, me nr. 203/10 prot., datë 03.07.2023 në KLSH, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. J.M. ka shprehur kundërshtit për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, NjA. Lekaj, Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 249,541,030 lekë pa Tvsh, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** “Nga përmbajtja e projekt raport që trajton këtë procedurë prokurimi pretendohet se BOE “B. B” Shpk & “D.C.” Shpk & “P.V.” Shpk, nuk plotësojnë kriterin e kërkuar në pikën 2.1 të Kapacitetit Ligjor që ka përmbajtjen si vijon “OE duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit, shoqëruar me dokumentacion që vërteton se nuk ka detyrime të pashlyera për taksat vendore pranë njësisve të qeverisjes vendore ku OE ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit të regjistrit, për vitet 2017, 2018 dhe 2019. Vërtetimi duhet detyrimisht të jetë përshkruar, ndër të tjera, edhe NIPT-in e subjektit. Në rastet e BOE, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Njësit e Qeverisjes Vendore”.

**A. OE “B. B” Shpk, për vitin 2018, ka ushtruar aktivitet në bashkitë Peqin, Korçë, Berat, Kavajë, Durrës, Fier,**

Selenicë, Mallakastër, Roskovec dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave për bashkitë Fier, Roskovec, Durrës e Berat.

Në lidhje me këtë pretendim po ju sqarojmë se bazuar në ekstraktin historik që figuron në QKB rezulton se OE "B. B" Shpk, ka ushtruar aktivitetet për periudhën e vitit 2018 në Bashkitë Fier, Durrës, Berat, Roskovec, Peqin dhe Korçë. Ai ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore si më poshtë:

- Vërtetim më datë 21.8.2020, për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2020 ndaj Bashkisë Peqin.

- Vërtetim nr. 4699, datë 20.6.2019 për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2019 të lëshuar nga Bashkia Korçë dhe mospasjen e asnjë detyrimi deri në këtë moment.

- Vërtetim nr. 45 prot., datë 22.10.2019 për shlyerje detyrimesh ndaj Bashkisë Peqin dhe mospasjen e asnjë detyrimi deri në këtë moment.

- Vërtetim nr. 1 268/1 datë 31.5.2019, për shlyerje detyrimesh ndaj Bashkisë Peqin.

Ndërsa sipas të dhënave të ekstraktit historik në QKB ai nuk ka adresë të rregjistruar për ushtrim aktiviteti në bashkitë Kavajë, Selenicë, Mallakastër. Pavarësisht OE ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, që vërteton që nuk ka pasur detyrime ndaj këtyre bashkive si më poshtë:

- Vërtetim nr. 72 prot., datë 24.10.2019 për shlyerje detyrimesh deri në datë 31.12.2019 ndaj Bashkisë Kavajë.

- Vërtetim nr. 730/1, datë 22.7.2019 për shlyerjen e detyrimeve deri në datë 22.7.2019 ndaj Bashkisë Mallakastër

**Në vitin 2019** ka ushtruar aktivitetet në bashkitë Fier, Cërrik, Rogozhinë, Berat, Kavajë, Peqin, Tiranë, Mallakastër, Korçë, Elbasan, Durrës dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për bashkitë Mallkastër, Fier, Roskovec, Durrës, Peqin, Berat, Rogozhinë, Kavajë, Maliq, Cërrik, Shijak, Elbasan e Pustec. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "B. B" Shpk, nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për Bashkitë Tiranë dhe Korçë.

Nga verifikimi në SPE dhe në të dhënat në ekstraktin historik në QKB të OE "B. B" Shpk, rezulton se ky operator ekonomik nuk ka ushtruar aktivitetet në territorin e Bashkisë Tiranë.

- Me vërtetim nr. 4699, datë 20.6.2019 për shlyerjen e detyrimeve për periudhën e vitit 2019 të lëshuar nga Bashkia Korçë dhe mospasjen e asnjë detyrimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore deri në këtë datë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Ushtrimi i aktivitetit të OE "B. B" Shpk, në bashkitë e cituara nga grupi i auditimit i është referuar web-it zyrtar të "Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit", i aksesueshëm nga kushdo që i nevojitet informacioni. Në këtë rast po ju sqarojmë që çdo pretendim juaj nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me aktivitetin OE "B. B" Shpk, në vitin 2020, argumentimi juaj qëndron e pasqyrohet në materialin e auditimit.

**Pretendimet e subjektit: "B. OE "Pesë Vëllezerit" Shpk për vitin 2017** ka ushtruar aktivitetet në bashkitë: Fier, Ballsh, Gjirokastrë, Kavajë, Berat, e Peqin, dhe ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Fier. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "P.V." Shpk nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për Bashkitë Ballsh, Gjirokastrë, Kavajë, Berat, Peqin.

Bazuar në ekstraktin historik në Qendrën Kombëtare të Biznesit të OE "P.V." Shpk, rezulton se ai nuk ka ushtruar aktivitetet për periudhën e vitit 2017, në territorin e Bashkive Ballsh, Gjirokastrë, Kavajë, Berat, Peqin. Pavarësisht faktit se OE nuk ka detyrim për paraqitje vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifash vendore për këto Njësi Vendore, OE "P.V." Shpk, ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme.

- Vërtetim nr. 116, datë 21.9.2018, për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri në datë 21.9.2018, ndaj Bashkisë Berat ku përfshihet dhe periudha e vitit 2017.

- Vërtetim nr.1269/1, datë 31.5.2019, për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri në datë 31.5.2019 ndaj Bashkisë Peqin ku përfshihet dhe periudha e vitit 2017.

- Vërtetim nr. 731/1, datë 22.7.2019, për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri në datë 21.9.2018 ndaj Bashkisë Berat ku përfshihet dhe periudha e vitit 2017.

**Në vitin 2018 OE "P.V." Shpk**, ka ushtruar aktivitetet në Bashkitë Fier, Roskovec, Kavajë, Berat e Peqin, dhe ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për Bashkinë Fier, Roskovec, Berat. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "P.V." Shpk, nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për Bashkitë Kavajë dhe Peqin.

Bazuar ne ekstraktin historik në QKB të OE "P.V." Shpk, rezulton se ai nuk ka ushtruar aktivitetet për periudhën e vitit 2018 në territorin e Bashkive Kavajë, Peqin. Pavarësisht faktit se OE nuk ka detyrim për paraqitje vërtetim për taksat dhe tarifatat vendore për këto Bashki ai ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme.

Vërtetim nr. 1269/1, datë 31.5.2019 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri në datë 31.5.2019 ndaj Bashkisë Peqin ku përfshihet dhe periudha e vitit 2017.

**Ne vitin 2019 OE "P.V." Shpk**, ka ushtruar aktivitetet ne Bashkitë Fier, Mallakastër, Gjirokastrë, Roskovec, Kavajë, Cerrik, Berat, e Maliq, dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë: Fier,

Mallakastër, Peqin, Rogozhinë, Maliq, Cërrik, Roskovec. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "P.V." Shpk, nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për Bashkitë Gjirokastrë, Kavajë dhe Maliq. Bazuar në ekstraktin historik në QKB të OE "P. V." Shpk, rezulton se ai nuk ka ushtruar aktivitet për periudhën e vitit 2019, në territorin e Bashkive Gjirokastrë, Kavajë dhe Maliq. Pavarësisht faktit se OE nuk ka detyrim për paraqitje vërtetime për këto Bashki ai ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme.

- Vërtetim nr. 2934/1, datë 12.6.2019 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri në datë 12.6.2019, ndaj Bashkisë Berat ku përshihet dhe periudha e vitit 2019."

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Ushtrimi i aktivitetit të OE "P.V." Shpk, në bashkitë e cituara nga grupi i auditimit i është referuar web-it zyrtar të "Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit", i aksesueshëm nga kushdo që i nevojitet informacioni. Në këtë rast po ju sqarojmë që çdo pretendim juaj nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me aktivitetin OE "P.V." Shpk, në vitin 2020, argumentimi juaj qëndron e pasqyrohet në materialin e auditimit.

**Pretendimet e subjektit:** "C. OE "D.C." Shpk Në vitin 2017 ka ushtruar aktivitet në bashkitë Skrapar, Tiranë, Korçë, Prrenjas dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrimeve vendore në bashkitë Tiranë e Skrapar. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "D.C." Shpk, nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për Bashkitë Korçë, Prrenjas. Në SPE rezulton se OE "D.C." Shpk, ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme:

- Vërtetim datë 16.3.2018, për shlyerjen e detyrimeve ndaj Bashkisë Prrenjas për periudhën e vitit 2017.

Bazuar në ekstraktin historik në QKB të OE "D.C." Shpk, rezulton se ai nuk ka ushtruar aktivitet për periudhën e vitit 2017 në territorin e Bashkisë Korçë.

Në vitin 2018 ka ushtruar aktivitet në Bashkitë Berat, Skrapar, Tiranë, Durrës, Prrenjas dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrimeve vendore në Bashkitë Tiranë e Skrapar. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "D.C." Shpk nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për Bashkitë Berat dhe Skrapar. Në SPE rezulton se OE "D.C." Shpk, ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme:

- Vërtetim nr. 357, datë 24.8.2018 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Skrapar për periudhën e vitit 2018.

- Vërtetim nr. 203 prot., datë 21.8.2019 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Berat dhe mospasjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri në datë 21.8.2019.

Në vitin 2019 ka ushtruar aktivitet në Bashkitë Berat, Skrapar, Tiranë, Durrës, Prrenjas, Urë Vajgurore dhe ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave dhe detyrimeve vendore në bashkitë Tiranë, Durrës, Berat e Prrenjas. Nisur nga përmbajtja e mësipërme pretendohet se OE "D.C." Shpk, nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerje taksash dhe tarifave vendore për bashkitë Urë Vajgurore dhe Skrapar. Në SPE rezulton se OE "D.C." Shpk ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme :

- Vërtetim nr. 2431 prot., datë 9.8.2019 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Skrapar për vitin 2019.

- Vërtetim nr. 2711/1 prot., datë 14.10.2019 për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore ndaj Bashkisë Urë Vajgurore për vitin 2019."

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Ushtrimi i aktivitetit të OE "D.C." Shpk, në bashkitë e cituara nga grupi i auditimit i është referuar web-it zyrtar të "Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit", i aksesueshëm nga kushdo që i nevojitet informacioni. Në këtë rast po ju sqarojmë që çdo pretendim juaj nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me aktivitetin OE "D.C." Shpk, në vitin 2020, argumentimi juaj qëndron e pasqyrohet në materialin e auditimit.

**Pretendimet e subjektit:** "Për sa parashtroam me sipër konkludojmë se BOE "D.C." Shpk & "B. B" Shpk & "P.V." Shpk, plotësojnë kriteret e kualifikimit të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Baza ligjor; Neni 46 i ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikon se "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë për mbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që AK i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese" dhe neni 53 pika 3, e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" sanksionon se AK, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Baza ligjore që ju i referohet i përket rastit kur plotësohen kriteret e kualifikimit, në rastin konkret konstatimet e përshkruara nga grupi i auditimit, vërtetojnë që kriteret e kërkuara në DT nuk plotësohen nga BOE.

Ushtrimi i aktivitetit të BOE “D.C.” Shpk & “B. B” Shpk & “P.V.” Shpk, në bashkitë e cituara nga grupi i auditimit i është referuar web-it zyrtar të “Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit”, i aksesueshëm nga kushdo që i nevojitet informacioni.

Sa sqaruar me sipër konkludojmë se BOE “D.C.” Shpk & “B. B” Shpk & “P.V.” Shpk, nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit të kërkuara në dokumentat e tenderit.

**Sa më sipër pretendimet tuaja nuk merret në konsideratë dhe pasqyrohen në Raportin Përfundimtar të auditimit.**

**B. Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2021, paraqiten si më poshtë:**

**7 -Procedura e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, lagjia e re Gosë”, me këto të dhëna:**

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, lagjia e re Gosë” Viti 2021		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.454, datë 29.12.2020	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:</b> Urdhër nr. 102, 1. H.P. (Kryetar) 2. A.S. (Anëtar) 3. E.H. (Anëtar)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër nr. 454, datë 29.12.2020 1. J.M. (Kryetar) 2. G.Gj. (Anëtar) 3. O.D. (Anëtar)
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Procedure e hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 24,570,117 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “M.” Shpk & “E.” Shpk me vlerën 24,308,811 lekë, me lidhje kontrate datë 01.03.2021 dhe me afat 3 mujor..	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 261,306 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit:</b> 01.02.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> “Të ardhurat e Bashkisë”	<b>10. Operatorët Ekonomike:</b> a) Pjesëmarrës në tender: 1 BOE b) S’kualifikuar 0 c) Kualifikuar 1BOE
<b>11. Ankimime në AK</b> JO	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b> JO	<b>13. Ankimime në KPP</b> JO

**Titulli i Gjetjes 19:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në hartimin e kriterëve dhe në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, lagjia e re Gosë”, me fond limit 24,570,117 lekë pa Tvsh.

**Situata:** Kriteret e Veçanta të Kualifikimit janë hartuar në përputhje me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*-Kriteret e vendosura, nuk janë në përputhje dhe në përpjesëtim me vlerën dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi dhe më konkretisht:*

**1. Në pikën 3.4 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: “Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:

**N.P - 3 A Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash**

**N.P – 7 B Ujësjetlla, gazësjetllës, vajësjetllës,**

**N.P – 12 B Punime të inxhinierisë së mjedisit.**

**N.S – 20 A Shpime gjeologjike-inxhinierike, ...**

Për Operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

AK nuk ka parashikuar punim për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorive në licencë, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi rregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterëve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**2. Në pikën 3.5** të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: **“Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën: OE duhet të jetë i pajisur me:**

- EN-ISO 9001-2015 mbi “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”.
- EN-ISO 14001-2015 mbi “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”.
- BS OHSAS 18001/2007 ose ISO 45001/2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”.
- BS PAS 99 :2012 “Sistemi i menaxhimit të integruar”.
- ISO EN 3834-2:2006 “Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike”.
- ISO 1452-1:2009 “Sistemi i tubacioneve plastike)
- DS CEN 15128 “Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit”.
- BS EN 13331-1 2002 “Sistemet për veshjen e kanaleve”.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mësipërme për konfirmimetin me sisteme të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të energjisë dhe sigurisë së zinxhirit të furnizimit nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: *...Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**3. Në pikën 3.5/a.** të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: është kërkuar 4 (katër) inxhinier të certifikuar për përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të punësuar si drejtues teknik pranë subjektit ofertues.

Certifikatat të jenë lëshuar në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

**Ofertuesit duhet:**

Të disponojë licencë QKL III.2.A (1+2) “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Të disponojë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje e mbetjeve Urbane”.

- Zbatimin e përcaktimeve të nenit 46 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që parashikon se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa për licencën e mësipërme duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;
- Ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacioneve teknike.
- Garantimi i realizimit të punimeve respektive në fazën e zbatimit përmbushet nëpërmjet disponimit nga ofertuesit të kategorisë respektive në licencën profesionale.

Veprimtaritë e nënkategorisë **III.2.B** specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

Kriteri për disponimin e licencës me Kodet e sipërcituara, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve.

**4. Në pikën 3.7** të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: “Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguar mesatar **70 punonjës** për gjashtë muajt e fundit. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat të konfirmuara nga administrata tatimore perkatëse me nënshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarinë e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të jenë kusht për skualifikimi”.

Kërkesat për fuqinë punëtore 70 punonjës nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje **me natyrën dhe përmasën e kontratës.**

**5. Në pikën 3.8 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “Subjekti duhet të këtë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontratë **pune të lidhur para noterit** .

- Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe të **plotë të lidhur para noterit**, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë .

- Drejtues Teknik inxhinier hidroteknik, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

- Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet/markshajder, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë - Drejtues Teknik **inxhinier mjedisi**, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

- Drejtues Teknik **inxhinier Gjeolog**, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

Shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë, nga administratori i shoqërisë, ku të percaktoj drejtuesin/t teknik të shoqërisë/i të cili/ët do të jetë/në i/të pranishëm gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Gjithashtu në këtë deklaratë administratori i shoqërisë duhet të deklarojë se autorizon AK për verifikimin e informacionit të dhënë për drejtuesin teknik. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

Referuar punimet konkrete të parashikuara në preventiv, nuk është parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do të ishte e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar nga AK dhe do të ishte e nevojshme ekspertiza plotësuese e **inxhinierëve**: Mjedisi dhe gjeolog.

AK nuk ka parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do nevojitej ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi e rregullave të prokurimit publik” *që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*

**6. Në pikën 3.9 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “Mjekë, 1 të punësuar, me kontrate individuale pune te lidhur para noterit i cili të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licencë. Në rast bashkim operatorësh të paktën njëri duhet ta plotësoj këtë kriter.

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. AK nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. AK duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj..) dhe jo çështje e verifikimit nga AK, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet **mjekut** të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të **kontraktuar nga jashtë**, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë OEpjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Vendosja e këtij kriteri, penalizon/kufizon pjesëmarrjen e OE/BOE, që nuk janë të detyruar për marrjen në punë të mjekut të ndërmarrjes referuar VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar (pika 12/2. Për subjektet që nuk përfshihen

në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.).

**7. Në pikën 3.10 të kapacitetit teknik** (paragrafi i nëntë) në DT është kërkuar: “Me qëllim që operatorët ekonomik të njihen me terrenin ku do kryhen punimet, AK, do të organizoj një vizitë në kantier ne 5 ditë para hapjes se tenderit. Në perfundim të vizitës AK do të pajisë operatorët ekonomik pjesmarrës me vertetim, ku do te vertetohet pjesmarja. Mospjesmarrja përben kusht skualifikimi.

AK në DT ka kërkuar vizitë në kantier pa e formuluar në njoftimin e shkurtuar të kontratës, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

Sa më sipër për kritere të vendosura në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, mban përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga: z. H.P., z. A.S. dhe z. E.H..

Tenderi është hapur me datë 01.02.2021. Në të kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar nga KVO sa më poshtë vijon:

Nr	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	“M.” Shpk & “E.” shpk	24,308,811	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Në këtë tender kanë marrë pjesë 1BOE, i cili është shpallur fitues me ofertën me vlerë **24,308,811 lekë**, me diferencë nga fondi limit në vlerën **261,306 lekë**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se BOE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:

-OE “E.” Shpk, nuk përmbush pikën 2/1 për shlyerjen e taksave vendore në Bashkitë ku ka ushtruar aktivitet, konkretisht ka paraqitur si punë të ngjashme punime që ka zhvilluar në Bashkinë Vorë në vitin 2019 dhe nuk ka paraqitur vërtetim të shlyerjes së detyrimeve të taksave vendore pranë kësaj Bashkie. Operatori ndonëse zhvillon aktivitet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vende zhvillimi të biznesit ku do të duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende të tjera zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njërive. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT “unik”. Mos regjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” nenin 40, nenin 3.1/a.b.c të ligjit nr. 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit”, si dhe ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

-OE “M.” Shpk nuk përmbush pikën 3.4.5. që të jetë i pajisur me certifikatë ISO. OE “M.” Shpk për kryerjen e punimeve në këtë objekt zotëron kuotat në masën 25.94%. Dy nga zërat e preventivit të punimeve janë: a) Mbushje cakull mbi tub. b) Shtresë rëre për mbrojtjen e tubit, për të cilat kërkohen certifikata të cilat OE nuk i ka paraqitur dhe të cilat janë:

- **DS CEN15128** (sistemi i standardeve evropiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit).
- **BS EN 13331-1 2002** (Sistemet për veshjen e kanaleve)

Lidhja e kontratës me vlerë **24,308,811 lekë pa Tvsh**, me fitues BOE “M.” Shpk & “E.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. J.M., z. O.D. dhe z. G.Gj..

**Kriteri:** Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

**Ndikimi:** kufizim i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në tender. Veprimet e mësipërme kanë sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë **24,308,811 lekë pa Tvsh**, me BOE “M.” shpk & “E.” shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT dhe është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë.



**Rekomandim:** Nga ana e bashkisë Rrogozhinë të merren masa për vendosjen e kriterëve të DT në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DT.

*Me shkresën nr. 2072 prot/1 Prot, datë 29.06.2023, me nr. 203/10 prot., datë 03.07.2023 në KLSH, Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. J.M. ka shprehur kundërshtit për procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, lagjia e re Gosë”, me fond limit 24,570,117 lekë pa Tvsh, si më poshtë:*

**Pretendimi i subjektit:** “Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “E.” shpk rezulton se kjo shoqëri figuron me adresë aktiviteti në adresat “Dibër Bulqizë BULQIZË Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjia e re, Banesa 775/I, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1 dhe TIRANË Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Muhedin Llagani, Pallati Vala Kompani, Kati 2, Nr 6 dhe për këto bashkie ka paraqitur vërtetimet e mëposhtme :

- Vërtetim datë 21.2.2020 të lëshuar nga Bashkia Tiranë ku vërtetohet se subjekti E. shpk nuk ka asnjë detyrim për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Tiranë deri në datë 21.2.2020.

-Vërtetim nr. 854 prot datë 24.2.2020 të lëshuar nga Bashkia Bulqizë ku vërtetohet se subjekti E. shpk nuk ka asnjë detyrim për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Bulqizë deri në datë 24.2.2020.

Përsa i përket inxhinierëve, BOE ka deklaruar këta inxhinierë si më poshtë :

1. Inxh. B. M. i punësuar pranë “E. shpk” i cili disponon certifikatë si koordinator për sigurinë dhe shëndetin në punë të lëshuar nga shoqëria certifikuese “K.”, certifikatë e cila rezulton me nr. 17041409 e lëshuar me date 24.4.2018.

2. Inxh. O.L. i punësuar pranë shoqërisë M. shpk i cili disponon certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të lëshuar nga shoqëria “A.” certifikatë e cila rezulton me nr. AQS/T/561252020 të lëshuar me datë 30.09.2020.

3. Inxh. Zh.Dh. i punësuar pranë shoqërisë “E.” shpk e cila disponon certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të lëshuar nga shoqëria “A.” certifikatë e cila rezulton me nr. AQS/T/542132020 të lëshuar me datë 01.06.2020.

4. Inxh. S.M. i punësuar pranë shoqërisë “M.” shpk i cili disponon certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të lëshuar nga shoqëria “A.” certifikatë e cila rezulton me nr. AQS/T/561262020 lëshuar në datë 30.09.2020.

Në interpretim të kërkesës për certifikatat ISO nga ana e AK është kërkuar që ofertuesi të disponojë certifikatat e cilësisë. Nga dokumentet që figurojnë në SPE rezulton se ofertuesi “E. shpk & M. shpk” disponojnë certifikatat **DS CEN 15128** (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit) të lëshuar nga shoqëria certifikuese A. me nr. AQS/TLS/34402018 e lëshuar me date 22.10.2018 si dhe **BS EN 13331-1 2002** (Sistemet për veshjen e kanaleve) të lëshuar nga shoqëria A. me nr. AQS/tIS/34402018 e lëshuar ne date 20/10/2018.

Në SPE rezulton se BOE “E. & M. shpk” ka paraqitur mjetet e mëposhtme me kapacitet transportues 2.5 deri ne 5 ton :

1. Mjetin me qira ne baze te kontrates noteriale me nr.2398 rep dhe nr.590 kol date 29.10.2019 me targa TR 3893 F ,me kapacitet transportues 4.68 ton .

2. Mjetin AA 907MF me qira , me kapacitet transportues 3,3 ton.

3. Mjetin me targa BZ 1424 A ne pronesi te M. shpk, me kapacitet transportues 3,3 ton.

4. Mjetin me qira me targa TR 9638 K me kapacitet transportues 4.8 ton.

5. Autobetoniere me targa AA 771 ES me qira me kontratë noteriale me nr. 675 rep dhe nr.164 kol date date 26.3.2020 ,i pajisur me kolaudim, siguracion dhe certifikatë transporti te vlefshme

6. Autobetoniere me targa DR1615 F me qira me kontratë noteriale me nr. 676 rep dhe nr. 175 kol, i pajisur me kolaudim, siguracion dhe certifikatë të vlefshme transporti.

7. Autobetoniere me targa AA251 RZ me qira me kontratë noteriale 676 rep dhe nr. 165 kol date 26.3.2020, i pajisur siguracion, kolaudim dhe certifikatë transporti të vlefshme.

8. Autopompe betoni me targa AA281MM me qira me kontratë noteriale me nr. 675 rep dhe nr.164 kol date date 26.3.2020me siguracion, kolaudim dhe certifikatë transporti të vlefshme

9. Autopompe betoni me targa AA902 FH me qira me kontrate noteriale me nr.4133 rep dhe nr.2754 kol date 29.6.2020, i pajisur siguracion ,kolaudim dhe certificate transporti te vlefshme”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Përsa i përket inxhinierëve të deklaruar, kamionët e paraqitur dhe certifikatat ISO, argumentimi juaj merret parasysh dhe është reflektuar në material.

Në lidhje me vërtetimin e taksave në vendet e ushtrimit të aktivitetit nga OE, pretendimi juaj nuk merret parasysh.

Gjithashtu nuk merret parasysh as pretendimi juaj për, të cilat duhet t'i disponojë OE që do të kryejë punimet përkatëse sipas përqindjes së ndarjes së punimeve.

**8. - Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Ujësjetllësit Gosë, Bashkia Rrogozhinë”.**

<b>8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Ujësjetllësit Gosë, Bashkia Rrogozhinë”, Bashkia Rrogozhinë viti 2021.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 58 datë 03.03.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Nr. 1316 prot., datë 03.03.2021	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr.1316 prot., datë 03.03.2021
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	1. H.P.(Jurist) 2. S. L. (Arkitekt) 3. E.H. (Shkenca sociale)	1. E.S. (Kryetar)-Jurist 2. F.M. (Ekonomist) 3. A.M. (Ekonomist)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 161,244,201 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk &, “D.C.” Shpk vlera e ofertës <b>159,636,487</b> lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,607,714 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 05.04.2021	<b>9. Burim i Financimit:</b> Granti Buxhetit te Shtetit (AKUM).	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE“B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk 2. OE “I. 2.” Shpk
<b>11. Ankimime AK:</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 1943 prot., datë 26.04.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 26.04.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>191,504,784</b>

**Përlllogaritja e Fondit Limit:**

Projekt zbatimi është realizuar nga OE “A.S.” Shpk, në vitin 2020, me drejtues projekti: znj. A.N., (Administratore) Ing. A.A. (Projektues) Ing. Ndërtimi A.A. Arkitekt R.H., Ing. Hidroteknik H.M., Ing. Elektrik A.A., Ing. Topograf I.B., Ing. Mekanik B.M., Ing. Ndërtimi M.M., Ing. Ndërtimi A.K. e Ing. Mjedisi A.R..

Me shkresën nr. 508/1 prot., datë 26.02.2021, në zbatim të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 «Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektimi, mbikqyrje dhe kolaudim», është përlllogaritur ndarja e fondit për objektin e sipërcituar.

Emërtimi i objektit	Vlera e plotë	Nga këto		
		Ndërtim montim	Drejtim punimesh	Kolaudim
Rikonstruksioni i ujësjetllësit Gosë	197,039,173	193,493,041	3,083,593	462,539

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Oponenca Teknike me nr. 514 prot., datë 02.03.2020, është realizuar nga Drejtoria e Rregullave dhe Oponencave në Institutin e Ndërtimit

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit më datë 03.03.2021, kanë formuluar/nënshkruar formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Më datë 03.03.2021, NJHD ka proseverbalim e miratimit/hartimit të dokumentave të tenderit, në të cilin janë përcaktuar kushtet, specififikimet teknike, dhe kriteret e kualifikimit.

Më datë 03.03.2021 Raporti analitik mbi fuqinë punëtore dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, formuluar/nënshkruar nga z. S. L..

**Ankesa për DT:**

Me nr. 155 prot., datë 02.09.2020 OE “B.” Shpk, (në Bashkinë Rogozhinë) ka formular kërkesën për sqarim ankesën depozituar në Bashkinë Rogozhinë me nr. 4843 prot., datë 03.09.2020.

Me nr. 4843 prot., datë 11.09.2020, Sqarim për kriteret dhe specififikimet teknike drejtuar OE “B.” Shpk, nga Titullari i AK znj. A.D., ku sqarohet se kriteret dhe specififikimet teknike janë të hartuara në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Titulli i gjetjes 20:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

Kritere që nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 46 Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit

26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**Situata:**

**1. Në pikën 4 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës që prokurohet.**

*Ofertuesit pjesëmarrës, duhet të jenë të pajisur me liçencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë dhe nivelet si më poshtë:*

- N.P – 1 C Punime gërmimi në tokë.*
- N.P – 5 C Punime nëntokesore, ura e vepra arti.*
- N.P – 7 D Ujësjellsa, gazësjellësa, vajësjellësa, vepra kullimi e vaditje.*
- N.P – 12 C Punime të inxhinierisë së mjedisit.*
- N.S – 4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, ...*
- N.S – 18 B Punime topogjeodezike.*
- N.S – 20 A Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime për ujë.*

AK nuk ka parashikuar punim për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorive në liçencë, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi erregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterereve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**2. Në pikën 6 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:Ofertuesit pjesëmarrës duhet të paraqesinçertifikimet e mëposhtme, për të cilat OE duhet të jetë i pajisur me:**

- **EN-ISO 9001-2015** ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë), ose ekuivalente.
- **BS OHSAS 18001/2007** ose **ISO 45001/2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose ekuivalente.
- **EN-ISO 14001-2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit), ose ekuivalente.
- **ISO EN 3834-2:2006** “(Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike), ose ekuivalente.
- **DS CEN 15128** (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit), ose ekuivalente.
- **BS EN 13331-1 2002** ( Sistemet për veshjen e kanaleve), ose ekuivalente.
- **SA 8000:2014** ( Sistemi i menaxhimit të përgjegjësive shoqërore), ose ekuivalente.
- **ISO 1452-1:2009** (Sistemi i tubacioneve plastike), ose ekuivalente.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mëspërme për konfirmimet me sisteme e menaxhimit të mjedisit; energjisë; sigurisë në trafikun rrugor; cilësisë për saldimin e materialeve metalike; përgjegjësive shoqërore; për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit e sistemet për veshjen e kanaleve nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: ...Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

**3. Në pikën 8 të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të tij të paktën 3 inxhinierë të çertifikuar për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, të cilët**

*duhet të figurojnë në licensën e shoqërisë pjesëmarrëse dhe në listpagesa, shoqëruar edhe me çertifikatat që provojnë çertifikimin e mësipërm dhe kontrata e punës noteriale.*

AK nuk ka parashikuar asnjë punim për zbatimin e të cilit do nevojitej ekspertiza profesionale e inxhinierave të kërkuar, sa më lart, në përmbushje edhe të përcaktimeve të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimi e rregullave të prokurimit publik” që kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vendosja e kriterereve të sipërcituar sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës (edhe pa disponimin e kategorive në fjalë), AK nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 20 të LPP për të shmangur çdo kriter apo kërkesë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

**4. Në pikën 10 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues duhet të ketë një numër mesatar prej 180 punonjës për periudhën Nentor 2020 – Janar 2021. Për të vërtetuar këtë pikë, ofertuesi të paraqesë vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ku të jetë specifikuar numri i punonjësve për secilin muaj, konform legjislacionit në fuqi.*

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mëspërme për konfirmimetin me sisteme e menaxhimit të mjedisit; energjisë; sigurisë në trafikun rrugor; cilësisë për saldimin e materialeve metalike; përgjegjësive shoqërore; për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit e sistemet për veshjen e kanaleve nuk përmbushin përcaktimet e pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 që kërkesat të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, si dhe te nenit 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ku parashikohet se: *Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**5. Në pikën 14 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier / specialistë me kontratë pune të lidhur para noterit, për punonjësit si më poshtë:*

- Drejtues Teknik **inxhinier ndërtimi, 2 të punësuar.** Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të **plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.**

- Drejtues Teknik **inxhinier hidroteknik, 2 të punësuar.** Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të **plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.**

- Drejtues Teknik **inxhinier mekanik, 1 të punësuar.** Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të **plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.**

- Drejtues Teknik **inxhinier topograf/gjeodet/markshajder, 1 të punësuar.** Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të **plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.**

- Drejtues Teknik **inxhinier mjedisi, 1 të punësuar.** Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të **plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.**

- Drejtues Teknik **inxhinier Ndërtimi në profilin Gjeoteknikë, 1 të punësuar.** Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të **plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.**

**6. Në pikën 15 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit, të paktën një inxhinier mjedisi, drejtues teknikë, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë për ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor, si dhe të jetë i pajisur me licensë kodi III.2.A (1+2), si dhe të jetë i certifikuar/kualifikuar si përgjegjës për dëmet mjedisore.*

**7. Në pikën 17 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues duhet të ketë të punësuar në shoqëri një inxhinier, të certifikuar si Ekspert privat zjarrëfikës, për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës, certifikata, si dhe të figurojë në listpagesa dhe licensën e shoqërisë.*

**8. Në pikën 19 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues duhet të ketë të punësuar në shoqëri një inxhinier, të certifikuar për dhënien e ndihmës së parë, për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës noteriale, certifikata e ndihmës së parë të lëshuar nga institucionet/organet kompetente, si dhe të figurojë në listpagesa dhe licensën e shoqërisë.*

**9. Në pikën 20 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit dhe të punësuar 1 Mjek, me kontratë individuale pune të lidhur para noterit, i cili të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë.*

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. AK nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. AK duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga AK, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disandryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë qëduhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet esigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet **mjekut** të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të **kontraktuar ngajashtë**, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë OEpjesëmarrës, sidhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Vendosja e këtij kriteri, penalizon/kufizon pjesëmarrjen e OE/BOE, që nuk janë të detyruar për marrjen në punë të mjekut të ndërmarrjes referuar VKM nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" i ndryshuar (pika 12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për atondërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.).

**10. Në pikën 21 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues, duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, minimalisht punonjësit e mëposhtëm:*

Kërkesa për 50 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

Kërkesat për manovrator, shoferë, automakinist, buldozerist, të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë OE për ekzekutimin e kontratës, kërkohen të jenë në pronësiore me qera. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listëpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga OE edhe nëpërmjet kontraktimit.

**Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit**, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se "Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar..." dhe jo "të lidhura para noterit".

Kërkesat nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.:

**11. Në pikën 22 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *“OE ofertues, duhet të jetë i pajisur me licensë kodi III.1.B.*

*Licensë kodi I.2.A për masat e mbrojtjes ndaj zjarrit.*

*Licensë kodi III.1.A(1+2) për vlerësimin e ndkimit në mjedis.*

*Licensë kodi III.2.B për transportin e mbetjeve.*

**12. Në pikën 22 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: *OE ofertues, duhet të ketë të punësuar në shoqëri një inxhinier, të çertifikuar si përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis, për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës, çertifikata, si dhe të figurojë në listpagesa dhe licensën e shoqërisë.*

**Për sa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. H.P., z. S. L., z. E.H. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

**Ndikimi:** Kufizimi ipjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën .

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specififikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. H.P., z. S. L., z. E.H. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërmat (c, ç, d), neni 2 gërmat (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga, H.P., z. S. L. e z. E.H., si dhe titullare e AK, znj. A.D., në cilësinë e miratuesit të tyre.***

**- Zhvillimi i procedurës.**

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave më datë 06.04.2021, kanë formuluar/nënshkruar formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Procesverbali i KVO me datë 06.04.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 (dy) OE/BOE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara.

Procesverbali i KVO më datë 08.04.2021, i hapjes së ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike dhe ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE pjesëmarrëse, njoftimi i klasifikimit është realizuar në SPE më datë 16.04.2021.

Raporti Përmbledhës është hartuar më datë 15.04.2021, nga z. E.S. Kryetar i KVO-së, miratuar më datë 15.04.2021 nga Titullari i AK z. E. M..

Formulari i njoftimit të fituesit më datë 16.04.2021, me nr. 1943/1 prot., datë 04.05.2021 Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.

**Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. BOE “B..B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk,** (me Nipt-e respektive K.; L. dhe K.), me vlerë ekonomike të ofertës: **159,636,487** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh.

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

OE “I.2.” Shpk, (me Nipti: L.), me vlerë ekonomike të ofertës: **160,413,717** (njëqind e gjashtëdhjetë milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh.

Duke iu referuar procedurës së prokurimit më datë **08.04.2021** është shpallur fitues: **BOE “B.. B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk,** me vlerë ekonomike të ofertës: **159,636,487** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh.

Formulari i publikimit njoftimit të fituesit më datë 16.04.2021

Në dosje gjendet Procesverbali i datës 16.03.2021, komisioni përbërë nga z. H.P.dhe z. S. L., ka shoqëruar OE të interesuar në kantier, ti njoh ata me projektin e objektit të prokurimit dhe ti pajis me kopjen e procesverbalit. Procesverbali është nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe përfaqësuesit me autorizim të OE “B..B” Shpk

Kontrata me **BOE “B..B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk,** fitues nr. 1943 prot., datë 26.04.2021. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **191,504,784** (njëqind e nëntëdhjetë e snjëë milion e pesëqindë e katër mijë e shtatëqindë e tetëdhjetë e katër)lekë me Tvsh. (Titullari i AK z. E. M.)

**Lidhur me BOE “B..B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk,** rezulton se BOE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**Titulli i gjetjes 21:** KVO ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “B..B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:**-AK Bashkia Rrogozhinë, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “B. B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, duhet të kishte skualifikuar dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e procedurës së prokurimit pasi asnjë prej OE pjesëmarrës në prokurim nuk plotësonin kushtet e DT. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “B. B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

**OE “B..B” Shpk,** ka paraqitur për:

**I. Kamion dhe kamioçina vetëshkarkues**

**Në pronësi:**

1. Kamion Marka Mercedes Benz; Targa AA467PE; Shasia nr.

**Ka këto mangësi:** Certifikata e transportit nr. 70, datë 02.03.2017, nga Drejtori Rajonale e Shërbimit Rrugor Fier ”Për transport ndërkombëtar mallrash për vete”; Nuk është vetshkarkues (7,490-4,324) 3.2 ton.

2. Kamion Marka MAN; Targa AA835E; Shasia nr. 4370016019

**Ka këto mangësi:** Certifikata e transportit nr. 151, datë 05.07.2017, nga Drejtori Rajonale e Shërbimit Rrugor Fier ”Për transport ndërkombëtar mallrash për vete”; (33,000-14,160) mbi 18 ton.

3. Kamion Marka Mercedes Benz; Targa AA922GA; Shasia nr. ĘDB9523072K844665

**Ka këto mangësi:** Certifikata e transportit nr. 84, datë 29.03.2017, nga Drejtori Rajonale e Shërbimit Rrugor Fier ”Për transport ndërkombëtar mallrash për vete”; (32,000-13,500) mbi 18 ton.

4. Kamion Marka MAN; Targa AA933NF; Shasia nr. ĘMAE5200118L014945

**Ka këto mangësi:** Certifikata e transportit nr. 151, datë 05.07.2017, nga Drejtori Rajonale e Shërbimit Rrugor Fier "Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vete"; (17,800-11,240) mbi 6 ton. (**Është paraqitur edhe për autobumatrice**).

5. Kamion Marka Mercedes Benz; Targa FR3839; Shasia nr. EDB6673021P139335

**Ka këto mangësi:**Nuk është vetshkarkues (4,600-2,380) 2.3 ton.

6. Kamion Marka Daimler Chrysler; Targa FR3839; Shasia nr. EDB9036221R427766

**Ka këto mangësi:**Nuk është vetshkarkues (3,500-2,150) 1.3 ton.

#### **Qera**

**a-**Kontratë qiraje nr. 948 rep., nr. 441 kol., datë 28.07.2020 me PF E. H. Objekt kontrate:

1. Kamion: Marka Man; Targa **AA015ZX**; shasia WMAT46ZZZYM283715. (40,000 – 16,000) mbi 18 Ton.

Certifikata e transportit nr. 01, datë 07.01.2021, nga Bashkia Roskovec "Për transport mallrash brenda vendit për të tretet"; është OK.

**b-**Kontratë qiraje nr. 23 rep., nr. 23 kol., datë 09.01.2021 me PF T.Ç. Objekt kontrate:

1. Kamion: Marka Daimler Chrysler; Targa **AA537LH**; shasia EDB9523141K708222 (40,000 – 15,000) **mbi 18 Ton. Ka këto mangësi:** Nuk ka Certifikatën e transportit.

**f-**Kontratë qiraje nr. 66 rep., nr. 59 kol., datë 14.01.2021 me PF A.I. Objekt kontrate:

1. Kamion: Marka Mercedes Benz; Targa **AA859HR**; shasia nr. WDB67404215282446. (**7,460– 4,480**) **mbi 3 Ton.**

**Ka këto mangësi:** Nuk ka Certifikatën e transportit. (është auto ving)

**i.** Kontratë qiraje nr. 5 rep., nr. 5 kol., datë 4.01.2021 me PF A.N. Objekt kontrate:

1. Kamion: Marka Renault; Targa **FR1391D**; shasia nr. EF633FVC000101103. (**32,000– 13,950**) **mbi 18 Ton.**

**Ka këto mangësi:** Nuk ka Certifikatën e transportit.

Certifikata e kryerjes së operacioneve teknike (tahografi) ka përfunduar më datë 28.12.2020

**L.** Kontratë qiraje nr. 1876 rep., nr. 816 kol., datë 19.12.2020 me PF L.B. Objekt kontrate:

1. Kamion: Marka Fiat; Targa **AA342JK**; shasia ZAF23000005169379. (3,200 – 1,950) mbi 1 Ton.

**Ka këto mangësi:** Nuk është vetëshkartkuese.

2. Kamion: Marka Dailmer Chrysler; Targa **AA537BG**; shasia WDB90662351N316390 (40,000 – 16,000) mbi 18 Ton.

Certifikata e transportit nr. 01, datë 07.01.2021, nga Bashkia Roskovec "Për transport mallrash brenda vendit për të tretet"; është OK.

3. Kamion: Marka Mercedes Benz; Targa **AB476BG**; shasia WDB9061351N301184. (40,000 – 16,000) mbi 18 Ton.

Certifikata e transportit nr. 01, datë 07.01.2021, nga Bashkia Roskovec "Për transport mallrash brenda vendit për të tretet"; është OK.

#### **II.** Autobetoniere:

Autobetoniere Copë 4

#### **B. B**

-Kontratë qiraje nr. 2 rep., nr. 32 kol., datë 04.01.2021 me OE "B." shpk Objekt kontrate:

1. APV -Autobetoniere+ Pompë betoni: Marka Astra; Targa **AA986XD**; shasia ZCNH784402P510364.

**Ka këto mangësi:** Certifikata e transportit datë 21.01.2019, nga NjA Gjocaj, Peqin "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet". Certifikata e kontrollit teknik, ka përfunduar më datë 17 Janar 2021;

2. APV -AutoBetoniere+Pompë betoni: Marka Iveco Magirus; Targa **AA508CR**; shasia WJM4CRS00C110464.

Certifikata e transportit datë 21.01.2019, nga NjA Gjocaj, Peqin "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet". Certifikata e kontrollit teknik ka përfunduar më datë 17 Janar 2021; Taksat vjertore kanë përfunduar më datë 17 Janar 2021;

3. APV -Autobetoniere+Pompë betoni: Marka Iveco Magirus; Targa **PE2609A**; Shasia WJM4CSS00C152274;



Certifikata e transportit datë 21.01.2019, nga NjA Gjocaj, Peqin "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet": Certifikatën e kontrollit teknik ka përfunduar më datë 17 Janar 2021;

4. APV -AutoBetoniere: Marka Dailmer; Targa **PE2610A**: shasia WDB9533141K571854;

Certifikata e transportit datë 21.01.2019, nga NjA Gjocaj, Peqin "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet"; Certifikate e kontrollit teknik, ka përfunduar më datë 17 Janar 2021;

**5. Kamion**; Marka Iveco Fiat; Targa **AA025ZT**: shasia WJM4CTS40C211591:

Certifikatën e kontrollit teknik ka përfunduar më datë 30 Janar 2021

:Mungon: Polica e sigurimit të mjeteve, Nuk ka Taksat vjertore; Nuk ka Certifikatë transportit

**6. Kamion**; Marka Iveco Magirus; Targa **AA985XD**: shasia WJM4CSS20C166316;

Certifikata e transportit datë 21.01.2019, nga NjA Gjocaj, Peqin "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet": Certifikatën e kontrollit teknik ka përfunduar më datë 17 Janar 2021 Mungon:

7. Tërheqës; Marka Scania: Targa **AA037ZT**; Shasia XLER4X20005261799; Certifikata e transportit datë 21.01.2019, nga NjA Gjocaj, Peqin "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet":

Nuk ka Certifikatë transportit; Certifikatën e kontrollit teknik ka përfunduar më datë 30 Janar 2021:

Mungon: Polica e sigurimit të mjeteve.

8. Gjysëm rimorkio Marka: ZORZI Targa **AHR028**; Shasia ZAX37S075PR014356 Certifikatën e kontrollit teknik ka përfunduar më datë 30 Janar 2021.

Leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjeteve, certifikatë për transport dhe foto të mjeteve ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit.

### **III. Për Autobot uji**

**a.** -Kontratë qiraje nr. 956 rep., nr. 448 kol., datë 29.07.2020 me PF Xh.F.. Objekt kontrate:

1. APV - Autobot uji: Marka Mercedes Benz; Targa **AA627UE**: shasia WDB6743181K250305.

**Ka këto mangësi:** Certifikata me nr. 084, datë 24.08.2020 "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet" nga Bashkia Fier.

**b**-Kontratë qiraje nr. 810 rep., nr. 272 kol., datë 09.04.2019 me PF N.LI.. Objekt kontrate

1. APV - Autobot uji: Marka Volv; Targa **AA668DN**: shasia YBIE5AIA0SB140627**Ka këto mangësi:** Certifikata me nr. 058, datë 05.06.2020 "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet" Lëshuar nga Bashkia Fier.

### **IV. Autobot prajmeri**

#### **B. B**

**a**-Kontratë qiraje nr. 518 rep., nr. 251 kol., datë 31.03.2021 me OE "I.S.P.P" Shpk Objekt kontrate:

1. APV -Autobitumatriçe prajmeri: Marka Mercedes Benz; Targa **LU3021C**:**Ka këto mangësi:** Nuk Ka Certifikata e transportit

**b**-Kontratë qiraje nr. 1014 rep., nr. 470 kol., datë 03.08.2020 me OE "A.L.F." Shpk Objekt kontrate:

1. APV -Bot naftë, bitumi & prajmeri: Marka MAN; Targa **AA486SK**: shasia WMAL332540G113231.

**Ka këto mangësi:** Certifikata me nr. 17, datë 27.02.2018 "Për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit" për përdorim të OE "A." Shpk.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga Titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues **BOE "B..B" Shpk & "P.V." Shpk & "D.C." Shpk**. Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*AK nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*".

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. E.S., z. A.M. e z. F.M..

**Ndikimi:** Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **159,636,487 lekë pa Tvsh**.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues BOE “B. B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **159,636,487 lekë pa Tvsh.**

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i BOE “B..B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DT. KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të, z. E.S., z. A.M. e z. F.M. si dhe titullarin e AK z. E. M..

Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, është kualifikimi **BOE “B..B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk**, në kushtet kur duhej anuluar dhe AK të zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **159,636,487 lekë pa TVSH**, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK, anëtarët e NJHDT dhe KVO.

### **Procedurat e prokurimit blerje të vogla për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022**

Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, dhe Udhëzimin e ndryshuar me nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

-Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2020 janë zhvilluar 22 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit pa tvshpër vlerën prej 16,566 mijëlekë, dhe vlerën e kontratës prej 8,172 mijë lekë (49% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 8,393 mijëlekë, nga ku 39 prej këtyre procedurave me fond limit 16,938,830 lekë janë mbi 100,000 lekë deri në 800,000 lekë.

-Për vitin 2021, sipas regjistrave të realizimit, janë zhvilluar 16 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 10,747 mijë lekë, dhe vlerën e kontratës 8,580 mijë lekë (79.8% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 2,167 mijë lekë.

-Për vitin 2022, sipas regjistrave të realizimit, janë zhvilluar 23 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 20,076 mijë lekë, dhe vlerën e kontratës 15,124 mijë lekë (75% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 4,861 mijë lekë.

- Për vitin 2020, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. H.M. me nr. 399, datë 09.01.2020 me përbërje si vijon:
  1. Z. J.M. – Kryetar
  2. Z. F.M. – Anëtar
  3. Z. S.B. – Anëtar
- Për vitin 2021, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. E. M. me nr. 20, datë 20.01.2021 me përbërje si vijon:
  - 1 Z. J.M. – Kryetar
  - 2 Z. O.D. – Anëtar
  - 3 Z. G.Gj. – Anëtari zëvendësuar me komisionin e ngritur me urdhër nr. 53, datë 01.03.2021 si vijon:
  - 1 Z. E.S. – Kryetar
  - 2 Z. F.M. – Anëtar
  - 3 Z. A.M. - Anëtar
- Për vitin 2022, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. E.M. me nr. 45, datë 26.01.2022 me përbërje si vijon:
  - 1 Z. R. V. – Kryetar

- 2 Z. O.D. – Anëtar
- 3 Z. A.P. – Anëtar  
i zëvendësuar me komisionin e ngritur me urdhër nr. 412, datë 14.11.2022 si vijon
- 1 Z. O.D. – Kryetar
- 2 Z. O. T. – Anëtar
3. Z. M.M. - Anëtar

**Titulli i gjetjes 22:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për procedurat e blerjeve të vogla.

**Situata:** 1. Në të gjitha procedurat e prokurimit për blerjet e vogla të testuara për vitet 2020 – 2022, mungojnë urdhrat e titullarit për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit.

2. Në të gjitha procedurat e testuara, personat që kanë hartuar fondin limit, nuk kanë argumentuar hartimin e këtij fondi, duke mos ju përmbajtur përcaktimin të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me nenin 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimit përkatës për blerjet e vogla.

3. Në mënyrë të përhapur, Komisioni për Blerjet e Vogla, nuk ka dokumentuar me procesverbal tërheqjen ose mos paraqitjen e operatorëve ekonomikë dhe kalimi tek OE të renditur pas tyre, sipas përcaktimit të pikës 18 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerës të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

4. Në disa raste kemi mungesë të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë me të cilët është lidhur kontrata. Dokumentet që mungojnë janë ato të kërkuara në ftesën për ofertë që u bëhet operatorëve ekonomikë.

5. Në 1 procedurë me objekt blerje mallrash, rezulton se natyra e produkteve nuk është e njëjtë ose e ngjashme (produkte ushqimore/ aparat tensioni), dhe si e tillë duhet të bëheshin procedura të ndryshme.

6. Në procedurat e vitit 2020, në mënyrë të përhapur mungon fletë hyrja e mallit të bërë në magazinë, duke mos u dokumentuar marrja e mallrave në dorëzim, veprim në kundërshtim me pikën 37 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili përcakton se *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).*

7. Në disa nga procedurat e audituara për vitin 2022, rezulton se në urdhrin e prokurimit është vendosur vlera e fondit limit, ndërkohë sipas pikës 8 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerës të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” përcaktohet qarte se *Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin konkret.*

8. Për vitin 2022, në 3 raste është konstatuar copëzim fondesh, pasi procedurat janë të natyrës së njëjtë/ ngjashme, dhe si të tilla nuk duheshin copëzuar në dy apo më shumë procedura, por të mbahej një procedurë prokurimi sipas vlerës së përllogaritur të fondit limit.

9. Në 11 raste të testuara, rezulton se likuidimi i faturave të lëshuara nga operatorët ekonomikë, është kryer përtej afatit 30 ditë, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullores së prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56, 59; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullores së prokurimit publik” i ndryshuar, neni 73, 76; Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerës të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 8, 18; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 37; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 52.

**Shkaku:** Mungesa e trajnimeve të duhura për komisionet e ngarkuara për blerjet e vogla. Angazhime pa pasur fondet në dispozicion,, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e KBV.*

**Ndikimi:** Ndikon në numrin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim 1:** Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me urdhrat përkatës për përlogaritjen e fondit limit. Komisionet përkatëse ose personat e ngarkuar, të evidentojnë me procesverbalin përkatës për çdo procedurë përlogaritjen e këtij fondi, duke evidentuar edhe mënyrën e ndjekur sipas rregullave të prokurimit publik.

**Rekomandim 2:** Komisioni për Blerjet e Vogla, të dokumentojë me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë. Të administrohen dokumentet e OE me të cilët lidhet kontrata, dhe në çdo rast të shoqërohet me fletë hyrjen e mallit në magazinë, të firmosur nga personi përgjegjës.

**Rekomandim 3:** Të evitohet copëzimi i fondeve nga AK. Procedurat për mallra/ shërbime me objekt të njëjtë ose të ngjashëm të kryhen nëpërmjet procedurave në përputhje me vlerën e fondit përkatës kur ajo e kalon vlerën 1,000,000 lekë, dhe jo të copëzohet në disa të tilla.

**Rekomandim 4:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditore.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për Blerjet e Vogla.*

## 2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

### 1. “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë.

#### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020 të lidhur mes AK Bashkia Rrogozhinë, të përfaqësuar nga Titullari Znj. A.D. dhe BOE “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, me përfaqësues z. Sh.D. me licencë profesionale NZ. 5433/16, datë 06.08.2019. Vlera e kontratës është 109,882,38 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 24 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1961/1 prot., datë 15.04.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “A.S.” Shpk me përfaqësues Znj. A.N., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2692/2, datë 14.05.2020, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 916.798,80 lekë me Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr., datë është lidhur kontrata e dhurimit (nuk gjendet në dosjen e zbatimit) përkatëse e këtij shërbimi me OE “H.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 2018/20, datë 18.06.2021 përfaqësuar nga z. F. B. dhe me vlerë të kontratës së dhurimit 0 lekë .

#### Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga OE “A.S.” Shpk në vitin 2017.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 07.05.2020 dhe kanë përfunduar me date 07.01.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 07.05.2020, sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Punimet kanë përfunduar më datë 07.01/2021, nuk janë marrë në dorëzim paraprak. Garancia e punimeve është 24 Muaj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë.</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr.2283 Prot. date 07/05/2020	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 109.882.338 lekë me Tvsh BOE B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk	<b>16. Likuiduar</b> 101,919,380 Lekë me tvsh.
<b>17- Situacioni Përfundimtar dtatë</b> <b>-Vlera me tvsh 107,283,558 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 89,402,965 lekë</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 4 muaj, Zbatuar 8 muaj. Fillim i punimeve: 07/05/2020 Përfundim i punimeve : 07/01/2021	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendamentin Nr.1, datë 07/09/2021.

<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> “A.S.” Shpk	Licenca Nr: MK.2692/2, dt 14.05.2020	Kontrata nr. 1961/1 prot., datë 15.04.2020	Vlera e Kontratës 916.798,8 lekë me Tvsh	Likujduar (me Tvsh) lekë
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “H.” Shpk	Licenca MK 2018/20,	Kontrata	Vlera e Kontratës (me Tvsh)	Likujduar (me Tvsh)
<b>22. Akt Kolaudimi datë 28.06.2021</b>	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim datë</b>			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga AK, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **93,600 lekë pa Tvsh**.

**Titulli i Gjetjes 23:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, nga zbatuesi i punimeve BOE fitues “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, për zërat e punimeve “Punime shtresash për trupin e rrugës”, “Punime KUB” e “Punime elektrike” dhe “Punime për sinjalistikë”.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve: “F.V. Shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm”, “F.V. Krah shtylle KRH-MSI 1500/1500/10”, “Ndriçues Led 94Ë”, “F.V. Morseteri shtylle 3P=sig, 16A+Kapak”, “F.V. Elektroda tokëzimi”, “F.V. Puseta tokëzimi 40x40x40, kapak të fortë RIC1084+1064”, “F.V. Tabela rrugore rëndësishme D=90cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr.2283 prot, datë 07.05.2020.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1961/1 prot., datë 15.04.020.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Rrogozhinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **20,179,800** lekë pa Tvsh nga BOE fitues “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2283 prot datë 07.05.2020 me objekt: “Rikonstruksion i rrugës të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Vlera prej 93,600 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Znj. A.N. me detyrë mbikëqyrësi i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. F.B. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara

**2. “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia Rrogozhinë.**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021 të lidhur mes AK Bashkia Rrogozhinë, të përfaqësuar nga Titullari Z.E. M. dhe BOE “B.” Shpk, & “Sh.” Shpk, me përfaqësues Z. A.L. me licencë profesionale NZ. 7274. datë 22.12.2020. Vlera e kontratës është 43.585.255 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 12 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2070/1 prot., datë 26.05.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “A.M.” Shpk me përfaqësues z. E.M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2892/5, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 774.665 lekë me Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me datë 07.01.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “D.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 1676/11, përfqësuar nga z. V.T. dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 59.580 lekë me Tvsh.

#### Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga OE “A.S.” vitin 2021.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 14.07.2021 dhe kanë përfunduar me datë 10.01.2022, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 14.07.2021, sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Punimet kanë përfunduar më datë 10.01.2022, janë marrë në dorëzim paraprak më datë 28.01.2022. Garancia e punimeve është 12 Muaj.

<b>2. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë”, Bashkia Rrogozhinë.</b>				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> nr. 1521/2 prot., datë 26. 05 2021	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh) 43.585.255 lekë me Tvsh</b> BOE fitues “B.” Shpk, & “Sh.” shpk		<b>16. Likuiduar lekë lekë</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar dtatë</b> <b>-Vlera me tvsh 43.585.255lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 41.405.992 lekë</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 6 muaj. Fillimi punimeve: 14.07.2021 Përfundimi punimeve: 10.01.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> “A.” Shpk	Licenca Nr: MK. 2892/5	Kontrata nr. 2070/1 prot., datë 26.05.2021	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 774.664 lekë me Tvsh	Likuiduar (me Tvsh) leke
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Emri Mbiemri: “D.” shpk	Licenca Nr: MK 1676/11	Kontrata nr. prot., datë xx.xx.20xx	Vlera e Kontratës 59.580 lekë (me Tvsh)	Likuiduar (me Tvsh)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 12.01.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 28.01.2022			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga AK, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **694,583.20 lekë pa Tvsh.**

**Titulli i Gjetjes 24:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë”, Bashkia Rrogozhinë, për zërat e punimeve “Punime dyer dritare”, “Punime Tarace” e “Tokëzimi”

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve “F V dritare d/alumini plastike me dopio xham”, “F V Vetratë d/alumini plastike me dopio xham”, “Ulluk shkarkimi vertikal me baker Ø 120”,

F.V Elektroda tokëzimi të xinguar 50x3mm, L=150cm”, “Përcjellës tokëzimi bakri, Cu, S=50mm<sup>2</sup> i zhveshur”, “Kapikorta bakri 1x50mm<sup>2</sup>”, “F.V Pusetë elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm”, “Përcjellës shiriti zinku tokëzimi, Zn =30x3mm”, “Shtizë rrufepritëse në çati L=38 D=166mm së bashku me aksesoret e fiksimit”, “Fiksues të zinkuar shirit-shirit 30x3mm” e “Gërmim e mbushje dhe me krah për kanale kategoria IV, h=1.5 m”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2283 prot, datë 07.05.2020.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1961/1 prot., datë 15.04.2020.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Rrogozhinë.

**Shkak:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 694,583.20 lekë pa Tvsh nga BOE fitues “B.” Shpk, & “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2283 prot datë 07.05.2020 me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

*Vlera prej 694,583.20 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë.*

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

1. Z. E.M. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V.T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

## 2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

**Titulli i Gjetjes 25:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me kuadrin rregullator.

### 1. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 59** në emër të zhvilluesit B.T., me datë aplikimi 29.12.2019, për objektin: “Shtesë kati 1-Kat mbi objektin ekzistues, gjithsej 2 Kat”.

**Situata:** a. Sipas dokumentacionit të paraqitur, zhvilluesi disponon një objekt 1 kat me sipërfaqe 147.5 m<sup>2</sup>, dhe ka aplikuar për shtesë kati me të njëjtën sipërfaqe mbi katin e parë, pra për 147.5 m<sup>2</sup> Kati i dytë.

- Në kushtet e një ndërtimi të ri, subjekti duhet të ishte pajisur me leje zhvillimi përpara se të aplikonte për leje ndërtimi, të cilën rezulton se nuk e disponon në dokumentacionin e paraqitur në *e-leje*. Sipas audituesve, nuk jemi në kushtet e përcaktuara në pikën 5 të nenit 9 “Leja e zhvillimit” të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, e cila përcakton rastet përjashtimore kur nuk kërkohet leja e zhvillimit gjatë aplikimit për leje ndërtimi.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni administruar në KLSH me nr. 203/11 prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** 1. Lidhur me pikën 1, sqarohet se sipas VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 9 pika 6, citohet se leja e zhvillimit nuk është e domosdoshme për pajisjen me leje ndërtimi për punimet, sipas shkronjave (b), (c) dhe (ç) të përcaktuara në nenin 11. Sipas nenit 11, citohet se për punimet që rezultojnë në rikonstruksion, riparim dhe restaurim që çojnë në krijimin e një strukture tërësisht ose pjesërisht të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe që kanë si pasojë shtimin e njësisë....

*Nga sa citohet në këto dy nene, nënkuptohet se leja e zhvillimit nuk është e domosdoshme për ti paraprirë lejes së ndërtimit.*

*2.Lidhur me pikën 2 për mungesën e raportit dhe certifikatës sëperformancës sipas përcaktimit të ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” sqarohet se në zbatim të këtij ligji, është miratuar VKM nr. 958, datë 02.12.2020 “Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit tëperformancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes së kushteve të regjistrimit të certifikatës sëperformancës së energjisë së ndërtesave, që nënkupton se ligji ka hyrë në zbatim, vetëm pasi është publikuar vendimi nr. 958 në fletore zyrtare.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Lidhur me pikën 1, pretendimi nuk pranohet, pasi referuar dispozitës së cituar nga ana juaj, nenit 11 të VKM-së përcaktohen termat rikonstruksion, riparim dhe restaurim, ndërkohë referuar objektit të lejes së miratuar, bëhet fjalë për ndërtim të ri dhe jo restaurim, riparim apo rikonstruksion. Duke qenë se zhvillimi për katin e dytë të objektit është totalisht i ri, duhet të kërkohej leja e zhvillimit si pjesë e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit.

-Lidhur me pikën 2, pranohet pretendimi juaj, pasi argumentoni ligjërisht se VKM që rregullon zbatimin e ligjit 116/2016, është miratuar me datë 02.12.2020, datë e mëvonshme me atë të lejes së miratuar.

## **2. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 2748** në emër të zhvilluesit K.T., me datë aplikimi 30.05.2020, për objektin: *“Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”*.

**Situata: a.** Polica e sigurimit e inxhinierit Arkitekt Konstruktor Instalimesh Teknike, A. Gj., është jashtë afati të vlefshmërisë nga data 17 Prill 2019. Gjithashtu edhe polica e sigurimit e inxhinierit A. U. është jashtë afatit të vlefshmërisë nga data 30 Qershor 2018, në kundërshtim me pikën 1 germa g të VKM-së 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

b.Mungon Relacioni i MNZ-së.

## **3. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 4630** në emër të zhvilluesit A. F., me datë aplikimi 30.05.2020, për objektin: *“Magazinë për përpunimin dhe ruajtjen bujqësore”*.

**Situata: a.**Sipas kartelave të pasurisë, konkretisht pasurisë së marrë me kontratë qiraje nga shtetasi A. Sh. me nr. pasurie 73/4 në ZK 2140, dhe pasurisë me nr. 73/5 ZK 2140 në emër të subjektit A. F. shpk, rezultojnë sipas llojit të pasurisë **Arë**. Tipologjia e ndërtimit përfshihet në kategorinë e zonave bujqësore B1, e cila sipas nenit 83 “Kategoritë e zonave bujqësore” të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Rrogozhinë të miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.10.2017 të KKT, përcaktohet se: *B1 – Aktivitetet ekonomike bujqësore. Këto zona përfshijnë ambiente të përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale, magazina bujqësore, stalla dhe funksione të ngjashme...*

- Sipas pikës 4 të nenit 14 të ligjit 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, përcaktohet se *Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.*

Sipas preventivit të punimeve, rezultojnë zëra që përfshijnë punime betoni dhe beton arme, punime të cilat kanë natyrë të përhershme, ndërkohë sipas dispozitës së cituar më sipër, për tipologjinë e ndërtimit kërkohej që materialet e ndërtimit të jenë të përkohshme. Në këto kushte leja duhet të ishte refuzuar ose të kërkohejshin ndryshime në projektin dhe preventivin e punimeve.

Gjithashtu, sipas pikës 3.2 të Vendimit për VNM me nr. **AN260320200004** datë 26.05.2020, përcaktohet se *Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bëjë ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi, ndryshim i cili nuk rezulton të jetë bërë.*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni administruar në KLSH me nr. 203/11 prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Praktika e sipërcituar është aplikuar bazuar në vendimin e KKT-së nr. 12, datë 27.09.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urbane (UB) Bujqësor (B) dhe Natyrore (N).*



*Ky vendim lejon që në çdo njësi strukturore me kod zhvillimor B1, B2, B3 dhe B4 të ndërtohet objekte në funksion të bujqësisë duke marrë fillimisht konformitetin e institucioneve përkatëse.*

*Referuar korrespondencës elektronike të kryer me institucionin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në shkresën e ardhur nga ana me nr. 713 prot., datë 10.09.2020, janë shprehur rreth dakordësisë për përputhshmërinë e projekt propozimit me zhvillues A. F. shpk për leje ndërtimi.*

*-Gjithashtu, sqarohet se për shkak të tejkalimit të afatit 1 vjeçar për fillimin e punimeve, konsiderohet si praktikë e pazbatueshme dhe objekti i kësaj leje nuk mund të konkretizohet në terren.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacioni juaj nuk pranohet, pasi referuar edhe Vendimit të KKT-së nr. 12, datë 27.12.2019, pika 2 përcaktohet se *Ndërtimi i objekteve dhe strukturave sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të respektojë legjislacionin në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj., sipas territorit specifik.* Konkretisht, në miratimin e kësaj lejeje ndërtimi, nuk është respektuar pika 4 e nenit 14 të ligjit 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, e cila përcakton se *Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.* Objekti konkret ka materiale të cilat janë të përhershme.

-Lidhur me faktin se punimet nuk kanë filluar brenda afatit 1 vjeçar të miratimit të lejes dhe pavarësisht se nuk janë prodhuar pasojat në terren për ndërtim në tokë bujqësore pa kryer konvertimin, duhet të merret në konsideratë në rastet në vijim ku miratimi i lejeve në tokat bujqësore, të respektojë legjislacionin sektorial përkatës.

#### **4. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 1877** në emër të zhvilluesit H. I., me datë aplikimi 22.03.2020, për objektin: *“Banesë 1 Kat me çati në pronën e tij, H. I, S.”.*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni administruar në KLSH me nr. 203/11prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:***Problematika që lidhet me raportin e auditimit të efikasitetit energjetik dhe certifikata e performancës, është e njëjtë me atë të trajtuar më sipër për lejen sipas regjistrimit me nr. 39, pretendimet të cilat janë pranuar dhe për ekonomicitet trajtimi konsiderohet e pranuar.*

#### **5. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 2748** në emër të zhvilluesit E. L., me datë aplikimi 30.05.2020, për objektin: *“Banesë 2 Kat”.*

**Situata:** a. Sipas treguesve të zhvillimit të paraqitur në planvendosje, si dhe certifikatën e pronësisë, përcaktohet se në numrin e pasurisë 92/33 ZK 2538 me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup> e llojit truall, nga kjo janë 222.66m<sup>2</sup> ndërtesë, e cila specifikohet se do priset për të vijuar me ndërtimin e ri. Në preventivin e paraqitur, mungojnë zërat që lidhen me prishjen e këtij ndërtimit të parashikuar për tu prishur, si dhe zërat e transportit, çka ka sjellë vlerë më të ulët të preventivit, dhe si rrjedhojë edhe shmangie të TNI-së e cila përlllogaritet mbi vlerën e preventivit. Punonjësit e ngarkuar për mbarëvajtjen e procesit për miratimin e lejeve të ndërtimit, duhej të kërkonin nga zhvilluesi, të përcaktonin saktë zërat e preventivit sipas projektit, relacionit dhe treguesve tjerë të ngarkuar në sistem.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni administruar në KLSH me nr. 203/11prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:***Lidhur me pikën 1 për Mungesën e Raportit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës (CPE), situata është e njëjtë dhe e trajtuar më sipër, dhe konsiderohet e pranuar.*

*2.Në lidhje me zërat e prishjes në preventivin e ngarkuar në sistem përgjatë marrjes së lejes, ju sqarojmë se kjo praktikë nuk ka përfunduar akoma dhe nuk është nxjerrë certifikata e përdorimit. Nga Drejtoria e Politikave Urbane, në momentin që subjekti zhvillues me investitorin do të paraqitet për tu pajisur me certifikatë përdorimi, do t'i kërkohet edhe preventivi i zërave në mënyrë që mbi të të përlllogarisim vlerën e taksës së papaguar.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

2.Lidhur me pikën 2, pranohet pjesërisht pretendimi juaj, por është detyrim i punonjësve të urbanistikës përlllogaritja e zërave të preventivit përpara miratimit të lejes, për të përcaktuar nëse zërat e punimeve janë në përputhje me projektin e paraqitur, kjo për të shmangur detyrimin e TNI-së që vjen nga përlllogaritja më e ulët e preventivit.


## 6. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 1535** në emër të zhvilluesit M. H., me datë aplikimi 19.03.2021, për objektin: “*Strukturë turistike 5 Kat mbi tokë + bodrum*”.

**Situata: a.** Nuk është bërë e saktë përlllogaritja e sipërfaqes totale të objektit, pasi në këtë përlllogaritje mungojnë sipërfaqet e ballkoneve për secilit kat. Konkretisht, sipas planimetrisë sipërfaqe totale e katit është llogaritur 326 m<sup>2</sup>, ndërkohë rezulton se sipërfaqe e ballkoneve, të cilat janë mesatarisht 1.2 m të dala + gjatësi totale e objektit 32.24 m, rezulton se sipërfaqe e pallogaritur për çdo kat është 38.7 m<sup>2</sup> x 5 kate = 193.5 m<sup>2</sup>.

b. Sipas verifikimit në google earth, në jug të pronës ndodhet një objekt i cili nga matjet e bëra rezulton me sipërfaqe rreth 330 m<sup>2</sup>.

*Pamje e objektit sipas GoogleEarth, imazh që mban datën 8/3/2020 që është datë përpara aplikimit për lejen e ndërtimit.*



- Së pari, rezulton se ky objekt nuk është paraqitur në planvendosje, duke bërë që të mos respektohet distanca ndërmjet 2 objekteve.

- Së dyti, mos llogaritja e sipërfaqes së këtij objekti në jug të pronës prej 330 m<sup>2</sup> + sipërfaqe e parcelës e zënë nga gjurma e objektit për të cilin aplikohet për leje prej 326 m<sup>2</sup> + 38.7 m<sup>2</sup> sipërfaqe e pallogaritur e ballkoneve, bëjnë në total 694.7 m<sup>2</sup> sipërfaqe e zënë me objekt mbi truallin prej 1036 m<sup>2</sup>. Kjo ka bërë që të mos respektohet koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim, i cili sipas rregullores së Planit të Detajuar Vendor për Njësinë Strukturore A41-01 të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 20.01.2021, është 40%, ndërsa nga përlllogaritja e shfrytëzimit të territorit për sipërfaqen 694.7 m<sup>2</sup> të cituar më sipër, rezulton se KSHT është 67% duke shkelur parametrat e pasaportës teknike të kësaj njësie strukturore dhe nenit 39 të VKM-

së 408 të cituar më sipër.

- Së treti, nga përlllogaritja e gabuar e sipërfaqes totale të ndërtimit + objekti në jug të pronës i cili është rreth 330 m<sup>2</sup> ka bërë që edhe intensiteti i ndërtimit të tejkalohet, pasi raporti i sipërfaqes totale të ndërtimit mbi këtë pronë është më shumë se sa 2% që përcakton PDV e kësaj njësie strukturore. Konkretisht sipërfaqe totale e ndërtimit mbi këtë parcelë është 2153.5 m<sup>2</sup> / 1036 m<sup>2</sup> = 2.08, pra ka një tejkalim të intensitetit.

c. Plani i Rilevimit Topografik nuk është i saktë, pasi nuk janë pasqyruar objektet sipas faktit në jug të pronës.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni administruar në KLSH me nr. 203/11prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Lidhur me pikën 1 sqarohet se faqja kallkan në fasadën veriore është pasqyruar në planimetrinë e ringarkuar në sistemin elektronik (Projekti arkitektonik) me datë 23.06.2021. Dmth faqja veriore është e gjitha mure pa çarje dhe nuk përbën domosdoshmëri shënimi i saj në planvendosje.

2. Në lidhje me pikën 2, sqarohet se fasada perëndimore referuar projektit arkitektonik dhe planvendosjes është 6.1 deri 6.8 metër nga kufiri i pronës. Kufiri i pronës në këtë rast është njëkohësisht edhe kufiri me rrugën. Referuar VKM-sënr 408, neni 36 pika 2 citohet se Distanca e lejuara të ndërtimit në raport me trupin e rrugës, përcaktohen nga autoritet përkatëse të planifikimit në PPV ose PDV duke marrë në konsideratë nevojat e e zgjerimit të

infrastrukturës rrugore, në përpjesëtim me zhvillimit e reja. Duke qenë se në zonën ku është dhënë leja e ndërtimit i është nënshkruar PDV, atëherë distancat e objektit me kufirin e rrugës apo vijën e ndërtimit përcaktohet në PDV.

3.Lidhur me pikën 3, sqarohet se do të saktësohen sipërfaqet e ballkoneve dhe do t'i mbahet taksa e ndikimit nëinfrastrukturë për pjesët e papërfshira në faturën e mbajtur në lejen e ndërtimit. Kjo do të kryhet përpara se investitori të aplikoj për pajisje me certifikatë përdorimi.

4.Lidhur me objektin që shfaqet në imazhin e google earth në jug të pronës, sqarohet se kjo strukturë është e çmontueshme (Dru+metalike), është e pacertifikuar dhe nuk pasqyrohet në certifikatën e pronësisë. Në këto rrethana përllogaritja e KSHT dhe Intensiteti nuk kryhet duke përfshirë volumin e objekteve të pacertifikuara për të tepër kur ato janë të çmontueshme.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet pika 1 e observacionit që lidhet me faqen kallkan në fasadën veriore dhe pika 2 për distancat në anën perëndimore, pasi argumentoni dhe provoni qëndrimin tuaj.

2.Lidhur me pikën 3, nuk pranohet pretendimi juaj, pasi rezultoni ashtu siç pranohet edhe nga ana juaj, se nuk janë përllogaritur sipërfaqet e ballkoneve si sipërfaqe totale e objektit, të cilat mund të ndikojnë jo vetëm në përllogaritjen e TNI-së, por edhe në KSHT dhe intensitetin e ndërtimeve.

3.Nuk pranohet pika 4 e observacionit. Punonjësit sqarojnë se objekti në jug të pronës është i çmontueshëm dhe nuk mund të ndikojë në parametrat teknik, por bashkëlidhur përgjatë aplikimit të lejes, nuk ka asnjë relacion të mbajtur nga punonjësit ku të përcaktohet situata e këtij objekti i cili dukshëm sipas fotove të paraqitura, ndikon në parametrat teknik duke ndikuar në intensitet dhe KSHT të ndërtimit.

### **7. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 4793** në emër të zhvilluesit R. K., me datë aplikimi 11.10.2021, për objektin: “Objekt banimi 1 Kat dhe 5 Kate dhe 1 Kat nëntokë, me funksion banimi dhe shërbimi, Spille “Bashkia Rrogozhinë”.

**Situata:** a.Nuk respektohen distancat me objektin 3 kat në anën perëndimore. Distanca e paraqitur është 5.3 m, ndërkohë duhet të jetë 10 m, sipas pikës 2 të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

b.Rilevimi topografik nuk reflektohet në planvendosjen e miratuar, duke mos evidentuar situatën reale të objekteve me të cilat kufizohet. Në foto të marrë nga ASIG për njësinë strukturore A41-04, pasqyrohen edhe disa objekte tjera të cilat nuk janë pasqyruar në planvendosje.

c.Nuk respektohet distanca me pronën në anën perëndimore, pasi përllogaritja e distancës nuk është bërë nga ballkoni por nga fasada e pallatit, në kundërshtim me nenin 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

d.Nuk është bërë e saktë përllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Rezultoni se sipas përllogaritjes së zyrës së financës, R. K. duhet të paguaj 2,218,038 lekë, përllogaritje e cila është bazuar në sipërfaqen totale të ndërtimit prej 2302.9 m<sup>2</sup> x 32105 lekë çmimi mesatar sipas Entit Kombëtar të Banesave x 3% TNI e përcaktuar në paketën fiskale = 2,218,038 lekë, ndërkohë në preventivin e paraqitur, vlera e investimit është 88,804,724 lekë x 3% = 2,664,141 lekë. Në mënyrë të paargumentuar, është ngarkuar një preventiv tjetër me vlerë me të vogël, e cila dukshëm ka ulur zërat e punimeve, ndërkohë nuk është reflektuar me ndryshime të projektit. Krahas uljes së volumeve të përcaktuara në preventivin fillestar, mungojnë edhe zëra të tjerë që duhet të parashikoheshin në preventiv si p.sh, parashikohet prishje e objektit 1 kat, zë i cili nuk është parashikuar, mungojnë zërat e transportit. Njëkohësisht, në preventiv është parashikuar që fasada lindore e objektit të jetë edhe me tulla xhami, fakt i cili nuk është parashikuar në preventiv. Sa më sipër, vendimmarrja e strukturave të ngarkuara për miratimin e lejes nuk ka evidentuar apo argumentuar mangësitë e mësipërme, duke miratuar lejen në kundërshtim me legjislacionin përkatës, si dhe duke shmangur minimalisht detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 446,103 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni administruar në KLSH me nr. 203/11prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**Lidhur me pikën 1 sqarohet se referuar pikës 4 të nenit 3 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015... përcaktohet se “Në rast se zhvillimi i propozuar përballet me struktura ekzistuese, të ndërtuar

tërësisht apo pjesërisht pa leje ndërtimi apo në shkelje të kushteve të lejes së miratuar nga autoriteti vendor i zhvillimit, propozimi për zhvillim përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat me pjesën informale. Në këto raste struktura e re e propozuar përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat me pjesën informale. Në këtë rast, struktura e re e propozuar do të respektojë distancat vetëm me lejen e miratuar në rastet kur përballet me situatë të formuar, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni apo me kufirin e pronës në rastet kur përballet me objekte të ndërtuara tërësisht pa leje...

Objekti 3 kat nuk është pajisur me leje ndërtimit nga Drejtoria e Politikave Urbane ku për pasojë nuk është detyrim respektimi i distancave.

2.Lidhur me pikën 3, sqarohet se referuar projektit arkitektonik të ringarkuar në sistemin elektronik, fasada lindore e objektit është e gjitha kallkan dhe pa çarje. Në këtë fasadë, nuk ka tulla xhami apo ndonjë lloj materiali përtej murit të plotë. Ritheksohet se në fasadën lindore nuk ka çarje murale apo dritare, përkundrazi kemi të bëjmë vetëm me elementë arkitektonik dekorativ.

3.Në lidhje me përlllogaritjen e TNI, nga ana e drejtorisë sqarohet se është bërë një lapsus i cili do korrigjohet në momentin kur subjekti apo sipërmarrësi të paraqitet për të deklaruar njoftimin e fillimit të punimeve. Duke qenë se kemi të bëjmë me një leje e cila nuk ka filluar zbatimin e saj, zyra e urbanistikës do të korrigjojë në hapin e parë të procedurës vijuese.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Lidhur me pikën 1 pretendimi nuk qëndron. Nuk përcaktohet në asnjë dokument se objekti është i pa ligjshëm. Fakti se nuk ka leje nga Bashkia Rrogozhinë për këtë objekt, kjo nuk nënkupton se objekti nuk disponon dokumentacion ligjor, dhe të mos i respektohet të drejtat që përcakton legjislacioni për respektimin e distancave minimale të lejuara. Siç citohet, nuk ka asnjë relacion të mbajtur dhe paraqitur në sistem, ku të përcaktohet se objekti është pa leje apo në shkelje të kushteve të lejes.

2.Pranohet pretendimi për fasadën lindore. Referuar projektit të ndryshuar, nuk përcaktohet më vendosja me tulla xhami.

3.Lidhur me pikën përlllogaritjen e TNI, të merren masat për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës së pa llogaritur.

### **8. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 1414** në emër të zhvilluesit Sh. T., me datë aplikimi 11.03.2021, për objektin: “*Banesë 1 Kat (me dalje në tarracë) + bodrum 1 Kat*”.

**Situata:** a.Mungon Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës (CPE) e miratuar brenda standardit, në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”. Në nenin 4 pika 5 përcaktohet se nga ky ligj përjashtohen *ndërtesat e veçuara me një sipërfaqe të shfrytëzueshme me pak se 50 m<sup>2</sup>*. Ndërtimi i kësaj shtese është më i madh se sipërfaqja 50m<sup>2</sup>; Neni 15, pika 1/1.v e VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, e cila përcakton ndër dokumentet e detyrueshme përcaktohet edhe *projekti i eficientës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj*;

b. Sipas treguesve të zhvillimit të paraqitur në planvendosje, si dhe certifikatën e pronësisë, përcaktohet se në numrin e pasurisë 4/1192 ZK 3234 me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> e llojit truall, nga kjo janë 122m<sup>2</sup> ndërtesë, e cila specifikohet se do priset për të vijuar me ndërtimin e ri. Në preventivin e paraqitur, mungojnë zërat që lidhen me prishjen e këtij ndërtimit të parashikuar për tu prishur, si dhe zërat e transportit, çka ka sjellë vlerë më të ulët të preventivit, dhe si rrjedhojë edhe shmangie të TNI-së e cila përlllogaritet mbi vlerën e preventivit. Punonjësit e ngarkuar për mbarëvajtjen e procesit për miratimin e lejeve të ndërtimit, duhej të kërkonin nga zhvilluesi, të përcaktonin saktë zërat e preventivit sipas projektit dhe relacionit dhe treguesve tjerë të ngarkuar në sistem.

### **9. LEJA E NDËRTIMIT ME OBJEKT:**

**Sipas regjistrimit elektronik nr. 1422** në emër të zhvilluesit A. L., me datë aplikimi 08.04.2022, për objektin: “*Shtesë 1 kat + papafingo në banesën ekzistuese 1 kat*”.

**Situata:** a.Mungon Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës (CPE) e miratuar brenda standardit, në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”. Në nenin 4 pika 5 përcaktohet se nga ky ligj përjashtohen *ndërtesat e veçuara me një sipërfaqe të shfrytëzueshme me pak se 50 m<sup>2</sup>*. Ndërtimi i kësaj shtese është më i madh se sipërfaqja

50m<sup>2</sup>; Neni 15, pika 1/1.v e VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, e cila përcakton ndër dokumentet e detyrueshme përcaktohet edhe *projekti i efincës energjetike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj*;

b.Nuk respektohet distancat me objektet në lindje dhe perëndim. Konkretisht, me objektin 2 kat në lindje, distanca varion nga 3.8 deri 4 metër, ndërsa me objektin 1 kat në perëndim varion nga 4.5 deri 4.7 metër. Referuar pikës 2 të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, distancat minimale ndërmjet objekteve do maten me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimeve + 2 metër. Sa më sipër, për objektin në lindje distanca duhet të jetë 3+2+2 = 7 metër, ndërkohë që rezulton nga 3.8 deri në 4 metër, ndërsa për objektin në perëndim distanca duhet të jetë 3+1+2 = 6 metër, ndërkohë rezulton 4.5 deri 4.7 metër.

Sa më sipër, rezulton se nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objekteve.

**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” neni 9 “Leja e zhvillimit”, neni 15, pika 1 germa g, pika 1/1.v “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimit”, neni 34 “Distancat minimale midis ndërtimeve”, neni 35 “distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”, neni 38 pika 2 “Intensiteti i ndërtimit”, neni 39 “Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim”, Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit” neni 46 pika 1 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, Ligji nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, neni 4 pika 5, Ligji nr. 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” neni 14 pika 4, Plani i Përgjithshëm Vendor i miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.10.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit neni 83.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjësit e përfshirë në miratimin e lejeve të ndërtimit, është paraqitur observacioni i administruara në KLSH me nr. 203/11 prot., datë 03.07.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Lidhur me pikën 1 për Mungesën e Raportit të Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës (CPE), sqarohet se kjo certifikatë së bashku me raportin e efincës ndodhet në dosjen fizike.

2.Në lidhje me distancat e objektit në zhvillim, sqarohet se i është përmbajtur nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar. Nëpërmjet zhvilluesit/ndërtuesit është depozituar me protokoll në dosjen fizike të praktikës, kontrata noteriale ku ka dhënë pëlqimin e tyre në lidhje me ruajtjen e distancave ekzistuese dhe ndërtimit e shtesës së katit.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

2.Lidhur me sqarimet e mësipërme, ato nuk pranohen. Sipas pikës 3/1 të nenit 3 të VKM-së 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, përcaktohet se *Bashkërendimi i punës, sipas këtij neni, me të gjitha institucionet shtetërore dhe operatorët e shërbimeve publike, si dhe marrja e informacionit apo pëlqimit nga institucionet që duhet të shprehen për kërkesat për leje, sipas legjisllacionit në fuqi, kryhet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.* Sa më sipër, dokumentet e mësipërme duhet të ngarkoheshin në sistemin e lejeve për tu marrë në shqyrtim nga ana juaj.

**Ndikimi:** Ndikon në kushtet e zhvillimit të territorit të Bashkisë Rrogozhinë. Mos respektimi i distancave sjell kufizim të drejtash për objektet dhe subjektet pronat e të cilëve cënohen nga zhvillimi i ri. Përllogaritja e gabuar e TNI ka sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë në vlerën 446,103 lekë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit Urban. Mos zbatim i kuadrit ligjor sektorial për lejet e ndërtimit.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandim 1:** Në mungesë të PDV-ve, të miratohen lejet e ndërtimit vetëm kur subjekti zhvillues të jetë pajisur me lejen e zhvillimit.

**Rekomandim 2:** Për të gjitha aplikimet për leje ndërtimi mbi 50 m<sup>2</sup>, të kërkohet në çdo rast Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës.

**Rekomandim 3:** Të respektohen maksimalisht distancat e objektit që po zhvillohet me objektet dhe pronat kufitare, si dhe të ruhet në përputhje me treguesit e zhvillimit intensiteti dhe koeficienti i shfrytëzimit të truallit, kjo për të mundësuar trajtim të barabartë të parametrave teknik të zhvillimit, duke mos cenuar të drejtat e zhvillimit të subjekteve tjera sipas njësive strukturore.

**Rekomandim 4:** Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për njoftim detyrimin ndaj subjektit zhvillues R. K., për të bërë të mundur arkëtimin e shumës 446,103 lekë si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. E. M.– Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë
2. Zj. A.D. – ish – Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë
3. Z. S. K. – ish Drejtor i Drejtorisë së Politikave Urbane
4. Z. S. L. – ish Drejtor i Drejtorisë së Politikave Urbane
5. Z. G. Gj. – Drejtor i Drejtorisë së Politikave Urbane
6. Z. E.A. – Kontrollues
7. Z. Z. P. - Kontrollues
8. Z. A.S. – Specialist
9. Zj. L. S. - Specialist
10. Z. I. B. – Specialist

## 2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

**Titulli i Gjetjes 26:** IMTV funksionon me staf të pakualifikuar. Aktiviteti jo në përputhje me detyrimet që përcakton ligji për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme dhe ai për planifikimin e territorit.

**Situata:** 1. -Për periudhën objekt auditim 01.11.2019 deri 08.04.2022 IMTV është drejtuar nga K/inspektor N. T., i cili rezulton me arsim oficer, dhe nga data 08.04.2022 e në vijim është drejtuar nga D. D. me arsim bachelor në financë – bankë.

Inspektorët që kanë punuar dhe punojnë gjatë kësaj periudhe janë F. G. me arsim policor, Z. K. me bachelor në drejtësi, F. H. me arsim të mesëm, A. T. – drejtësi, S. M. me shkollë të mesme bujqësore, F.B. me shkollë të mesme, E. K. – financë bankë, dhe E. B. Drejtësi.

Për sa më sipër, konstatohet se IMTV Bashkia Rrogozhinë, përgjatë periudhës objekt auditimi, ka rekrutuar stafin në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i cili përcakton se:

*Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.*

Kryeinspektorët dhe disa nga inspektorët e cituar më sipër, nuk kanë arsimimin e duhur për të ushtruar detyrën e K/inspektorit dhe atë të inspektorit. Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përkshuar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

2. -Për periudhën 01.11.2019 – 31.12.2019, janë mbajtur 2 akte konstatimi për punime pa leje, për të cilat nuk rezulton të jetë lëshuar asnjë vendim gjobe, asnjë vendim për prishje, dhe 1 vendim pezullimi.

-Lidhur me aktet e mbajtura, rezulton se në asnjërin prej tyre, konkretisht për aktet që lidhen me situatën ndërtimore në proces, në të paktën 2 raste, mungonin vendimet për gjobë ndaj subjekteve kundërvajtës.

-Për 2 rastet e mësipërme, njëkohësisht nuk janë mbajtur vendimet për prishjen e punimeve dhe është nxjerrë 1 vendim për pezullim punimesh.

*Mos mbajtja e këtyre akteve, është në kundërshtim me nenin 5, pika b, ç dhe d “Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, i cili përcakton:*

*Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:*

*b.Vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;*  
*ç.Vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e*

vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;  
d.Vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

si dhe ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, neni 52 “Kundërvajtjet administrative” germa (e) e cila përcakton se:

e. Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

**2.1.-**Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020 janë mbajtur 18 akte konstatimi për punime pa leje.

- Lidhur me aktet e mbajtura, rezulton se vetëm në 1 rast është nxjerrë vendimi i gjobës për 1 subjekt në vlerën 500,000 lekë, ndërsa për 17 rastet e tjera të konstatimit të kundërvajtjes nuk janë nxjerrë vendimet për gjobë.

- Për asnjë nga rastet e mësipërme, nuk janë nxjerrë vendimet për prishjen e punimeve.

- Janë nxjerrë 2 vendime për pezullim punimesh.

Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5, pika b, ç dhe d “Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, neni 52 “Kundërvajtjet administrative” germa (e), të cituara më sipër.

**2.2.-** Për vitin 2021, punonjësit e IMTV nuk kanë vënë në dispozicion të audituesve bllokun në të cilin mbahen procesverbalet e akt konstatimit. Lidhur me këtë fakt, K/Inspektori z. D. D., ka paraqitur një relacion me shkrim që mban datën 29.03.2023 në të cilin përcakton se për vitin 2021 nuk disponohet bllok procesverbali konstatimi.

-Për këtë periudhë (viti 2021), sipas bllokut të gjobave, rezulton se janë nxjerrë 2 vendime për gjoba, konkretisht 50,000 lekë për shtetasin G.G. dhe 500,000 lekë për shtetasin N. D.

-Për të njëjtën periudhë (viti 2021), sipas bllokut për vendimet e pezullimit, rezulton se janë nxjerrë 11 vendime pezullimi.

-Për të njëjtën periudhë (viti 2021), sipas bllokut për vendimet e prishjes, rezulton se janë nxjerrë 4 vendime për prishje objekti, nga të cilët 3 janë të paidentifikuar dhe 1 vendim është në emër të shtetasit G. G.

**2.3.-** Për vitin 2022 janë mbajtur 18 akte konstatimi për punime pa leje.

- Në 7 raste, janë nxjerrë vendimet e gjobës në vlerë totale 3,050,000 lekë, ndërsa në 1 rast nuk është nxjerrë ky vendim për shtetasin E. L.

- Në asnjë nga rastet e mësipërme nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së ndërtimit pa leje.

- Në 7 raste janë nxjerrë vendimet e pezullimit dhe në 1 rast ky vendim mungon, konkretisht për shtetasin E. L.

- Lidhur me veprimet e mësipërme, konstatohet sërish mangësi në veprimtarinë e IMTV, pasi masa e gjobës për 7 subjektet e mësipërme, është aplikuar gabim, pasi me ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

e)kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me....

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pa se 35,000 lekë për metër katror.

- Lidhur me këto mangësi, audituesit kanë sqaruar në hyrje të këtij akt konstatimi, se do duhej që në stafin e IMTV-së të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më minimum gjobe në vlerë të përcaktuar, por kërkohet ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përllogaritjet dhe nxjerr masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

- Gjithashtu, përsa lidhet me masën e gjobës, konstatohet se disa nga punimet e ndërtimit pa leje, janë kryer në zonës bregdetare të Spillesë, në zonën ranore të plazhit, për të cilat ligji 119/2019 i cituar më sipër, në nenin 52, pika 1, germa (e)/v, përcakton se:

*Kryerja e punimeve pa leje brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në zonat e mbrojtura apo zonën kufizuese të një monumenti kulture dënohet me 5.000.000 (pesë milionë) lekë gjobë. Lejet apo deklaratat paraprake të punimit, të miratuara në këto zona nga organet e pushtetit vendor, pa marrë paraprakisht aktin e konfirmimit nga KKT-ja, janë akte absolutisht të pavlefshme. Shkelja e këtij rregulli nga autoritetet vendore dënohet me 2.000.000 (dy milionë) lekë gjobë.*

-Sa më sipër, në kushtet kur një pjesë e punimeve është kryer në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, K/inspektori dhe inspektorët e IMTV kanë për detyrim aplikimin e dispozitës përkatëse, për të përmbushur detyrimin ligjor që lidhet me aktivitetin e inspektimit.

**3.** Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët nuk kanë miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. Njëkohësisht sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi punonjësit nuk kanë kualifikimin sipas ligjit për të kryer akte kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi.

**4.** Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

**5.** Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, k/inspektori i IMT, nuk ka përcjellë Kallëzime Penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje nga organet përkatëse, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

**6.** Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët kanë nxjerrë disa vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

**7.** Lidhur me konstatimet e mësipërme, në asnjë rast nuk disponohej një dosje e hapur për subjektin kundërvajtës, por procesverbalet e mbajtura dhe aktet që ka nxjerrë inspektorati, ishin vetëm nëpër blloqe, duke mos pasur një praktikë estetike të administrimit të dokumentacionit.

**8.** Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se shumë procedura nuk dispononin fotot e konstatimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer, dhe në rastet kur ato disponoheshin, nuk ishin të firmosura nga inspektorët përkatës. Mungesa e fotografive të kundërvajtjes, është veprim në kundërshtim me nenin 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se:

Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta

*a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.*

**9.** Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori, për periudhën objekt auditimi nuk ka miratuar planet mujore të punës, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Rrogozhinë, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit.

**10.** Lidhur me gjobat e vendosura nga IMT, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar. K/inspektori i IMT, sqaron me shkresën e datës 04.04.2023 se njofton Bashkinë Rrogozhinë, zyrën e tatim – taksave, zyrën e financës dhe zyrën juridike për të bërë ndjekjen e procedurave ligjore për vjeljen e gjobës, duke bashkëlidhur edhe modele të këtyre shkresave, nga ku rezulton se shkresa i drejtohet Bashkisë Rrogozhinë, dhe për dijeni drejtorive të cituara më sipër.

- Lidhur me vijimin e procedurës për arkëtimin e tyre, nuk ka asnjë veprim nga zyrat e mësipërme, ndërkohë nuk rezulton të jetë bërë asnjë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv.



**Kriteri:** Ligji 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, ç, d, dh, f) neni 11, 12; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Rrogozhinë, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit.

**Ndikimi:** Ndikon në ndërtimet e reja në mos përputhje të planit rregullues. Shmangen detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Nuk jep garanci për një kontroll efektiv dhe cilësor të territorit.

**Shkaku:** Personeli i pakualifikuar dhe jo në përputhje me detyrimet që përcakton ligji.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandim 1:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

**Rekomandim 2:** IMT Bashkia Rrogozhinë, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

**Rekomandim 3:** IMT Bashkia Rrogozhinë, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve. Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

**Rekomandim 4:** IMT Bashkia Rrogozhinë, të disponojë të gjitha praktikantët në dosje të veçanta për secilin konstatim, duke u dokumentuar krahas akteve të mbajtura, edhe fotografitë për situatat e konstatuara të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes përkatëse.

**Rekomandim 5:** IMT Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Taksave, të bashkërendojnë punën për të mundësuar arkëtimin e gjobave të nxjerra. Drejtoria Juridike, të marrë masa të menjëhershme për të përgatitur kërkesë padite drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, në rastet kur subjektet refuzojnë likuidimin e tyre në mënyrë vullnetare.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. E. M. – Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë
2. Z. D. D. – Kryeinspektor i IMTV
3. Z. B. T. – ish Kryeinspektor i IMTV
4. Z. F. G. – Inspektor
5. Z. Z. K. – Inspektor
6. Z. A. T. – Inspektor
7. Z. S. M. - Inspektor
8. Z. F. H. – Inspektor
9. Z. F.B. - Inspektor
10. Z. E. K. – Inspektor

## **2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme**

*Auditimi i fundit në Bashkinë Rrogozhinë:*

Auditimi i fundit në Bashkinë Rrogozhinë është kryer në zbatim të Programit të Auditimit nr. 514/1 prot., datë 27.05.2022, i ndryshuar, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021.

Për vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, është ushtruar auditim në Bashkinë Rrogozhinë mbi: “Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në vitin 2022, paraqitur me shkresën nr. 1114/7, datë 04.03.2022.

## I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Rrogozhinë rekomandimet e auditimi me shkresën nr. 1114/7 prot., datë 04.03.2022, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është dërguar plani i veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve me qëllim marrjen e masave të plota për shqyrtimin, analizimin dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH, jo në zbatim me nenin 15 shkronja “j” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 muajor** nga momenti i dërgimit të shkresës për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, konstatohet se me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1114/7 prot., datë 04.03.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve. Nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”.

## III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Rrogozhinë” administruar në KLSH me nr. 732/10 prot., datë 25.03.2022, dhe protokolluar në Bashkinë Rrogozhinë me nr. 6078/19 prot., datë 28.03.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- 15** masa organizative.
- 1** masa për shpërblim dëmi në vlerën **66,401 lekë**.
- 6** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **210,466 mijë lekë**.

## IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Ligjore												
Organizative	15		15		3		3		1		8	
Shpërblim dëmi	1	66	1	66							1	66
Tre E-të	6	210,466	6	210,466			3	90,465	2	119,619	1	382
Disiplinore												
Administrative												
<b>Gjithsej</b>	<b>22</b>	<b>210,532</b>	<b>22</b>	<b>210,532</b>	<b>3</b>		<b>6</b>	<b>90,465</b>	<b>3</b>	<b>119,619</b>	<b>10</b>	<b>448</b>

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, janë pranuar plotësisht 15, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, në proces zbatimi janë 1 , zbatuar 3 , zbatuar pjesërisht 3 dhe pazbatuar 8.

Për përmirësimin e gjendjes është rekomanduar 1 Masë për Shpërblim Dëmi me vlerë **66,401 lekë**, e cila ka statusin e ecurisë së zbatimit: e pazbatuar 1.

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 6 Masa të Ardhura të Munguara në vlerë **210,466 mijë lekë**, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit: pjesërisht zbatuar 3 në vlerë **90,465 mijë lekë**; në proces zbatimi 2 në vlerë **119,619 mijë lekë** dhe pazbatuar 1 masë në vlerë **382 mijë lekë**.

### **- Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve :**

Niveli i ulët realizmit të rekomandimeve 14%, për disa nga masat Bashkia Rrogozhinë nuk ka mundur nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e

ndalesave. Janë rritur detyrimet e reja pa likuiduar detyrimet e prapambetura. Nuk janë sistemuar llogaritë në pasqyrat financiare. Bashkia Rrogozhinë nuk e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

**Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:**

**3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Rrogozhinë 15 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 masa organizative; 1 zbatuar pjesërisht; 3 masa, në proces zbatimi 1 masë dhe pa zbatuar 8 masa. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:**

**Rekomandimi 1.1:** Bashkia Rrogozhinë në vijimësi të marrë masa:

- për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit.
- të dokumentojë mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.
- të publikojë VKBnë faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve.
- ti dërgojë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar-Dhjetor, në total tre raporte monitorimi vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Komenti i Subjektit:** “Ky rekomandim është duke u realizuar në buxhetin afatmesëm, që është në proces. Në lidhje me dokumentimet e mbledhjeve sqarojmë se po e zbatojmë në PBA, i cili nuk është përfunduar akoma.

VKB, janë publikuar, për pjesën tjetër të rekomandimit është zbatuar sipas shkresës së dërguar MFE-së. Raportet e monitorimit janë dërguar rregullisht në MFE edhe detyrimet për çdo katërmujor si edhe Performanca për çdo periudhë sipas ligjit.

**Koment i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim pjesa e parë e tij nuk rezultoi të jetë zbatuar në momentin e verifikimit, pasi ende nuk kishte përfunduar hartimi i buxhetit.

- Në lidhje me mbledhjet e strukturës duke qenë se nuk ka pasur më parë (për periudhën nga mbërritja e Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së deri në kryerjen e verifikimit për zbatimin e rekomandimeve) si dhe nuk kishte përfunduar PBA, që të mundësohej dokumentimi, rezultoi se kjo pikë e rekomandimit të konsiderohet në proces zbatimi.

- Nga verifikimi i ëbsite-it të Bashkisë Rrogozhinë rezultoi se vendimet janë të pasqyruara sipas afateve të parashikuara, pra kjo pjesë rekomandimit rezultoi të jetë e zbatuar dhe duhet të vijojë të zbatohet në vijimësi.

- Në lidhje pjesën e tretë të rekomandimit të lënë nga grupi i auditimit, rezultoi se nga ana e Bashkisë Rrogozhinë janë dërguar në MFE në total tri raporte monitorimi vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve. Raportet janë dërguar nga Bashkia Rrogozhinë MFE-së përkatësisht me anë të: shkresës nr. 1827 prot., datë.13.04.2021, shkresës nr. 2821 prot., datë 05.07.2021 dhe me shkresën nr. 4991 prot., datë. 22.10.2021, pra kjo pjesë e rekomandimit rezultoi e zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

**Rekomandimi 2.1:** Bashkia Rrogozhinë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të

marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “E zbatuar, shkresa përcjellëse për Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga Bashkia Rrogozhinë është dërguar shkresa nr.3133, datë 20.07.2022 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku tregohet edhe shpërndarja e shlyerjes së detyrimeve në katër vite sipas mundësive buxhetore të Planifikuara në Buxhetin Afatmesëm.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se në katërmujorin e I-rë të vitit 2022 është shlyer shuma 67,378,686 lekë dhe janë krijuar detyrime të reja 24,198,906 lekë, pjesa më e madhe nga shërbimet, në katërmujorin e II-të 2022 është shlyer shuma 50,167,080 lekë dhe janë krijuar 32,643,116 lekë detyrime të reja, në katërmujorin e I-rë detyrimet janë 198,503,360 lekë, 21.7 % më pak, në katërmujorin e II-të 180,979,396 pra rreth 9% të totalit. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

**Rekomandimi 3.1:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis drejtorive, sektorëve dhe bashkëpunimin me strukturat e tjera në mënyrë që planifikimi të kryhet bazuar të ardhurave që priten të arkëtohet për vitin konkret dhe jo duke u bazuar në vitet paraardhëse ose duke e fryrë këtë vlerë e cila në përfundim nuk do të ketë asnjë përfitim për Bashkinë Rrogozhinë.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Ne nuk besojmë se të ardhurat janë jashtë parashikimit për arsye se ato janë realizuar mbi 50% çdo vit, në vitin aktual mund të realizohen mbi 60% të planifikimit dhe treguesi që del çdo vit me mosrealizim është planifikimi i lejeve të ndërtimit, por nuk është realizuar deri tani asnjë leje ndërtimi.

Gjithashtu mosrealizim ka edhe në taksën e pronës për arsye se pjesa më e madhe e familjarëve janë në emigracion, sidomos për taksën e tokës bujqësore.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim në dispozicion të grupit të auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion, që të vërtetojë marrjen e masave për zbatimin e tij, gjithashtu arsyetimi i bërë nga ana e subjektit, nuk përbën një bazë të arsyeshme për të mbështetur arsyet e mosrealizimit të tij. Për sa më sipër ky rekomandim rezultoi i pazbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar

**Rekomandimi 4.1:** Këshilli Bashkiak, të marrë në analizë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, pasi për shkak të moszbatimit të tyre, edhe në auditimin e radhës janë evidentuar shkelje, mangësi, si dhe veprime, në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përsëritura. Nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinë, t’i kërkohet Kryetarit të Bashkisë, marrja e masave për shqyrtimin, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, të cilat rezultojnë të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht.

#### Menjëherë

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Ky rekomandim nuk është zbatuar.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim, nga ana e subjektit nuk u vu në dispozicion ndonjë dokument, po ashtu dhe komentet e subjektit konfirmojnë mos realizimin e këtij rekomandimi.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Rekomandimi 5.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” për vlerën 67,894,200 lekë.

## Menjëherë

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Ky rekomandim është sistemuar në Bilanin Kontabël të vitit 2020.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim u bë verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, konkretisht i llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar”, ku u konstatua se është bërë sistemimi përkatës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

**Rekomandimi 6.1:** Nëpunësi Zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke e njohur të ardhurën për vitin 2019 në vlerën 41,217,566 lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 44,375,475 lekë.

## Menjëherë

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Ky rekomandim është sistemuar në Bilancin Kontabël të vitit 2020.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim u bë verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, konkretisht i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, ku u konstatua se është bërë sistemimi përkatës i llogarisë në mënyrë retrospektive për periudhën 2019 dhe 2020. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

**Rekomandimi 7.1:** Nëpunësi Zbatues të marrin masa për sistemimin financiar të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” duke u kujdesur për kuadrimet respektive të Llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

## Menjëherë

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Për sistemimin e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” dhe për kuadrimet respektive të llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” do të bëhen në bilancin e vitit 2022.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim në momentin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 rezultoi se nuk është vepruar nga Titullari i Bashkisë Rrogozhinë dhe Nënpunësi Zbatues, pasi Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së ka mbërritur 28.02.2022, ky veprim mund të reflektohej dhe më parë në pasqyrat e vitit 2021, me anë të një veprimi rregullës për korrigjimin e gabimeve, pas datës së bilancit dhe në mënyrë retrospektive, siç parashikohet në SKK 8. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Rekomandimi 8.1:** Nga Bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë SHA me vlerë kontabël 62,051,960 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

## Menjëherë

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Në zbatim të këtij rekomandimi mbi kontabilizimin e llogarisë 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” me anë të Urdhrit nr.137, datë 26.05.2022 ngarkohet Sektori i Kontabilitetit që të bëjë sistemimin.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi se me anë të Urdhrit nr. 137, datë 26.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë është urdhëruar kryerja e sistemimit. Nga verifikimi i pasqyrave financiare u konstatua se janë reflektuar rregjistrimet përkatëse për llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në Pasqyrën e

Pozicionit Financiar të datë 31.12.2020 të Bashkisë Rrogozhinë, shumë e cila rezulton të jetë e njëjtë me atë të paraqitur në zërin “ Kapital i nënshkruar” në pasivin e Pasqyrës së Pozicionit Financiar të datës 31.12.2020 të Ujësllës Kanalizime Rrogozhinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

**Rekomandimi 9.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa të menjëhershme:

- Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

- Titullari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe financës të marr masa për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Krijimi dhe mbajtja e regjistrit është në proces, në zbatim të rekomandimit për vlerësimin e aktiveve është nxjerrë Urdhri nr.132, datë 16.05.2022, ku urdhërohen njësite Lekaj, Kryevidh, Gose dhe Sinaballaj që të sjellin pranë njësisë qendrore të gjithë dokumentet që kanë lidhje me asetet për të bërë procedurën e regjistrimit të aseteve të Bashkisë. Për pikën 3 kemi emëruar një specialist për rregjistrimin e pronave Ka filluar rregjistrimi i aseteve, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe është në përmirësim e sipër mënyra e mbajtjes së regjistrit në rrugë elektronike duke marrë nga ditarët dhe lista e mëparshme, datën e krijimit vlerën si edhe vlerën e amortizimit të trashëguar për çdo aset.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Me anë të Urdhrit nr. 132, datë 16.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë Z. E. M. janë urdhëruar NjA: Kryevidh, Lekaj, Gose dhe Sinaballaj për të dërguar sa më pranë Drejtorisë së Financës të gjitha dosjet e aseteve dhe çdo dokument tjetër, i cili ka lidhje me asetet e njësisë përkatëse. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se nuk është dërguar informacion në lidhje me asetet nga Njësia Gosaj dhe Kryevidh, ndërsa informacioni i dërguar nga njësitë e tjera është i periudhës para vitit 2015. Nuk rezulton të jetë krijuar regjistri i aktiveve të njësisë dhe nuk janë saktësuar të dhënat, që duhet të përmbante informacioni që duhet të raportohet nga njësitë. Nga verifikimi i informacionit të dërguar, konstatohet se ai nuk është i detajuar sipas specifikimeve të rekomandimit të lënë nga grupi i auditimit (data e hyrjes, vlera e blerjes, shpenzimet kapitale,,, etj.) ç’ka vështirëson krijimin dhe mbajtjen e regjistrit në një format të plotë. Në lidhje me pikën 3 të rekomandimit nuk ka komente nga ana e subjektit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

**Rekomandimi 10.1:** Nga Bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke ndjekur rakordimet me llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” e cila është 67,894,200 lekë.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Për sistemimin e llogarisë 466” Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke ndjekur dhe rakordimet me llogarinë 520 “Disponibilitet në thesar” do të bëhen në bilancin e vitit 2022.”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nisur nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit,

konstatohet se ky rekomandim nuk është zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Rekomandimi 11.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 7,154,000 lekë për vitin 2020. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Vlera prej 7,154,000 lekë është lëvizje, që nuk korrespondon nga mosdeklarimi i faturave pranë Degës së Thesarit nga ana jonë, por ne në kontabilitet shumë në kemi deklaruar e kemi të saktë dhe që është më e madhe si detyrim nga ajo e Thesarit.

Këtë shumë ne e kemi dërguar të rregullt në informacionin, që i dërgojmë MFE. Momentalisht nuk kemi një informacion të saktë të gjendjes së llogarisë 467. Raportimi i detyrimeve të prapambetura pranë MFE është bërë.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga ana e Titullarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për të bërë sistemimet përkatëse, sipas rekomandimit të grupit të auditimit të KLSH-së. Pjesa e raportimit pranë MFE është kryer. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet në pjesërisht i zbatuar.

**Rekomandimi 12.1:** Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë të kryej korrigjimet e nevojshme në Vendimin nr.25, datë 11.03.2020, si të pabazuara në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, duke vlerësuar drejt shtresat më vulnerabël.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Nuk është zbatuar”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje këtë rekomandim, nga ana e subjektit nuk u vu në dispozicion ndonjë dokument, po ashtu dhe komentet e subjektit konfirmojnë mos realizimin e këtij rekomandimi.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Rekomandimi 13.1:** Titullari i Institucionit të marri masat për të kryer analizë të thelluar dhe të nxirren përgjegjësitë për personat përgjegjës në këtë proces.

**Menjëherë**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Kjo gjë është bërë për shkak të mungesës së specialistëve të duhur të fushës.....”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje këtë rekomandim, nga ana e subjektit nuk u vu në dispozicion ndonjë dokument, gjithashtu komentet e subjektit nuk janë konkrete. Në rekomandimin e KLSH-së është kërkuar realizimi i analizës së thelluar dhe nxjerrja e përgjegjësive për personat përgjegjës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Rekomandimi 14.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë dhe GMS, të marrin masa për rishikim të vazhdueshëm të risqeve që vijnë nga situata të paparashikuara, si dhe të hartojnë aktivitete të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre, me qëllim uljen e ndikimit në arritjen e objektivave institucional.

**Në Vazhdimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Nuk është zbatuar.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje këtë rekomandim, nga ana e subjektit nuk u vu në dispozicion ndonjë dokument, po ashtu dhe komentet e subjektit konfirmojnë mos realizimin e këtij rekomandimi.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Rekomandimi 15.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë të bashkëpunojë me ASHK për të ndjekur dhe verifikuar në vijimësi problematikën mbi pronësinë, për të nxjerrë dhe analizuar arsyet e mungesave të këtij dokumentacioni i cili mund të sjellë probleme sociale dhe ligjore në vijimësi.

**Në Vazhdimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Kjo gjë është bërë për shkak se mbi 90% e familjeve nuk kanë certifikatë pronësie. Një arsye tjetër është se në trajnimet e bëra në Zyrat e Ndërtimit, na është thënë, që personi mund të aplikojë me një vërtetim, fakti ku mund të jetë gjurma e shtëpisë, etj. Ne kemi pranuar si dokument kontratën e lidhjes së sahatit të OSHEE-së dhe jo pagesës së energjisë elektrike.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se nuk janë ndërmarrë veprime për zbatimin e tij. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

## **B. Masa për shpërblim dëmi**

**Rekomandimi 1.1:** Nga ana e Titullarit të Bashkisë Rrogozhinë të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, me qëllim arkëtimin shumës **66,401 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Në lidhje me këtë rekomandim nuk na rezulton të kemi pasaktësi.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim të lënë nga grupi i auditimit prej subjektit nuk është ndërmarrë asnjë masë për të kthyer shumën e munguar. Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

## **C. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).**

**Rekomandimi 1.1:** Të dërgohet në ASHK (për pasuritë e paluajtshme) kërkesa për vendosjen e barrës siguroese, bazuar në nenin 91, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH.” Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”. Sektori i të ardhurave të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Rrogozhinë të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **79,206,436 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Në lidhje me këtë rekomandim nga ana e Drejtorisë së Taksave janë dërguar kërkesat për vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e paluajtshme”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se Drejtoria e Taksave, pranë Bashkisë Rrogozhinë me anë të shkresës nr. 5710 prot., datë 22.10.2022 i është drejtuar Agjencisë së Kadastrës Kavajë “Kërkesë për vendosjen së barrës siguroese për pasuritë e paluajtshme”, por nuk ka pasur veprim të mëpasshëm për të zbatuar këtë rekomandim. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.



**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

**Rekomandimi 2.1:** Sektori i të ardhurave të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës. Bashkia Rrogozhinë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore si dhe vjelja e debisë në shumën prej **104,015,431 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Në lidhje me këtë rekomandim kemi parashikuar të veprimet në planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për periudhën e auditimit 01.01.2020-31.12.2020.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Me anë të shkresës nr. 4894 prot., datë 25.11.2022 Bashkia Rrogozhinë, Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH për periudhën e auditimit 01.01.2020-31.12.2020 ka përgatitur planin e punës dhe masat e marra. Në këtë plan, në lidhje me këtë rekomandim është parashikuar njoftimi mbi detyrimet e taksave të familjareve nëpërmjet postës dhe aty ku nuk është e mundur nëpërmjet postës, me anë të specialistëve të taksave, po ashtu në plan përcaktohet se për këtë kategori të taksave do të aplikohen kamatvonesat në përputhje me legjislacionin në masën 0,06% e detyrimit, që nga janari 2022. Për vjeljen e shumës 104,015,431 lekë, nuk është vepruar, pasi dhe në planin e punës Bashkia Rrogozhinë parashikon njoftimin e debitorëve dhe citon se : “... kërkon angazhimin e të gjitha strukturave që të gjendet një rrugë për arkëtimin e kësaj shume pasi vit pas viti po vjen në rritje...”, ndërsa në lidhje me marrjen e masave për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie, deri në momentin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nga KLSH nuk rezulton të jenë marrë masa, madje dhe për arkëtimin e shumës nuk janë bërë veprime konkrete për të kërkuar bashkëpunimin me strukturat e tjera. Për sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

**Rekomandimi 3.1:** Drejtoria e Urbanistikës të bashkëpunoj me institucionet përgjegjëse që ta ketë data bazën e plotë për sa i përket aplikuesve dhe të dhënave të tyre.

Drejtoria e Urbanistikës të marr masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **15,603,837 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Rrogozhinë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Bashkia Rrogozhinë të njoftojë qytetarët të cilët nuk kanë kryer ende pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Ne si drejtori i kemi dërguar ASHK-se Kavajë shkresën me nr. 3536 pro.t, datë 30.08.2022 ku kemi kërkuar listën e plotë e të përditësuar që nga fillimi i procesit të legalizimit të objekteve informale deri më 31.08.2021. ASHK ka kthyer përgjigje me shkresën me nr.4235/1 datë 12.09.2022, ku ka dërguar listën e plotë të kërkuar nga ana jonë. Aktualisht Drejtoria e Politikave Urbane është duke u marrë me sisteminin e kësaj liste në mënyrë që të evidentohen qytetarët/subjektet, të cilët nuk kanë paguar ende taksën e ndikimit në infrastrukturë për objektet informale. Lista e dalë do ti dërgohet ASHK Kavajë për ndjekje të mëtejshme.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi se ishte komunikuar me ASHK Kavajë me anë të shkresës nr. 3536 datë 30.08.2022, ku kërkohej dërgimi i listës së plotë të përditësuar nga fillimi i procesit të legalizimit të objekteve informale deri më 31.08.2022 dhe nga ASHK Kavajë është dërguar informacioni i kërkuar me anë të shkresës nr. 18352 datë 12.09.2022, por nga Drejtoria e Urbanistikës databaza e plotë nuk ishte krijuar ende deri në momentin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të kryer nga ana jonë. Njoftimi i qytetarëve është parashikuar në planin e masave të Bashkisë Rrogozhinë dhe për vjeljen e detyrimit nuk

janë marrë ende masa. Nga sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet **në proces zbatimi**.

**Rekomandimi 4.1:** Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **10,920,000 lekë**, e ardhur e munguar për Bashkinë Rrogozhinë si dhe ti mbaj këto subjekte në dosje të veçanta ku të bashkëlidh dokumentacionin e subjektit së bashku me mandatet e arkëtimit dhe të krijoj regjistër të posaçëm.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Në zbatim të këtij rekomandimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vlerën 1,000,000 lekë për 5 vite e ka përpjestuar nga 200,000 lekë në vit, pasi një pjesë e mirë e subjekteve tregtare që tregtojnë këto lëndë i kanë pikat e karburantit me qera dhe afati i qerasë nuk përputhet me afatin 5 vjeçar të licencës për tregtimin e karburantit. Data e Autorizimit dhe data e pagesës për çdo vit pasardhës ka filluar në datën, që ka mbaruar Autorizimi dhe nuk ka asnjë të ardhur të munguar. Rregjistri i subjekteve me datat e fillimit dhe mbarimit të autorizimit me datat e pagesës ku është bërë pagesa me emrin e bankës Për subjektet, që nuk kanë kryer pagesën për autorizim kemi marrë masa me bllokimin e llogarive.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi se rregjistri i subjekteve me datat e pagesës së autorizimit është, por nga grupi i auditimit të KLSH-së gjithashtu është kërkuar mbajtja e dosjeve të detajuara me mandatpagesat përkatëse për çdo subjekt të veçantë. Gjithashtu në lidhje me të ardhurën e konstatuar si të ardhur të munguar në masën 10,920,000 lekë, nga të cilat 120,000 lekë janë llogaritje të gjobave nga grupi auditues nuk rezultoi të jenë marrë masa për mbledhjen e saj. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i zbatuar**.

**Rekomandimi 5.1:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për ndjekjen dhe për mbledhjen e detyrimit në vlerën **339,262 lekë**, të ardhura të munguara në Bashkinë Rrogozhinë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se kemi ndërrmarrë masat për mbledhjen e detyrimit.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim në dispozicion të grupit të auditimit u vu në dispozicion informacioni mbi gjendjen e detyrimeve për kontratat e lidhura nga Bashkia Rrogozhinë “Për dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore për vitet 2018-2021”, pagesat e kryera ndër vite dhe statusin e kontratave.

Gjatë vitit 2022, konkretisht me ane të shkresave nr. 146 dhe 147, datë me 13.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë janë zgjidhur 2 kontrata në mënyrë të njëanshme nga për dy subjekte, të cilat nuk kanë bërë likuidimet përkatëse. Informacioni në lidhje me zgjidhjet e kontratave nuk është i detajuar, pasi zgjidhja e tyre nuk parashkruan detyrimet e mëparshme, sipas observacionit të paraqitur nga subjekti i audituar këto detyrime nuk janë kërkuar për shkak se në brenda sipërfaqeve janë paraqitur me certifikata pronësie persona të ndryshëm, por përsëri nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk janë masa për t'i reflektuar këto fakte. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i zbatuar**.

**Rekomandimi 6.1:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për zbatimin me përpikmëri të ndjekjes së fazave: ngritje kantieri+ muri rrethues, piketim objekti, përfundim i themeleve 0.00, përfundim i karabinasë, përfundim i fasadave dhe rifiniturave+ sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje etj, përfundimi i sistemeve të jashtme, tarifat sipas llojit: për banesa, për biznes, për pallatet+ bregdet, tarifat për marrjen e certifikatës së përdorimit të objekteve sipas llojit të ndërtimit dhe për mbledhjen e detyrimit duke ju

referuar tarifave të vendosura nga zyra e Drejtorisë së Politikave Urbane, bazuar në VKM nr. 408, datë 13.05.2015 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit në vlerën **381,400 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i subjektit:** “Ne si Drejtori i disponojmë dosjet e plota të të gjithë qytetarëve dhe subjekteve të cilët kanë aplikuar në sistemin elektronik e-leje për leje ndërtimi dhe zhvillimi ku ndodhen të gjitha mandatet e arkëtimit sipas fazave të kontrollit”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit auditues rezultoi se nuk janë marrë masa për mbledhjen e detyrimit në masën e përcaktuar nga grupi i auditimit. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar

*Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Rrogozhinë, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:*

Masa	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Ligjore												
Organizative	15		15		3		3		1		8	
Shpërblim dëmi	1	66	1	66							1	66
Tre E-të	6	210,466	6	210,466			3	90,465	2	119,619	1	382
Disiplinore												
Administrative												
<b>Gjithsej</b>	<b>22</b>	<b>210,532</b>	<b>22</b>	<b>210,532</b>	<b>3</b>		<b>6</b>	<b>90,465</b>	<b>3</b>	<b>119,619</b>	<b>10</b>	<b>448</b>

Kontrolli i Lartë i Shtetit inkurajon subjektin Bashkia Rrogozhinë që krahas punës që ka bërë për zbatimin e rekomandimeve, të vijojë procedurat administrative e ligjore për zbatimin e masave të pazbatuara dhe në proces zbatimin deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë vijon:

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik në zbatim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetë qeverisjes vendore”, neni 37.

Mungon Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projekt Buxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit, në faqen zyrtare të bashkisë Rrogozhinë nuk e kemi të mundur aksesin si pasojë e bllokimit të faqes nga mospagimi i detyrimit. Ka diferencamidis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsai përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2020 ka arritur në 85.04 %.

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 27,806,962 lekë.

Shlyerja e këtyre detyrimeve, nuk është programuar si zë më vete i tregueseve të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101.

Bashkia Rrogozhinë nuk ka përpiluar dhe nuk i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte monitorimi vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve.

**Rekomandimi 1.1:** Bashkia Rrogozhinë në vijimësi të marrë masa:

- për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit.

- të dokumentojë mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

- të publikojë VKBnë faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve.

- ti dërgojë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte monitorimi vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 260,843,939 lekë. Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të pa likuiduar i zënë Investimet në vlerën 159,142,791 lekë ose 61 %. Mallra dhe Shërbime në vlerën 101,063,948 lekë ose 38.7 %, vlerë e pa likuiduar i cili i përket OSHEE- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, faturat e papaguara në vlerën 25,523,210 lekë. Nga administrata e Bashkisë Rrogozhinë nuk janë zhvilluar procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Për procedurat e raportuara si të prapambetura nuk është ruajtur plotësisht radha e financimit. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 637,200 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ose 0.24 %, detyrim i cili është krijuar korrik-shtator 2020, të cilat kanë kaluar me përmbarues.

Nga administrata e bashkisë Rrogozhinë nuk është paraqitur në të gjitha rastet në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

**Rekomandimi 2.1:** Bashkia Rrogozhinë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e pasqyrave të realizimit të të ardhurave, konstatohet se për vitin 2020, është planifikuar si e ardhur vlera 276,445,900 lekë dhe është realizuar në vlerën 111,719,008.62 lekë, të ardhurat paraqiten të realizuara ndaj planit fillestar në masën 40.41 % ose -164,726,891 lekë. Planifikimi i të ardhurave nuk është bërë saktë pasi ka zëra të ardhurash të cilat kanë tejkalim, si në rastin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, taksë regjistrimi automjeti, taksë gjelbërim biznesi, qira nga ndërtesat. Ka disa taksa të tjera me realizim shumë të ulët si taksa e kalimit të pronësisë, taksë e përkohshme, tarifë parkimi, taksë reklame. Nga auditimi është evidentuar realizim i ulët i të ardhurave nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, gjë e cila flet për punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre.

**Rekomandimi 3.1:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis drejtorive, sektorëve dhe bashkëpunimin me strukturat e tjera në

mënyrë që planifikimi të kryhet bazuar të ardhurave që priten të arkëtohet për vitin konkret dhe jo duke u bazuar në vitet paraardhëse ose duke e fryrë këtë vlerë e cila në përfundim nuk do të ketë asnjë përfitim për Bashkinë Rrogozhinë.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin të rekomandimeve, ka rezultuar se, nga Titullari i institucionit, nuk janë marrë masat e duhura.

- nuk është vënë në funksion Grupi i punës, nuk është raportuar në KLSH brenda afatit 20 ditore, referuar Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, neni 15;

- nuk është raportuar në KB, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5”.

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 7 “Masa organizative”, nga të cilat është zbatuar plotësisht 1 masë; janë zbatuar pjesërisht 2 masa; një masë ka dalë nga konteksti kohor dhe nuk janë zbatuar, 3 masa.

Në auditimin e mëparshëm, janë rekomanduar 3 masa me efekt negativ në realizimin e të ardhurave të Bashkisë Rrogozhinë, nga të cilat janë në proces zbatimi dy masa, si dhe nuk është zbatuar një masë.

**Rekomandimi 4.1:** Këshilli Bashkiak, të marrë në analizë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, pasi për shkak të moszbatimit të tyre, edhe në auditimin e radhës janë evidentuar shkelje, mangësi, si dhe veprime, në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përsëritura. Nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinë, t’i kërkohet Kryetarit të Bashkisë, marrja e masave për shqyrtimin, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, të cilat rezultojnë të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht.

#### **Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 50,171,339 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 163,326,385 lekë. Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t’u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

**Rekomandimi 5.1:** Nëpunësi Zbatues të marrin masa për sistemimin financiar të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” duke u kujdesur për kuadrinet respektive të Llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

#### **Brenda datës 30.06.2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Duke analizuar veprimet e shtesave dhe pikësimeve të AAM-ve sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës, vihen re mospërputhje me vlerat e pasqyruara në bilanc. Llogaria. 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 5,839,355 lekë; Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet e pandryshuar prej 1,596,452 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëjloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël, dhe as inventar fizik.

Për llogaritë e AAJM, edhe për ato aktive që ekziston një regjistër kontabël, nuk specifikohet analitiku i llogarisë, si: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të më pasme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve vetë mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

**Rekomandimi 6.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa të menjëhershme:

- Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

- Titullari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe financës të marr masa për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstrukione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

**Brenda datës 30.06.2023**

**7. Gjetje nga auditimi:** Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Rrogozhinë, në fund të vitit 2020 llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” paraqitet në vlerën 40,629,939 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 40,629,939lekë. Kjo shumë nuk është e njëjtë me tepricën e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” e cila është 67,894,200 lekë.

**Rekomandimi 7.1:** Nga Bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke ndjekur rakordimet me llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” e cila është 67,894,200 lekë.

**Brenda datës 30.06.2023**

**8. Gjetje nga auditimi:** Për llog 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore, investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 68,713,115 lekë. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investime të Bashkisë Rrogozhinë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2021, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020, e cila përbën informacion financiar jo të drejtë duke nënvlerësuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 7,154,000 lekë për vitin 2020.

**Rekomandimi 8.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 7,154,000 lekë për vitin 2020. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

**Brenda datës 30.06.2023**

**9. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, ka miratuar sistemin e pikëzimit, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.25, datë 11.03.2020 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, sipas të cilit është vendosur sistemi pikëzimit, jonë përputhje me renditjen e përcaktuar në VKM nr.5, datë 06.01.2020, pika 17. Referuar pikëzimit të miratuar nga Bashkia Rrogozhinë me VKB nr.25, datë 11.03.2020, rezulton se grupi “Pensionistë” i listuari katërti në radhën e prioritetëve është vlerësuar me më pak pikë se dy grupet e tjera “Familje me skemën e ndihmës ekonomike” dhe “Familje të rena në krye të detyrës”, të listuar të pestët dhe të gjashtët në radhën e prioritetëve.

**Rekomandimi 9.1:** Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë të kryej korrigjimet e nevojshme në Vendimin nr.25, datë 11.03.2020, si të pabazuara në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, duke vlerësuar drejt shtresat më vulnerabël.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aplikimeve për grante rikonstruksioni ose riparimi rezulton se:

- Në pothuajse të gjitha rastet e audituara, Akt konstatimet vizuale, apo Formulari Tip B dhe C, të mbajtur për të vlerësuar dëmet e shkaktuara, nuk kanë të shënuar datën e mbajtjes së tyre; nuk janë të plotësuar, në të gjitha rubrikat e parashikuara nga formati i miratuar;
- Në shumë raste, inspektimi dhe vlerësimi i objekteve në terren është bërë nga 1 person (specialist në Bashkinë Rrogozhinë), ndërkohë që në aktet nënligjore të dala për të rregulluar këtë proces, është kërkuar që verifikimet të kryhen nga grupe inspektimi.
- Për të gjitha rastet e vlerësimit të dëmit niveli DS3, i cili ka të bëjë me dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dëmtim i mureve ndarëse dhe perimetralë, nuk ka vlerësim të përcaktuar nga akt ekspertiza e thelluar, me përjashtim të 1 rasti.
- Në pothuajse të gjitha rastet, në dosjet përkatëse, por dhe në të dhënat e hedhura në sistem, për të vërtetuar masën e dëmit (DS3) janë paraqitur Akt konstatime vizuale nga specialistët e Bashkisë Rrogozhinë, ndërkohë që për këtë nivel dëmi (DS3), duhej të kryhej akt ekspertizë e thelluar.
- Në asnjë prej rasteve përshkrimi i dëmeve (zërat) dhe sipërfaqet e dëmtuara, të cilësuar në Akt konstatimi vizual, apo Formularin Tip B, nuk kanë përputhje me zërat e punimeve dhe sipërfaqet përkatëse të cilësuar në preventivin tip bashkëngjitur.

Sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 5, datë 06.01.2020 me ndryshime, Kreu IV“ Grantet për rikonstruksion”, pika 2 dhe pikën 13 të Kreut II, aplikimet për grante rikonstruksioni ose riparimi.

**Rekomandimi 10.1:** Titullari i Institucionit të marrë masat për të kryer analizë të thelluar dhe të nxirren përgjegjësitë për personat përgjegjës në këtë proces.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga 102 praktika të audituara vetëm në 25 raste, ose në 24.5% të tyre, për të vërtetuar pronësinë mbi objektin, ishin paraqitur dokumente pronësie, të cilët kanë të specifikuar sipërfaqet e objekteve; nga 102 praktika të audituara në 29 raste, ose në 28.4 % të tyre, nga inspektorët e verifikimit të dëmeve në terren, nuk është specifikuar në aktet e mbajtura sipërfaqe e objektit, gjë e cila ka shërbyer si kriter për vendosjen e masës së përfitimit, referuar pragjeve nën dhe mbi 100 m<sup>2</sup>; Nga 102 praktika të audituara në 28 raste, ose në 27.4% të tyre, janë evidentuar diferenca në cilësimin e sipërfaqeve të objekteve, të cilësuar në Kontratën e masës së përfitimit dhe sipërfaqeve të cilësuar në Akt konstatime, Dokumente pronësie, apo deklarimi i tyre, nga ASHK.

**Rekomandimi 11.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë dhe GMS, të marrin masa për rishikim të vazhdueshëm të risqeve që vijnë nga situata të paparashikuara, si dhe të hartojnë aktivitete të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre, me qëllim uljen e ndikimit në arritjen e objektivave institucionale.

**Në Vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Përsa i përket dokumentacionit që vërteton pronësinë mbi objektin është kërkuar që të paraqitet, çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar. Në lidhje me këtë kërkesë në aplikacionin "Shtëpia ime", është publikuar një

listë me opsione si: (certifikatë pronësie; vërtetim hipoteke ; vërtetim fakti; vendim gjykate; kontratë sipërmarrje; kontratë shitblerje; akt dhurimi; leje legalizimi), por nga ana e Bashkisë Rrogozhinë si dokument (zëvendësues-justifikues-vërtetues), është pranuar Kontrata e pagesës së energjisë elektrike me OSHEE. Ky dokument nuk mund të shërbejë për të vërtetuar pronësinë mbi objektin, prandaj nuk është pjesë e listës së dokumenteve që mund të pranohen për të vërtetuar pronësinë mbi objektin.

Nga 102 praktika të audituara, vetëm në 25 raste në dosje kishte dokumentacion që vërteton të drejtën e pronësisë mbi objektin, sipas listimit të tyre në aplikacion. Në të gjitha rastet e tjera, në dosje për të plotësuar këtë kërkesë është pranuar Kontrata me OSHEE.

**Rekomandimi 12.1:** Titullari i Bashkisë Rrogozhinë të bashkëpunojë me ASHK për të ndjekur dhe verifikuar në vijimësi problematikën mbi pronësinë, për të nxjerrë dhe analizuar arsyet e mungesave të këtij dokumentacioni i cili mund të sjellë probleme sociale dhe ligjore në vijimësi.

**Në Vazhdimësi**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e politikave urbane i ka paraqitur më datë 11.11.2019, nr.4870 prot. një relacion Këshillit Bashkiak Rrogozhinë “Për miratimin e tarifave të vendosura nga zyra e Drejtorisë së Politikave Urbane për shërbimet që do kryej ndaj qytetarëve”. Tarifat për Akt- Kontrollat në faza të ndryshme të ndërtimit të objekteve të ushtruara nga personeli i Zyrës së Drejtorisë së Politikave Urbane. Në bazë të VKM nr.408, datë 13.05.2015 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 27/1 për Mbikëqyrjen e Punimeve, mbahen Akte Kontrolli kundrejt pagesave nga pika a në f: ngritje kantieri+ muri rrethues, piketimi objekti ,përfundim i themeleve 0.00, përfundim i karabinasë, përfundim i fasadave dhe rifiniturave + sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje etj, përfundimi i sistemeve të jashtme, tarifat sipas llojit: për banesa, për biznes, për pallatet+bregdet. Si dhe tarifat për marrjen e certifikatës së përdorimit të objekteve sipas llojit të ndërtimit. Grupi auditues analizoi 6 dosje në të cilat kishte mungesa të arkëtimit të fazave të ndryshme nga pika a në f, me dëm ekonomik total në vlerën 66,401 lekë nga “K.” sh.p.k, në vlerën 12,200 lekë, “A. sh.p.k në vlerën 42,427 lekë, Xh. në vlerën 2,670 lekë, E.L. në vlerën 1,780 lekë, H. I. në vlerën 4,410 lekë, B. T. në vlerën 2,914 lekë dhe të ardhura të munguara në vlerën 381,400 lekë mungesë arkëtimi për certifikatën e përdorimit.

**Rekomandimi 1.1:** Nga ana e Titullarit të Bashkisë Rrogozhinë të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore, me qëllim arkëtimin shumë **66,401 lekë.**

**Brenda datës 30.06.2023**

## **D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRIJTJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Deri më 31.12.2019 debitorët familjarë arrijnë në vlerën 38,929,763lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 21,569,034 lekë, në total 60,498,797 lekë. Vlera 8,655,236lekë është arkëtuar në Bashkinë Rrogozhinë. Debitorët familjarë për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri më 31.12.2020 arrijnë në total 51,843,561 lekë të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë. Mbi këto vlera nuk janë llogaritur kamatë vonesa.



Në Bashkinë Rrogozhinë ka 188 biznese të vogla dhe 34 biznese të mëdha debitorë. Gjohat e pa llogaritura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për taksat dhe tarifave vendore dhe të papaguara nga subjektet shkojnë në vlerën 1,617,137 lekë, vlerë e cila përbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Në total vlera e Debitorëve nga bizneset më datë 31.12.2020 paraqitet 25,745,738 lekë + 1,617,138 lekë gjoha për mospagim në afat të detyrimit tatimor arrin në total vlerën 27,362,875 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifave vendore të papaguara nga bizneset dhe që përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

**Rekomandimi 1.1:** Të dërgohet në ASHK (për pasuritë e paluajtshme) kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese, bazuar në nenin 91, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH.” Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”. Sektori i të ardhurave të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Rrogozhinë të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **79,206,436 lekë**.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Taksa e tokës bujqësore në vitin 2020 është realizuar në masën 58.27%, e ardhur për Bashkinë Rrogozhinë. Njësia administrative Gosë dhe Kryevindh shfaqet më problematike për sa i përket detyrimeve të prapambetura respektivisht në vlerat 39,724,695 lekë dhe 30,607,993 lekë. Në total vlera e debitorëve nga taksa e tokës më datë 31.12.2020 paraqitet 104,015,431 lekë, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

**Rekomandimi 2.1:** Sektori i të ardhurave të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës. Bashkia Rrogozhinë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore si dhe vjelja e debisë në shumën prej **104,015,431 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> për Bashkinë Rrogozhinë. Llogaritja e vlerës kryhet (Sip.Objektit\*32,105\*0.5%). Grupi auditues kërkoi nga Drejtoria e Planifikimit regjistrin e plotë por kjo drejtori nuk e disponon. Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit nuk ka asnjë databazë ku të ketë të përcaktuar (emër, mbiemër, sipërfaqen e ndërtimit, funksionin e banimit/ ekonomik- verifikim nëse për të dyja ka të njëjtin nivel takse, detyrimin), përveç se listën e qytetarëve të cilët e kanë paguar detyrimin e tyre me shumën e paguar sipas viteve. Në vijim grupi auditues i kërkoi Bashkisë Rrogozhinë t’i dërgonte shkresë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë në lidhje me numrin e qytetarëve të cilëve ju është miratuar leja e legalizimit për periudhën 2015-2020. Shkresa është nisur në datën 12.11.2021, me nr. 5333 prot. dhe në datë 13.11.2021, me nr.4933/2 prot. ka patur përgjigje nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Kavajë. Në total për periudhën 2015- 2020 i është

miratuar leja e legalizimit 908 subjekteve në vlerën 32,835,411.22 lekë, nga të cilat 406 subjekte kanë paguar në vlerën 17,231,574. Diferenca e papaguar për periudhën 2015- 2020 është vlera 15,603,837 lekë për 502 subjekte, të ardhura të munguara për Bashkinë Rrogozhinë. Theksojmë se 68 subjekteve nuk i është përcaktuar sipërfaqja dhe si pasojë e kësaj grupi auditues nuk e ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për këto 68 subjekte. Bashkia Rrogozhinë nuk i ka njoftuar qytetarët të cilët nuk kanë kryer ende pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Rekomandimi 3.1:** Drejtoria e Urbanistikës të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse që ta ketë databazën e plotë për sa i përket aplikuesve dhe të dhënave të tyre.

Drejtoria e Urbanistikës të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **15,603,837 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Rrogozhinë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Bashkia Rrogozhinë të njoftojë qytetarët të cilët nuk kanë kryer ende pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë operojnë 13 subjekte nga të cilat 2 prej tyre tregtojnë gaztë lëngshëm dhe 11 prej tyre tregtojnë naftë- benzinë- gaz. Dy subjekte të tjera, K. O. dhe K. O. sipas verifikimeve të kryera nga bashkia Rrogozhinë e kanë mbyllur aktivitetin e tyre por që qëndrojnë aktiv në QKB. Gjobat nuk janë llogaritur nga drejtoria dhe nuk janë përcaktuar si gjobë në Paketën Fiskale të vitit 2020. Për vitin 2020 janë llogaritur gjobat dhe detyrimet nga grupi auditues duke qenë se verifikimi në terren nga bashkia për këto 2 subjekte që rezultojnë që nga viti 2017 debitor është kryer më 02.06.2020, në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për “Përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 9. Të ardhurat e munguara arrijnë në vlerën 10,920,000 lekë nga të cilat 120,000 lekë janë llogaritje të gjobave nga grupi auditues. Bashkia Rrogozhinë nuk ka aplikuar gjoba për vazhdimin e aktivitetit pa marrë licencën.

Grupi auditues përzgjedhi disa nga dosjet tek të cilat konstatoi se drejtoria nuk i ka mbajtur këto subjekte në dosje të veçanta ku të ishte i bashkëlidhur dokumentacioni i subjektit së bashku me mandatet e arkëtitimit. Bashkia Rrogozhinë e ka llogaritur tarifën e dhënies së licencës për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikantë në vlerën 200,000 lekë në vit dhe në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për “Për caktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” si dhe Paketës Fiskale 2020 ku janë të përcaktuara tarifatat 5 vjeçare. Paketa fiskale po ashtu nuk ka të specifikuar nivelin e gjobës për shkelje në rastet ku vazhdon aktiviteti pa pajisur me licencë.

**Rekomandimi 4.1:** Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **10,920,000 lekë**, e ardhur e munguar për Bashkinë Rrogozhinë si dhe ti mbaj këto subjekte në dosje të veçanta ku të bashkëlidh dokumentacionin e subjektit së bashku me mandatet e arkëtitimit dhe të krijoj regjistër të posaçëm.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Me Bashkinë Rrogozhinë janë lidhur kontrata me 21 subjekte për “Dhënie të fondit pyjor kombëtar në zonën pyjore Spille”, nga të cilët 18 subjekte për një

periudhë 10 vjeçare, 1 subjekt 5 vjeçar dhe 2 subjekte për një periudhë 25 vjeçare. Në bazë të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja më 28.03.2018, nr.1293 prot. Bashkia Rrogozhinë i ka nisur “Njoftim për shlyerjen e detyrimeve” 10 subjekteve të cilët nuk kanë paguar në afatin kohor deri më 20.04.2018, nga të cilët vetëm një subjekt është paraqitur për kryerjen e pagesës. Nga 22 kontrata të lidhura përgjatë viteve nga viti 2001 e në vazhdim, vetëm 11 subjekte vazhdojnë të kryejnë pagesën vjetore dhe të kenë kontratën me Bashkinë Rrogozhinë. Nga sipërfaqja totale 17314 ha në 6759 ha në total. Për këto kontrata të lidhura rezultojnë 2 debitorë të cilët nuk kanë paguar vlerën e prapambetur 214,158 lekë dhe në vitin 2020 debitor në vlerën 125,104 lekë. Në total vlera 339,262 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Rrogozhinë.

**Rekomandimi 5.1:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për ndjekjen dhe për mbledhjen e detyrimit në vlerën **339,262 lekë**, të ardhura të munguara në Bashkinë Rrogozhinë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Politikave Urbane i ka paraqitur më datë 11.11.2019, nr. 4870 prot. një relacion Këshillit Bashkiak Rrogozhinë “Për miratimin e tarifave të vendosura nga zyra e Drejtorisë së Politikave Urbane për shërbimet që do kryej ndaj qytetarëve. Tarifat për Akt-Kontrollet në faza të ndryshme të ndërtimit të objekteve të ushtruara nga personeli i Zyrës së Drejtorisë së Politikave Urbane. Në bazë të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 27/1 për Mbikëqyrjen e Punimeve, mbahen Akte Kontrolli kundrejt pagesave nga pika a në f: ngritje kantieri + muri rrethues, piketim objekti, përfundim i themeleve 0.00, përfundim i karabinasë, përfundim i fasadave dhe rifiniturave + sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje etj, përfundimi i sistemeve të jashtme, tarifat sipas llojit: për banesa, për biznes, për pallatet+ bregdet. Si dhe tarifat për marrjen e certifikatës së përdorimit të objekteve sipas llojit të ndërtimit. Grupi auditues analizoj 6 dosje në të cilat kishte mungesa të arkëtimit të fazave të ndryshme nga pika a në f, dëm ekonomik në vlerën 66,401 lekë dhe të ardhura të munguara në vlerën 381,400 lekë mungesë arkëtimi për certifikatën e përdorimit. Zyrës së Drejtorisë së Politikave Urbane. Në bazë të VKM nr.408, datë 13.05.2015 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit, neni 27/1 për Mbikëqyrjen e Punimeve, mbahen Akte Kontrolli kundrejt pagesave nga pika a në f: ngritje kantieri + muri rrethues, piketim objekti, përfundim i themeleve 0.00, përfundim i karabinasë, përfundim i fasadave dhe rifiniturave + sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje etj, përfundimi i sistemeve të jashtme, tarifat sipas llojit: për banesa, për biznes, për pallatet + bregdet. Si dhe tarifat për marrjen e certifikatës së përdorimit të objekteve sipas llojit të ndërtimit. Grupi auditues analizoj 6 dosje në të cilat kishte mungesa të arkëtimit të fazave të ndryshme nga pika “a” në “f”, dëm ekonomik në vlerën 66,401 lekë dhe të ardhura të munguara në vlerën 381,400 lekë mungesë arkëtimi për certifikatën e përdorimit.

**Rekomandimi 6.1:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për zbatimin me përpikmëri të ndjekjes së fazave: ngritje kantieri + muri rrethues, piketim objekti, përfundim i themeleve 0.00, përfundim i karabinasë, përfundim i fasadave dhe rifiniturave + sistemet e ndryshme si ngrohje, ftohje etj, përfundimi i sistemeve të jashtme, tarifat sipas llojit: për banesa, për biznes, për pallatet + bregdet, tarifat për marrjen e certifikatës së përdorimit të objekteve sipas llojit të ndërtimit dhe për mbledhjen e detyrimit duke ju referuar tarifave të vendosura nga zyra e Drejtorisë së Politikave Urbane, bazuar në VKM nr. 408, datë 13.05.2015 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit në vlerën **381,400 lekë**.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Rrogozhinë, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2022, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

**1.2 Rekomandim:** Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil si dhe të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2022 NJAB ka funksionuar me specialist të pa certifikuar në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr.83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për tu certifikuar [NJAB].

Për periudhën raportuese janë realizuar gjithsej 5 angazhime nga 9 angazhime të planifikuara, ose 22% e planit. Referuar Raporteve të Auditimit për çdo angazhim janë identifikuar gjithsej 17 parregullsi Për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar plani i auditimit, si pasojë e mungesës së punonjësve me eksperiencë dhe mungesës së njohurive të duhura për të realizuar 9 auditime brenda kësaj periudhe.

Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Rrogozhinë, nuk ka një vlerësim të riskut, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në*

*pikën 2.1, faqe 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke marrë masa për certifikimin e audituesve të pa certifikuar.

**2.2 Rekomandim:** Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

**2.3 Rekomandim:** Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Rrogozhinë

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin e programeve sipas prioriteteve vendore dhe institucionale, u konstatua se:

- Nuk janë ngritur dhe miratuar Ekipet e Menaxhimit të Programeve [EMP] për Bashkinë Rrogozhinë sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 i ndryshuar me atë nr. 108, datë 17.11.2016;

- Nuk është zhvilluar asnjë takim me komunitetin për prezantimin e PBA 2022-2024/ Projekt Buxheti Vjetor 2022 në komunitet dhe grupet e interesit, nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

- Në PBA 2022-2024 dhe Planin e Buxhetit Vjetor 2022, nuk janë paraqitur projektet e planifikuara për buxhetin me këto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në mos zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

- Nuk janë hartuar dhe miratuar në KB “Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Planit Vjetor të Buxhetit 2022 për Bashkinë Rrogozhinë dhe njësitë e varësisë” në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33;

- PBA 2022-2024 dhe Plani Vjetor i Buxhetit 2022 nuk janë hartuar/miratuar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

- Ndryshimet e bëra në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, nuk janë shoqëruar me argumentimet përkatëse lidhur me shpërndarjen apo lëvizjen e fondeve nga një artikull në tjetrin apo dhe më kryesorja nga një program në tjetrin, në moszbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

- Bashkia Rrogozhinë nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi programit 042 “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; për programet 052 “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve” dhe 056- “Ndërgjegjësimi mjedisor”, si programe që lidhen ngushtë me programin 051-“Menaxhimi i mbetjeve”; 061-“Shërbimi urban”; 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, 041-“Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi”; mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë për programet kyçe, tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e

funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Në Bashkinë Rrogozhinë, GMS dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që të paraqesin projektet e planifikuara për buxhetin me të gjitha specifikimet sipas kërkesave ligjore dhe EMP të secilit program, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare kryesisht atyre të mjedisit dhe pyjeve, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi mosrealizimin e planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore u konstatua se:

- Ka diferenca të dukshme midis treguesve të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Kështu nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie;

- Në mbyllje të vitit 2022, Bashkia Rrogozhinë nuk ka miratuar buxhetin faktik të vitit 2022 në KB, pasi nuk është hartuar asnjë relacion përfundimtar mbi zbatimin e buxhetit me një analizë të detajuar të treguesve buxhetorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44;

- Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës është miratuar në vlerën totale 26,962 mijë lekë. Në referim të ligjit nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. U konstatua se, vlera totale e tyre është 9,638 mijë lekë më pak ose rreth 74 % të vlerës që duhej të planifikohej si dhe për vitin 2022 ky fond nuk është përdorur;

- Referuar kriterëve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë: a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Rrogozhinë për vitin 2022 fondin për emergjencat civile e ka planifikuar në vlerën e 5,005 mijë lekë. Ndërkohë fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në moszbatim kjo të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1; Gjithashtu rezultoi se ky fond nuk është shpenzuar dhe është trashëguar për vitin pasardhës. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje jo racionale për përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi përmirësimit të situatës pas fatkeqësive natyrore, sesa masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore;

- Nga auditimi rezultoi niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit, ndërsa niveli i realizimit në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rënie nga viti 2020 në vitin 2021 dhe 2022; nga tabela e planifikimit të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta në vitin 2022, investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit, por në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 1,858 mijë lekë. Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi

bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandim:** Në Bashkinë Rrogozhinë, GMSdhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga Vendimet Gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime rezultoi se:

- Janë 21 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Rrogozhinë me 29 fatura në total të pa likuiduara “për investime”, vlera e të cilave është trashëguar në vitin 2023 dhe “për mallra e shërbime” 24 subjekte me 49 fatura në vlerë totale 82,373,713 lekë; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve kreditore, Bashkia Rrogozhinë nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimi” pika 13;

- Nga auditimi i PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se nuk është planifikuar fond për programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”; kjo ka sjellë që likuiditeti i detyrimeve të prapambetura nga ana e bashkisë Rrogozhinë në raport me vlerën e detyrimit, të jetë i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, kjo pasi shoqërohet me lindjen e detyrimeve të reja për shkak të pamundësisë për pagesa nga mungesa e fondeve.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** Kryetari e Bashkisë, GMSdhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare, u konstatua se:

- Nga analiza e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezultoi se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte inventarë të klasifikuara gabim, të cilat janë: me emërtimin makineri e pajisje në vlerën 74,063 lekë e cila duhej të ishte e regjistruar në llog. 214 “pajisje e makineri”; me emërtimin gjelbërim në vlerën 564,096 lekë duhej të ishte e regjistruar në llog. 212; me emërtimin riparim dyersh në vlerën 780,000 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; me emërtimin lulishte qendër –ura e mekeve në vlerën 790,922 lekë duhej të ishte regjistruar në llog. 212; në total vlera e regjistruar gabim në

llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” është 2,209,081 lekë. Pra llog. 213 është mbivlerësuar në vlerën 2,209,081 lekë, llog.212 nënvlerësuar me 2,135,018 lekë dhe llog. 214 nënvlerësuar me 74,063 lekë;

- Nga analiza e llog. 218 “*inventar ekonomik*” u konstatua se, kategoria “*pajisje kompjuterike*” nuk është ndarë si kategori më vete për të pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj dhe saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit;

- Nga analiza e llog. 401-408 rezulton se gjatë vitit 2022 janë 4 fatura të reja të pa likuiduara në kohë dhe që mbeten të paguhen për vitin pasardhës në vlerën totale 2,982,100 lekë, që iu përkasin 3 furnitorëve ekzistues. Ndërsa vlera e atyre të likuiduara është 12,817,950 lekë për 6 fatura që iu përkasin 6 furnitorëve. U konstatua një diferencë midis vlerës së llog. 401-408 “*furnitorë e llogari të lidhura me to*” pasqyruar në formatin 1 dhe analizës së kësaj llogarie dhe konkretisht: diferenca mes gjendjes në fillim në vlerën e 4,166,226 lekë dhe asaj në mbyllje të vitit me vlerën 5,002,307 lekë;

- Llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*” dhe llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,729,475 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,471,672 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 335,126 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 nuk është pasqyruar. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar. Nga ditari i pagesave rezultoi se vlera e përbashkët e këtyre 2 llogarive është 1,796,119 lekë dhe që përbën 11.2% të pagës bruto [1.7% sig. shënd + 9.5% sig. shoqërore të paguara nga punëdhënësi, u konstatua se vlera e llog. 436 nuk është pasqyruar më vete;

- Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Rrogozhinë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 49,023,066 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 53,650,528 lekë; kjo llogari përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. U konstatua një diferencë mes vlerës së pasqyruar në format 1 dhe asaj në analizën e llogarisë prej 3,891,800 lekë më shumë, vlerë e cila mungon në analizën e llogarisë 466;

- Llogaria 24 “*Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara*” në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 paraqitet me vlerën 0, ndërkohë që nga procedurat e inventarizimit janë vlerësuar të dëmtuara dhe për jashtë përdorimit inventare në vlerën 3,779,347.21 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 1,553,416.00 lekë për vitin 2022. Nga auditimi u konstatua se përderisa procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit nuk është realizuar për asnjë vit, këto vlera duhet të ishin pasqyruar në llog.24 “*Aktive të Qënd. të trupëzuara të dëmtuara*” në pasqyrat format 1 dhe format 7/a,b;

- Llogaria 600 “*paga dhe përfitime e punonjësve*” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 175,829,567 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga “*paga personeli i përhershëm*”, “*paga personel i përkohshëm*”, “*shpërblime*”, “*shpenzime të tjera për personelin*”. U konstatua se vlera e llogarisë 600 nuk është ndarë në 2 llogaritë respektive, për të pasqyruar vlerat përkatëse të llog. 6001 “*paga personeli përhershëm*” dhe llog. 6002 “*paga personel i përkohshëm*”.

- Nga analiza dhe verifikimet mbi plotësimin e pasqyrave sipas formateve standarde të miratuara nga MFE, u konstatua pasqyra format 8 “*numri i punonjësve dhe fondi i pagave*” është plotësuar pjesërisht, duke mos dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit.

- Nga auditimi u konstatua se për vitin ushtrimor 2022 janë dërguar në Degën e Thesarit Kavajë me shkresën nr. 1394 prot., datë 04.04.2023 dhe me nr. 150 prot., datë 04.04.2023 të Degës së



Thesarit Kavajë, në tejkallim të afatit ligjor, datë 31 Mars 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit Bashkia Rrogozhinë, të kryejë veprimet dhe sistemimet kontabël për diferencat, nënvlerësimet, mbivlerësimet në llogaritë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 466 “Mjete në ruajtje”, 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, 230-231, 218 “Inventar ekonomik”.

Të hartohen dhe të miratohen pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor brenda afateve ligjore datë 31 mars të vitit pasardhës; Të plotësohen me rigorozitet të gjitha pasqyrat sipas formateve të miratuara nga MFE.

Të ndiqen me vëmendje pagesat e aktiveve në proces, që me likuidimin e vlerës së kontratës, të merren në dorëzim objekti i investimit dhe të bëhen veprimet kontabël për mbylljen e llog. 230-231 dhe kontabilizimin e vlerës së tij në llogarinë përkatëse të AAGJM.

### *Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurën e Inventarizimit të aktiveve , u konstatua se:

- Urdhrat e Brendshëm të titullarit nuk kanë afat për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit, duke sjellë vonesa dhe zvarritje të procedurës në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 73, 74;

- Nga auditimi i praktikave dokumentare të procedurës së inventarizimit rezultoi se nga NjA, nuk janë zbatuar me rigorozitet hapat e procedurës, nga nxjerrja e Urdhrave të brendshëm të administratorëve të njërive për ngritjen e komisioneve, deri tek relacioni përmbyllës i procedurës; Këto parregullsi u konstatuan në NJA Kryevidh dhe Sinaballaj, në moszbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 81, 82;

- Në praktikat e Inventarizimit Fizik të aktiveve Procesverbalet e vlerësimit të aktiveve nuk kanë informacion të plotë mbi aktivet e cilësuara të dëmtuara: emërtimin e plotë, vitin e hyrjes, çmimin, sasia, vlera etj. Në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 95;

- Komisionet e krijuara me Urdhrin e Brendshëm të titullarit për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për asgjësim/ shkatërrim të tyre, nuk e kanë përfunduar këtë procedurë për vitin 2021 dhe për vitin 2022 në moszbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;

- Bashkia Rrogozhinë dhe GMS nuk kanë hartuar dhe miratuar një Rregullore për menaxhimin e aktiveve të njësisë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 6,7,8,9;

- Bashkia Rrogozhinë vazhdon të mos ketë hartuar dhe miratuar regjistrin e asetëve të njësisë, në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli IV pika 85/a,b,c .Kjo ka sjellë mos regjistrimin në vlera reale të AAGJM dhe mos pasqyrim te saktë të vlerave të llogarive 210, 211 212 dhe 215 në pasqyrat financiare të njësisë;

- Nga auditimi rezultoi se asetet e Bashkisë Rrogozhinë nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie, mos rivlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë mos pasqyrim të saktë të vlerave të tyre në llogaritë përkatëse 210, 211, 212, dhe 215. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandim:** Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Sekretari i Përgjithshëm në Bashkinë Rrogozhinë të marrin masa për të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjесimit të atyre të amortizuara; në krijimin e regjistrit të aktiveve sipas kërkesave të akteve ligjore/nënligjore në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.2 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.3 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me njësitë e tjera në strukturë të hartojnë regjistrin e aseteve të bashkisë, ku të identifikohen dhe të pasqyrohen gjithë të dhënat konform udhëzimeve ligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.4 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, u konstatua se:

- Gjatë hartimit dhe miratimit të strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Rrogozhinë rezultoi se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”;

- Plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil është miratuar në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar neni 18, por në tejkallim të afateve, në moszbatim të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 11;

- Nga auditimi i informacionit dokumentar të vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore për punonjësit me kontratë të përkohshme (bashkia me NjA) për periudhën janar-dhjetor e pasqyruar dhe në tabelë, rezultoi se punësimet e kësaj kategorie janë kryesisht në Drejtorinë e shërbimeve publike në pozicionet: sanitare, mirëmbajtje, punëtor krahu etj. U konstatua se në Strukturën organizative dhe planin vjetor të punësimeve miratuar me VKB, nuk është pasqyruar edhe numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të planifikuar për vitin 2022 si dhe sektorët /drejtoritë që u nevojitet ky kontigjent, në moszbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika c, neni 54 pika dh, neni 64 pika j;

- Referuar Ligjit 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, neni 7, pika 5 “Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000

banorë”; pika 6 “Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se **14** zjarrfikës, personel profesionist”, nga auditimi rezulton se njësia e MZSH-së në Bashkinë Rrogozhinë, nuk i plotëson kriteret përsa i përket numrit të personelit profesionist; nisur nga numri i banorëve, Bashkia Rrogozhinë hyn në kategorinë nga [20000-50000] banorë, duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë nga 19 deri në 23 zjarrfikës personel profesionist;

- Lidhur me formimin arsimor e profesional/ lloji diplomës e personelit përbërës të Njesisë së IVMT-së, rezulton se kryeinspektori nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme”, gjë që riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr.894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njesisë vendore”;

- Nga të dhënat e pasqyrës së pagave, rezulton se fondi i pagave në Bashkinë Rrogozhinë zë 20.6% të buxhetit. Nga auditimi mbi planifikimin e fondit të pagave, u konstatohet se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve me “status civil”; gjithashtu nuk zbatohet as VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore” për punonjësit me “kod pune”;

- Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në dosjet e personelit nuk ishin bërë pjesë e tyre: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; vërtetimi i prokurorisë dhe gjykatës, formulari i vetëdeklarimit, përshkrimi i punës;

- Dosjet e punonjësve të larguar nuk ishin bërë pjesë e tyre praktika e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe Komunikimit, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Rrogozhinë të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative konform funksioneve që i atribuon ligji, për rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022 u konstatuan mangësi që lidhen me zhvillimin e tyre nga komisionet përkatëse.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit për blerjet e vogla të testuara për vitet 2020 – 2022, mungojnë urdhrat e titullarit për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit.

-Në të gjitha procedurat e testuara, personat që kanë hartuar fondin limit, nuk kanë argumentuar hartimin e këtij fondi.

-Në mënyrë të përhapur, Komisioni për Blerjet e Vogla, nuk dokumentohen me procesverbal tërheqja ose mos paraqitja e operatorëve ekonomikë dhe kalimi tek OE të renditur pas tyre.

-Në disa raste kemi mungesë të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë me të cilët është lidhur kontrata.

-Në 1 procedurë me objekt blerje mallrash, rezulton se natyra e produkteve nuk është e njëjtë ose e ngjashme (produkte ushqimore/ aparat tensioni), dhe si e tillë duhet të bëheshin procedura të ndryshme.

-Në procedurat e vitit 2020, në mënyrë të përhapur mungon fletë hyrja e mallit të bërë në magazinë, duke mos u dokumentuar marrja e mallrave në dorëzim.

-Në disa nga procedurat e audituara për vitin 2022, rezulton se në urdhrin e prokurimit është vendosur vlera e fondit limit.

-Për vitin 2022, në 3 raste është konstatuar copëzim fondesh, pasi procedurat janë të natyrës së njëjtë/ ngjashme, dhe si të tilla nuk duheshin copëzuar në dy apo më shumë procedura, por të mbahej një procedurë prokurimi sipas vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

-Në 11 raste të testuara, rezulton se likuidimi i faturave të lëshuara nga operatorët ekonomikë, është kryer përtej afatit 30 ditë, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandim:** Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me urdhrat përkatës për përlllogaritjen e fondit limit pa copëzuar fondet, duke evidentuar mënyrën e ndjekur sipas rregullave të prokurimit publik duke dokumentuar me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë.

*Në vijimësi*

**9.2 Rekomandim:** Komisioni për Blerjet e Vogla, të dokumentojë me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë. Të administrohen dokumentet e OE me të cilët lidhet kontrata, dhe në çdo rast të shoqërohet me fletë hyrjen e mallit në magazinë, të firmosur nga personi përgjegjës.

*Në vijimësi*

**9.3 Rekomandim:** Të evitohet copëzimi i fondeve nga AK. Procedurat për mallra/ shërbime me objekt të njëjtë ose të ngjashëm, të kryhen nëpërmjet procedurave në përputhje me vlerën e fondit përkatës kur ajo e kalon vlerën 1,000,000 lekë, dhe jo të copëzohet në disa të tilla.

*Në vijimësi*

**9.4 Rekomandim:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 9 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në *e-leje*, i kanë miratuar ato pa përmbushur dokumentacionin e rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me treguesit distancave ndërmjet ndërtimeve dhe pronave, në 1 rast konstatohet mos respektim i KSHT-së dhe intensitetit të ndërtimit. Në mënyrë të përhapur nga punonjësit e përfshirë në procesin e miratimit të lejeve, nuk është kërkuar Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës për objektet mbi 50m<sup>2</sup>. Janë miratuar leje ndërtimi në toka bujqësore me materiale të përhershme. Në 1 rast konstatohet përlllogaritje e gabuar e sipërfaqeve totale të objektit. Në 2 raste planvendosjet e paraqitura nuk paraqesin gjendjen reale duke mos vendosur objektet kufitare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e

rregullores së zhvillimit të territorit” neni 9 “Leja e zhvillimit”, neni 15, pika 1 germa g, pika 1/1.v “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimit”, neni 34 “Distancat minimale midis ndërtimeve”, neni 35 “distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”, neni 38 pika 2 “Intensiteti i ndërtimit”, neni 39 “Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim”, Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit” neni 46 pika 1 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, Ligji nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, neni 4 pika 5, Ligji nr. 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” neni 14 pika 4, Plani i Përgjithshëm Vendor i miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.10.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit neni 83. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 183-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit Urban në procesin e miratimit për lejet e ndërtimit, të respektojë rregullat e zhvillimit të territorit kjo për të mundësuar trajtim të barabartë të parametrave teknik të zhvillimit, duke mos cenuar të drejtat e zhvillimit të subjekteve tjera sipas njësive strukturore.

*Në vijimësi*

**10.2 Rekomandim:** Në mungesë të PDV-ve, të miratohen lejet e ndërtimit vetëm kur subjekti zhvillues të jetë pajisur me lejen e zhvillimit.

*Në vijimësi*

**10.3 Rekomandim:** Për të gjitha aplikimet për leje ndërtimi mbi 50 m<sup>2</sup>, të kërkohet në çdo rast Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për veprimtarinë e Inspektoratit të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, rezultoi se stafi i rekrutuar përfshirë Kryeinspektorin nuk kanë arsimin e duhur, duke mos dhënë garanci për një kontroll cilësor dhe efektiv të territorit. Konstatohet mos aplikim i masave administrative për kundërvajtjet e kryera, duke mos aplikuar vendimet për gjoba, pezullim dhe prishje të ndërtimeve pa leje. Mungojnë aktet e kontrollit për ndërtimet që kryhen me leje ndërtimi. Praktikrat e konstatuara nuk administrohen me dosje përkatëse si dhe nuk disponohen materiale provuese si fotografitë për evidentimin e situatave ndërtimore. Mungon korrespondenca 3 mujore me IKMT. Mungojnë planet e punës mujore dhe vjetore. Lidhur me gjobat e mbajtura, nuk është marrë asnjë masë për të bërë të mundur arkëtimin e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, ç, d, dh, f) neni 11, 12; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Rrogozhinë, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 190-194 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11.2 Rekomandim:** IMT Bashkia Rrogozhinë, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në

fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11.3 Rekomandim:** IMT Bashkia Rrogozhinë, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve. Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11.4 Rekomandim:** IMT Bashkia Rrogozhinë, të disponojë të gjitha praktikat në dosje të veçanta për secilin konstatim, duke u dokumentuar krahas akteve të mbajtura, edhe fotografitë për situatat e konstatuara të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11.5 Rekomandim:** IMT Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Taksave, të bashkërendojnë punën për të mundësuar arkëtimin e gjobave të nxjerra.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **12. Gjetje nga auditimi:**

### Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Nga auditimi u konstatua se, në strukturën organizative të DAZHE/ Bashkia Rrogozhinë, janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit, si ajo e drejtorit dhe e 3 specialistëve, që ndonëse me profilin e duhur arsimor, nuk ka rezultuar me zgjidhjen e problematikave të trashëguara ndër vite, uljen e borxhit tatimor të njësisë; mungesa e një specialisti IT në strukturën e DAZHE ka sjellë mungesën e krijimit të një regjistri të plotë elektronik të subjekteve taksapaguese si dhe në mos evidentimin në kohë reale të subjekteve (ose vonesa në evidentimin e tyre), mos llogaritjen e detyrimeve fiskale për këto mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave, kjo në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot., datë 07.02.2018;

### Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtoria e të Ardhurave, duke mos patur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Kavajë (ASHKK);

- Drejtoria e të ardhurave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Rrogozhinë, nuk ka dërguar njoftim detyrimi për këto familje, baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Nga ana e DAZHE na u komunikua se UK Rrogozhinë nuk pranon bashkëpunim për të marrë mbi vete rolin e agentit tatimor, kjo për shkak të problemeve të tyre të akumuluar. Në këto kushte deri në fund të vitit 2022 Akt rakordimet me agjentët tatimorë UK Rrogozhinë dhe ASHKDVK rezultojnë të mos jenë mbajtur;

- Ndërsa janë bërë akt rakordime me DRSHTRR në modelin e një proces-verbali, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk është konfirmuar baza e të dhënave statistikore mbi të cilën janë

bërë llogaritjet dhe është vlerësuar niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime të cilat janë në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve;

Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 5311 prot., datë 06.12.2019 (e cila nuk është përditësuar), nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

- Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ZVRPP Kavajë, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, *nuk janë kryer*;

- Renta Minerare nga Agjentët Tatimorë “Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Durrës”. Në zbatim të të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, Neni 4 “Niveli i Taksave Kombëtare”, pika 4, të Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008, dhe UMF Nr. 12, Dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, sipas shtojcës 2 të këtij ligji, niveli i Rentës Minerare varion nga 4 deri në 10%, sipas llojit të mineralit. Rakordimet me Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Durrës, për Rentën Minerare, *nuk janë kryer*. Nga administrata tatimore e Bashkisë Rrogozhinë, nuk është ushtruar kujdesi i duhur për të arkëtuar të ardhurat nga veprimtaria minerare e dy subjekteve debitorë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik/Bashkia Rrogozhinë të marrë masat për krijimin e një regjistri elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12.2 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12.3 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Rrogozhinë nga taksat që mblidhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Rrogozhinë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Rrogozhinë rezultoi se:

- Nga 15 masa organizative të lëna janë zbatuar plotësisht 3 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 8 masa.

- Nuk është zbatuar masa për shpërblim dëmi në vlerën 66,401 lekë.

- Nga 6 masa për përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e 3E janë zbatuar pjesërisht 3 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar ende 2 masa.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 191-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandim:** Kontrolli i Lartë i Shtetit inkurajon subjektin Bashkia Rrogozhinë që krahas punës që ka bërë për zbatimin e rekomandimeve, të vijojë procedurat administrative e ligjore për zbatimin e masave të pazbatuara dhe në proces zbatimin deri në mbylljen e plotë të tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **788,183 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, me vlerë të kontratës 109,882,338 (njëqind e tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e tetë) lekë me Tvsh, me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, fituar nga BOE “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **93,600 lekë pa Tvsh**, në zërat e punimeve: “Shtresë bindër me granil gurrkave, 6cm me makineri”, “Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4cm me makineri”, “Puseta b/a shiu 40x60, h=100cm, me kapak gize”, “F.V.Shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm”, “F.V. Krah shtylle KRH-MSI 1500/1500/10”, “Ndriçues Led 94Ë”, “F.V Morseteri shtylle 3P=sig, 16A+Kapak”, “F.V Elektroda tokëzimi”, “F.V. Puseta tokëzimi 40x40x40, kapak të fortë RIC1084+1064”, “F.V Tabela rrugore rë ndryshme D=90cm”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 179-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **93,600 lekë pa Tvsh** nga BOE “B. B” Shpk & “B. N” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia



Rrogozhinë, me vlerë të kontratës 43,585,255 (*dyzetë e tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë lekë* pa Tvsh, me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021, fituar nga BOE “B.” Shpk, & “Sh.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **694,583 lekë pa Tvsh**, në zërat e punimeve: “F V dritare d/alumini plastike me dopioxham”, “F V Vetrare d/alumini plastike me dopioxham”, “Ulluk shkarkimi vertikal me baker Ø 120”, “F.V Elektroda tokëzimi të xinguara 50x3mm, L=150cm”, “Përcjellës tokëzimi bakri, Cu, S=50mm<sup>2</sup> i zhveshur”, “Kapikorta bakri 1x50mm<sup>2</sup>”, “F.V Pusetë elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm”, “Përcjellës shirit zinku tokëzimi, Zn =30x3mm”, “Shtizë rrufepritëse në çati L=38 D=166mm së bashku me aksesoret e fiksimit”, “Fiksues të zinkuar shirit-shirit 30x3mm” e “Gërmim e mbushje dhe me krah për kanale kategoria IV, h=1.5 m”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 179-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **694,583 lekë pa Tvsh** nga BOE “B.” Shpk, & “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021, me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

#### Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, rezultoi se 2 subjekte:

- Subjekti “P.M.” me kontratën e lidhur në vitin 2013 dhe vlerën e kontratës 38,500 lekë me afat 10 vjeçar, rezultoi se deri më 03.02.2023 nuk ka kryer pagesë pra është debitor në vlerë të plotë 38,500 lekë;

- Subjekti “S.Gj.” me kontratën e lidhur në fund të vitit 2021 dhe vlerën e kontratës 2,475,500 lekë me afat 10 vjeçar, rezultoi se deri më 03.02.2023 nuk ka kryer pagesë, pra është debitor në vlerë të plotë 2,475,500 lekë. Të dyja këto subjekte janë njoftuar me shkresat nr. 490 prot., datë 03.02.2023 dhe nr. 489 prot., datë 03.02.2023. U konstatua se nga Drejtoria e Bujqësisë e vetmja masë për vjeljen e detyrimeve është njoftimi zyrtar i Subjekteve debitore, ndonëse Subjekti “P.M.” i përfundon afati në dt.17.07.2023 dhe ka një detyrim me një vlerë relativisht të vogël prej 38,500 lekë;

#### Detyrimet e familjarëve

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore vlera debitore për abonentët familjarë është në vlerën **174,195 mijë lekë**, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimor janë në vlerën **25,557 mijë lekë; për vitin 2022** sipas rakordimit me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik detyrimi (për taksa ndërtese, pastrim, gjelbërim, ndriçim) është **19,973 mijë lekë**, ndërsa vlera progresive e detyrimit është **227,045 mijë lekë**, Vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar;

- Nga informacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ka një rritje në 3 vitet e fundit të numrit të debitorëve që nuk kanë paguar “taksën e ndërtesës” me 217 nga 2020 në 2021 dhe me 778 nga 2021 në 2022. Kjo ka ardhur si rezultat i veprimtarisë së pamjaftueshme të informimit dhe të sensibilizimit publik mbi pagesën e “taksës së ndërtesës” nga strukturat përgjegjëse të bashkisë si edhe nga moszbatimi me rigorozitet i kërkesave të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar, neni 5; Kjo vihet re edhe në informacionin e paplotë të dhënë nga DAZHE/Bashkia Rrogozhinë mbi taksat dhe tarifat vendore të miratuara me VKB në territorin e saj. Aktiviteti i saj mjaftohet vetëm me njoftime të debitorëve, pa analizuar konfirmimin ose jo nga ana e tyre, duke çuar në mos marrjen e masave shtrënguese për të siguruar vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe detyrimin vjetor në kohë nga ana tjetër, për të ulur edhe numrin e debitorëve edhe vlerën e detyrimit të akumuluar.

#### Taksa e tokës bujqësore

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Rrogozhinë nuk disponon të dhëna mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 7501 “Për tokën” çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave për familje në NjA Kryeviidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj dhe Rrogozhinë, është **10,060 ha** e ndarë kjo sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe çmimit për bonitet të miratuara në paketat fiskale me VKB nr. 70 datë 22.12.2021 (e rezultuar kjo edhe në paketën fiskale për vitin 2021), planifikimi i kësaj takse për vitin ushtrimor 2022 duhet të ishte në vlerën **35,734 mijë lekë** dhe jo në vlerën **25,942 mijë lekë** (sipas tabelës të plan/fakt të ardhurash), në fakt nga DAZHE Bashkia Rrogozhinë është realizuar në vlerën **21,540 mijë lekë**. Pra për dy vite radhazi planifikimi për të ardhurat nga toka bujqësore rezultoi në vlerë më të vogël prej 9,792 mijë lekë nga vlera e taksës që duhej të ishte llogaritur referuar kjo paketës fiskale 2021/2022 si dhe me trend në rënie nga viti 2021 në vitin 2022. Pra vlera 9,792 mijë lekë është vlerë e pa përfshirë në vlerën e planifikuar të taksës së tokës bujqësore dhe konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

- Nga auditimi rezultoi gjithashtu se, detyrimi i pa vjelë nga toka bujqësore deri në 31.12.2022, realizimi i vjeljes së taksës për vitin 2022 është (-) 4,402,327 lekë më pak nga planifikimi ose në masën 83%; Ndërsa deri në 31.12.2022 vlera e akumuluar e saj është për 7870 familjet debitore prej 9,623,461 lekë;

#### Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave

Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Rrogozhinë ndonëse ka 45 regjistrime të bizneseve të reja (të përhershme dhe sezonale), kjo është shoqëruar edhe me mbylljen (çregjistrimin e përhershëm) të aktivitetit të 9 bizneseve (48 janë sezonale), duke e çuar në 547 numrin e bizneseve aktive në fund të vitit 2022; gjithashtu rezulton se ka trend në rënie numri i biznesit të vogël, kurse për biznesin e madh është trend në rritje. Për këtë nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, Koordinatori i Riskut, GMS, DAZHE, DLBNJ nuk kanë bërë asnjë analizë mbi risqet që ndikojnë dhe që kanë krijuar këtë situatë, me qëllim marrjen e masave për hartimin e planeve periodikë e vjetorë, për minimizimin e rasteve të mbylljes së aktivitetit të subjekteve tatimpaguese si dhe për të mbajtur në nivel të kënaqshëm të ardhurat që vilen nga aktiviteti i tyre; Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara në regjistra, sipas aktiviteteve, njoftimet mbi detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që u kërkuan për auditim, u konstatua se informacionet e vëna në dispozicion, nuk paraqesnin të dhëna të analizuarra për çdo zë tatimor që DAZHE/Bashkia Rrogozhinë aplikon;

#### Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik/Bashkia Rrogozhinë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje, rezultoi se Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m<sup>2</sup> për Bashkinë Rrogozhinë. Për hartimin e regjistrit të përfituesve nga legalizimet u konstatua se nuk kryhet Akt Rakordimi mes Bashkisë Rrogozhinë/DAZHE dhe ASHKDV Kavajë, por Bashkia Rrogozhinë mjaftohet vetëm me informacionin mujor shkresor që i nis zyrtarisht ASHK-DV Kavajë. Në disa raste ky informacion ka qenë jo i plotë dhe kjo ka sjellë pamundësi të llogaritjes së taksës;

- Drejtoria e Planifikimit Urban nuk ka krijuar nga ana e saj asnjë regjistër elektronik sipas kritereve procedurale dhe akteve ligjore/nënligjore mbi të cilat ajo ushtron funksionet e saj, ku të ketë të përcaktuar (emër mbiemër i subjektit, sipërfaqen e ndërtimit, funksionin e banimit/ekonomik- verifikim nëse për të dyja ka të njëjtin nivel takse, detyrimin etj), përveç se listën e qytetarëve të cilët e kanë paguar detyrimin e tyre me shumën e paguar sipas viteve. Në total për periudhën 2015- 2022 iu është miratuar leja e legalizimit 1621 subjekteve, nga të cilat 1018 subjekte rezultuan debitorë në vlerën 38,580,035 lekë dhe 13 subjekte me vlerën e detyrimit 439,493 lekë, janë dërguar gabimisht në Bashkinë Rrogozhinë, pasi i përkasin Bashkisë Kavajë. Nga auditimi rezultoi se, nga DPU Bashkia Rrogozhinë nuk iu është dërguar zyrtarisht informacioni dokumentar për 13 subjektet të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Kavajë, duke i lënë jashtë listës së debitorëve të saj. Deri në 31.12.2022 janë 603 subjekte që kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 26,778,170 lekë dhe 1018 debitorë ndaj Bashkisë Rrogozhinë që nuk e kanë shlyer detyrimin;

- U konstatua gjithashtu se nga këta, 57 debitorëve nuk iu është llogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë, pasi informacioni i ardhur nga ASHK- DV Kavajë nuk është i plotë me të gjithë parametrat e domosdoshëm mbi të cilët llogaritet taksa. Kështu, vlera e taksës së papaguar e 974 debitorëve është 39,019,528 lekë. Diferenca e papaguar për periudhën 2015- 2022 është më shumë se 38,580,035 lekë për 1018 subjekte dhe konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Rrogozhinë. Për vitin 2022 rezulton të jenë arkëtuar 4,843,612 lekë për 100 subjekte; Ndërsa për 57 subjektet të cilëve nuk i është përcaktuar sipërfaqja, grupi auditues nuk ka mundur të llogarisë taksën e ndikimit në infrastrukturë;

- DPU/Bashkia Rrogozhinë, nuk ka plotësuar paraprakisht regjistrin e vet elektronik me të dhënat që duhet duke sjellë mungesën e informacionit paraprak mbi detyrimin e secilit subjekt për taksën e ndikimit në infrastrukturë;

- U konstatua gjithashtu se Bashkia Rrogozhinë për periudhën ushtrimore nuk ka njoftuar subjektet debitorë, nuk i është drejtuar zyrtarisht ASHKDV Kavajë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës, pa bërë më parë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Rrogozhinë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1;

#### Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore

Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2020 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 1226 subjekte në vlerën totale të detyrimit 29,145,411 lekë;

për vitin 2021 janë 1357 subjekte me vlerën totale të detyrimit 33,793,835 lekë; për vitin 2022 janë 12918 debitorë në vlerën 26,643,829 lekë dhe me vlerë progresive deri më 31.12.2022 prej 154,675,658 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë;

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB konstatohet se në bashkinë Rrogozhinë gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 22 subjekte. Nga auditimi rezulton se Bashkia Rrogozhinë sipas Akt Konstatimin të datës 02.06.2020 ka verifikuar subjektet që tregtojnë hidrokarbure në terren (me foto të bashkangjitura) dhe që rezultojnë aktiv në QKB,

Në total rezultojnë 22 subjekte, ku nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nga Bashkia Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2022 ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua gjithashtu se vetëm 3 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar rregullisht detyrimet në vlerën e 100,000 lekë secila dhe 300,000 lekë në total; 5 subjekte në vlerën **4,100,000** lekë të cilat nuk kanë paguar detyrimet si dhe kanë qenë të pa pajisura me autorizim, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë; ndërsa 11 subjekte janë pajisur me autorizim 1 vjeçar të cilët kanë paguar detyrimet në total në vlerën 2,500,000 lekë, pajisja me autorizim për afatin 1 vjeçar është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15;

- Lidhur me 5 subjektet të cilat janë konstatuar me aktivitet të mbyllur në terren, nga ana e DAZHE na u bë me dije se gjatë vitit 2022 i është dërguar për bllokim të llogarive bankare të subjekteve debitore, gjithë bankave të nivelit të dytë dhe së fundmi rikërkuar me shkresën nr. 599 prot., datë 13.02.2023 ndaj subjektit debitor “A.M.”. Theksojmë se nga ana e DAZHE/Bashkia Rrogozhinë kjo është e vetmja masë që është marrë ndaj këtyre subjekteve debitore;

Të ardhura nga gjobat e IMTV

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Rrogozhinë janë vendosur 7 gjoba me vlerën në total 3,050,000 lekë; ndërsa bashkë me ato të vendosura në periudhat e mëparshme janë 15 gjoba në vlerën **5,700,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që dhe nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre. Nga informacioni verbal i komunikuar, rezultoi se kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit midis IMTV dhe Drejtorisë Ligjore, për ndjekjen e hapave administrativë e ligjorë me qëllim arkëtimin e vlerës së gjobave nga ana e debitorit, duke mos e lënë në likuidimin vullnetar (si edhe na u komunikua nga bashkia Rrogozhinë), duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 5,700,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik /Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët

për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore progresive në vlerën totale 343,141 mijë lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.
- Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me NjA, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.2 Rekomandim:** Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 38,580,035 lekë dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Kavajë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.3 Rekomandim:** DAZHE në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 5 subjekteve për arkëtimin e vlerës 4,100,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.4 Rekomandim:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutivë, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën totale 5,700,000 lekë.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit për zhvilluesin R.K. për objektin “Objekt banimi 1 Kat dhe 5 Kate dhe 1 Kat nëntokë, me funksion banimi dhe shërbimi, Spille “Bashkia Rrogozhinë”, rezulton se përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është bërë e saktë. Sipas përlllogaritjes së zyrës së financës, R. K duhet të paguaj 2,218,038 lekë, përlllogaritje e cila është bazuar në sipërfaqen totale të ndërtimit prej 2302.9 m<sup>2</sup> x 32105 lekë çmimi mesatar sipas Entit Kombëtar të Banesave x 3% TNI e përcaktuar në paketën fiskale = 2,218,038 lekë, ndërkohë në preventivin e paraqitur, vlera e investimit është 88,804,724 lekë x 3% = 2,664,141 lekë. Në mënyrë të paargumentuar, është ngarkuar një preventiv tjetër me vlerë me të vogël, e cila dukshëm ka ulur zërat e punimeve, ndërkohë nuk është reflektuar me ndryshime të projektit. Krahas uljes së volumeve të përcaktuara në preventivin fillestar, mungojnë edhe zëra të tjerë që duhet të parashikoheshin në preventiv si p.sh, parashikohet prishje e objektit 1 kat, zë i cili nuk është parashikuar, mungojnë zërat e transportit. Njëkohësisht, në preventiv është parashikuar që fasada lindore e objektit të jetë edhe me tulla xhami, fakt i cili nuk është parashikuar në preventiv. Sa më sipër, vendimmarrja e strukturave të ngarkuara për miratimin e lejes nuk ka evidentuar apo argumentuar mangësitë e mësipërme, duke miratuar lejen në kundërshtim me legjislacionin përkatës, si dhe duke shmangur

minimalisht detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 446,103 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 183-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **446,103 lekë** ndaj subjektit R.K. për taksën e ndikimit në infrastrukturë e cila është përlogaritur gabim nga personat përgjegjës.

*Menjëherë*

## **D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimin e 8 procedurave me vlerë të fondit limit **631,562 mijë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP në 8 procedura me vlerë kontrate **627,332 mijë lekë** ose 99 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin pa eficientë të fondeve publike për vlerën **627,332 mijë lekë, respektivisht:**

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rrugëve të Lagjes sipër Stacionit të Trenit, në Qytetin e Rrogozhinës, Faza e Parë”, viti 2020, me fond limit 91,666 mijë lekë, me fitues BOE “B.-B” Shpk & “B.N.” Shpk & “M.” Shpk & “P.V.” Shpk, me vlerë të ofertës 91,568 mijë lekë pa Tvsh, ku ka rezultuar aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, dhe KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike për vlerën **91,568 mijë lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Rrogozhinë” Viti 2020, me fond limit 6,500 mijë lekë, me fitues OE “G. C. G.” Shpk me marzh fitimi 14%, ku ka rezultuar se, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike për vlerën **6,500 mijë lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion objekti në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë”, Bashkia Rrogozhinë. Viti 2020, me fond limit 10,607 mijë lekë, me fitues OE “B.” Shpk me vlerë të ofertës 10,399 mijë lekë pa Tvsh, ku ka rezultuar aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, dhe KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike për vlerën **10,399 mijë lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “ReH.timi i kanaleve sekondare Peqin-Kavajë, Faza e Tretë”, viti 2020, me fond limit 81,891 mijë lekë, me fitues BOE “E.S” Shpk & “B.-B” Shpk & “B. N” Shpk, me vlerë të ofertës 81,402 mijë lekë pa Tvsh, ku ka rezultuar aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, dhe KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike për vlerën **81,402 mijë lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Pastrim kanali kullues Bashkia Rrogozhinë” Viti 2020, me fond limit 4,099 mijë lekë pa Tvsh, me fitues BOE “Ll.” Shpk & “B.” Shpk me ofertë 4,080 mijë lekë, ku ka rezultuar aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, dhe KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën **4,080 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave, Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Nj. A, Lekaj, Bashkia Rrogozhinë”. Viti 2020, me fond limit 249,541 mijë lekë, me fitues BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk, me ofertë 249,435 mijë lekë pa Tvsh, ku ka rezultuar aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, dhe KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën **249,435 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, lagjia e re Gosë” Bashkia Rrogozhinë, me fond limit 24,570 mijë lekë, me fitues BOE “M.” Shpk & “E.” Shpk, me ofertë 24,308 mijë lekë, ku ka rezultuar aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën **24,308 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Ujësjellësit Gosë, Bashkia Rrogozhinë”, viti 2021, me fond limit 161,244 mijë lekë, me fitues BOE “B.-B” Shpk & “P.V.” Shpk & “D.C.” Shpk me ofertë 159,636 mijë lekë, ku ka rezultuar se aplikimi i kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën **159,636 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 115-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, dhe nenin 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3.

**1.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masat për hartimin e kriterëve teknike në dokumentet e tenderit, të argumentuara dhe në përputhje me objektin e kontratës dhe të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike për vlerën **627,332 lekë pa Tvsh**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **E. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”,

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 germa g, neni 15, pika 4, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, kontratën individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, në proporcion me shkeljen, për punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, në proporcion me shkeljen, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

**1. Z. G.Gj**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Urban për veprimet dhe mos veprimet në arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve të reja, si dhe për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

**2. Z. A. K.**, me detyrë Përgjegjës Sektori i Biznesit dhe Kontabilizimit e të Ardhurave për mos marrjen e masave për të ulur vlerën e borxhit tatimor.

**3. Z. O. T.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për mos marrjen e masave për të ulur vlerën e borxhit tatimor dhe mos pagesën e detyrimeve për autorizim nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë.

**4. Znj. M. Th**, me detyrë Përgjegjëse i Sektorit e taksave dhe tarifa familjare për mos marrjen e masave për të ulur vlerën e borxhit tatimor.

**5. Z. D.D.**, me detyrë Kryeinspektor i IMTV për veprime dhe mos veprime lidhur me pagesën e gjobave të vendosura nga IMTV Rrogozhinë si dhe problematikat e konstatuara në zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e territorit .

**6. Z. H.P.**, në cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.

**7. Z. F.M.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

**8. Z. O.D.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

**9. Z. E.S.**, në cilësinë e Kryetarit të KVO për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

**10. Z. A.M.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

**11. Z. I.B.**, me detyrë Specialist për veprimet dhe mos veprimet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

### **Për punonjësit e larguar**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion si rezultat nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore:

**1. Z. A.S.**, me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar, si dhe për shkeljet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.



2. **Z. E.H.**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.
3. **Z. S. L.**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.
4. **Z. J.M.**, në cilësinë e Kryetarit të KVO për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.
5. **Z. S.B.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.
6. **Z. G.Gj.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.
7. **Z. Z.P.**, me detyrë Kontrollues për veprimet dhe mos veprimet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
8. **Zj. L.S.**, me detyrë Specialist për veprimet dhe mos veprimet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

#### **Njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Rrogozhinë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**